

KONTROLI I KUSHTETUTSHMËRISË SË LIGJIT NË SHQIPËRI: QASJE KRAHASIMORE

Irisi Topalli

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
“Shkenca Juridike”, me profil “E Drejtë Publike”, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Asoc. Dr. Sokol Sadushi

Numri i fjalëve: 54.020

Tiranë, Nëntor 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Me anë të së cilës deklaroj se ky punim është punë origjinale e imja!

Irisi Topalli

ABSTRAKT

“ Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri: qasje krahasimore ” është tema e përzgjedhur për trajtim në këtë punim doktorat. Arsyet janë të shumta, qoftë në drejtim të rëndësisë që drejtësia kushtetuese në terësi dhe kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në veçanti përbën dhe paraqet, por nga ana tjetër edhe për shkak të problematikës që ky kontroll mund të paraqesë. Të dy këto aspekte, qoftë rëndësia dhe problematika, janë të ndërlidhura ngusht me njëra – tjetrën, aq më tepër nëse nënvizojmë, se në thelb të kontrollit të kushtetutshmërisë, përmes garantimit dhe respektimit të Kushtetutës, si akti më i lartë në shtet, qëndron garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, qëndron garantimi i shtetit të së drejtës! Prandaj ky kërkim shkencor, do të marrë përsipër t’i kthejë përgjigje pyetjes: Sa efikas është sistemi shqiptar i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit; a është më i përshtatshmi për vendin tonë - në drejtim të cilave karakteristika mund të bëhen ndryshimet përkatëse duke i adoptuar ato nga sistemi tjetër, ai amerikan apo qoftë edhe duke adoptuar karakteristika të tjera nga vetë sistemi evropian, por të marra këto nga modelet e ndryshme që përfaqësohen brenda këtij sistemi? Në fokus të këtij punimi, do të jetë analiza e modaliteteve të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri, me qëllim “përsosjen” e sistemit tonë të kontrollit. Gjatë kësaj analize, duke u bazuar në vendet që përfaqësojnë në mënyrë më tipike modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, të sistemeve të lartpërmendura, do të analizohen mundësitë e adoptimit, qoftë edhe vetëm në mënyrë të pjesshme, të atyre karakteristikave të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve, të cilat nuk janë prezent aktualisht sot në vendin tonë, pasi problemi që shtrihet në këtë rast, përbën njëkohësisht edhe pyetjen kërkimore të këtij hulumtimi. Metodologjia bazë është ajo cilësore.

Fjalët kyçe: kontrolli i kushtetutshmërisë, ligj, abstrakt, konkret, incidental, a priori, a posteriori

ABSTRACT

"Control of the constitutionality of the law in Albania: a comparative approach" is the theme selected for this paper doctoral treatment. The reasons are many, both in terms of the importance of constitutional justice on the whole, and control of the constitutionality of the law in particular makes and presents, but on the other hand because of the problems that this control can provide. Both these aspects, whether the importance and problems are closely related to one - another, especially if stress, that basically control of constitutionality, through guarantee and respect of the Constitution as the highest act in the country, stands guaranteeing rights and fundamental freedoms, stands guaranteeing the rule of law! Therefore this research, will take to reply to the question: How efficient is the albanian system of constitutional control of the law; is best suited for our country - in terms of which features can be made relevant amendments to those adopted by the other system, the American or even by adopting features of the European system itself, but received these from different models included within this system? The focus of this paper will be the analysis of the modalities of control of the constitutionality of the law in Albania in order to "perfection" of our control system. During this analysis, based on the countries that more typically embrace the modalities of control of the constitutionality of the law, of the aforementioned systems, will be analyzed possibilities of adopting, even if only partially, to those characteristics of constitutional control of the laws, which are not currently present in our country, as the problem that arises in this case, that constitutes the research question of this research. Based methodology is qualitative.

Key words: control of constitutionality, law, abstract, concrete, incidental, a priori, a posteriori

*Dy janë ditët më të rëndësishme të njeriut në jetë: dita kur lind dhe dita kur e kupton pse
ke lindur... "Mark Twain"*

Të shtrenjtëve, Babit, Mamit, Invës, Elizonit!

Do të dëshiroja të shprehja falenderimet dhe mirënjohjen time më të sinqertë ndaj atyre që më inkurajuan dhe më ndihmuan në realizimin e këtij punimi.

Falenderoj me mirënjohje dy profesorët e mi, Prof. Dr. Ksenofon Krisafi dhe Prof. Asoc. Sokol Sadushi, për gjithë mbështetjen e dhënë përmes inkurajimit, ndihmesës dhe udhëzimeve të vlefshme gjatë realizimit të këtij punimi!

Një falenderim i veçantë shkon për familjen time, për gjithë suportin e gjithanshëm që më kanë ofruar gjatë gjithë kohës së këtij kërkimi shkencor!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Kapitulli I: Hyrje

<i>Qëllimi dhe rëndësia.....</i>	<i>1</i>
<i>Metodologjia.....</i>	<i>6</i>
<i>Literatura.....</i>	<i>9</i>
<i>Struktura.....</i>	<i>12</i>

KAPITULLI II: SISTEMET E KONTROLLIT TË KUSHTETUTSHMËRISË DHE IDETË KRYESORE (PËRFAQËSUESE) MBI TO

2.1 Sistemi europian i kontrollit të kushtetutshmërisë

2.1.1 Vështrim i përgjithshëm mbi lindjen e sistemit europian të kontrollit

<i>2.1.1.1 Origjinat e idesë së kontrollit të kushtetutshmërisë në sistemin europian.....</i>	<i>15</i>
<i>2.1.1.2 Debati Kelsen – Schmitt.....</i>	<i>19</i>
<i>2.1.1.3 Gjykatat e para kushtetuese në sistemin europian të kontrollit.....</i>	<i>21</i>
2.1.2 Modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në sistemin europian	
<i>2.1.2.1 Kontrolli i centralizuar.....</i>	<i>25</i>
<i>2.1.2.2 Kontrolli abstrakt dhe konkret.....</i>	<i>28</i>
<i>2.1.2.2.1 Kontrolli a posteriori dhe a priori.....</i>	<i>36</i>
<i>2.1.2.3 Llojet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe efektet e tyre.....</i>	<i>37</i>

2.1.3 Veçoritë e kontrollit të kushtetutshmërisë në gjykatat kryesore kushtetuese të sistemit europian

2.1.3.1 Gjykata Kushtetuese Austriake.....	39
2.1.3.2 Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane.....	39
2.1.3.3 Gjykata Kushtetuese Italiane.....	42
2.1.3.4 Gjykata Kushtetuese Spanjolle.....	43

2.2 Sistemi amerikan i kontrollit të kushtetutshmërisë

2.2.1 Vështrim i përgjithshëm mbi lindjen e sistemit amerikan të kontrollit

2.2.1.1 Origjinat e idesë së kontrollit të kushtetutshmërisë në sistemin amerikan.....	46
2.2.1.1.1 Lindja e idesë së kontrollit të kushtetutshmërisë në Angli.....	46
2.2.1.1.2 Evoluimi dhe konsolidimi i idesë së kontrollit të kushtetutshmërisë në SHBA.....	49
2.2.1.1.2.1 Argumentet e Hamilton dhe Letrat e Federalistit – baza teorike e konstitucionalizmit amerikan.....	50
2.2.1.1.2.2 Marbury v. Madison - Doktrina e judicial review.....	51

2.2.2 Modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në sistemin amerikan

2.2.2.1 Kontrolli i decentralizuar.....	56
2.2.2.2 Kontrolli konkret.....	58
2.2.2.3 Kontrolli a posteriori.....	59

2.2.2.4 Vendime me fuqi inter partes.....	61
---	----

2.2.3 Disa kritika për sistemin amerikan të kontrollit.....	62
---	----

KAPITULLI III: MODALITETET E KONTROLLIT TË KUSHTETUTSHMËRISË SË LIGJIT NË SHQIPËRI

3.1 Kontrolli abstrakt dhe konkret i kushtetutshmërisë së ligjit

3.1.1 Kontrolli abstrakt dhe konkret: disa problematika të legjitimitetit.....	66
---	-----------

3.1.1.1 Kontrolli i kushtetutshmërisë për kategori të veçanta ligjesh.....	84
--	----

3.1.2 Kontrolli incidental i kushtetutshmërisë së ligjit.....	88
--	-----------

3.1.2.1 Bindje apo dyshim për gjyqtarin a quo.....	90
--	----

3.1.2.2 Kompetencat, “interesi” dhe pozicioni procedural i gjyqtarit a quo.....	91
---	----

3.1.3 Ankimi individual si mundësi për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit.....	95
---	-----------

3.1.4 Disa rregulla të përgjithshme procedurale.....	102
---	------------

3.2 Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit, përmes dy formave të kontrollit a posteriori dhe a priori

3.2.1 Kontrolli a posteriori përballë atij a priori. Analizë krahasimore e tyre.....	107
---	------------

3.2.1.1 Karakteristikat e kontrollit a priori.....	108
--	-----

3.2.1.2 Avantazhet dhe disavantazhet mes kontrollit a priori dhe a posteriori.....	110
--	-----

3.2.2 Sistemi dualist i kontrollit. Mundësitë e aplikimit në Shqipëri

3.2.2.1 Rasti i Francës.....	115
3.2.2.2 Shembuj të tjerë të juridiksioneve kushtetuese dhe gjyqësore.....	117
3.2.2.3 Vetoja e Presidentit si instrument për kontrollin a priori.....	120

KAPITULLI IV: GJYKATA KUSHTETUESE SHQIPTARE NË FUNKSION TË KONTROLLIT TË KUSHTETUTSHËMRISË SË LIGJIT. REFORMA NË DREJTËSI DHE IMPAKTI I SAJ NË KONTROLLIN KUSHTETUES TË LIGJIT

4.1 Mundësia e adoptimit të kontrollit të decentralizuar në Shqipëri

4.1.1 Argumentet pro dhe kundër kontrollit të centralizuar dhe atij të decentralizuar.....	123
4.1.2 Përafrimi i dy modeleve të kontrollit: Modeli miks.....	130

4.2 Problematika e kontrollit të centralizuar në Shqipëri

4.2.1 Ndikimi i politikës në kushtetutshmëri.....	136
4.2.2 Një “Drejtësi e Re Kushtetuese”.....	139
4.2.3 Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit.....	140

4.3 Ndikimi i Reformës në Drejtësi mbi kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit

4.3.1 Rëndësia e Reformës.....151

4.3.2 Analiza kushtetuese dhe ligjore mbi reformën e Gjykatës Kushtetuese.

Ndikimi i saj në kontrollin kushtetues.....156

4.3.3 Rritja e efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në funksion të ankimit individual.....166

4.3.4 Ndryshime në rrethin e subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.....169

4.3.5 Afate më të arsyeshme në kërkesën për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit.....172

4.3.6 Efektet juridike, shpallja dhe ekzekutimi i vendimeve.....174

Kapitulli V:

Konkluzione.....178

Rekomandime.....198

Bibliografia.....199

LISTA E SHKURTIMEVE

GJK - Gjykata Kushtetuese

GJKFGJ – Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane

GJL - Gjykata e Lartë

KK – Këshilli Kushtetues

LTHFGJ – Ligji Themelor Federal Gjerman

GJEDNJ – Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

RSH – Republika e Shqipërisë

KAPITULLI I: HYRJE

Qëllimi dhe rëndësia

E gjithë jeta dhe veprimtaria e individit rregullohet nga normat juridike, pjesën më të rëndësishme të të cilave e zënë ligjet! Këto norma janë pjesë e një sistemi juridik që ndjek rregullin e vlefshmërisë së normës më të lartë, kriter i famshëm ky tashmë, i juristit të shquar Hans Kelzen. Në krye të kësaj hierarkie normash juridike, ku norma më e lartë i jep vlefshmëri normës më të ulët, qëndron Kushtetuta. Por le të imagjinojmë për një çast sikur tërësia e ligjeve të ishin në kundërshtim me vetë Kushtetutën, me aktin themelor të shtetit, me atë akt që për nga vlera juridike qëndron sipër tyre, me aktin që është garanti kryesor i të drejtave dhe lirive tona... atëherë natyrshëm lind pyetja...çfarë do të ndodhte? Në qoftë se organi ligjvënës, Parlamenti, i krijuar nga vetë ne, qytetarët, përfaqësuesi i vullnetit të popullit, do të abuzonte me pushtetin e tij duke miratuar ligje të tilla, çfarë do të ndodhte...?

Doktrina kushtetuese njeh në shek. XX, institutin më të ri dhe modern, Drejtësinë Kushtetuese, e cila e pajisur me instrumentin më të rëndësishëm të saj, kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, i jep zgjidhje pyetjeve të shtruara më lart.

Dihet se një qeverisje mund të kufizohet nga ekzistenca e një kushtetute, por nuk mjafton një kushtetutë për të pohuar se qeverisja është kushtetuese. Shpërdorimin e pushtetit nuk është në gjendje ta ndalojë plotësisht asnjë kushtetutë, sado mirë të jetë formuluar ajo. Është drejtësia kushtetuese ai mekanizëm që si mision kryesor të saj ka institucionalizimin e rendit demokratik, kufizimin e pushtetit dhe respektimin e lirive dhe të

drejtave të shtetasve, që mund të realizojë atë që shkruan kushtetuta. Një drejtësi kushtetuese mund të veprojë mirë vetëm brenda një sistemi të qëndrueshëm shoqëror dhe politik që ka një kushtetutë kompakte ose, si quhet ndryshe, një kushtetutë të ngurtë, ku kushdo respekton vendimet e organeve shtetërore (Sadushi, 2012: 127-128).

Shteti i së drejtës, si një nga parimet bazë mbi të cilin funksionon demokracia, mishëron në vetvete idenë e kushtetutshmërisë dhe të kufizimit të pushteteve. Në sistemet demokratike, krahas tri pushteteve tradicionale, ekziston edhe një *“pushtet i katërt”*, që shfaqet si një lloj pushteti kontrollues. Në analizën monumentale që Aleks de Tokëvil (Alexis de Tocqueville) i bën demokracisë amerikane në veprën *“ Mbi demokracinë në Amerikë ”*, nxjerr në pah rolin e gjyqësorit në sistemin e ri politik, duke argumentuar, se pushteti i dhënë gjykatave për të shpallur papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën është një nga pengesat më të fuqishme të ngritura kundër tiranisë së shumicës. Ai komenton se *“duke u mohuar gjyqtarëve të drejtën për t’i cilësuar ligjet si antikushtetuese, ne i japim tërthorazi trupit legjislativ pushtetin për ta ndryshuar Kushtetutën, sepse ai nuk ndeshet më me asnjë pengesë ligjore që mund ta ndalojë”*. Një qëndrim i tillë evidentonte domosdoshmërinë e kufizimit të pushteteve, por edhe rolin që duhet të luajnë veçanërisht gjykatat në mbrojtjen e Kushtetutës (Sadushi, 2012: 99-100).

Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit përbën një ndër pjesët më të rëndësishme të drejtësisë kushtetuese bashkëkohore si dhe është ajo që ka njohur rinovimin më të madh doktrinor përgjatë dyzet viteve të fundit. Sistemi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit është evoluar hap pas hapi në përputhje me drejtësinë kushtetuese. Ky kontroll ka kaluar përmes një procesi evolutiv, ashtu si dhe vetë Kushtetuta në vetvete. Kështu, Kushtetuta në

kuptimin e një ligji të prodhuar përmes një vendimi politik që rregullon themelet e shtetit, është një risi e shekullit XVIII, që sigurisht nuk u krijua si e tillë nga hiçi por që nga ana tjetër, nuk kishte ekzistuar më parë në këtë formë (Grimm, 2002: 31). Pikë së pari përmendet Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në vitin 1776, për të kaluar më pas, trembëdhjetë vite më vonë me të ashtuquajturën, Kushtetutë Europiane e Francës, në vitin 1789. Në këtë mënyrë shekulli XIX karakterizohet nga përhapja e kushtetutave në Europë dhe në të gjithë botën. Fitorja e idesë së konstitucionalizmit, që dukej sikur lulëzoi në fund të Luftës së Parë Botërore, megjithatë në këtë periudhë e pati “jetën” e shkurtër, pasi vetëm nga fundi i shekullit XX, pas disa peripecish, konstitucionalizmi mbizotëroi në të gjithë botën universalisht. Sot, shtetet pa kontroll kushtetutshmërie janë një përjashtim që tregon se kushtetuta nuk merret seriozisht në çdo cep të saj (Grimm, 1995: 10)!

Në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë, krijohen dhe dy sistemet kryesore më të mëdha në botë, përkatësisht sistemi amerikan dhe ai evropian, të cilët pavarësisht të veçantave dhe ngjashmërive që paraqesin, ndjekin të njëjtin qëllim, atë të kontrollit të kushtetutshmërisë.

Instituti i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri, parashikohet për herë të parë në Kushtetutën e vitit 1946, e cila ngarkonte me një funksion të tillë Presidiumin e Kuvendit Popullor. Ndërkohë që me Kushtetutën e vitit 1976 kjo kompetencë iu la vetë Kuvendit Popullor. Ndryshimet e tjera në këtë drejtim, datojnë në prill të vitit 1991, ku për herë të parë në historinë e vendit krijohet një Këshill Kushtetues që pavarësisht emërimit, ishte në fakt një Gjykatë Kushtetuese edhe pse me kompetenca rekomanduese. Ndërsa më 4

prill të vitit 1992, me ligjin kushtetues nr. 7561 “ Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, u vendos kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve nga Gjykata Kushtetuese, të cilës iu veshën tashmë kompetenca vendimore (Omari & Anastasi, 2010: 411-413).

Sot një kontroll i tillë në Shqipëri realizohet po nga Gjykata Kushtetuese dhe ka këto karakteristika:

- i centralizuar,
- *a posteriori*,
- abstrakt - direkt,
- konkret,
- incidental,
- *erga-omnes*,

duke u përfshirë kështu në sistemin evropian të kontrollit.

Pikërisht, në fokus të këtij punimi, do të jetë analiza e modaliteteve të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri, me qëllim “përsosjen” e sistemit tonë të kontrollit. Gjatë kësaj analize, duke u bazuar në vendet që përqafojnë në mënyrë më tipike modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, të sistemeve të lartpërmendura, do të analizohen mundësitë e adoptimit, qoftë edhe vetëm në mënyrë të pjesshme, të atyre karakteristikave të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve, të cilat nuk janë prezent aktualisht sot në vendin tonë, pasi problemi që shtrohet në këtë rast, që përbën njëkohësisht edhe pyetjet kryesore kërkimore të këtij hulumtimi, është ai që ka të bëjë me efikasitetin që ky kontroll paraqet:

*Sa efikas është sistemi aktual i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri?;
A është më i përshtatshmi për vendin tonë? - Në drejtim të cilave karakteristika mund të
bëhen ndryshimet përkatëse duke i adoptuar ato nga sistemi tjetër, ai amerikan apo qoftë
edhe duke adoptuar karakteristika të tjera nga vetë sistemi evropian, por të marra këto nga
modelet e ndryshme që përfshihen po brenda këtij sistemi?*

Qëllimi i këtij studimi është të shihet efikasiteti dhe mundësia e përsosjes së sistemit të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri, përmes një studimi analitiko - krahasues të karakteristikave të sistemit tonë të kontrollit me ato të modeleve të tjera. Kështu, për realizimin e këtij qëllimi, argumenti apo hipoteza kryesore është: Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri mund të përfshijë karakteristikat më të mira të sistemeve të kontrollit, sistemit amerikan dhe sistemit evropian. Parë se tendencat e drejtësisë kushtetuese (referuar kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit) janë ato të përfshirjes e gërshetimit të karakteristikave të njërit sistem kontrolli me tjetrin. Ky qëllim mund të arrihet përmes qasjes krahasimore dhe analizës së mundësive juridike.

Në lidhje me rëndësinë e këtij studimi, duke qenë se instituti i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit është instituti juridik më i ri në doktrinën e drejtësisë kushtetuese si dhe një ndër më të rëndësishmit për vetë nevojën që e dikton, të kesh si qëllim përmirësimin e këtij kontrolli në një sistem të caktuar, përbën një rëndësi më vete, përbën një kontribut akoma dhe më të madh në këtë fushë. Pikërisht rëndësia e këtij studimi

qëndron në qëllimin që ky studim ka, në qëllimin e përmirësimit të sistemit të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri. Kjo paraqet rëndësi të veçantë aq më tepër në drejtim të problematikës. Në këtë drejtim ky studim përbën një risi. Ai do të mund t'i shërbejë kërkimeve të reja akademike dhe do të plotësojë në lidhje me problematikën në fjalë, kërkimet ekzistuese. Një studim i tillë i drejtohet të gjithë atyre që operojnë në fushën e drejtësisë, praktikantëve të sektorit si dhe kolegëve profesionalë dhe akademik por edhe kujtdo që dëshiron të ketë njohuri në fushën e drejtësisë në përgjithësi dhe për atë të Drejtësisë Kushtetuese në veçanti, në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve në vendin tonë por edhe më gjerë.

Metodologjia

Metodologjia bazë e këtij punimi është ajo cilësore. Metodatat që do të përdoren në këtë kërkim shkencor, për realizimin e qëllimit të tij, duke iu përgjigjur kështu pyetjeve kërkimore dhe duke testuar hipotezat, janë:

- metoda e kërkimit doktrinar
- metoda e kërkimit të krahasuar
- metoda e analizës jurisprudenciale.

Metodologjia nuk fokusohet dhe as përbën një metodë të vetme. Ndërkohë që metoda është rruga për zgjidhjen e një problemi a disa problemeve, metodologjia shpjegon arsyet pse metoda e zgjedhur është më e përshtatshme (Gestel, Micklitz & Maduro, 2012:

12). Metodatat e përzgjedhura do të jenë ato të analizës teorike, doktrinë, por pa lënë mënjanë dhe analizën e jurisprudencës kryesisht shqiptare por dhe të huaj, në planin krahasues, për sa kohë kemi të bëjmë me një qasje krahasimore. Kështu, për realizimin e qëllimit të këtij kërkimi shkencor, për të parë mundësinë e përsosjes së sistemit tonë të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, do të analizohen modalitetet e këtij kontrolli në Shqipëri, duke i krahasuar ato me karakteristikat e tjera respektive të cilat janë të pranishme në sistemin amerikan të kontrollit si dhe tek modelet e tjera që përfshihen po brenda sistemit evropian.

Gjatë kësaj analize krahasimore, do të bëhen dhe interpretimet përkatëse të karakteristikave në fjalë, duke u mbështetur tek rastet nga praktika dhe më konkretisht në procedurat dhe vendimet e organeve që realizojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, në vendet respektive që do të merren si model krahasimi. Kjo me qëllim për të parë se cilat karakteristika janë më të frytshme në drejtim të përmbushjes së qëllimit që instituti i kontrollit të kushtetutshmërisë ka, për realizimin e këtij funksioni sa më me efikasitet si dhe për t'i adoptuar këto karakteristika në sistemin tonë, në rastin që ato nuk janë prezent.

Pikë së pari është përdorur metoda e kërkimit doktrinar e cila ka evidentuar dhe nxjerrë në pah pikëpamjet si dhe qëndrimet e ndryshme të mbajtuara nga doktrina për drejtësinë kushtetuese në përgjithësi e kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit në veçanti, modalitetet që ky kontroll paraqet, efikasitetit të tyre, referuar jo vetëm rasteve e shembujve konkret të marrë për studim, por edhe në nivel të përgjithshëm teorik doktrinar. Përmes metodës së kërkimit doktrinar, bazuar në parime, vlera e ide, janë evidentuar ato karakteristika të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit që paraqesin më shumë efikasitet, e

që i shërbejnë më mirë përmbushjes së qëllimit që kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit ka në vetvete e për të cilin “u lind”. Metoda e kërkimit doktrinar, ndihmon këtë kërkim shkencor për të ngritur bazën mbi të cilën do të qendrojë punimi, duke evidentuar idetë kryesore përfaqësuese në lidhje me kontrollin kushtetues të dy sistemeve më të mëdha të kontrollit. Metoda e kërkimit doktrinar nga ana tjetër ndihmohet nga metoda e kërkimit të analizës jurisprudenciale, duke parë se si gjetjet realizohen e funksionojnë në praktikë, duke u mbështetur në vendimmarrjen e jurisprudencën e organeve që realizojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit në vendet e marra për rast studimor. Në bazë e në lidhje të këtyre metodave, duke shkuar përkrah tyre, qëndron metoda e kërkimit të krahasuar, pa të cilin ky studim për efekt të qëllimit e objektivave që ka, do të ishte i pamundur e nuk do të rezultonte produktiv.

Gjatë këtij punimi nuk do të trajtohet legjitimiteti i Drejtësisë Kushtetuese, në kuadrin e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, pasi ai është afirmuar tashmë, si instituti më i ri dhe ndër më të rëndësishmit në doktrinën kushtetuese:

“Ligjshmëria i nënshtrohet kontrollit të kushtetutshmërisë” (Omari, 2004: 216).

Gjithashtu për efekt studimi në planin analitiko - krahasues, do të merren si rast studimor vetëm ato vende (si kryesisht Itali, Gjermani, Francë, SHBA) që përfaqësojnë në mënyrë më tipike modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, të dy sistemeve përkatëse, përkatësisht atij evropian dhe amerikan.

Së fundmi, në këtë punim nuk do të trajtohet ligji në kuptimin material por vetëm ai në kuptimin formal (*stricto sensu*), si akti i nxjerrë nga organi ligjvënës, në bazë të një procedure të mirëpërcaktuar legislative, duke qenë se ai përbën dhe objektin kryesor të kontrollit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese si dhe burimin kryesor të së drejtës në Shqipëri¹ (Berberi, 2014: 50).

Literatura

Përsa i përket literaturës së përdorur, instituti i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, për nga vetë rëndësia që ka, shtron nevojën për studim dhe diskutim. E në fakt për një institut të tillë është bërë shumë, duke u trajtuar gjerësisht dhe imtësisht jo vetëm nga studiues apo autorë të ndryshëm të huaj, por edhe nga studiues të shquar shqiptar, ku ndër më kryesorët mund të përmendim dy konstitucionalistët më të njohur të fushës, Sokol Sadushi dhe Kristaq Traja. Konstitucionalisti Sokol Sadushi, madje i dedikon dy punime shumë të rëndësishme çështjeve të drejtësisë kushtetuese në terësi dhe atyre të kontrollit të kushtetutshmërisë në veçanti, konkretisht veprat me tituj “ Kontrolli Kushtetues ” i vitit 2004 si dhe “Drejtësia Kushtetuese në zhvillim. Trajtime teorike dhe të praktikës së

¹ Referuar faktit që sistemi juridik shqiptar i përket familjes romako-gjermanike. Për më tepër shih S. Berberi, “Kufijtë kushtetues strukturorë të pushtetit ligjvënës dhe kontrolli kushtetues”, 2014, fq.50

gjkimit kushtetues” i vitit 2012. Kështu, në punimet dedikuar kësaj fushe autori, trajton historikun dhe nevojën e Drejtësisë Kushtetuese, modelet e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës juridike, respektivisht atë amerikan dhe evropian si dhe llojet e kontrollit të kushtetutshmërisë duke i pasqyruar ato me shembuj mjaft të pasur nga praktika dhe çka është më e rëndësishme për studimin tonë, rezervon pjesë të veçanta për kontrollin e kushtetutshmërisë në Shqipëri. Këto punime e sidomos ai i vitit 2012, i cili është dhe më voluminoz, janë të pasur me shembuj përsa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë nga vende të ndryshme të botës; janë të pasur me jurisprudencë jo vetëm shqiptare por dhe të huaj; të pasur me qasje analitiko – krahasimore. Për të gjitha këto arsye, këto dy punime, do të përbëjnë dhe bazën kryesore referuese të kërkimit tonë. Një pjesë tjetër e rëndësishme e literaturës referuese, është edhe libri “ Drejtësia Kushtetuese ” i studiuesit shqiptar Kristaq Traja, botim i vitit 2000, ku trajtohen po ashtu mjaft çështje të rëndësishme në drejtim të kërkimit tonë. Edhe ky punim bazohet dhe trajton dy sistemet kryesore të kontrollit të kushtetutshmërisë. Studiuesi Traja jep kontributin e tij duke trajtuar çështje të Drejtësisë Kushtetuese kryesisht në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë. Autori analizon karakteristikat e kontrollit të kushtetutshmërisë duke u bazuar në dy sistemet kryesore dhe duke konkluduar faktin e rëndësishëm që asnjëri nga këto sisteme nuk është i pastër. Edhe ky punim është i pasur me analizë krahasuese. Vlen për t’u përmendur këtu edhe pikëpamja e një tjetër studiuesi shqiptar, Luan Omari, i cili rezervon një kapitull për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, në punimin e tij me titull “Shteti i së Drejtës” i vitit 2004, duke u përqëndruar kryesisht në organin që realizon kontrollin e kushtetutshmërisë, në përbërjen e tij si dhe në karakteristikën përkatëse, kontroll i centralizuar – kontroll i decentralizuar. Një bazim i mirë teorik janë edhe botimet në bashkëautorësi të autorëve

Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Arta Vorpsi, etj. Ndërsa referuar literaturës së huaj, përmendim veprat e ndryshme të konstitucionalistëve kryesorë të huaj si kryesisht, Louis Favoreu, Michel Fromont, Giuseppe de Vergottini, Temistocle Martines, Alec Stone Sweet, Mario Cappelletti, Arjomand, Fabbrini e shumë të tjerë.

Shembujt literaturë të cituara më sipër, dëshmojnë padyshim për kontributin e rëndësishëm të dhënë në fushën e kontrollit të kushtetutshmërisë në përgjithësi si dhe në veçanti për vendin tonë si rrjedhojë. Në këto punime trajtohen probleme të ndryshme në lidhje me fushën si legjitimiteti i kontrollit të kushtetutshmërisë, sistemet respektive të këtij kontrolli, modelet përfaqësuese të tyre, karakteristikat që ato paraqesin, duke konkretizuar herë pas here nëpërmjet shteteve të ndryshme, përfshi këtu edhe Shqipërinë dhe duke sjellë në vëmendje shembujt përjashtimor. E megjithatë nuk gjenden shembuj literaturë të cilat të kenë terësisht në qendër të studimit dhe analizës kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri, të parë në këndvështrimin e mundësisë së ndryshimit të ndonjëres prej karakteristikave të këtij sistemi kontrolli, në këndvështrimin e mundësisë së përsosjes së tij! Kështu, në këtë mënyrë, do të ishte jo vetëm interesante por edhe e rëndësishme, që të dedikohej një punim i tërë, i veçantë dhe ekskluziv për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri, me qëllim përsosjen e sistemit tonë të kontrollit, duke parë mundësitë e adoptimit qoftë edhe vetëm në mënyrë të pjesshme, të atyre karakteristikave të kontrollit të kushtetutshmërisë të cilat nuk janë prezent aktualisht sot në vendin tonë; duke patur si objektiv parësor dhe të vetëm, mundësinë e përsosjes së sistemit tonë të kontrollit, edhe përballë “sfidës” së ndryshimit të këtij sistemi!

Struktura

Me qëllim realizimin e objektivit kryesor të këtij punimi, në drejtim të të gjitha atyre që parashtruam pak më sipër, struktura e punimit paraqitet si më poshtë:

Kapitulli II “*Sistemet e kontrollit të kushtetutshmërisë dhe idetë kryesore (përfaqësuese) mbi to*” është kapitulli i përgjithshëm teorik e doktrinar. Ashtu siç kuptohet mjaft mirë dhe nga vetë titulli i kapitullit, do të trajtohen dy sistemet kryesore të kontrollit të kushtetutshmërisë, përkatësisht ai evropian dhe amerikan, në prizmin e vështirimit të përgjithshëm mbi lindjen e tyre dhe analizës së modaliteteve të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit që secili nga këto sisteme paraqet. Qëllimi kryesor i këtij kapitulli do të jetë shpjegimi i koncepteve kryesore që do përdoren gjatë punimit, shtjellimi i thelluar i literaturës më pranë problematikës së zgjedhur në punim si dhe diskutimi kritik mbi idetë kryesore, përfaqësuese. Ky kapitull shërben si baza teorike për dy kapitujt e tjerë të analizës empirike.

Kur themi “*kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit*”, duhet të kuptojmë dy aspekte: pikë së pari, funksionin në vetvete dhe së dyti, organin që e realizon këtë funksion. Për këtë qëllim, ndarja në Kapitullin III dhe Kapitullin IV, është bërë si më poshtë vijon:

Në Kapitulli III “*Modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri*” kalohet më gjerë në konkretizimin e rastit shqiptar, mbi bazën e pikëpamjeve teorike të parashtruara në Kapitullin II. Ky kapitull evidenton problematikën kryesore që qëndron në bazë të sistemit tonë të kontrollit. Analiza fillon me kontrollin abstrakt dhe konkret: disa problematika të legjitimitetit; vazhdohet me kontrollin e kushtetutshmërisë për kategori të

veçanta ligjesh; kontrolli incidental i kushtetutshmërisë së ligjit, kompetencat, “interesi” dhe pozicioni procedural i gjyqtarit *a quo*; ankimi individual si mundësi për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit e së fundmi trajtohen disa rregulla të përgjithshme procedurale. Pjesë tjetër shumë e rëndësishme e këtij kapitulli, është kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit, përmes dy formave të kontrollit *a posteriori* dhe *a priori*, ku trajtohet kontrolli *a posteriori* përballë atij *a priori* përmes një analize krahasimore të tyre; karakteristikat e kontrollit *a priori*; avantazhet dhe disavantazhet mes kontrollit *a priori* dhe *a posteriori* e së fundmi shihet mundësia e aplikimit në Shqipëri të një sistemi dualist kontrolli duke kaluar përmes rastit të Francës e shembujve të tjerë të juridiksioneve kushtetuese dhe gjyqësore.

Kapitulli IV “*Gjykata Kushtetuese Shqiptare në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit. Reforma në Drejtësi dhe impakti i saj në kontrollin kushtetues të ligjit*”, është kapitulli tjetër i analizës empirike dhe ndalet tek mundësia e adoptimit të kontrollit të decentralizuar në Shqipëri; argumentet pro dhe kundër kontrollit të centralizuar dhe atij të decentralizuar; përfrimi i dy modeleve të kontrollit: modeli miks; problematika e kontrollit të centralizuar në Shqipëri; ndikimi i politikës në kushtetutshmëri; një “Drejtësi e Re Kushtetuese”; pavarësia e Gjykatës Kushtetuese në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit. Pjesë shumë e rëndësishme e këtij kapitulli është ajo që trajton ndikimin e Reformës në Drejtësi mbi kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit. Kur trajtuam qëllimin e këtij kërkimi shkencor thamë se do të shihet mundësia e përsosjes të sistemit tonë të kontrollit, edhe përballë “sfidës” së ndryshimit të tij. Përmes këtij trajtimi do të shihet se sa dhe si Reforma arrin të ndikojë në këtë qëllim. Rëndësia e Reformës; analiza

kushtetuese dhe ligjore mbi reformën e Gjykatës Kushtetuese dhe ndikimi i saj në kontrollin kushtetues; rritja e efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në funksion të ankimit individual; ndryshime në rrethin e subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese; afate më të arsyeshme në kërkesën për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit; efektet juridike, shpallja dhe ekzekutimi i vendimeve janë çështjet që do të trajtohen në pjesën e tretë të kapitullit.

KAPITULLI II: SISTEMET E KONTROLLIT TË KUSHTETUTSHMËRISË DHE IDETË KRYESORE (PËRFAQËSUESE) MBI TO

*“Që të mos abuzohet me pushtetin, duhet që pushteti të kufizojë pushtetin...!”
Montesquieu*

2.1 Sistemi evropian i kontrollit të kushtetutshmërisë

2.1.1 Vështrim i përgjithshëm mbi lindjen e sistemit evropian të kontrollit

2.1.1.1 Origjinat e idesë së kontrollit të kushtetutshmërisë në sistemin evropian

Ideja e kontrollit të kushtetutshmërisë ka një zanafillë shumë të hershme që i referohet ideve natyraliste të së drejtës, duke qenë se sipas teorisë të së drejtës natyrore: “që një sistem normativ të ketë karakter juridik, duhet që të jetë në përputhje me parimet morale dhe të drejtësisë” (Nino, 1996: 24). Koncepti që të gjitha ligjet duhet t’u nënshtrohen parimeve të një rendi më të lartë e të pandryshueshëm, siç është e drejta, është në bazë të të gjitha teorive shekullare ose fetare të së drejtës natyrore (Omari, 2004: 185). Në një stad të tillë qëndron Kushtetura si akti më i lartë i një shteti, si akti me të cilin duhet të jenë në përputhje gjithë aktet e tjera. Një arsyetim i tillë në fakt është ndjekur gjithmonë dhe vazhdon të ndiqet edhe në rastet kur jo domosdoshmërisht kemi të bëjmë me një shtet të së drejtës.

Kur Cappelletti dhe Cohen, dy studjues të rëndësishëm të fushës, shprehen për origjinat e një ideje të tillë kontrolli, e fillojnë këtë arsyetim që me ndarjen e famshme që Tommaso d’ Aquino bën mes *jus naturale* dhe *jus positivum* e deri tek rasti *Bonham* i vitit

1610, në të cilin afirmohet parimi i kontrollit të përpuethshmërisë së ligjeve me disa norma juridike më të larta (Cappelletti & Cohen, 1979: 9). Në këtë rast gjyqtari Edward Coke, mbi bazën e *common law*, shtjellonte argumente kundër një ligji të miratuar nga Parlamenti, duke shpallur epërsinë e *common law* (Omari, 2004: 186).

Pikëpamjet e së drejtës natyrore, shërbyen për fillimin e kontrollit kushtetues, edhe në shtete të tjera të Europës, si për shembull në Gjermani ku varësia e qeveritarëve nga të ashtuquajturat “ligje themelore”, e zhvilluar në teorinë e juristëve të mëdhenj gjermanë të shekullit XVIII, Wolff dhe Pufendorf, shënoi fillimin e konstitucionalizmit në Gjermani. Në shekullin XIX, në teorinë e përgjithshme të shtetit dhe të së drejtës u diskutua më konkretisht çështja e kontrollit të ligjeve dhe të drejtësisë kushtetuese. Projekti i një kontrolli gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve u shfaq për herë të parë në valën e lëvizjes për Kushtetutën në vitin 1848. Kushtetuta e miratuar në atë kohë nga Dieta (Parlamenti Konfederal i Frankfurtit) parashikonte krijimin e një Gjykate të Perandorisë, që do të ishte një gjykatë e vërtetë kushtetuese, e cila midis të tjerave, do të ushtronte edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Por lëvizja e vitit 1848-të dështoi dhe bashkë me të edhe përpjekja për krijimin e një Gjykate Kushtetuese. Kushtetuta e Frankfurtit u shfuqizua. Në këtë debat pati një rëndësi të veçantë mendimi i Robert fan Molit (von Mohl), i cili, më 1852, theksonte përsëri epërsinë e Kushtetutës ndaj ligjeve dhe të drejtën e gjyqtarëve për t'i kontrolluar ligjet nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre. Këto pikëpamje u konkretizuan plotësisht dhe juridikisht shumë më vonë, me Kushtetutën e Republikës Federale Gjermane të vitit 1949 (Omari, 2004: 189-190).

Mirëpo pa diskutim, ashtu siç pohohet gjerësisht edhe në literaturë, një ide më të moderuar mbi kontrollin e kushtetutshmërisë e gjejmë të përfaqësuar në Francë. Kështu gjatë revolucionit francez ideja e një kushtetute që të ishte shprehja e sovranitetit të kombit dhe baza e gjithë rendit juridik u materializua në tri Kushtetuta, të viteve 1791, 1793 dhe 1795. Por, krahas kësaj, lindi për herë të parë ideja e një kontrolli të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetuën. Kjo ide u shpreh në fillim nga Sieyès, prift dhe ideolog i moderuar, i ndryshimeve revolucionare, i cili, gjatë punimeve për përgatitjen e Kushtetutës së vitit 1791 kërkoi krijimin e një *jurie kushtetuese*. Në një nga fjalimet e tij të mbajtura me këtë rast ai argumentoi se, për të imponuar respektimin e Kushtetutës, duhej patjetër një autoritet i posaçëm që të kishte kompetencë të shfuqizonte aktet dhe ligjet që vinin në kundërshtim me Kushtetutën. Por ky autoritet në roje të Kushtetutës nuk do të ishte pushteti gjyqësor (pavarësisht se ai përdorte termin “juri”) por një trup i posaçëm politik, përfaqësues. Kjo ide e Sieyès nuk u pranua në Kushtetutën e vitit 1791 (Omari, 2004: 191).

Ndërkohë që Sieyès mbronte një ide të tillë, Bonaparti do të krijonte përmes Kushtetutës së 1799-ës një pseudokontroll kushtetutshmërie duke ia besuar atë Senatit konservator (Favoreu, 1986: 6-16). Një nga atributet e këtij Senati ishte që ai të sanksiononte ose të shfuqizonte aktet që i parashtroheshin si antikushtetuese nga gjykata ose nga qeveria. Edhe Kushtetuta e Perandorisë së Napoleonit e parashikonte një kompetencë të tillë të Senatit. Këtë e trashëgoi edhe Kushtetuta e Prandorisë së dytë, e vitit 1852. Gjatë Revolucionit francez, përveç propozimit të Sieyèsit, pati edhe propozime të tjera si projekti i paraqitur nga Kersen (Kersaint) më 1792 që brenda Asamblesë Legjislative të krijohej një grup censorësh i cili do të mbikqyrte që aktet e pushteteve

ligjvënës dhe ekzekutiv të ishin gjithmonë në përputhje me Kushtetutën si dhe projekti i një “jurie të madhe kombëtare” të propozuar nga Robespieri në vitin 1793 dhe që u pasqyrua në kreun XV të projektit të Kushtetutës jakobine, juri e madhe e përbërë nga një anëtar për çdo departament të Francës për të “garantuar qytetarët kundër shtypjes së pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv”. - Pra, edhe në këto raste, parashikohej që kontrolli t’u besohej jo organeve gjyqësore, por organeve politike të veçanta, ndonëse më të pavarura sesa Senati i periudhës bonapartiste. Siç shihet për një kohë të gjatë në Francë është përkrahur me këmbëngulje teza se asnjë organizëm gjyqësor nuk duhej të kishte pushtet për të kontrolluar përputhjen e ligjeve me kushtetutën ose me një të ashtuquajtur të drejtë më të lartë. Edhe kur, në disa kushtetuta të veçanta, është pranuar mundësia e një kontrolli të kushtetutshmërisë së ligjeve, deri vonë kjo mundësi kontrolli kish mbetur teorike dhe nga ana tjetër ai u besohej organizmave që kishin një karakter politik dhe jo gjyqësor (Omari, 2004: 191-193).

Duke iu referuar rastit të Francës do të mund të thonim se ka patur gjithashtu një moment në historinë e saj (projekt - kushtetuta e vitit 1799), ku u shfaq ideja për një kontroll të centralizuar të kushtetutshmërisë së ligjit, nga i ashtuquajturi “corpo degli efori” që në fakt konsistonte në një organ gjyqësor dhe jo politik (Aquarone, D’addio & Negri, 1959: 269-271).

Në Francë, ashtu si edhe në të gjithë Europën, parimi i absolutizmit të ligjit ishte i padiskutueshëm përgjatë gjithë shekullit XIX dhe fillimeve të shekullit XX: në Europë ligji është i shenjtë, ndërkohë që në SHBA e shenjtë është Kushtetuta. Do të duhet të pritët Hans Kelsen dhe intuited e tij gjeniale për një kontroll mbi kushtetutshmërinë e ligjeve, e

garantuar përmes një organi të krijuar posaçërisht dhe që ka monopolin në këtë fushë, me qëllim për të patur modelin e parë të kontrollit të kushtetutshmërisë në Europë (Favoreu, 1986: 6-16).

2.1.1.2 *Debati Kelsen - Schmitt*

Në vitin 1928, kur Kelsen përcaktonte qëllimin kryesor të kontrollit kushtetues, shprehej si më poshtë:

Nëse thelbi i demokracisë nuk qëndron në plotfuqinë e maxhorancës por në konsensusin e vazhdueshëm mes asaj që maxhoranca dhe minoranca përfaqësojnë në Parlament, pra në paqen sociale, atëherë kontrolli kushtetues duket të jetë instrumenti më ideal në realizimin e këtij qëllimi (Kelsen, 1981: 145).

E thënë në këtë mënyrë qëllimi i kontrollit kushtetues është ai që të garantojë përmes stabilitetit të kushtetutës, paqen sociale. Realizimi i këtij qëllimi kërkon prezencën e një “gjyqtari të ligjeve”, që të jetë në gjendje të realizojë dy funksione kryesore: pikë së pari, të kontrollojë sferën politike përmes parametrave kushtetues dhe në rradhë të dytë t’u imponojë të gjithë pushteteve publike respektin ndaj normave, parimeve e vlerave që janë në themel të shtetit dhe shoqërisë (Cheli, 1996: 9-10). Janë të njohura tashmë në këtë drejtim, dy këndvështrime kryesore: pikëpamja “ iluministe ” – referuar Hans Kelzen, i cili parashikon një drejtësi kushtetuese të orjentuar në thelb drejt garantimit të lirive themelore të shtetasve; - pikëpamja “ realiste ” referuar Carl Schmitt - që të garantojë një zhvillim të ekuilibruar të raporteve mes pushteteve në vend. Në këtë linjë, do të ndikohet edhe drejtimi që marrin organet e drejtësisë kushtetuese, nëse referuar modelit të parë apo atij të dytë. Kjo konkretizohet në debatin e zhvilluar në Europë mes Kelsen dhe Schmitt,

gjatë viteve 1928 - 1931, në lidhje me faktin se cili duhet të jetë garanti i Kushtetutës (Zagrebelsky, 1988: 28). Kelzeni kritikonte ashpër pikëpamjet e Schmitt, për arsye se ky i fundit nuk parshikonte ekzistencën e një organi të pavarur me qëllim garantimin e kushtetutës. Schmitt në fakt nga ana tjetër i besonte një funksion të tillë kryetarit të shtetit duke iu referuar doktrinës së Benjamin Constant, mbi *pouvoir neutre* të monarkut, duke qenë se sipas këtij të fundit monarku ishte titullari i një pushteti neutral (Schmitt, 1981: 204). Me të drejtë kundërpërgjigjia që vinte në këtë rast nga Kelzen ishte pikërisht ajo që ideja se monarku është mbartës i një pushteti neutral është një shpikje që lidhet me doktrinën konstitucionale të shek. XIX, pasi mbreti në fakt, qoftë në aspektin formal (parashikuar në kushtetutë) qoftë edhe në atë material (sipas realitetit politik) është kryetari suprem i parlamentit dhe qeverisë, pra do të thotë se është organi që ushtron pushtetin ekzekutiv dhe atë legjislativ në veçanti (Kelsen, 1981: 233). Si i tillë ai në asnjë rast nuk mund të jetë i pavarur dhe ashtu siç thotë dhe vetë Kelzen: “*si mund të jetë monarku, mbartës i pjesës më të madhe të pushtetit shtetëror, një institucion i pavarur me qëllim kontrollin e kushtetutshmërisë ?*” (Kelsen, 1981: 233).

Zgjedhëm në fakt të japim një trajtim të shkurtër të debatit Kelsen - Schmitt, duke qenë se këto ide edhe pse jo në origjinën e hershme, qëndrojnë në themel të të gjithë sistemit evropian të kontrollit. Ashtu siç do ta shohim në mënyrë më të zgjeruar në pjesët në vazhdim, numri më i madh i vendeve në kontinentin evropian, zgjedhën që të përqafojnë modelin kelzenian, duke ia besuar kontrollin e tyre të kushtetutshmërisë së ligjit (por edhe të normës në përgjithësi) një organi kushtetues të pavarur, të posaçëm e të specializuar në

një funksion të tillë, pra një Gjykatë Kushtetuese, ndërtimi dhe funksionimi i së cilës në fakt, ndjek po ashtu modelin kelzenian.

2.1.1.3 Gjykatat e para kushtetuese në sistemin evropian të kontrollit

Shekulli XX dhe veçanërisht gjysma e dytë e tij, evidentoi dy nga transformimet kryesore institucionale, të cilat lidhen me ardhjen e demokracive qeverisëse në shumicën e vendeve europiane, si dhe me konsolidimin e kontrollit të gjyqtarit kushtetues. Nevoja për ekzistencën e një kontrolli të karakterit kushtetues ndaj veprimtarisë së organeve, që përfaqësojnë tri pushtetet në fushën e nxjerrjes së akteve juridike, [...] si dhe domosdoshmëria e mbrojtjes dhe e respektimit të ligjit themelor të shtetit, kushtetutës, diktonin për kohën ekzistencën e një organi të lartë me natyrë kushtetuese, i cili mund të bëhej në të njëjtën kohë dhe garanti i respektimit dhe i mosdhunimit të saj. Kushtetutat e shkruara sidomos Pasluftës së Dytë Botërore, u dhanë gjykatave pushtetin për rishikim kushtetues, me shpresën për të kufizuar efektivisht pushtetin e shumicës legislative (Sadushi, 2012: 82).

Me themelimin e Gjykatës Kushtetuese austriake, në vitin 1920, do të kemi edhe modelin e parë të kontrollit të kushtetutshmërisë në Europë: Europa krijon një model të sajën, duke qenë modeli amerikan i paaplikueshëm për arsye teknike e historike - por me të njëjtat objektiva (Favoreu, 1986: 16). Këtu duhet theksuar fakti se krijimi i një gjykate të tillë u bë në bazë të Kushtetutës së hartuar kryesisht nga vetë Kelzeni (Omari & Anastasi, 2010: 409). Shembulli austriak do të ndiqet nga Spanja, e cila do të krijojë gjatë Republikës

së II-të, Gjykatën e Garancive Kushtetuese. Tendenca do të përhapet gjatë Luftës së Dytë Botërore e kështu do të lindin Gjykata e Republikës Federale Gjermane (1949), e Italisë (1955), e Qipros (1960), e Turqisë (1961) dhe ajo e Jugosllavisë (1963). Gjatë fundit të viteve '70 dhe fillimit të viteve '80 do të jetë rradha e Greqisë (1975), e Portugalisë (1976) dhe e Spanjës (1978), e Belgjikës (1982) me Gjykatën e Arbitrazhit, e Polonisë (1982) dhe së fundmi e Hungarisë (1983) (Favoreu, 1992: 3).

Historia e gjysmës së dytë të shekullit XX, e njohur si periudha e tri gjeneratave të gjykatave kushtetuese dhe që lidhet me rënien e regjimeve jodemokratike, dëshmoi për një konsolidim të mëtijshëm të gjykatave kushtetuese në Europë, si një përgjigje ndaj përdorimit instrumental të ligjit dhe shpërdorimeve të institucioneve kryesore të shtetit. Gjatë kësaj periudhe u zgjerua së tepërmi pikëpamja origjinale e projektuar nga Kelsen. Përjashtimet më të dukshme në Europë janë në disa vende skandinave, Zvicër e ndonjë vend tjetër, të cilat nuk kanë miratuar ende një model kelsenian (Sadushi, 2012: 83). Përsa i përket vendeve skandinave në fakt, duhet thënë se ato nuk kanë një traditë të fortë të kontrollit të kushtetutshmërisë apo doktrinë kushtetuese. Këtu, rëndësia e zhvillimeve kushtetuese është zëvendësuar qartësisht me sovranitetin popullor dhe supermacinë e parlamentit (Nergelius, 2008: 9).

Fillimisht, Franca pranoi një rishikim shumë të ngushtë të legjislacionit në përputhje me traditat e saj, por gradualisht filloi t'i përafrohet modelit të specializuar. Ndërkohë që vende të tilla, si: Gjermania, Italia, Austria përfshinë në kushtetutat e tyre gjykatën kushtetuese, si organ që do të realizonte gjykimin kushtetues sipas modelit kelsenian. [...]. Zbatimi i modelit kelsenian, në shtete të ndryshme evropiane, ka qenë i

varur nga kushtet vendore dhe për këtë arsye kompetencat dhe organizimi i gjykatave kushtetuese ka shkuar shumë më tepër se ato të një ligjvënësi negativ. Këto karakteristika mbetën në fuqi edhe për gjeneratën e dytë të gjykatave, e cila i përket periudhës së viteve '80 të shekullit XX. Kjo periudhë e krijimit të gjykatave kushtetuese përkon me rrëzimin e regjimeve autoritare fashiste në Portugali, Spanjë dhe në Greqi. Gjykata Kushtetuese portugeze dhe ajo spanjolle, të krijuara përkatësisht pas rënies së regjimit të Salazarit dhe të Frankos, ushtrojnë edhe kontrollin ligjor, si dhe vendosin për ankesat kushtetuese. [...] Greqia është familjarizuar me kontrollin gjyqësor që nga shekulli XIX. Pavarësisht se Greqia nuk ka një gjykatë kushtetuese sipas modelit kelsenian, elemente të gjykimit kushtetues përfshihen në organizimin institucional të këtij shteti (Sadushi, 2012: 84-85).

Gjenerata e tretë filloi të përhapej pas rënies së regjimeve komuniste në Europë. Rrëzimi i kampit komunist përkoj me një valë të re të krijimit të institucioneve. Të gjitha vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, ndoqën pikërisht këtë model të kontrollit kushtetues. Në këto vende, njohja e juridiksionit kushtetues u kthye në një simbol të sundimit të së drejtës dhe në një përkrahje ndërkombëtare, për ndryshimin nga sistemi autoritar në një sistem demokratik e kushtetues (Sadushi, 2012: 85).

Në këtë mënyrë dalë nga dalë lindi ai që sot njihet si sistemi evropian i kontrollit të kushtetutshmërisë. Përhapja e një kontrolli të tillë ndaj ligjeve u realizua në mënyrë kaq masive, sa që ky kontroll shfaqet, ashtu siç shprehet Favoreu: *“si një ndër institutet më moderne të konstitucionalizmit bashkëkohor”* (Favoreu, 1992: 3).

Nëse do t'i referoheshim themelimit të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare, do ta rendisnim atë në gjeneratën e tretë të gjykatave kushtetuese në Europë duke qenë se ajo u krijua si një përparësi politike e qeverisjes demokratike, që u vendos pas lëvizjeve të viteve '90. Deri në këtë kohë, në Shqipëri, nuk ishte folur për ekzistencën e një organi të veçantë që do të kontrollonte kushtetutshmërinë e normave. Kushtetutat shqiptare të hartuara përpara Luftës së Dytë Botërore, u përpoqën të krijonin imazhin e një gjyqësori të pavarur, por në asnjë rast nuk shtruan nevojën e kontrollit gjyqësor. Gjatë periudhës së shtetit monist, gjeti përhapje teoria e kontrollit parlamentar të kushtetutshmërisë, e cila buronte nga teoria majtiste e omnipotencës parlamentare, që u zhvillua sidomos në periudhën e revolucionit francez të shekullit të XVIII-të (Sadushi, 2004: 36).

Për herë të parë, krijimi i Gjykatës Kushtetuese, si një organ i centralizuar i kontrollit gjyqësor të normave, u sanksionua në Ligjin nr. 7561 dt. 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491 dt. 29.04.1991, 'Për dispozitat kryesore kushtetuese', "Organizimi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese". Në bazë të këtij ligji, kjo gjykatë përbënte autoritetin më të lartë që mbronte dhe garantonte respektimin e Kushtetutës dhe bënte interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Ky fakt, të krijonte përshtypjen se kishim të bënë me një organ gjyqësor, por duhet thënë se ajo, qysh në fillim, u krijua si një organ i veçantë dhe nuk u përfshi në organizimin gjyqësor apo, në ndonjërin nga të tria pushtetet. Ky status i Gjykatës Kushtetuese, si një organ kushtetues i pavarur që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës, sanksionohet edhe në Kushtetutën e vitit 1998. (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 157-158).

2.1.2 Modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në sistemin europian

2.1.2.1 Kontrolli i centralizuar

Kur flitet për sistemin europian të kontrollit mendja menjëherë të shkon tek karakteristika e parë që ky sistem paraqet e që është pikërisht ajo e centralizimit. Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në mënyrë të centralizuar mund të ushtrohet nga një organ juridik - gjyqësor por edhe politik.

Kontrolli politik përfshin verifikimin që i bëhet kushtetutshmërisë së ligjit që në brendësi të procesit të perfeksionimit të tij. Ky proces ka karakter *preventiv* ndaj hyrjes në fuqi të ligjit, mund të ngrihet nga një organ kushtetues dhe jo nga subjekte të jashtme, dhe sjell si pasojë, kur verifikohet jokushtetutshmëria, mospublikimin dhe hyrjen në fuqi ose edhe mosmiratimin e ligjit nëse kontrolli ushtrohet gjatë procesit të formimit të tij. Kontrolli i kushtetutshmërisë përmes një organi politik është karakteristikë e sistemit francez, në të cilin, duke filluar nga periudha e Revolucionit, u zhvillua doktrina e “sovrانيتetit” parlamentar në bazë të së cilës nuk do të ishte as e mendueshme që t’i lejohej një organi tjetër që nuk do të ishte parlamenti, dhe veçanërisht gjyqtarëve, të shfuqizonin një ligj. Në vazhdimësi kushtetutat e viteve `800 dhe ajo e vitit 1852 do t’ia akordonin Senatit, “kustodit” të kushtetutës, detyrën për të verifikuar kushtetutshmërinë e ligjeve përpara shpalljes së tyre (De Vergottini, 2004: 188). Do të jetë Kushtetuta e vitit 1958 ajo e cila në nenet 56 - 63 do të parashikojë krijimin, përbërjen dhe funksionet e Këshillit Kushtetues.

Kontrolli politik ka qenë i parashikuar edhe në sistemet socialiste, të cilat ia ngarkonin verifikimin e kushtetutshmërisë asamblesë legjislative. Në këtë rast përqëndrimi

i kompetencës së kontrollit kushtetues në vetë organin legjislativ, lidhet me faktin se në këto sisteme asambleja legjislative konsiderohej si organi me pushtetin më të lartë shtetëror, dhe si rezultat mundësia e censurimit të saj nga instanca të tjera as që mund të mendohej. Nga ana tjetër e paimagjinueshme po ashtu ishte edhe parashikimi i një instance kontrolli gjyqësor që t'i kundërvihej asamblesë - kjo mbi bazën e parimit të “centralizimit të pushtetit”. Në përgjithësi, kontrolli i kushtetutshmërisë i besohet *Presidiumit* të asamblesë (si për shembull kjo ka qenë e parashikuar nga Kushtetuta rumune e vitit 1965-së, në nenin 13 dhe 43 të saj; nga Kushtetuta hungareze e vitit 1972, neni 30; Kushtetuta kubane e 1976 -ës, neni 73/c; e ish-Bashkimit Sovjetik, e vitit 1977- të, neni 121 si dhe ajo kineze e 1978 -ës, neni 22) duke parashikuar ndonjëherë edhe institucionin e një komisioni parlamentar të specializuar me attribute përgatitëse dhe këshilluese, si në Kushtetutën rumune të vitit 1965, neni 53 i saj (De Vergottini, 2004: 189).

Gjithsesi, tashmë ideja që kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit, nuk i duhet besuar një organi politik, është e superuar dhe madje, vetë në literaturën franceze gjejmë kritika të shumta për kontrollin politik të këtij vendi. Këtu do të mund të citonim Georges Burdeau, i cili thotë se: “ [...] nëse i besohet kontrolli kushtetues një organi politik, ai rrezikon që të shprehet më së shumti mbi bazën e preferencave politike [...] ” (Burdeau, 1963: 84).

Kontrolli juridik si rregull realizohet *a posteriori*, pra pas perfeksionimit të ligjit, shpalljes, publikimit e hyrjes së tij në fuqi. Ai realizohet nga një organ që është i mirëdallueshëm nga organi që ka detyrën e miratimit të vetë aktit. Ky kontroll gjendet zakonisht në sistemet që garantojnë parimin e ndarjes së pushteteve (De Vergottini, 2004: 190).

Kur në literaturë flitet për kontrollin e centralizuar² juridik, thuhet se një kontroll i tillë mund t'i besohet një organi juridik kushtetues siç është gjykata kushtetuese, seksioneve të veçanta pranë saj, siç është rasti i disa vendeve në Amerikën Latine por flitet edhe për mundësinë e realizimit të një kontrolli të tillë nga ana e disa organeve *ad hoc*. Në fakt po t'i referohemi Giuseppe de Vergottinit, këto organe *ad hoc* nuk janë gjë tjetër veçse gjykatat kushtetuese të cilat zotërojnë edhe kompetenca të tjera në funksion të garantimit të kushtetutës (De Vergottini, 2004: 190). Për të realizuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit me kushtetutën, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ashtu si dhe shumë kushtetuta të vendeve të tjera demokratike, kanë krijuar një organ *ad hoc*, që për nga struktura dhe funksionet që kryen, e bëjnë atë sa të ngjashëm, po aq edhe të dallueshëm nga institucionet gjyqësore (Sadushi, 2012: 116). Po ashtu kur Temistocle Martines, flet për Gjykatën Kushtetuese Italiane thotë se Kushtetuta e Italisë (neni 134 e në vijim) ka krijuar një organ *ad hoc* me tipare tipike, (përsa i përket përbërjes dhe funksioneve) që e bëjnë atë të jetë një lloj më vete (Martines, 2011: 332). Këtu është fjala për të gjitha kompetencat e kësaj gjykate, përfshi dhe atë të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Nga ana tjetër në

²Pas rënies së regjimit sovjetik dhe adoptimit të teksteve kushtetuese me orientim demokratiko-liberal nga vendet e Europës Lindore, sistemi i centralizuar u mbajt në thelb nga Polonia dhe Hungaria dhe u fut *ex novo* në Slloveni, Rumani, Rusi, Republikën Çeke dhe Republikën Sllovaqe. Modeli i gjyqtarit të vetëm kushtetues është adoptuar edhe në disa sisteme të tjera edhe pse pa patur një rol të krahasueshëm me ato të gjykatave europiane (Guatemala, Kushtetuta e 1965-ës, n. 262-265; Kili, ligji i reformës kushtetuese i 21 janarit 1970 i lidhur me n. 78 të kushtetutës; Peru, Kushtetuta e 1979, n. 296; Turqi, Kushtetuta e 1961-shit, n. 145-152; Qipro, Kushtetuta e 1960-ës, n. 133-151; Irak, Kushtetuta e 1968-ës, n. 87). Interesante është të përmendet se në Kubë, pas eliminimit të regjimit presidencial dhe futjes së regjimit kastrist, Ligji kushtetues i 7 shkurtit 1959 kishte mbajtur formalisht kontrollin e kushtetutshmërisë që i ishte besuar Gjykatës së Lartë të Drejtësisë duke parashikuar veprimin e drejtpërdrejtë si të organeve publike ashtu edhe të qytetarëve kundër ligjeve jokushtetuese. Një legjislacion i tillë, që rritet atë të parashikuar nga kushtetuta e mëparshme e 1940-ës dhe që nuk rezulton të jetë aplikuar ndonjëherë, nuk është konfirmuar në kushtetutën e 1976-ës. Shih G. de Vergottini, vep.e cit., fq.194

vendimin nr. 11, dt. 06.04.2010, Gjykata Kushtetuese Shqiptare e ka përcaktuar veten: “ si një gjykatë, por si një gjykatë *sui generis*, e cila administron drejtësinë kushtetuese”.

2.1.2.2 Kontrolli abstrakt dhe konkret

Karakteristikë e përbashkët për gjykatat kushtetuese që i përkasin sistemit europian të kontrollit, është fakti se ato me qëllim verifikimin e kushtetutshmërisë së një ligji me kushtetutën, mund të vihen në lëvizje nga autoritete publike apo subjekte politike në kuadër të kontrollit abstrakt si dhe nga gjykatësit e zakonshëm përmes kontrollit konkret - incidental me referim. Përjashtim në këtë pikë bën Gjykata Kushtetuese e Austrisë ku me inisiativën e Kelzenit, u parashikua edhe vetëlëvizja e Gjykatës, pra veprimi i saj *ex officio* për të verifikuar konstitucionalitetin e një ligji (Traja, 2000: 193). Sipas Temistocle Martines, procedura e parë është në rrugë të zakonshme (ose goditje e drejtpërdrejt e ligjit) ndryshe nga e dyta që është e jashtëzakonshme ose incidentale (Martines, 2011: 340).

Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve është një kontroll abstrakt kur çështja e përputhjes së ligjit me Kushtetutën shtrohet jashtë çdo konflikti që mund të jetë në gjykim (nga kjo vjen termi “abstrakt” që i kundërvihet atij që quhet kontroll konkret). Si rrjedhojë, nuk është fjala për një kontroll që ushtrohet si pasojë e një prapësimi, e një objeksioni konkret për një të drejtë të caktuar që është shkelur nga ligji. Ky kontroll abstrakt ushtrohet vetëm nga Gjykata Kushtetuese (Omari, 2004: 242-243). Kjo ka qenë edhe procedura më e vjetër e një gjykimi të tillë kushtetues (Traja, 2000: 62).

Në të kundërt kontrolli konkret - incidental realizohet në rastin kur gjykatësi i zakonshëm, gjatë gjykimit të një çështjeje konkrete, kryesisht ose me kërkesë të palëve, si rezultat i faktit se ligji që duhet të zbatohet me qëllim zgjidhjen e konfliktit konkret, “dyshohet” për antikushtetutshmëri, pezullon çështjen, dhe ia kalon atë (çështjen e kushtetutshmërisë së ligjit në fjalë) Gjykatës Kushtetuese.

Literatura, kryesisht ndarjen në kontroll konkret dhe abstrakt e bën mbi bazën e natyrës së interesit që mbrohet. Kështu, një nga studiuesit kryesor shqiptar, në fushën e Drejtësisë Kushtetuese, Kristaq Traja, kur flet për procedurat abstrakte të drejtësisë kushtetuese, thotë se:

Drejtësia kushtetuese është me karakter objektiv dhe abstrakt, atëherë kur ajo nuk ushtrohet në lidhje me një të drejtë subjektive të individit, por synon një qëllim objektiv, pajtueshmërinë e legjislacionit me kushtetutën, [...]. Në një procedurë objektive dhe abstrakte, roli i individit mungon ose është i dorës së dytë.

[...] Ky është një kontroll abstrakt, sepse objekti i tij janë normat juridike si njësi të përgjithshme dhe abstrakte. Interesi për një kontroll të tillë nuk është më i individit, por i bartësve të funksionit publik (Traja, 2000: 61-66).

Pra, nga ky citim, kuptojmë faktin e rëndësishëm që autori në fjalë, merr si kriter kryesor klasifikimi, llojin apo natyrën e interesit që synon të mbrohet, përmes atakimit të ligjit për antikushtetutshmëri. Një veçori tjetër që hasim në këtë trajtim, është fakti se Traja, me qëllim për t’ju referuar karakteristikës së centralizimit dhe karakterit abstrakt që sistemi evropian i kontrollit paraqet, përdor termin “karakter objektiv”, duke e lidhur kështu drejtpërsëdrejti karakteristikën në fjalë me atë të natyrës së interesit që mbrohet.

Një tjetër studiues shumë i rëndësishëm i fushës, Sokol Sadushi, kur trajton kontrollin e centralizuar të sistemit evropian, i referohet këtij kontrolli si rishikim i

përqendruar dhe thotë se kjo është një mënyrë sipas parimit të traditës së kontinentit evropian, që nënkupton ekzistencën e një organi të lartë dhe të ndarë nga gjykatat e zakonshme, i cili kontrollon pajtueshmërinë e ligjit ose aktit juridik me kushtetutën (Sadushi, 2004: 31). Gjithashtu edhe studiuesi në fjalë për ndarjen e kontrollit në abstrakt dhe konkret bazohet në interesin objektiv - publik apo subjektiv që mbrohet:

Gjatë kontrollit abstrakt Gjykata Kushtetuese, si organi i ngarkuar me ushtrimin e funksioneve të drejtësisë kushtetuese, angazhohet për shqyrtimin "objektiv" të vlefshmërisë ose të pavlefshmërisë kushtetuese të një norme ligjore. Në procedurën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, gjykatën kushtetuese mund ta vënë në lëvizje për arsye të një interesi publik, qoftë dhe pa pasur një interes konkret subjektiv, autoritete të larta shtetërore dhe në veçanti pakica parlamentare. Interesi i këtyre bartësve të funksionit publik, për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet e rëndësishme mbi të cilat funksionon shteti, si: konstitucionalizmi, ndarja e pushteteve, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale, etj., nuk është një interes që mund të kushtëzohet (Sadushi, 2012: 144-145).

Kështu referuar kontrollit abstrakt, mund të themi se paraqitet me këto karakteristika: është kontroll i ushtruar nga një gjykatë e posaçme; kontrolli i ligjit është abstrakt; vihet në lëvizje nga autoritetet publike ose politike, dhe, së fundi, vendimet e saj kanë autoritetin absolut të gjësë së gjykuar (*erga omnes*) (Traja, 2000: 66). Madje vendimi i marrë nga Gjykata Kushtetuese si rezultat i një kontrolli abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit, ka gjithmonë efekt *erga omnes*, ndaj të gjithëve, dhe jo vetëm ndaj palëve të procesit kushtetues (Omari, 2004: 243), meqenëse gjykata vendos jo për një rast të veçantë konkret, por për ligjin në vetvete, *in abstracto*, vendimi i saj ka një karakter absolut, që imponohet *erga omnes*³ (Omari & Anastasi, 2010: 425).

Ndërkohë që, kontrolli konkret i ligjeve ose siç quhet ndryshe kontrolli i tërthortë, lind kryesisht nga procedurat që zhvillohen para një gjykate të zakonshme. Karakteri

³ Këtu bën përjashtim Belgjika dhe Portugalia

subjektiv dhe konkret i drejtësisë kushtetuese, shfaqet edhe ndaj shqyrtimit të ankesave individuale kundër akteve të ndryshme të zbatimit të ligjeve. Megjithatë, në doktrinën dhe jurisprudencën kushtetuese, kontrolli konkret është identifikuar kryesisht me kontrollin që Gjykata Kushtetuese ushtron mbi çështjet që inicohen nga gjykatat e zakonshme. Gjatë kontrollit konkret, ose siç quhet ndryshe kontrolli incidental, gjykata e zakonshme e cila mund të bëhet inicuese e një gjykimi kushtetues, duhet të jetë bindur për antikushtetutshmërinë e ligjit (Gjermani) ⁴ ; të ketë edhe dyshime rreth kësaj antikushtetutshmërie - Itali (Sadushi, 2012: 149); gjyqtari mjafton ta shtrojë çështjen e pajtueshmërisë (Belgjikë); ndërkohë që në Austri rekursin e referimit mund ta ushtrojnë vetëm disa gjykata apeli dhe kasacioni; në Greqi tre gjykatat e larta, Aeropagu, Gjykata e Llogarive dhe Këshilli i Shtetit (Traja, 2000: 59). E ashtu siç thotë dhe Michel Fromont kur analizon në këtë drejtim rastin e Italisë:

Gjykata është kompetente të marrë në shqyrtim të gjitha kërkesat mbi kontrollin e kushtetutshmërisë së një ligji të propozuar nga një gjykatë, e cila duhet të zbatojë këtë ligj për të zgjidhur një mosmarrëveshje, por që ka dyshime mbi përputhjen e tij me Kushtetutën (Fromont, 2009: 61).

Në këtë mënyrë mund të themi se kryesisht shkak për nisjen e kontrollit konkret është dyshimi ose bindja që krijon gjykata e zakonshme gjatë shqyrtimit të një çështje konkrete për kushtetutshmërinë e ligjit, të cilit kërkon t'i referohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes juridike ndërmjet palëve. Prandaj çështja kushtetuese e shtruar për zgjidhje, është një çështje paragjykimore për gjykimin e zakonshëm, e cila lind në mënyrë incidentale (Sadushi, 2012: 149). Kjo është edhe arsyeja pse gjerësisht në literaturë, kur flitet për

⁴Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, BverfGE 1,184

kontrollin “konkret” të sistemit evropian, përdoret termi kontroll *incidental me referim* ose thjesht *incidental*. E në fakt jemi të mendimit se ky është një përdorim më i saktë për dy arsye kryesore: pikë së pari kontrolli kushtetues konkret i ligjit i ka rrënjët në sistemin amerikan dhe së dyti gjykatës së zakonshme në sistemin evropian nuk i lejohet të vendosë vetë për papajtueshmërinë kushtetuese të ligjit specifik, për shkak të përqëndrimit të kësaj të drejte në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese⁵. Këtu dallohet edhe sistemi i centralizuar i kontrollit konkret (parimi i kontinentit evropian), nga sistemi difuz (karakteristikë e sistemit amerikan) (Sadushi, 2012: 149-150). Në këtë mënyrë do të ishim të mendimit se kontrolli konkret është më tipik për sistemin amerikan të kontrollit ndërkohë që ai *incidental me referim* ose thjeshtë *incidental* i përket sistemit evropian. Madje në literaturë shkohet edhe më tej kur pohohet se kontrolli konkret që realizohet nga gjykatat kushtetuese europiane konsiderohet më shumë “abstrakt” sesa “konkret”. Një arsyetim mjaft interesant lidhur me çështjen e gjejmë të trajtuar nga konstitucionalisti shqiptar Sokol Sadushi i cili thotë se pothuajse të gjitha gjykatat kushtetuese europiane dhe më gjerë, e administrojnë kontrollin konkret nëpërmjet ndërthurjes së tij me kontrollin abstrakt. Modeli evropian i kontrollit konkret ushtrohet në mënyrë të centralizuar, me anë të pezullimit që gjykatat e zakonshme i bëjnë çështjes në shqyrtim dhe dërgimit të saj në Gjykatën Kushtetuese, për të

⁵Kur studiuesi shqiptar Luan Omari në librin e tij “Shteti i së Drejtës”, flet për kontrollin konkret thotë se: *Kontrolli konkret ushtrohet në rastin kur, në një gjykatë të zakonshme, është në gjykim një çështje konkrete, dhe gjatë këtij gjykimi gjykata arrin në konkluzionin se ligji, zbatimi i të cilit ka lidhje me çështjen, është antikushtetues. Në sistemin amerikan ku drejtësia kushtetuese është e shpërqëndruar, vendimin për antikushtetueshmërinë e ligjit mund ta marrë çdo gjykatë e zakonshme. Ky vendim konkret quhet edhe kontroll incidental. Në sistemin evropian, përkundrazi, gjykata e zakonshme si rregull, ka vetëm të drejtë të pezullojë gjykimin e çështjes dhe t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi antikushtetueshmërinë eventuale të ligjit. Ky lloj kontrolli konkret i gjykatës së zakonshme quhet edhe kontroll incidental me referim* (Omari, 2004: 243). Nuk do të ishim dakort me një përdorim të tillë, duke qenë se pikërisht gjykatësi i zakonshëm në sistemin evropian pezullon çështjen dhe nuk mund të shprehet për kushtetueshmërinë ose jo të ligjit në asnjë rast. Nuk është ai që realizon një kontroll të tillë, por Gjykata Kushtetuese.

vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjit, që do t'i shërbejë për zgjidhjen e mëtejshme të çështjes konkrete. Në këtë mënyrë, Gjykatat Kushtetuese ushtrojnë kontrollin “konkret”, në një gjykim të kontrollit “abstrakt” të kushtetutshmërisë së normës juridike. Gjykata Kushtetuese i shqyrton referimet nga gjykatat e zakonshme në kuptimin “abstrakt”. Arsyeimi kushtetues, që ajo përdor në këto raste, nuk e dallon këtë lloj gjykimi nga kontrolli abstrakt, që inicohet nga subjektet e tjera kushtetuese. Sidoqoftë, elementi subjektiv ose konkret është i domosdoshëm për të realizuar kontrollin në kuptimin objektiv, për arsye se gjyqtari ose gjykata duhet të argumentojnë lidhjen midis gjykimit konkret dhe ligjit të pretenduar si antikushtetues. Pikërisht, ekzistenca e kësaj lidhje përbën dhe thelbin e ndërthurjes së konkretes me abstrakten, të së drejtës subjektive me të drejtën objektive, të raportit që krijohet ndërmjet gjykatave të zakonshme dhe Gjykatës Kushtetuese. Ky çast përbën një ndërthurje të një elementi të “konkretes” me çështjen “abstrakte”, për arsye se palët në proces dhe vetë gjykata e zakonshme kërkojnë ta zgjidhin çështjen konkrete nëpërmjet një kundërshtimi në abstrakt të ligjit. Përfundimi në të cilën do të arrijë Gjykata Kushtetuese, për antikushtetutshmërinë e ligjit të kundërshtuar, do të shërbejë për të zgjidhur jo vetëm çështjen konkrete të palëve në gjykimin e zakonshëm, por edhe të gjitha çështjet e tjera që mund të jenë në shqyrtim në gjykatat e zakonshme. Një vendim i tillë, duke e nxjerrë ligjin e kundërshtuar nga sistemi juridik, merr njëkohësisht efekte të përgjithshme, për arsye edhe të karakterit objektiv të gjykimit (Sadushi, 2012: 150-151). Doktrina kushtetuese, përdor një argument të ngjashëm kur pohon se në fakt vendimi *inter partes*, në sistemin amerikan, merr efekte të përgjithshme *erga omnes* për shkak të parimit “*stare decisis*” pra të precedentit. Në një farë mënyre kjo do të thotë se asnjë nga sistemet e kontrollit nuk është i pastër dhe se tendencat për gërshetimin e karakteristikave të njërit

me tjetrin, janë tipike për konstitucionalizmin e sotëm modern. I të njëjtit mendim është Kristaq Traja kur pohon se edhe pse përgjithësisht pranohet se ekzistojnë dy modele bazë të drejtësisë kushtetuese, klasifikimi në vetvete është disi i vështirë për shkak të kombinimit të ndryshëm të tipareve të sistemeve të ndryshme në një model ose në një tjetër (Traja, 2000: 41) apo dhe Louis Favoreu kur thotë se në të dy sistemet po tentohet gjithnjë e më shumë drejt kontrollit abstrakt të ligjit (Favoreu, 1992: 8).

Gjithashtu për kontrollin abstrakt dhe konkret ka konsiderata të ndryshme në lidhje me rolin e tyre në funksion të politikës së një vendi. Në këtë drejtim thuhet se në vendet ku kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit është abstrakt, shumica e rasteve për rishikim janë sjellë para Gjykatës Kushtetuese nga opozita parlamentare, një praktikë kjo që rrit mundësinë për “juridiksionimin” e procesit politik (Sweet, 2000: 50). Veçanërisht domethënëse shfaqet e drejta që i është dhënë në disa sisteme, një pjese të parlamentit (1/3 e anëtarëve të *Bundestag*-ut në Gjermani, 1/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar në Austri, pesëdhjetë deputetë ose pesëdhjetë senatorë në Spanjë, 1/10 e anëtarëve të Kuvendit të Republikës në Portugali), që t’i drejtohet gjykatave respektive kushtetuese përmes kontrollit abstrakt, duke goditur ligje për të cilat forcat politike opozitare nuk kanë mundur të pengojnë miratimin e tyre. Ndjekja me mjete gjyqësore e kompetencave politike, bën që minorancat parlamentare ta shohin gjerësisht të vlerësuar funksionin e tyre opozitar duke ju dhënë garanci të rëndësishme kundrejt vendimeve të marra në parlament nga maxhoranca (De Vergottini, 2004: 191). Shpeshësia me të cilën opozita e përdor këtë strategji, ka çuar në mendime se Gjykata Kushtetuese është shndërruar si në një dhomë Senati. E megjithatë

kjo nuk e ka ndaluar gjykatën në përdorimin e fuqisë së saj, për të hedhur poshtë ligjet e Parlamentit (Arjomand, 2008: 108).

Sipas Favoreu në planin politik, zgjedhja mes një kontrolli incidental apo direkt, ka impaktin e vet të rëndësishëm pasi procedimi në rrugë incidentale është më pak “fyes” kundrejt legjislatorit sesa ai në rrugë direkte, dhe i siguron më shumë autonominë (Favoreu, 1992: 5-6).

Dallimi kryesor ndërmjet sistemeve të gjyimit konkret, siç realizohet në gjykatat amerikane, dhe kontrollit abstrakt, që është karakteristikë për shumicën e gjykatave kushtetuese europiane, qëndron te subjektet që inicojnë gjykime të tilla. Kontrolli konkret ka si veçori kryesore se nuk fillon mbi nismën e funksionarëve publikë ose të parlamentarëve. Kështu legjislatorët amerikanë kanë të drejtë të inicojnë procese me natyrë kushtetuese vetëm në rastet kur disa interesa individuale, konkrete, lidhen me detyrën zyrtare që ata kryejnë, por nuk mund ta ushtrojnë këtë mjet juridik si përfaqësues të zgjedhësve. Ata nuk mund të kërkojnë antikushtetutshmërinë e ligjeve që janë miratuar, pavarësisht nga vërejtjet që mund të kenë për to. Mosrealizimi i një mundësie të tillë qëndron në faktin se, kur ligjbërësit amerikanë individualisht mund të jenë të pakënaqur me procesin ligjbërës, nuk e gjejnë zgjidhjen te gjyqësori, por brenda vetë procesit legjislativ. Ndërkohë që ligjvënësit amerikanë nuk mund ta transferojnë te gjykatat hetimin e kushtetutshmërisë së akteve legislative, në gjykatat kushtetuese është e njohur prirja e parlamentarëve dhe e zyrtarëve publikë për të kërkuar në rrugën e kontrollit abstrakt shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjeve (Sadushi, 2012: 163).

Autorë të tjerë mendojnë se ndërkohë që kontrolli abstrakt është një mekanizëm i projektuar për të “goditur” Parlamentin (Sweet, 1992: 60), kontrolli konkret ka për qëllim që të mbrojë të drejtat e njeriut (Ajromand, 2008: 109). Kontrolli abstrakt nuk synon sigurimin e të drejtave kushtetuese të individëve, të cilët nuk kanë të drejtë të nisin një procedurë kontrolli abstrakt, por më shumë zgjidhjen e konflikteve ndërmjet aktorëve të jetës politike e shtetërore, të cilët mund të jenë edhe nismëtarët e një procedure të tillë. Ky është edhe aspekti që ka spikatje të dukshme politike, i cili është konstruktuar shpesh nga nevoja për të mbajtur sistemin e zakonshëm gjyqësor larg presioneve politike (Traja, 2000: 33). Pretendimet për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ka më shumë gjasa që të lindin pas hyrjes në fuqi të një ligji (Sweet, 1992: 113). Padyshim që bëhet fjalë për kontrollin indirekt apo incidental me referim.

Gjithsesi në fund të këtyre konsideratave, e rëndësishme është të themi se shqyrtim gjyqësor ofron një linjë alternative të përgjegjësisë ligjore (më tepër se politike), duke i bërë parlamentarët përgjegjës në një “gjykatë të ligjit”, për veprimet dhe vendimet e tyre. Kërcënimi i një kërkesë të mundshme për shqyrtim gjyqësor është një nxitje e fuqishme për të vepruar ligjërisht, racionalisht dhe në mënyrë të drejtë (Howard, 2013: 107).

2.1.2.2.1 Kontrolli a posteriori dhe a priori

Një konsideratë tjetër e rëndësishme në lidhje me kontrollin abstrakt është fakti se ky kontroll ndahet në *a priori* dhe *a posteriori*, sipas faktit nëse kontrolli i kushtetutshmërisë ushtrohet para apo pas shpalljes dhe hyrjes në fuqi të ligjit. Në këtë

drejtim, në krahasim me sistemin amerikan të kontrollit, ai evropian është më radikal sepse e shfuqizon ligjin në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe kur parashikohet kontrolli *paraprak* ose *a priori* i një ligji, siç ndodh në Francë, ka mundësi që ligji të asgjësohet që në fillim, pa prodhuar ende ndonjë efekt juridik (Omari & Anastasi, 2010: 426).

2.1.2.3 Llojet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe efektet e tyre

Temistocle Martines në librin e tij “Diritto Costituzionale”, pasi trajton gjithë procesin e kontrollit kushtetues të ligjit nga Gjykata Kushtetuese, në fund, me të drejtë shtron çështjen se si mund të përfundojë gjykimi për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit duke e ndarë vendimin që merr në fund Gjykata Kushtetuese në disa kategori: vendim pranimi⁶, nëse pranohet dhe shpallet antikushtetutshmëria e ligjit me Kushtetutën si dhe vendim rrëzimi, me anë të të cilit gjykata nuk e pranon çështjen në themel. Mirëpo vendimet e rrëzimit sipas autorit ndryshe nga të parat, nuk kanë vlerë *erga omnes* dhe as atë të *res judicata*, çka i mundëson subjektet e legjitimuara që të atakojnë përsëri ligjin në fjalë për antikushtetutshmëri, por duke e goditur atë tashmë për të meta të tjera. Efektshmëria e këtij vendimi vlen vetëm (në procesin incidental) lidhur me gjykimin *a quo*, në kuptimin që gjyqtari do të jetë i detyruar të zbatojë ligjin kundër të cilit ishte formuluar çështja. Gjithashtu autori trajton edhe vendimet e interpretimit, të cilat i ndan në vendime pranimi⁷

⁶ Shih vendimin nr. 73/1983; vendimin nr.88/1966; vendimin nr. 223/1983; vendimin nr. 266/1988; vendimin nr. 501/1988; vendimin nr. 1/1991; vendimin nr.124/1991 si dhe nr.390/1991 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë

⁷Shih vendimin nr. 88/1977; vendimin nr. 477/ 1991; vendimin nr. 254/1992; vendimin nr. 343/1992 si dhe vendimin nr. 368/1992 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë

dhe vendime rrëzimi⁸ (Martines, 2005: 402-410). Forma e rishikimit kushtetues mund të jetë me vendim anulues, *ab initio* ose me vendim shfuqizues në perspektivë, *pro futuro*. Lidhur me efektet e vendimeve të gjykatës, të cilat janë të natyrës përfundimtare, të përgjithshme dhe të detyrueshme për të gjithë (*erga omnes*) ato mund të jenë vendime të efekteve *ex tunc*, kur vendimi paraqitet si anulues, pra nul dhe me efekte *ex nunc*, kur vendimi është shfuqizues (Sadushi, 2004: 46).

2.1.3 Veçoritë e kontrollit të kushtetutshmërisë në gjykatat kryesore kushtetuese të sistemit europian

Do të mund të nisnim këtë pjesë të trajtimit tonë duke ngritur pyetjen se cilat janë në fakt tendencat e vërteta për ndjekjen e këtyre modaliteteve të kontrollit të kushtetutshmërisë, nga ana e gjykatave kushtetuese europiane? Për këtë qëllim, pasi bëmë një trajtim të përgjithshëm mbi modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në sistemin europian, le të shohim më konkretisht veçantitë që paraqiten në gjykatat kryesore kushtetuese të kontinentit.

Kjo referuar dhe “paralajmërimit” të Kelzen se është e pamundur të propozohet një zgjidhje uniforme për të gjitha kushtetutat ekzistuese pasi kontrolli kushtetues duhet të organizohet sipas karakteristikave specifike që ka secila prej tyre (Sweet, 2012: 4).

⁸ Shih vendimin nr. 40/1979; vendimin nr. 84/1979 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë

2.1.3.1 Gjykata Kushtetuese Austriake

Le ta fillojmë me Gjykatën Kushtetuese Austriake e cila siç e përmendëm dhe pak më lart, është më e vjetra ndër gjykatat kushtetuese dhe në një farë mënyre dhe modelkrijuesja e drejtësisë kushtetuese evropiane (Traja, 2000: 187). Kontrolli i kushtetutshmërisë nga një organ i veçantë gjyqësor është futur për herë të parë pikërisht në Austri me Gjykatën Kushtetuese Federale, parashikuar në kushtetutën e vitit 1920, e imituar nga kushtetuta çekoslllovake e të njëjtit vit, duke mirëpranuar atë që Hans Kelsen nënkuptonte me një mjet për të garantuar respektimin e kushtetutës (De Vergottini, 2004: 191). Vënia në lëvizje e Gjykatës me nismën e vet, u jep indirekt individëve mundësinë t'i drejtohen që në fillim asaj, për të kërkuar vlerësismin e kushtetutshmërisë së një ligji duke i drejtuar një rekurs kundër një akti administrativ, me arsyetimin se ky akt është nxjerrë mbi bazën e një ligji antikushtetues (Traja, 2004: 194). Aspekt tjetër thelbësor i sistemit austriak është që Gjykata, pas hyrjes në fuqi të ligjit, nëse i njeh antikushtetutshmërinë, prodhon shfuqizim me efekt *erga omnes*, që vepron nga publikimi i vendimit (*ex nunc*) (De Vergottini, 2004: 192).

2.1.3.2 Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane

Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane⁹, e krijuar në vitin 1951, ka shërbyer si model për të gjitha gjykatat kushtetuese të krijuara më pas (Sadushi, 2012: 83). Ligji

⁹Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë nuk është e vetme, për arsye se në çdo land (me përjashtim të Berlinit deri në vitin 1990 dhe aktualisht të Landit të Shlezvig-Holshtajnit), janë krijuar dhe Gjykata Kushtetuese të njëjësive federale. Kompetencat e gjykatave kushtetuese të landeve nuk kanë ndjekur të njëjtin

Themelor i Republikës Federale (neni 93 e në vijim) parashikon si kontrollin abstrakt të ligjit ashtu edhe kontrollin incidental. Kërkesa për kontroll kushtetutshmërie mund të ngrihet nga një autoritet politik (Qeveria e Federatës ose e një Landi, apo çereku i anëtarëve të Bundestag-ut - kundrejt një ligji të nxjerrë qoftë para ashtu edhe pas vitit 1949); nga një gjyqtar i cili është i bindur për antikushtetutshmërinë e një ligji që duhet të zbatohet në një proces gjyqësor, kur ky ligj është shpallur që nga viti 1949; si dhe nga vetë individi në rrugën e rekursit individual për shkeljen e një të drejte themelore, në bazë të antikushtetutshmërisë së një ligji të zbatuar nga gjyqtari. Sipas Michel Fromont rekursit individuale i lejojnë Gjykatës Kushtetuese Federale që të inkorporojë parimet kushtetuese në praktikën e së drejtës së gjykatave (Fromont, 2005: 29). Kjo me të drejtë pasi po t'i referohemi edhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Federale, siç dihet i jepet një rëndësi e veçantë garantimit të të drejtave themelore (Beguin, 1982: 128). Ndër të tjera rekursi individual i kushtetutshmërisë (*Verfassungsbeschwerde*) garantohet më shumë se në sistemin austriak (De Vergottini, 2004: 192). Po sipas Fromont, në këtë drejtim, sistemi gjerman ka më shumë ngjashmëri me sistemin amerikan sesa me atë francez (Fromont, 2005: 29). E në fakt me të drejtë, këtë përafrim mund ta shohim, për ligje të shpallura para vitit 1949, ku gjyqtarit të zakonshëm në sistemin gjerman, i jepet më shumë liri në krahasim me gjyqtarët e tjerë të kontinentit, duke qenë se për këtë kategori ligjesh ai ka të drejtë të mënjanojë zbatimin e ligjit. Më pas i takon individit që përmes rekursit individual, në kuadër të një interpretimi të gabuar të ligjit nga gjykata, t'i drejtohet Gjykatës

model. Kështu, Gjykata Kushtetuese Federale, është e autorizuar të vendosë në të gjitha rastet e kushtetutshmërisë së akteve federale që shqyrton, ndërsa gjykatat kushtetuese të landeve janë të autorizuar të vendosin vetëm për raste të pajtueshmërisë së akteve të landeve me kushtetutat e tyre. Shih S. Sadushi (2012), vep.e cit., fq.83-84

Kushtetuese. Ndërkohë që për ligje që i përkasin periudhës pas vitit 1949, çështja shtrohet në të njëjtën mënyrë si dhe në pjesën tjetër të kontinentit, pra çështja e kushtetutshmërisë së ligjit, dërgohet menjëherë në Gjykatën Kushtetuese (Fromont, 2005: 47-50).

Një veçori tjetër për pushtetin gjyqësor në Gjermani në dallim nga shtetet e tjera që kanë pranuar modelin europian të kontrollit kushtetues, është se Gjykata Kushtetuese Federale konsiderohet pjesë e sistemit gjyqësor (Sadushi, 2012: 86).

Kur gjyqtari kushtetues gjerman, shpall një ligj si antikushtetues, atëherë i takon ligjvënësit që të korigjojë ligjin brenda një afati të caktuar. Një mënyrë tjetër është edhe ajo e interpretimit maksimal konformues. Por interesante është edhe e drejta e Gjykatës, për të nxjerrë rregullore¹⁰ të përkohshme për atë kohë sa ligjvënësi të plotësojë vakumin ligjor të krijuar nga shpallja e antikushtetutshmërisë së ligjit (Fromont, 2005: 50).

Ndryshe prej asaj që është parashikuar në Austri dhe Itali, efektet e shpalljes së antikushtetutshmërisë janë prapavepruese (*ex tunc*) (De Vergottini, 2004: 191). Kur Fromont, flet për kontrollin *a posteriori* të ligjeve, vë përballë modelin austriak, ku vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi *ex nunc*, me atë gjerman me fuqi *ex tunc*, dhe preferon të parin për arsye se modeli gjerman sipas tij, sjell pasiguri juridike (Fromont & Rieg, 1984: 6).

¹⁰ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, BVerfGe 88,203

2.1.3.3 Gjykata Kushtetuese Italiane

Modeli austriak ka patur sukses të dukshëm pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse me ndryshime relevante, u ndoq nga Kushtetuta Italiane e vitit 1948 që parashikoi si kontrollin incidental¹¹ ashtu dhe atë abstrakt (De Vergottini, 2004: 192). Çështjet kushtetuese të ligjeve, të referuara nga gjykatat e zakonshme, të cilat kërkojnë zgjidhje për rastin në shqyrtim, përbëjnë numrin më të madh të çështjeve që zgjidhen nga Gjykata Kushtetuese e Italisë (Sadushi, 2012: 84). Gjykata Kushtetuese italiane pranon që problemi i kushtetutshmërisë së ligjit, të mund të rishqyrtohet me zvellimin e shoqërisë. Kjo shihet si një ndër faktorët përmes të cilit Gjykata Kushtetuese ka kontribuar në modernizimin dhe evoluimin e së drejtës italiane (Fromont, 2005: 62).

Temistocle Martines, kur flet për Gjykatën Kushtetuese Italiane dhe për kontrollin e kushtetutshmërisë thotë se:

Në këtë pikë duhet theksuar se në konsideratë të sistemit të drejtësisë kushtetuese (veçanërisht lidhur me çështjet mbi kushtetutshmërinë e ligjeve) në fuqi në Itali, del se në sistemin tonë subjekti që mendon se është cenuar nga një tjetër subjekt privat ose nga një pushtet publik një situatë juridike subjektive vetjake me rëndësi kushtetuese, do të duhet gjithsesi, për të “gjetur drejtësi” dhe duke qenë se nuk lejohet ankimi individual përpara Gjykatës, t’i drejtohet një gjyqtari të zakonshëm ose të veçantë, sipas rasteve. Do të varet nga ky gjyqtar nëse [...] ligji që njëra nga palët prezumon se vjen në kundërshtim me normën kushtetuese që mbron situatën e tij juridike subjektive objekt të gjykimit, do t’i nënshtohet kontrollit të Gjykatës Kushtetuese (Martinez, 2011: 332-333).

¹¹Kontrolli incidental është një procedurë mjaft komplekse dhe në Itali ajo është më e zhvilluar se në çdo vend tjetër europian. Italia është vendi klasik i referimit paragjykimor. Për të administruar fluksin shumë të madh të këtyre referimeve, Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar kritere pranueshmërie shumë strikte. Shih K.Traja, vep.e cit., fq. 214 e në vijim

Dhe në një moment të dytë, kur flet për procedurën incidentale të kontrollit kushtetues thotë se ankimi i drejtpërdrejtë¹² drejtuar organit të drejtësisë kushtetuese, në rastin kur pushtetet publike shkelin një të drejtë themelore, është parshikuar në Gjermaninë federale (me institutin *Verfassungseschörde*), në Austri, në Spanjë dhe në disa vende të tjera latino – amerikane, me institutin *amparo* (Martines, 2011: 343).

2.1.3.4 Gjykata Kushtetuese Spanjolle

Pikërisht në Spanjë teknika *amparo*¹³ u parashikua për herë të parë nga Kushtetuata e vitit 1931¹⁴. Kur përmes tij goditet posaçërisht ligji për antikushtetutshmëri, specifikisht teknika quhet *amparo contra leyes* (Groppi, 1997: 4339). Veçoria e tij qëndron në faktin se atë mund ta përdorë çdo shtetas që ka një interes të drejtpërdrejtë. Në krahasim me rekursin evropian, *amparo* paraqet dy dallime: së pari është rekurs paralel me rekurset që bëhen në proceset e zakonshme gjyqësore dhe jo rekurs i fundit (pra që përdoret pas shterimit të të

¹²Një e drejtë e tillë është parashikuar së fundmi në disa kushtetuta të Europës Lindore si Hungaria, Republika Çeke dhe Sllovaqe, Rusia, Kroacia dhe Sllovenia. Ndërsa në sistemin polak, ankesa e paraqitur nga individ i është pranueshme vetëm nëse është drejtuar për të anuluar një vendim gjyqësor ose administrativ “definitiv” të krijuar mbi një ligj që mbahet si jokushtetues. Shih G. De Vergottini, vep.e cit.195

¹³ E parashikuar për herë të parë në Kushtetutën e shtetit të Yucatan, të vitit 1841 (nenet 53,63,64) e si rezultat u adoptua nga Kushtetuta meksikane e vitit 1917 (neni 103). Shih G. de Vergottini, vep.e cit. fq.195

¹⁴ Kushtetuta spanjolle e vitit 1931 (n. 121) krijoi Gjykatën e garancive kushtetuese duke i besuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, sikurse edhe apelimin “amparo” (*mrojtje*) të garancive kushtetuese, mjet për mbrojtjen e të drejtave themelore. Kushtetuta e vitit 1978 parashikon një Gjykatë Kushtetuese (n. 159-165), disiplinon kontrollin e kushtetutshmërisë me veprim të drejtpërdrejtë ose në rrugë incidentale të qeverisë, të Avokatit të Popullit, pesëdhjetë deputetëve ose pesëdhjetë senatorëve. Ndër të tjera rifut edhe apelimin *amparo*, në mbrojtje të të drejtave themelore të garantuara nga kushtetuta, të çdo personi fizik dhe juridik që ka një interes legjitim, sikurse edhe të Avokatit të Popullit dhe të Këshillit të Ministrave. Shih G. de Vergottini, vep.e cit. fq.192-193

gjitha mjeteve të tjera procedurale); së dyti, efekti *amparo* nuk mund të jetë *erga omnes* por vetëm ndërmjet palëve në proces (*inter partes*) (Traja, 2000: 38).

Nëse do të na duhej të zbrisnim në disa konsiderata të përgjithshme në lidhje me atë çka u parashtrua pak më sipër, do të ishim dakort me mendimin se: përsa i përket rregullimit ligjor, gjenerata e tretë e gjykatave kushtetuese ka qenë e prirur drejt modelit gjerman. Në shumë vende, rishikimi abstrakt *ex ante* i ligjeve, është zgjeruar drejt shqyrtimit abstrakt *ex post*¹⁵. Shqyrtimi abstrakt ka qenë i bashkuar me shqyrtimin konkret, duke lejuar individët për t'iu drejtuar gjykatave kushtetuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në formën e gjykimit incidental. [...] Megjithëse duket sikur mbrojtja e të drejtave të njeriut është kthyer në një përjashtim, ose të paktën është kufizuar vetëm për disa nga këto të drejta, gjykatat kushtetuese europiane, në kundërshtim me funksionin e tyre origjinal, po shndërrohen gradualisht në gjykata të zakonshme, duke iu përshtatur Gjykatës së Lartë Amerikane. Shtimi i rasteve që shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese Italiane, pas inicimit të kërkesave nga gjykatat e zakonshme në rrugën e gjykimit incidental, trajtimi i ankesave të shumta individuale nga Gjykata Kushtetuese Gjermane, si dhe suksesi i padiskutueshëm i kërkesave ”*amparo*” në Gjykatën Kushtetuese Spanjolle, dëshmojnë për hapësirat që ka marrë kontrolli gjyqësor i ligjeve, por edhe për efektivitetin e ndërhyrjes së gjyqtarit kushtetuese (Sadushi, 2012: 85-86).

¹⁵ Do të jetë objekt studimi e analize, në mënyrë më të plotë, në Kapitullin III të këtij punimi

Gjithashtu ka edhe mendime se në vendet që janë pjesë e sistemit *civil law* të së drejtës, gjykatat kushtetuese vetëm adresojnë kushtetutshmërinë e ligjit në fjalë dhe jo interpretimin e tij nga gjykatat. Një qytetar i cili mendon se të drejtat e tij të garantuara me kushtetutë janë shkelur nga një interpretim antikushtetues i një ligji, nuk ka asnjë rekurs në dispozicion, dhe kështu duhet të mbështetet në vullnetin e mirë të gjykatës, përmes apelimit të saj. Ky duket si një problem i përbashkët i gjykatave kushtetuese kelzeniane (Czamota, 1999: 66).

Për ta mbyllur me mendimin e Favoreu i cili thotë se në Republikën Federale Gjermane ashtu si edhe në Spanjë, individi kundërshton shpesh antikushtetutshmërinë e ligjeve me qëllimin e vetëm për të patur një mundësi më shumë apelimi apo rekursi: gjykata kushtetuese shfaqet në këtë mënyrë si një shkallë e katërt e gjyqësorit dhe shndërrohet në një “super” Gjykatë të Lartë. Me përjashtim të Portugalisë ku ekziston një sistem miks (Favoreu, 1992: 4-5).

2.2 Sistemi amerikan i kontrollit të kushtetutshmërisë

“Konstitucionalizmi është emri që i jepet besimit ose garancisë që përçon tek Populli, sigurinë se ai do të qeveriset sipas ligjit dhe rregullave!”

Walton H. Hamilton

2.2.1 Vështrim i përgjithshëm mbi lindjen e sistemit amerikan të kontrollit

2.2.1.1 Origjinat e idesë së kontrollit të kushtetutshmërisë në sistemin amerikan

2.2.1.1.1 Lindja e idesë së kontrollit të kushtetutshmërisë në Angli

Fillimet e drejtësisë kushtetuese, ashtu si të shumë institucioneve të tjera, i gjejmë në Angli, madje edhe për t'u çuditur, se pikërisht këtu, në vendin e një parlamenti sovran, si askund tjetër, është origjina e idesë se kur ligjet vijnë në kundërshtim me të drejtën e vendit, ato janë të pavlefshme dhe nuk zbatohen. Paradoksalisht, Anglia është djepi i idesë së një institucioni që ajo nuk e ka dhe nuk e ka pranuar as sot dhe kësaj dite. Megjithatë, ashtu siç parashtruam dhe pak më lart, ideja se gjyqtari mund të refuzojë zbatimin e një ligji në kundërshtim me një rregull më të lartë është pikërisht angleze. Që në fillim të shekullit XVII gjyqtari ser Eduard Kok, thoshte se e drejta angleze, *common law*, kishte fuqi juridike më të lartë se ligji mbretëror, duke futur kështu idenë e ligjit më të lartë në vend. Në çështjen Bonham, që u shqyrtua nga gjykata e *Common Pleas*, më 1610, ai dha një vendim në të cilin shkroi: *Leximi i përmbledhëseve tona tregon se, në shumë çështje common law, është mbi ligjet e Parlamentit, dhe se në disa raste ajo i deklaron ato nule e të paqëna; në të vërtetë kur një ligj i Parlamentit është në kundërshtim me një të drejtë të konsakruar nga common law dhe me arsyen, ose e papranueshme ose e pamundëshme për t'u zbatuar, ai shqyrtohet nga pikëpamja e common law dhe deklarohet i pavlefshëm*”. Në këtë çështje,

mendimi i Kokut ishte, se “Kolegji i Mjekëve” të Londrës nuk kishte kompetencë të dënonte z. Bonham për ushtrim pa leje të mjekësisë, sepse ligji që parashikonte dënimin atij i dukej i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me common law. Sipas këtij mendimi, kjo e drejtë, duke qenë monopol i pushtetit gjyqësor, është njëherësh ligji themelor i Mbretërisë dhe mishërimi i arsyes. Në këtë mënyrë, një ligj i Parlamentit, në kundërshtim me “ligjin më të lartë”, duhet të deklarohet i pavlefshëm.

Në Angli ideja e Kokut vazhdoi të mbijetonte edhe deri në fillim të shekullit XVIII, ndonëse më shumë si një ide e arsyeshme, sesa si parim pune. Më 1701, kryegjyqtari Holdt, duke pranuar idenë e supermacisë së ligjit të Parlamentit, përsëri nuk mund të mos thoshte në Westminster se: *“Ajo që ka thënë lordi Kok në vendimin e tij lidhur me çështjen Dr. Bonhamit nuk është aspak e çuditshme, sepse është e arsyeshme dhe e saktë të thuash që, në qoftë se një ligj i Parlamentit urdhëron që i njëjti person të jetë edhe gjyqtar edhe palë, ose që është e njëjta gjë, gjyqtar në çështjen e vet, ai është i pavlefshëm; sepse është e pamundur të jesh gjyqtar dhe palë, pasi gjyqtari duhet të vendosë ndërmjet dy palëve”* (Traja, 2000: 17-19).

Në këtë mënyrë në Angli u përpunua parimi i epërsisë së kushtetutës, në kuptimin modern të fjalës, pavarësisht nga paradoksi se kjo epërsi, e shpallur teorikisht, nuk hyri në praktikën juridike të Anglisë, e cila edhe sot nuk ka një kushtetutë të shkruar që të dallohet nga ligjet e tjera (Omari, 2004: 187). Megjithëse Kushtetuta britanike ka pjesë që janë të shkruara (si Habeas Corpus Act të 1641 dhe 1679), nuk ka marrë asnjëherë përsipër të autorizojë ndonjë gjykatë britanike për të shpallur pavlefshërinë e një akti të Parlamentit

(Anastaplo, 2006: 34). Shqyrtim gjyqësor¹⁶ nuk u mundëson gjykatave që të godasin Aktet e Parlamentit dhe edhe pse mund t'i shqyrtojnë ato për pajtueshmërinë me Human Rights Acts të 1998-ës, nuk kanë fuqi për të lënë mënjanë legjislacioni primar. Megjithatë, gjykatat do të shqyrtojnë nëse aktet apo vendimet e marra nën kompetencën e dhënë me anë të një Akti të Parlamentit, kanë respektuar kriteret dhe kufizimet e vendosura nga Human Rights Acts (Howard, 2013: 106).

Modeli britanik i Kushtetutës jo të ngurtë, që mund të pësojë përshtatje të herëpas'herëshme kur këto duket se kanë një konsensus kombëtar, është një përjashtim në demokracitë perëndimore. Përdorimi i referendumit, pranimi i nënkuptuar i një kufizimi të sovranitetit të Parlamentit me aderimin në traktatet e Bashkimit Europian, kanë bërë që të ngrihen zëra, ndonëse ende të paktë, në favor të krijimit të një gjykate kushtetuese. Megjithatë mungesa e një gjykate të tillë në Britaninë e Madhe, nuk do të thotë se nuk ka asnjë kontroll mbi ligjet. Së pari, gjyqtarët britanikë, përballë ligjit, përdorin interpretimin, që u jep mundësi ta ndryshojnë, në një farë mase, kuptimin e ligjit; Së dyti, shumë norma, sidomos në fushën e lirive dhe të drejtave, nuk burojnë nga Parlamenti, por përbëjnë të drejtën e përgjithshme, të formuar nga gjyqtarët; Së treti, respektimi i Kushtetutës së pashkruar e ka burimin më shumë në garancitë politike dhe morale sesa në ato juridike. Dhe kjo është vlerësuar se përbën njëkohësisht forcën dhe dobësinë e këtij sistemi (Omari, 2004: 188-189).

¹⁶ Është fjala për *judicial review* sipas konceptimit britanik

2.2.1.1.2 Evoluimi dhe konsolidimi i idesë së kontrollit të kushtetutshmërisë në SHBA

Megjithë këto konsiderata për sistemin anglez, mendimi se gjyqtarët mund dhe duhet të veprojnë si mbrojtës të rregullave kushtetuese, arriti të përpunohej dhe konsolidohej vetëm pas krijimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Janë amerikanët ata që sollën të parët konceptin modern për Kushtetutën, por edhe për drejtësinë kushtetuese (Sadushi, 2012: 74). Madje pranohet se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mendimet e shprehura për këtë çështje u kanë paraprirë edhe konsideratave që pat shfaqur në Francë Sieyes (Omari, 2004: 196). Kështu, kur vetë anglezët e braktisën këtë ide, me fitoren përfundimtare të Parlamentit, pas Revolucionit të Lavdishëm të 1688-1689 -ës, kolonët anglezë të Amerikës i mbetën besnikë asaj dhe, duke e zhvilluar realizuan për herë të parë në praktikë funksionimin e saj nëpërmjet sistemit gjyqësor. Në mbrojtje të pavarësisë së kolonive të Anglisë së Re, **Xhejms Otis** dhe **Xhon Adams**, përpunuan konceptin e tyre të kushtetutës, epërsia e së cilës mund të sigurohej vetëm duke pranuar se kur një ligj është në kundërshtim me kushtetutën, ai është i pavlefshëm e i paqënë (Traja, 2000: 18).

Gjithsesi duhet theksuar fakti se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, drejtësia kushtetuese nuk ka qenë parashikuar asnjëherë formalisht si në kushtetutat e shteteve ashtu dhe në Kushtetutën Federale. Kjo e fundit nuk thotë asgjë që Gjykata e Lartë amerikane të ketë të drejtë të shmangë zbatimin e ligjeve federale duke i deklaruar ato të pavlefshme. Asnjë fjalë që të çojë në këtë ide nuk ka në nenin 3 të Kushtetutës, i cili i kushtohet pushtetit gjyqësor. Megjithatë, praktika dhe zakoni kushtetues në shtetet e Amerikës e njihnin dhe e zbatonin idenë e kontrollit të kushtetueshmërisë, ose më saktë të drejtësisë

kushtetuese. Ky kontroll ushtrohej në rradhë të parë mbi pajtueshmërinë e ligjeve të shteteve me kushtetutat e tyre. Disa gjykata shtetesh, sidomos ato të Nju-Xhersit ishin të angazhuara natyrshëm në një veprimtari të tillë, që amerikanët e quajnë *judicial review* (Traja, 2000: 19). Madje edhe vetë Gjykata e Lartë, në jurisprudencën e saj sugjeron se një gjyqësor i ngarkuar me një kushtetutë të shkruar është dyfish i autorizuar si dhe i detyruar të zhvlerësojë masa antikushtetuese (Anastaplo, 2006: 34).

2.2.1.1.2.1 Argumentet e Hamilton dhe Letrat e Federalistit – baza teorike e konstitucionalizmit amerikan

Përsa i përket rishikimit konstitucional federal bazat e tij teorike janë argumentet e Hamiltonit, njërit prej etërve themelues të Kushtetutës amerikane, në letrën nr.78 të Federalistit, në të cilin ai shkruan: “*Njëfarë hutimi lidhur me të drejtën e gjykatave për të shpallur pavlefshërinë e akteve legislative për shkak të qënies së tyre në kundërshtim me Kushtetutën, ka shkaktuar përfytyrimi se kjo doktrinë do të nënkuptonte epërsinë e pushtetit gjyqësor mbi atë ligjvënës*”, dhe më tej “*Një kushtetutë vështrohet në fakt, dhe duhet të vështrohet nga gjyqtarët si ligji themelor. Prandaj u takon këtyre të saktësojnë kuptimin e saj si dhe kuptimin e çdo akti të veçantë që nxjerr organi ligjvënës. Në qoftë se ndodh që të ketë një ndryshim të papajtueshëm ndërmjet tyre, akti që ka detyrueshmërinë më të lartë, sigurisht duhet, të parapëlqehet ose, me fjalë të tjera, Kushtetuta duhet të pranohet para ligjit*” prandaj gjyqtarët “*...duhet t’i japin vendimet e tyre në bazë të ligjit themelor, para se t’i japin ato në bazë të ligjeve që nuk janë themelore*”. Në të vërtetë, kjo e drejtë e

rishikimit gjyqësor është kontestuar nga disa sepse pasazhi i mësipërm nuk përcakton deri në fund, nëse gjykatat amerikane kanë të drejtë të interpretojnë ligjet sipas frymës së Kushtetutës. Për më tepër, po Hamiltoni në letrën nr. 81, i përmbahet mendimit se në projekt Kushtetutë (që në këtë pikë është njëlloj si në Kushtetutën e ratifikuar më pas) nuk ka as edhe një rrokje që t'u japë drejtpërdrejt gjykatave të drejtën t'i interpretojnë ligjet sipas frymës së Kushtetutës (Traja, 2000: 19-20). Të njëjtën gjë mund të themi edhe në rastin e Konfederatës dhe madje ka mendime në literaturë se asnjëherë nuk janë dhënë argumente serioze që justifikojnë rishikimin gjyqësor të akteve të Kongresit për antikushtetueshmëri, bazuar në një parashikim të shprehur apo eksplicit nga vetë hartuesit e Kushtetutës, edhe pse, kjo mund të duket e sugjeruar në letrat e federalistit, nr. 78 dhe 81 (Anastaplo, 2006: 35). Por nuk mungojnë edhe mendimet e kundërta sipas të cilave Aleksandër Hamilton tek Federalisti deklaroi haptazi se qëllimi i themeluesve ka qenë ai që t'ua besonte një kontroll të tillë gjykatave (Favoreu, 1992: 2).

2.2.1.1.2.2 Doktrina e *judicial review* – *Marbury v. Madison*

E pavarësisht këtyre kritikave apo këtij debati, më planin federal idetë e Hamiltonit u morën nga kryegjyqtari Marshall, i cili i vuri ato në themel të doktrinës së tij të *judicial review* federal, përmes vendimit historik *Marbury v. Madison*¹⁷ (1803), ku për herë të parë

¹⁷ Çështja lindi nga një debat politik pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 1800 në të cilat Tomas Xheferson, një demokrato-republikan, mundi Presidentin efektiv, Xhon Adams, njërin prej federalistëve. Në ditët e fundit të administratës së Adamsit, Kongresi që dominohej nga federalistët krijoi një numër vendesh në gjyqësor, përfshi 42 gjykatës për distriktin e Kolumbisë. Senati i konfirmoi këto emërimet, Presidenti i firmosi dhe ishte detyrë e Sekretarit të Shtetit që t'i vuloste mandatet dhe t'ua jepte të emëruarve. Në vrullin e punëve të minutës së fundit, sekretari që po largohej nga posti nuk ua dhe mandatet katër gjykatësve përfshi William Marbury. Xhejms Madison, Sekretar i ri i Shtetit në administratën e Presidentit Xheferson, refuzoi t'ua jepte mandatet, sepse administrata e re ishte “zemëruar” me federalistët që ishin

u mënjanua zbatimi i një ligji federal në kundërshtim me Kushtetutën. I quajtur shpesh vendimi më i rëndësishëm në historinë e Gjykatës Supreme, *Marbury v. Madison* vendosi parimin e rishikimit gjyqësor dhe kompetencën e Gjykatës për të përcaktuar kushtetutshmërinë e ligjit (Vështrim mbi sistemin amerikan të qeverisjes, 2001: 86). Gjykata e Lartë¹⁸ nuk ndoqi rrugën e vërtetimit të emërimit të gjyqtarit të ri, por shkoi më tej: shfuqizoi vetë dispozitën ligjore që i njihte asaj Gjykate të drejtën që ta urdhëronte zbatimin e vendimit të emërimit, duke e cilësuar këtë të drejtë si antikushtetuese. Në këtë mënyrë vendimi i Gjykatës së Lartë, i kapërceu caqet e një konflikti të thjeshtë rreth një emërimi të ligjshëm a të paligjshëm, por u bë një precedent gjyqësor me rëndësi historike, që sanksionoi të drejtën e organit më të lartë gjyqësor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjeve dhe për të shfuqizuar atë ligj ose dispozitë të ligjit që bie në kundërshtim me Kushtetutën. Vendimi i vitit 1803 i Gjykatës së Lartë të

përpjekur ta uzurponin gjyqësorin me anëtarë të partisë së tyre. Marbury ngriti padi në Gjykatën Supreme që kjo ta urdhëronte Madisonin për t'i dhënë mandatin. Nëse Gjykata do t'i jepte të drejtë Marburyt, Madison përsëri mund ta refuzonte dhënien e mandatit dhe Gjykata nuk do kishte forcë për ta vënë udhën në fuqi. Nëse Gjykata nuk do t'i jepte të drejtë Marburyt, ekzistonte rreziku që kompetencat gjyqësore t'u kalonin xhefërsionanëve duke u lejuar kështu që t'ia mohonin Marburyt postin që i takonte ligjërisht. Kryetari i Gjykatës, Xhon Marshall e zgjidhi këtë dilemë duke arritur në përfundimin se Gjykatës Supreme i mungonte kompetenca për të vepruar në një rast të tillë. Marshall deklaroi se paragrafi 13 i Ligjit për Gjyqësorin, në bazë të të cilit Gjykatës i jepej një kompetencë e tillë, ishte jokushtetues pasi e zgjeronte juridiksionin origjinal të Gjykatës jashtë caqeve të juridiksionit të përcaktuar nga vetë Kushtetuta. Duke gjykuar të mos jepte vendim për këtë çështje, Gjykata Supreme i siguroi vetes pozicionin si arbitër përfundimtar i ligjit. Gjykata Supreme iu përmbajt mendimit se “një akt legjislativ i kundërt me Kushtetutën nuk përbën ligj”, mendim që ajo e shtjellon më tej me vërejtjen se “përcaktimi se ç’është ligj është prerazi një domen dhe detyrë e departamentit të gjyqësorit”. Kjo doktrinë mori një zgjerim të mëtejshëm duke mbuluar edhe veprimtarinë e qeverive të shteteve dhe ato vendore. Shih “Vështrim mbi sistemin amerikan të qeverisjes” Zyra e Programeve Ndërkombëtare të Informacionit, 2001, fq.86-92.

¹⁸ Ndaj këtij vendimi të Gjykatës së Lartë në precedentin e famshëm *Marbury vs. Madison*, ka patur edhe kritika ndaj faktit se Gjykata nuk bëri asgjë në këtë rast (pra referuar faktit se nuk i dha zgjidhje konfliktit në fjalë), përveç se këmbënguli se ajo duhet të jetë në gjendje të deklarojë të pavlefshëm për antikushtetutshmëri një akt të “pahijshëm” të Kongresit. Ky insistim nuk u mbështetet nga ndonjë citim i vendimeve përkatëse gjyqësore deri në atë kohë, në traditën kushtetuese anglo-amerikane. Shih G. Anastaplo, vep.e cit., fq.34

SHBA-së plotësonte në këtë mënyrë një zbrazëti të Kushtetutës, e cila siç u tha dhe pak më lart, nuk parashikon kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Kushtetuta e SHBA-së parashikon një Gjykatë të Lartë, por nuk thotë asgjë për përbërjen, numrin e anëtarëve, zgjatjen e mandatit dhe për organet që i emërojnë. Ajo nuk shprehet as për natyrën e kompetencave të Gjykatës, por shtron vetëm parimin e përgjithshëm të epërsisë së legjislacionit federal – Kushtetutë, ligje dhe traktate të Federatës – mbi kushtetutat dhe ligjet e shteteve të federuara, por nuk përcakton mekanizmat me të cilët sigurohen garantimi dhe respektimi i saj (Omari, 2004: 196-197).

Vendimi i Gjykatës së Lartë në këtë rast, e bëri atë sikundër shprehet Robert Dahl *“një institucion politik, një institucion, pra që vendos mbi vendime për çështje polemizuese të politikës kombëtare”*. Sipas këtij vendimi, përderisa gjyqësori shprehet për kuptimin e ligjeve dhe të Kushtetutës, mund të urdhërojë zyrtarët e degëve të tjera të qeverisë, që të zbatojnë kushtetutën në përputhje me interpretimin e bërë nga vetë gjyqtarët. Dhënia e një pushteti të tillë gjyqtarit ishte tronditëse për kohën, sepse dukej se cenonte parimin e ndarjes së pushteteve, nëpërmjet nënshtrimit të degëve legjislative dhe ekzekutive ndaj gjyqësorit. Thënia e kryetarit të Gjykatës Supreme Amerikane, Xhon Marshall, se *“Kushtetutë është ajo që thotë Gjykata e Lartë”* i jepte gjyqtarit amerikan pozicionin e mbrojtësit të Kushtetutës (Sadushi, 2012: 75-76). Me arsyetim e tij Marshalli i kishte hapur rrugën gjykatës drejt njërës prej kompetencave më të fuqishme që mund të kenë institucionet e shtetit – kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe më gjerë drejtësisë kushtetuese (Traja, 2000: 23). Ky është rasti i parë në historinë e drejtësisë kushtetuese amerikane, mbi të cilën u ngrit e gjithë teoria e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit

(Sadushi, 2012: 75-76). Që nga ajo kohë një kontroll i tillë¹⁹ do të vazhdojë duke u konsoliduar në SHBA si dhe duke filluar nga gjysma e shek. XIX do të shfaqet edhe në disa vende të Amerikës Latine, do të aplikohet në vendet skandinave e kryesisht në Norvegji duke filluar që nga viti 1890 (Favoreu, 1992: 2).

Fryma konstitucionaliste në Amerikë pati rrënjë më të thella se kudo gjetiu. Ka disa arsye që shpjegojnë përse SHBA kanë qënë vendi i parë që njohu një sistem juridik që garanton respektimin e Kushtetutës.

Një nga arsyet është konsideruar sundimi në SHBA i “*common law*”, e cila përmbante disa parime që Parlamenti nuk mund t’i cënonte, aq më tepër që nuk ishin vendosur prej tij. Por ndërsa në Britaninë e Madhe kjo nuk çoi në vendosjen e një kontrolli gjyqësor mbi ligjet, në Amerikë çështja u zhvillua ndryshe, sepse kolonët e atjeshëm filluan të konstatojnë se Parlamenti anglez nxirrte shpesh herë ligje që nuk merrnin parasysh interesat e tyre specifike. Kjo bëri që gradualisht amerikanët të prireshin ta konsideronin ligjvënësin anglez si armik të interesave të tyre dhe kështu ta vinin në pikëpyetje ligjin, në vend që ta quanin të shenjtë e të pacënueshëm, siç vlerësohej në vendin amë, në Angli.

¹⁹Shtete të Europës Perëndimore e Veriore (veçanërisht Britania e Madhe, Holanda, Finlanda e Luksenburgut), lëvizën në drejtim të sistemeve të rishikimit gjyqësor. Disa vende skandinave, por edhe vende të tjera si Greqia dhe Zvicra, u përshtatën me modelin amerikan, në dallim nga shtete të tjera europiane që zgjedhën modelin evropian të kontrollit nga një organ që nuk përfshihej brenda piramidës gjyqësore. Për më tepër shih, S.Sadushi (2012), vep. e cit., fq.90-97

Veç kësaj, në këtë frymë, që sa vende zinte rrënjë në Amerikë, ndihmuan edhe teoritë e së drejtës natyrore që e vinin theksin tek epërsia që parimet universale të drejtësisë kishin mbi ligjet pozitive.

Edhe pas shpalljes së pavarësisë, vazhdoi të zhvillohej ky mosbesim kundrejt ligjeve, i cili u mbështet edhe nga doktrinat juridike. Që në vitet e para të pavarësisë mjaft gjykata të Shteteve filluan të shfuqizonin ligje që konsideroheshin prej tyre si në kundërshtim me parimet kushtetuese.

Gjatë përpunimit të Kushtetutës së vitit 1787, hartuesit e saj diskutuan gjatë rreth oportunitetit të krijimit të një kontrolli gjyqësor të kushtetutshmërisë, por, më së fundi, ai nuk u përfshi në Kushtetutë. Por opinioni mbizotërues ishte në favor të një kontrolli të tillë dhe atë që nuk e bëri shprehimisht Kushtetuta e SHBA -së (Omari, 2004: 197-198), - edhe pse këtu gjejmë me vend të nënvizojmë faktin se epërsia e klauzolës së nenit 6 të Kushtetutës amerikane, shpesh herë shihet si bazë për të justifikuar rishikimin gjyqësor të akteve të Kongresit (Anastaplo, 2006: 35), - e bëri vetë Gjykata e Lartë me vendimin e lartpërmendur të vitit 1803, që hyri në histori për rrjedhojat që pati në sistemin kushtetues të vendit (Omari, 2004: 198).

2.2.2 Modalitetet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në sistemin amerikan

Sistemi amerikan i kontrollit të kushtetutshmërisë është bërë pikë referimi për shkencën e së drejtës kushtetuese (Omari, 2004: 198). Siç u trajtua dhe pak më lart, sistemi evropian lindi nga teoritë e juristit Hans Kelzen, ndërkohë që ai amerikan lindi nga praktika (Omari, 2004: 233). Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë edhe përfaqësueset më ideale të sistemit amerikan të kontrollit. Një kontroll i tillë paraqitet me këto karakteristika: i decentralizuar, konkret, *a posteriori* dhe *inter partes*. Pra siç shihet në pamje të parë, ky sistem paraqitet disi më i thjeshtë së ai evropian i kontrollit.

2.2.2.1 Kontrolli i decentralizuar

Kontrolli i kushtetutshmërisë është i decentralizuar, duke qenë se realizohet nga i gjithë sistemi gjyqësor në vend (Omari, 2004: 222). Kjo do të thotë se një e drejtë e tillë realizohet nga çdo gjyqtar, federal ose i shtetit, i çdo shkalle dhe i çdo natyre²⁰ (Traja, 2000: 47). Në rastin e kontrollit të decentralizuar çdo gjyqtar është titullar i fuqisë së verifikimit të përputhshmërisë me kushtetutën të ligjit që duhet të aplikojë (De Vergottini, 2004: 190). Në këtë mënyrë një sistem i tillë çon në forcimin e pushtetit gjyqësor, çka është

²⁰ Studiuesi amerikan Craig Emmert ka bërë një studim interesant në lidhje me veprimtarinë e gjykatave të zakonshme të shteteve të federuara dhe asaj të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në drejtim të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, për periudhën pesëvjeçare 1981-1985. Nga ky studim ai ka nxjerrë numrin si dhe përqindjen e ligjeve të atakuara për antikushtetutshmëri si dhe numrin e përqindjen e atyre ligjeve që janë shpallur si antikushtetuese për periudhën në fjalë. Në përfundim të këtij studimi Emmert ka dalë në konkluzionin se gjykatat shtetërore kanë një mundësi reale për të marrë pjesë në rishikimin gjyqësor të çështjeve në fjalë dhe se roli i tyre shpesh herë është më evident dhe i prekshëm sesa ai i Gjykatës së Lartë amerikane. Kjo sipas tij varet nga disa faktorë siç është për shembull pasigurija e dërgimit të çështjes para Gjykatës së Lartë, duke qenë se vendimi i kësaj të fundit edhe pse me fuqi *inter partes*, do të kthehet në një precedent për të gjithë. Shih Craig F. Emmert, *Judicial review in state supreme courts: Opportunity and activism*- material i paraqitur në Mbledhjen Vjetore të Midwest Political Science Association, Chicago, 1988

e natyrshme në një vend ku zbatohet *common law*, ku gjyqtari mban një pjesë të sovranitetit të shtetit, që është e vështirë të pranohet në vendet ku ka një traditë tjetër juridike, siç është ajo e të drejtës romake (Omari, 2004: 222). Amerikanët ishin të parët që me përpunimin e idesë së kushtetutës së shkruar, rritën ndjeshëm statusin e gjyqësorit duke e veshur atë me një pushtet të fuqishëm kontrolli (Sadushi, 2012: 87). Fuqia e gjyqtarëve amerikanë është kaq e madhe saqë mund të citojmë këtu mendimin e Alexis de Tocqueville sipas të cilit gjyqtari amerikan është një nga fuqitë e para politike (De Tocqueville, 1995: 167) apo mendimin e disa konstitucionalistëve të tjerë që mendojnë se kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në SHBA është konsakruar nga gjyqtari, për gjyqtarin (Grewe & Fabri, 1995: 69).

Doktrina e *judicial review*²¹ ka formuluar parimet themelore që lidhen me kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë. Gjyqtarët në zgjidhjen e çështjeve praktike bazohen në ligjin më të lart, Kushtetutën, si dhe kanë për detyrë që aktet juridike të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, t'i sjellin në pajtim me kushtetutën, ose t'i shmangin në zbatim, kur janë në kundërshtim me të (Sadushi, 2012: 87). Kjo për faktin se ashtu siç përmendem dhe pak më lart, sipas Favoreu, në Amerikë është e shenjtë Kushtetuta, dhe jo ligji, apo siç thotë dhe De Tocqueville: “...kjo është një e drejtë natyrore e çdo gjyqtari” (De Tocqueville, 1956: 75).

Në doktrinë thuhet se kontrolli i decentralizuar mund të konsiderohet si një zgjidhje e ndërmjetme mes sovranitetit parlamentar dhe një gjykate kushtetuese të centralizuar (Rosenfeld & Sajo, 2012: 815).

²¹*Judicial review*, në fillim kishte të bënte me dhënien e urdhërave prerogativë (*certiorari*, *mandamus*), që historikisht janë përdorur nga Këshilli Mbretëror, me qëllim mbikëqyrjen e punës së gjyqtarëve të paqes të cilët kishin përgjegjësi si juridike ashtu dhe administrative brenda lokaliteteve. Shih A. Beale, “Essential Constitutional Law”, Second Edition, Cavendish Publishing Limited, London - Sydney, 1997, f.55

Krahas shembullit klasik të kontrollit të decentralizuar, mjaft interesant është shembulli i Hollandës, i cili konsiderohet si një sistem tejet i decentralizuar kontrolli, pasi nuk ka as gjykatë të veçantë, as gjykatë të lartë me kompetenca të veçanta kontrolli, por çdo gjykatë e sistemit gjyqësor ka të drejtën të rishikojë ligjin (Heringa & Kiiver, 2012: 12).

2.2.2.2 Kontrolli konkret

Kontrolli në SHBA mund të ushtrohet si ndaj ligjit federal ashtu dhe ndaj ligjit të një shteti (Omari, 2004: 227). Ky kontroll është konkret sepse realizohet në kuadër të një çështjeje konkrete, e cila bëhet shkak për një kontroll të tillë. Kjo do të thotë se gjyqtari amerikan vendos për çështje konkrete, në rastet dhe mosmarrëveshjet e veçanta. Kjo kërkesë është shprehur në Kushtetutë (neni 3), sipas së cilës gjykatat e kufizojnë veprimtarinë e tyre në ato që quhen “*cases and controversies*” (Traja, 2000: 48). Referuar kësaj, jemi dakort me mendimin e konstitucionalistit dhe studiuesit Sokol Sadushi, sipas të cilit: “Ndoshta kufizimi më i rëndësishëm kushtetues i pushtetit të gjykatave, është kërkesa për *cases and controversies*, që parashikohet në nenin 3 të Kushtetutës Amerikane” (Sadushi, 2012: 88). Koncepti i çështjes gjyqësore është përcaktuar në praktikë dhe nënkupton respektimin e disa kërkesave rigoroze: që gjykata të pranojë një çështje për gjykim, kërkuesi duhet të justifikojë një interes të tijin ligjor (*standing*); çështja duhet të jetë e pjekur për gjykim, e tillë që interesi të mos jetë abstrakt dhe vetëm i përfytyrueshëm (*ripeness*); që çështja të jetë aktuale (*mootness*) dhe së fundi që çështja të mos ketë karakter politik (*absence of political question doctrine*). Nëse këto kërkesa nuk përmbushen,

gjyqtari nuk e pranon padinë dhe kjo bëhet në bazë të një parimi të ngulitur, sipas të cilit çdo ndërhyrje e gjyqtarit jashtë një rasti konkret konsiderohet uzurpim i pushtetit legjislativ. E ashtu siç thotë dhe De Tocqueville: “*Në qoftë se gjyqtarit do t’i jepej e drejta të diskutonte ligjin mbi bazën e parimeve të përgjithshme teorike, në qoftë se ai do të merrte nismën dhe të korrigjonte ligjvënësin, ai do të luante një rol të dukshëm politik...*” (Traja, 2000: 48). Një term tjetër i përdorur shpesh për probleme të këtij lloji është “*justifikueshmëria*” – domethënë nëse një mosmarrëveshje ose çdo përpjekje tjetër për të kërkuar ndërhyrjen e gjykatës, i mungon njëra nga katër kërkesat për *çështje* ose *mosmarrëveshje*, ajo nuk është e “*justifikuar*” (Sadushi, 2012: 88).

2.2.2.3 Kontrolli a posteriori

Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në sistemin amerikan të kontrollit realizohet *a posteriori*. Për të realizuar kontrollin e kushtetutshmërisë së një ligji, gjykatat nuk mund të vihen vetë në lëvizje (*ex officio*). Gjykatën mund ta venë në lëvizje vetëm palët, kur paraqesin një kërkesë të tillë. Detyra kryesore e gjyqtarit është t’i japë një zgjidhje përfundimtare çështjes që i është paraqitur për shqyrtim, duke disponuar jo vetëm për natyrën ligjore, por edhe mbi natyrën kushtetuese të saj. Një kompetencë e tillë i krijon mundësisë gjyqtarit që, mbi bazën e kërkesës së papajtueshmërisë së ligjit me kushtetutën, të vlerësojë pretendimin e palës, duke mënjанuar për zgjidhjen e çështjes zbatimin e ligjit me përmbajtje antikushtetuese, ose të interpretojë normën juridike në atë mënyrë, që e sjell atë në përputhje me kushtetutën (Sadushi, 2012: 89). Pra siç mund të vihet re, ndryshe nga

sistemi evropian i kontrollit, gjyqtari amerikan nuk e pezullon çështjen por e vazhdon atë duke përdorur *parimin e mënjanimit të zbatimit të ligjit* ose atë të *interpretimit konformues*. Gjithashtu kërkesa për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit në proces, nuk ka karakterin e një çështjeje paragjykimore (si në rastin e kontrollit incidental, ku gjyqtari i zakonshëm ia referon çështjen gjyqtarit kushtetues), por natyrën e përjashtimit osë të prapësimit – mjete këto që janë të zakonshme për proceset ordinare. Përveç prapësimit që është mjeti i përdorur më shpesh, ka edhe mjete të tjera proceduriale më pak të shpeshta, si kërkesa për të nxjerrë një urdhër pezullimi ndaj një akti (*injunction*), këtu bëhet fjalë për një procedurë që aplikohet para se të jetë zbatuar ligji dhe ka karakter preventiv ose sigurimi të interesave të palëve. Mjet tjetër për të shtruar çështjen e kushtetutshmërisë së ligjit është edhe padia deklaratore, nëpërmjet të cilës i kërkohet gjyqtarit të përcaktojë të drejtat e palëve, dhe kur është rasti të shprehet për kushtetutshmërinë e ligjit. Një procedurë e tillë të kujton së largu një lloj kontrolli abstrakt të ligjit, krejt i huaj për gjykatën amerikane, i cili, megjithatë nuk ka atë karakter abstrakt, siç e gjejmë në modelin evropian, sepse ajo e bën këtë kontroll, pasi paraprakisht të ketë vendosur diçka për statusin e palëve, dhe pra, t'i ketë hyrë disi shqyrtimit të çështjes (Traja, 2000: 49).

2.2.2.4 Vendime me fuqi inter partes

Karakteristikë e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, sipas sistemit amerikan është se vendimi që merr gjyqtari për mënjanimin e zbatimit të ligjit, me përmbajtje antikushtetuese, nga zgjidhja e çështjes konkrete, nuk barazohet me shfuqizimin e ligjit dhe me heqjen e tij nga sistemi juridik. Pavarësisht këtij qëndrimi që mban gjyqtari për ligjin me përmbajtje antikushtetuese, vendimi i tij nuk ka fuqi *erga omnes*, por *inter partes*. Një vendim i tillë nuk është i detyrueshëm për gjykatat e tjera dhe as pengesë për vetë gjykatën, për të vlerësuar, në një tjetër rast kushtetutshmërinë e ligjit. Qëndrimet e ndryshme të mbajtura nga gjykatat për vlerësimin e kushtetutshmërisë të të njëjtit ligj, zgjidhen përfundimisht nga GJL nëpërmjet vendimeve të saj, të cilat kanë fuqinë e precedentit (*stare decisis*) (Sadushi, 2012: 89). Kuptohet që këto vendime nuk mund të apelojnë në ndonjë gjykatë tjetër (Vështrim mbi Sistemin Amerikan të Qeverisjes, 2001: 85).

Diçka e tillë u përcaktua që në vendimin e hershëm të GJL, *Martin v. Hunter's Lessee*, 14 U.S. 304 (1816), që përcaktoi epërsinë e pushtetit të GJL mbi gjykatat e larta të shteteve përmes fuqisë së precedentit, duke unifikuar kështu praktikën gjyqësore në të gjithë federatën (Sadushi, 2012: 89).

2.2.3 Disa kritika për sistemin amerikan të kontrollit

Lidhur me atë çka u trajtua pak më sipër, na duhet të theksojmë, se sistemit amerikan i janë bërë disa kritika, pikë së pari, referuar faktit se sjell pasiguri juridike. Kështu, kur Kelsen, fliste për sistemin amerikan shprehej se kontrolli *a posteriori* dhe incidental²² lejon që të ekzistojë për një kohë të gjatë një ndryshim për kushtetueshmërinë e ligjit, çka është në dëm të sigurisë juridike sepse vendimet e gjykatave, përfshi ato të GjL, kanë një vlerë relative dhe konflikti kushtetues mund të rilindë në çdo çast me anë të një procesi gjyqësor (Omari, 2004: 234).

Përballë një kritike të tillë në fakt, do të ishim disi dakort, deri në momentin që nuk është konfirmuar akoma antikushtetutshmëria e ligjit nga Gjykata e Lartë, sepse më pas, mbi bazën e *stare decicis*, do të bëhet edhe unifikimi e njësimi i praktikës gjyqësore.

Gjykata e Lartë në vendimin e saj *S.Clara County v. S.P.R.Company*, 118 U.S. 394 (1886) shprehej në këtë mënyrë:

“Një ligj që bie në kundërshtim me Kushtetutën nuk është fare një ligj, nuk krijon asnjë të drejtë [...], në aspektin juridik ai është null, sikur të mos ishte votuar ndonjëherë” (Bon, Moderne & Rodrigues, 1984: 22).

Në literaturë hasim edhe mendime, dhe me të drejtë në fakt, që për shkak të parimit të precedentit, ajo çka vendoset mes palëve në një proces konkret, duket sikur e kalon fuqinë e vet nga *inter partes* në *erga omnes*. Kështu, studiuesi shqiptar, Omari, duke ju referuar dhe vendimit të cituar më lart, thotë se ky nulitet i ligjit teorikisht, ka efekt vetëm

²² Bëhet fjalë për kontrollin konkret sipas sistemit amerikan

për palët, por në praktikë ai ka efekt edhe për të tretë për shkak të parimit “*stare decisis*” (Omari, 2004: 227).

Sistemit amerikan²³ i bëhen kritika ndaj decentralizimit, edhe pse kontrolli kushtetues është konsoliduar tashmë, pasi garantimi i epërsisë së kushtetutës me anë të një kontrolli gjyqësor të ligjeve, ka shtruar problemin e pushtetit të gjyqtarëve, të legjitimitetit të tij, sepse kontrolli do të thotë pushtet. Po t’u ngarkohet gjyqtarëve ky kontroll, kjo do të thotë që pushteti gjyqësor të ngrihet në një instancë që do të mbikqyrë tërë veprimtarinë politike. Studiues të ndryshëm vazhdojnë arsyetimin duke thënë se ndonëse tani janë të shumta shtetet ku është vendosur një kontroll i tillë, janë ende të pakta ato ku ky funksion kryhet me korrektësi. Prandaj këto raste shërbejnë për të përforcuar argumentimin se organi që duhet ta ushtrojë këtë kontroll nuk është gjyqtari i zakonshëm, por një gjykatë e posaçme, përbërja e së cilës jep maksimumin e garancive të objektivitetit (Omari, 2004: 211-212).

Gjithashtu në literaturë ka akoma mendime (të karakterit kryesisht juridiko-filozofik), që e shohin dhe trajtojnë *judicial review* si një mjet jo dhe aq demokratik (Alexander, 2001: 274). Ndërkohë që nga të tjerë shihet si një formë alternative për të sfiduar veprimet e qeverisë (Ginsburg, 2003: 25), apo si çelësi ndërmjetës konstitucional midis Kongresit, Qeverisë dhe Gjyqësorit. Sipas tyre gjykatat mbajnë nën kontroll kufijtë e

²³ Kur i referohemi këtij sistemi, ajo që të bie gjithashtu në sy është edhe fakti se vetë literatura që trajton drejtësinë kushtetuese amerikane, në shumë pak raste trajton mënyrën e rregullimit të këtij instituti në vende të tjera. Nuk mund të themi të njëjtën gjë për literaturën referuese sistemit evropian, e cila në fakt, pothuajse në çdo rast trajton edhe drejtësinë kushtetuese amerikane. Shih Mary Ann Glendon, “Rights talk: The impoverishment of political discourse”, New York: Free Press, 1991, fq. 70-153

vendosur përmes ligjeve nga Kongresi, dhe gjithashtu imponojnë standartet e tyre të arsyeshmërisë, drejtësisë dhe administrimit të mirë të organeve publike (Howard, 2013: 118).

Nëse do të zbrisnim në disa konsiderata të përgjithshme pas këtij trajtimi, do të thonim se eksperiencat europiane kanë qenë sigurisht në origjinë të një rinovimi për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, ashtu siç nga ana tjetër ky kontroll lindi dhe u zhvillua në SHBA. Teoria e kontrollit kushtetues ka evoluar dhe është transformuar e ndërkohë edhe pse në të dy anët e Atlantikut është arritur në të njëjtin qëllim duke ndjekur rrugë të ndryshme, ka sigurisht ngjashmëri dhe dallime mes dy sistemeve kryesore të kontrollit. Kështu siç dhe pamë, në rastin e SHBA, do të mund të flitet për kontroll të decentralizuar, konkret, *a posteriori* dhe *inter partes*, çka duket sikur mund t’ia kundërvëmë totalisht kontrollit francez i cili paraqitet abstrakt, direkt, *a priori* dhe me efekte absolute (*erga omnes*); kontrolli italian do të prezantohet si kontroll abstrakt, incidental, *a posteriori* dhe *erga omnes*; përse i përket kontrollit gjerman, spanjoll dhe atij portugez, paraqesin njëkohësisht më shumë se një nga këto karakteristika. E megjithatë, rëndësi përbën fakti që nga njëra anë disa modele kontrolli akumulojnë karakteristika të ndryshme marrë nga të dy sistemet, e nga ana tjetër vetë praktika synon të amortizojë diferencat teorike. Kështu në SHBA dhe Kanada, është përhapur praktika e *test cases*, e mosmarrëveshjeve të krijuara artificialisht, me synimin për t’i nënshtruar gjykatave e kryesit GJL, probleme të përgjithshme e të mirëpërcaktuara shoqërore (si për shembull

rastin e lejimit të abortit). Edhe në Republikën Federale Gjermane, përmes zgjedhjes së rasteve të tilla, GJK sjell në vëmendje rastin e rëndësishëm konstitucional që ajo do të trajtojë. Në këtë mënyrë mund të thuhet se nuk “ndodhemi” shumë larg kontrollit abstrakt (Favoreu, 1992: 7-25).

KAPITULLI III: MODALITETET E KONTROLLIT TË KUSHTETUTSHMËRISË SË LIGJIT NË SHQIPËRI

3.1 Kontrolli abstrakt dhe konkret i kushtetutshmërisë së ligjit

3.1.1 Kontrolli abstrakt dhe konkret: disa problematika të legjitimit

Siç kemi parashtruar dhe më lart, Gjykata Kushtetuese e parë në historinë e Shqipërisë, u krijua në vitin 1992. Modeli u mor nga Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë dhe Italisë, me përshtatjet përkatëse (Traja, 2000: 35). Gjykatës Kushtetuese i janë veshur nga Kushtetuta një sërë kompetencash që e bëjnë atë të paraqitet si “gjykatësi suprem” (Sadushi, 2012: 138), mirëpo ashtu siç pohohet gjerësisht në literaturë, funksioni kryesor i saj, i cili do të jetë dhe në fokus të këtij punimi, është padyshim kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit me Kushtetutën, funksion ky që e afirmon Gjykatën Kushtetuese si organin kryesor që kontrollon respektimin e parimit të sovranitetit të popullit dhe atë të shtetit të së drejtës (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 162). Një kontroll i tillë në Shqipëri mbart karakteristikat e sistemit europian të kontrollit. Si i tillë ai paraqitet i centralizuar, abstrakt - direkt, konkret , incidental me referim, *a posteriori* dhe *erga omnes*.

Çështjen e legjitimit (locus standi) Gjykata me të drejtë e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues, qëndrim ky i konsoliduar dhe i ritheksuar së fundmi edhe në vendimet e saj nr. 11/2014, 10/2015, 11/2015, 20/2015, 22/2015, 23/15, 46/2015 si dhe 64/2015. Jurisprudenca kushtetuese shqiptare ka mbajtur një qëndrim uniform lidhur me rëndësinë e legjitimit të subjekteve, e megjithatë në

praktikë janë evidentuar problematika në lidhje me legjitimitimin e tyre, kjo siç do të shihet, kryesisht në drejtim të subjekteve me legjitimitet të kushtëzuar.

Kur në nenin 131/a të Kushtetutës, parashikohet se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, ashtu siç pohohet dhe në literaturë, bëhet fjalë për kontrollin abstrakt të ligjit. Një kontroll i tillë, mund të inicohet me kërkesën e Presidentit të Republikës, Kryeministrit, jo më pak se 1/5 së deputetëve si dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përkatësisht shkronjat **a, b, c**, dhe **ç** të nenit 134 të Kushtetutës, si dhe neni 49/1 i ligjit nr. 8577, dt.10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Por vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese, duke iu referuar po nenit 134/ **dh, e, ë, f** si dhe nenit 49/2 të ligjit organik për GJ K, bëhet me anën e kërkesës edhe të disa subjekteve të tjera si Avokati i Popullit, organeve të qeverisjes vendore, organeve të bashkësive fetare, partive politike dhe organizatave të tjera, me kushtin që subjektet e para e ushtrojnë kërkesën në mënyrë të pakushtëzuar, të ashtuquajtura dhe subjekte të “privileguara” (Rosenfel & Sajo, 2012: 806), ndërsa të fundit në mënyrë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesa të tyre”. Në këtë përfundim, ka arritur vetë GJ K përmes vendimit të saj nr. 49, dt. 31.07.2000, ku thuhet se:

Sipas nenit 134 të Kushtetutës, subjektet që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese ndahen në dy grupe; në subjekte që mund të ushtrojnë kërkesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe në subjekte, që mund të ushtrojnë kërkesë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”. Ky dallim, del nga përmbajtja e pikës 2, të nenit 134 të Kushtetutës [...]

Siç trajtuam dhe në Kapitullin II të këtij punimi, tipari dallues i kërkesës së autoriteteve publike është se, ato vënë në lëvizje një kontroll abstrakt dhe objektiv të ligjit.

Në këtë rast, interesi ligjor që kërkohet të mbrohet nuk është individual, por ka të bëjë me funksionimin e shtetit. Nuk ndodh e njëjta gjë me organet e qeverisjes vendore, të cilat së bashku me Avokatin e Popullit, organet e bashkësive fetare, partitë politike si dhe organizatat e tjera mund të ushtrojnë këtë të drejtë vetëm kur argumentojnë se çështja lidhet me interesat e tyre (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 164). Siç shprehet dhe vetë GJ K në vendimet e saj nr.9, dt.19.03.2008 dhe nr.17, dt.25.07.2008, për këto subjekte ekziston detyrimi për të provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar si dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, për të cilat kërkojnë shpalljen si të papajftueshme me Kushtetutën. Në të njëjtën linjë është edhe vendimi nr. 36/2007, ku GJ K i ka konsideruar organizatat si subjekte që ushtrojnë të drejtën për t'iu drejtuar GJ K, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Mund të citojmë këtu edhe vendimin nr. 35/2007 ku GJ K thotë se:

Çështjen e legjitimitetit të kërkuarit, (locus standi) Gjykata Kushtetuese e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit e veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

E së fundmi në vendimin nr. 43/2015 GJK shprehet:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 134/1 ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kriteri kushtetues i "detyrimit për të justifikuar interesin", i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit të mësipërm, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, subjektet e parashikuara në shkronjat "dh", "e", "ë", "f" dhe "g" të paragrafit 1 të nenit 134, të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, janë subjekte të kushtëzuara. Parashikimi i këtij kriteri kushtetues vetëm për një numër të kufizuar subjektesh kushtetuese, në një interpretim a contrario, do të thotë se ai nuk është i zbatueshëm për subjektet e tjera të parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të pikës 1 të nenit

134 të Kushtetutës, të cilat nuk kanë detyrimin për të justifikuar interesin në rast se i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese²⁴.

Rrethi i subjekteve që duhet të argumentojnë interesin e tyre me çështjen në shqyrtim ka paraqitur një rëndësi të veçantë për jurisprudencën kushtetuese, sidomos në drejtim të përcaktimit të disa kriterëve standarte që duhen përmbushur. Në jurisprudencën kushtetuese janë vërejtur luhatje përsa u përket standarteve të vendosura për legjitimimin e grupit të dytë të këtyre subjekteve të parashikuara në nenin 134. Vendime të tilla janë ato që lidhen me legjitimimin e Avokatit të Popullit, nr. 49/2000 ku në analizën që i bën termit “interes”, GJ K përfshin çështjet që kanë të bëjnë “me organizimin dhe funksionimin e tij, pavarësisht nëse janë vërtetuar pasoja ose jo” - ndërkohë që mungesa e pasojave e bën kontrollin abstrakt - duke e kufizuar “interesin” në cenimin e “statusit të tij si person ose punonjësve të tjerë të institucionit”; vendimi nr. 178/2001 ku “interesi” është kufizuar “në ushtrimin e kompetencave që kanë lidhje me përmbushjen e funksionit të tij”; vendimi nr. 3/2004 ku “interesi” u zgjerua deri në mbrojtje të të drejtave të individëve në fushën e veprimtarisë së administratës publike, por duke përjashtuar nga kompetenca e tij ligjin; e partive politike, si vendimi nr. 32/2010 ku “interesi” lidhet me atë “çka është plotësisht në misionin, qëllimin dhe interesin kryesor të një partie politike”. Përsa i përket pozicionit të organizatave, GJ K në vendimet e saj nr. 16/2008, 17/2008 dhe 31/2009, ka interpretuar se me “organizata të tjera” në kuptim të nenit 134/f, do të kuptohen të gjitha ato shoqata, fondacione, sindikata apo organizma të tjerë që kanë qëllim mbrojtjen e interesave të grupeve të caktuara shoqërore, me qëllime politike, ekonomike, sociale apo çdo qëllim

²⁴ Në mënyrë të ngjashme shih edhe vendimit nr. 22/2015 të GJK

tjetër të ligjshëm. Ndërkohë që një qëndrim të luhatur ajo ka mbajtur në vendimet nr. 7/2010 dhe 3/2005. Ndërsa në vendimin nr. 35/2007, Gjykata është shprehur për mungesën e legjitimitetit kur ka vërejtur se pretendimet e një organizate nuk mbartin interesin për t'u konsideruar si subjekt inicues i gjykimit abstrakt, për çështje të cilat nuk lidhen me veprimtarinë e saj. Jurisprudenca e GJ K nuk duket se i ka identifikuar dhe interpretuar në mënyrë shteruese kriteret bazë për legjitimimin e organizatave në rastet kur ato kërkojnë kontrollin e kushtetutshmërisë. Qëndrimit të mbajtur më parë në jurisprudencën kushtetuese, për moslegjitimimin e organizatave për të inicuar një gjykim të kontrollit abstrakt, pa u konstatuar një cenim në të drejtat kushtetuese, GJ K i është rikthyer përsëri. Kjo ka ndodhur me vendimin nr. 4/2011 ku GJ K është shprehur se pretendimet e subjekteve me legjitimitet të kushtëzuar, kur i referohen parimeve kushtetuese që lidhen me pavarësinë e gjyqësorit, me hierarkinë e akteve normative ose me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive do të duhet të merren në konsideratë vetëm në plotësim të kushtit të kërkuar nga pika 2, e nenit 134, pra vetëm nëse do të rezultonte se kërkuesi kishte një interes real të cenuar nga ligji i kundërshtuar. Në këtë mënyrë, ngushtimi i hapësirës për individin i cili nuk vendoset në të njëjtin pozicion si dhe subjektet e tjera, ka qenë një ndër arsytet që ka nxitur artificialisht disa nga subjektet, që ndodhen më pranë mbrojtjes së interesave të shtetasve, të paraqiten më shpesh para GJ K. Kjo prirje e këtyre subjekteve, për të marrë për çdo rast pozicionin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, ka detyruar GJ K për të qenë sa e hapur në zgjerimin e pakufizuar të rrethit të subjekteve që legjitimohen për t'u paraqitur para saj, aq edhe e vetëpërmbajtur deri në një kufizim të skajshëm të aksesit për një gjykim kushtetues. Në mënyrë graduale, jurisprudenca kushtetuese, duke e interpretuar termin “interes” në funksion të çdo rasti konkret, ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme në

pasurimin e doktrinës kushtetuese. Përsa i përket individit, aksesit i tij në GJ K kushtëzohet me justifikimin e interesit, si një argument për të ngritur vetëm pretendimin për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor (Sadushi, 2012: 282-304).

Në vendimin nr. 10/2014 GJ K analizon se kërkuesi ka iniciuar një gjykim të kontrollit abstrakt dhe, sipas kërkesave të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, për t'u legjitimuar *ratione materiae* ka detyrimin të provojë interesin e tij në lidhje me çështjen, lidhjen e domosdoshme që ekziston ndërmjet misionit që ka dhe marrëdhënies juridike të cenuar nga dispozitat përkatëse të ligjit nr. 109/2013, "Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë". Kërkuesi ishte Unioni i Gjyqtarëve të RSH dhe ku ndër të tjera konkludohet se Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 134, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

Po përsa i përket legjitimitetit të "*organizatave të tjera*", në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mjaft interesant për trajtim është edhe vendimi nr. 7/2010 i GJK, ku Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 4 të nenit 48 të Ligjit nr.9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin nr.10047, datë 24.12.2008. Subjektet e interesuara kanë pretenduar se Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si jokushtetuese të dispozitës së kundërshtuar të Ligjit "Për Avokatinë". Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese rithekson se, në një sërë vendimesh të saj si nr.9/2008, 41/2007, 35/2007, 11/2007 si dhe 9/2007, janë interpretuar kriteret kushtetuese për legjitimitetin e subjekteve që mund ta vënë

atë në lëvizje sipas nenit 134 të Kushtetutës. Bazuar në këtë dispozitë, dhe konkretisht në pikën 1, germa “f”, të saj, Gjykata Kushtetuese, vihet në lëvizje, *inter alia*, me kërkesë të *organizatave të tjera*. Termi “organizata të tjera”, ashtu siç theksohet edhe në vendimet e saj nr. 17/2008 dhe 16/2008, është interpretuar se i referohet shoqatave, fondacioneve apo çdo organizimi tjetër, aktiviteti i të cilave mund të ketë qëllime politike, ekonomike, sociale, apo çdo qëllim tjetër të ligjshëm. Këto organizata e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Për pasojë, ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Parashikuar dhe në vendimin nr. 12/2009, interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Sipas Ligjit 9109, thuhet në vendimin nr. 7/2010, Dhoma Kombëtare e Avokatisë është person juridik që ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur nga shteti. Dhoma përgjigjet për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë. Në nenin 1 të Statutit të saj, parashikohet se Dhoma është bashkim i anëtarëve aktivë dhe jo aktivë të dhomave të avokatisë. Objekti i veprimtarisë së këtij subjekti është “Forcimi i pavarësisë së profesionit të lirë të avokatit; ... Mbrojta e avokatëve nga çdo qëndrim arbitrar ose presion që synon të cenojë pavarësinë e profesionit të avokatit” (neni 6 i Aktit të Themelimit dhe neni 2 i Statutit). Kërkesa, paraqitur Gjykatës Kushtetuese, përmban si argument për jokushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, cenimin e parimeve themelore të lirisë, pavarësisë dhe të vetërregullimit e vetëdrejtimit të Dhomës. Nisur nga lidhja që ekziston ndërmjet objektit të veprimtarisë së Dhomës dhe çështjes së paraqitur për shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konkludon se Dhoma Kombëtare e Avokatisë

legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së saj para Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 134, pika 1, shkronja “f”, dhe pika 2 të Kushtetutës. Lidhur me pretendimin e shkeljes së të drejtës kushtetuese të organizimit kolektiv të individëve, parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës, kërkuesi ka pretenduar se pika 4 e nenit 48 cenon të drejtën e avokatëve për t’u organizuar dhe për të funksionuar si shoqatë e pavarur jofitimprurëse. Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në esencë, kërkuesi pretendon papajtueshmërinë e kësaj dispozite me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 11 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Neni 46 i Kushtetutës, ashtu si edhe neni 11 i KEDNJ-së, sanksionon të drejtën e organizimit kolektiv të individëve për çfarëdo qëllimi të ligjshëm, çka nënkupton se çdo person mund të bashkohet me të tjerë, me vullnet të lirë dhe pa ndërhyrjen e shtetit, për të arritur një qëllim të përbashkët të caktuar. Organizimet që hyjnë në fushën e veprimit të këtyre dispozitave karakterizohen nga “karakteri vullnetar”, gjë që nënkupton se një individ nuk mund të detyrohet të bëjë pjesë në shoqata. Por, Gjykata Kushtetuese thekson se jo të gjitha organizatat janë shoqata në kuptimin e dispozitave të mësipërme. Në kontekstin industrial ose profesional, liria e organizmit vullnetar në shoqata zbatohet vetëm për organizatat e të drejtës private. Shoqatat profesionale dhe të tjera që përcaktohen nga Shteti dhe qeverisen nga e drejta publike, në parim, dalin jashtë fushës së veprimit të kësaj dispozite, pasi këto organizma janë pjesë e kuadrit rregullues dhe veprojnë në interesin publik për të siguruar ruajtjen e standardeve profesionale. Gjykata Kushtetuese vlerëson se një organ rregullues si Dhoma e Avokatisë nuk mund të konsiderohet si shoqatë në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës, sepse ky organizëm nuk është krijuar në ushtrim të të drejtës kushtetuese individuale të organizimit kolektiv²⁵. Në këtë vendim GJK duket sikur ka

²⁵ Shih më tepër vendimin nr.7/2010 të GJK

përdorur dy standarte duke qenë se nga njëra anë e legjitimon kërkesin në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, por jo në kuptim të nenit 46 të saj. Ajo çka është pozitive në këtë trajtim është fakti që GJK ka qenë konform qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen e ngjashme *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, ku është shqyrtuar statusi i Dhomës së Mjekëve në Belgjikë²⁶. Në fakt, GJEDNJ, ka mbajtur një qëndrim të njëjtë edhe në vendimet *O.V.R. kundër Rosisë* në lidhje me dhomat ruse të noterisë dhe *Popov e të tjerët, Vakarelova, Markov e Bankov kundër Bullgarisë* në lidhje me dy organizata profesionale bullgare të dentistëve dhe të doktorëve, vendime ku konkludohet se organet rregulluese të profesioneve të lira nuk janë shoqata në kuptimin e nenit 11 të Konventës. Qëndrim të njëjtë ka mbajtur GJEDNJ edhe në vendimin *Dhoma Kombëtare e Noterisë kundër Shqipërisë*, ku Gjykata shprehet se organet rregulluese të profesioneve të lira nuk janë shoqata në kuptimin e nenit 11 të Konventës dhe se këto subjekte nuk mund t'i ngjasojnë shoqatave të së drejtës private apo sindikatave, por mbeten të integruara brenda strukturave të shtetit²⁷.

Nga ana tjetër, në vendimet nr. 9/2007; 11/2007; 35/2007; 40/2007; 41/2007; 9/2008; 16/2008; 12/2009; 7/2010; 11/2010; 29/2010 si dhe 30/2015 GJ K ka theksuar faktin se interesi që duhet provuar duhet të jetë i drejtëpërdrejtë, vetjak dhe i ligjshëm. Një konkretizim të tillë ajo e ka bërë në vendimin e saj nr. 33/2010, ku nuk ka legjitimuar Avokatin e Popullit për arsye se ky i fundit nuk arriti të provojë që të drejtat e rregulluara nga ligji i atakuar për antikushtetutshmëri, ishin objekt i veprimtarisë konkrete të tij.

²⁶ Shih më tepër vendimin *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, të GJEDNJ, dt.23.06.1981

²⁷ Shih vendimin *Dhoma Kombëtare e Noterisë kundër Shqipërisë*, të GJEDNJ, dt.06.05.2008

Mirëpo problemi që shtrohet në këtë rast është ai që ka të bëjë me faktin, nëse subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” do të vënë në lëvizje Gjykatën, në kuptim të kontrollit abstrakt apo konkret? Kështu, në vendimin nr. 17/2008 veç të tjerash GJ K është shprehur në këtë mënyrë:

[...] procedurën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, në aspektin formal, mund ta vënë në lëvizje, për arsye të një interes publik qoftë dhe pa patur një interes konkret subjektiv, vetëm autoritete të larta shtetërore, (subjektet e parashikuara nga neni 134/1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të Kushtetutës). Pra, kushtetutbërësi ka legjitimuar për të vënë në lëvizje Gjykatën në lidhje me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës vetëm katër subjektet e parë të listuar në pikën 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ky kontroll nuk ushtrohet në lidhje me një të drejtë subjektive të individit, por për një ballafaqim ndërmjet akteve normative me Kushtetutën. Mbi këtë bazë, të gjithë subjektet e tjerë, që parashikohen në nenin 134/1, shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f”, dhe “g”, i drejtohen Gjykatës në kuptim të kontrollit konkret të kushtetutshmërisë së normës juridike.

Përsa i përket legjitimitit të subjekteve, të cilëve u kërkohet interesi i tyre me çështjen, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjektit si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike. Pra interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real apo potencial dhe jo tek premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit.

Nga ana tjetër, po në këtë vendim të GJ K ka qenë edhe mendimi i pakicës i cili është shprehur në favor të legjitimitit të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike me kërkesën e shoqatës në fjalë.

Të njëjtën linjë arsyetimi, Gjykata Kushtetuese ka përdorur edhe në vendimin nr. 4/2011, ku veç të tjerash ajo ka shtuar se: “Për të treguar që ka legjitimitet, subjekti inicues ka detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet interesit ligjor që ai ka dhe çështjes kushtetuese të ngritur”. E në fund të arsyetimit të saj ka konkluduar:

Ndaj Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet si subjekt për të inicuar kontrollin kushtetues të ligjit objekt shqyrtimi lidhur me pretendimet për cenim të të

drejtave për një proces të rregullt ligjor, të drejtës së pronës dhe të së drejtës për mbrojtjen e jetës private.

Edhe në këtë rast ka patur mendim pakice ku është konstatuar moskoherenca e vendimit në lidhje me legjitimimin, si më poshtë vijon:

Nga njëra anë, shumica ka arritur në përfundimin “se kërkuesi legjitimohet si subjekt për të inicuar kontrollin kushtetues të ligjit objekt shqyrtimi, lidhur me pretendimet për cenim të të drejtave për një proces të rregullt ligjor, të drejtës së pronës dhe të së drejtës për mbrojtjen e jetës private”, ndërkohë që, nga ana tjetër, ka konkluduar se këto pretendime do të merreshin në konsideratë “vetëm nëse do të rezultonte se kërkuesi kishte një interes real të cenuar nga ligji i kundërshtuar.”

E kundërta ka ndodhur në vendimin nr. 1/2005, ku është legjitimuar kërkuesi me argumentimin se:

Për Gjykatën Kushtetuese është i njohur rregulli i pranuar në doktrinë dhe në jurisprudencën kushtetuese, se gjatë kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme juridike nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar kërkuesin. Tipari dallues i një kërkesë të tillë është se ajo vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të ligjit, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por është një interes që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre. Ky është dhe një qëndrim i mbajtur edhe në jurisprudencën tonë kushtetuese.

Ndërkohë që mendimi i pakicës ka qenë si më poshtë:

As në kërkesë dhe as në seancë gjyqësore, kërkuesi nuk paraqiti argumente për të provuar interesin e tij konkret dhe të drejtpërdrejtë për këtë çështje, ashtu siç kërkon paragrafi i dytë i nenit 134 të Kushtetutës. Thjesht fakti i të qenit parti politike është i pamjaftueshëm për të justifikuar automatikisht interesin e kërkuesit për të kërkuar në Gjykatën Kushtetuese të deklarojë si antikushtetues çdo lloj dispozite ligjore lidhur me procesin zgjedhor. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të kërkojë vetë argumente për ta gjetur këtë interes. Argumenti i kërkuesit për cënimin ose jo në këtë rast të parimit kushtetues të barazisë midis shtetasve, është hipotetik dhe nuk përbën interes të drejtpërdrejtë të tij si parti politike.

Për të gjitha këto arsye të parashtruara, duke iu referuar dhe faktit se GJ K nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim për interpretimin e “interetit” të subjekteve në fjalë, çka është shumë i rëndësishëm jo vetëm për legjitimitimin e tyre por edhe për klasifikimin e një kontrolli si konkret apo abstrakt, jemi të mendimit se përsa kohë nuk kemi një qëndrim të konsoliduar, çështja duhet të shihet rast pas rasti, pasi në disa raste shpallja e një ligji si antikushtetues, prevalon mbi moslegjitimitimin e një subjekti, për shkak të arsyeve të parashtruara më sipër. I tillë është rasti i ligjit ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, në lidhje me të cilin mendimi i pakicës në vendimin nr. 4/2011 është shprehur se:

Nxjerrja e këtij ligji kaq të rëndësishëm, por në shkelje të standardeve kushtetuese, nuk arrin t'i shërbejë as qëllimit, për të cilin ai është miratuar. Prandaj, shpallja si antikushtetues i ligjit objekt shqyrtimi dhe miratimi nga ligjvënësi i një ligji tjetër, në respekt të normave kushtetuese, do të ishte zgjidhja më e drejtë për të parandaluar dhe për të goditur krimin e organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet marrjes së masave parandaluese kundër pasurisë.

Problematikë ka paraqitur edhe legjitimitimi i Avokatit të Popullit, ku në vendimin nr. 178/2001 dhe 2/2004, ky i fundit nuk është legjitimuar për shfuqizimin e ligjeve respektive si antikushtetuese. Në vendimin nr. 2/2004 argumenti i GJ K ka qenë:

Dispozitat e ligjit që kërkohet të shfuqizohen trajtojnë çështje të fushës së doganave. Ato nuk kanë lidhje me organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk e prekin atë. Në këto kushte, Avokati i Popullit në kuptim të nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, nuk legjitimohet në paraqitjen e kërkesës sepse ajo nuk ka lidhje me interesat e tij.

Ndërkohë, gjyqtarët që kanë patur mendim pakice, me të drejtë kanë shtruar pyetjen:

Kur Avokati i Poullit i cili është në gjendje të vlerësojë paligjshmërinë e një veprimi të administratës publike, krijon bindje se kjo paligjshmëri që ka cenuar individin, rrjedh nga antikushtetutshmëria e ligjit të zbatuar, atëherë a mund të heshtë ai, apo duhet të ndërhyjë që shtetasit të mos dhunohen në të drejtat e tyre?

Ata shtojnë se në konceptin kushtetues të veprimeve të paligjshme të administratës publike përfshihen edhe ato raste kur organet administrative, nëpërmjet zbatimit të një ligji që mund të jetë antikushtetues, cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve (Sadushi, 2012: 290). E në fakt, nuk mund të mos jemi dakort me një mendim të tillë. Nga ana tjetër, këtij koncepti i kanë qendruar edhe studiues të doktrinës kushtetuese shqiptare, kur kanë theksuar se Avokati i Popullit “mund të kërkojë vetëm shqyrtimin e ligjit antikushtetues që është bërë bazë e cënimit të të drejtave të individit nëpërmjet akteve të administratës²⁸”. Pas disa vendimeve që nuk legjitimonin Avokatin e Popullit, në vendimin nr. 40/2007, GJ K e pa me vend të ndalet edhe njëherë në përcaktimin e konceptit “interes”, duke i dhënë një kuptim më të zgjeruar legjitimitetit të këtij institucioni kushtetues. Ajo pranoi si të drejtë mendimin e shfaqur më parë nga gjyqtarët në pakicë, duke modifikuar në këtë rast qëndrimin e shumicës. Kur Avokati i Popullit, nënvizon GJ në këtë vendim, krijon bindjen se shkelja ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së një ligji [...] atëherë ai mund të investojë GJK duke kërkuar shfuqizimin e aktit si antikushtetues”. Në raste të kësaj natyre çështja nuk mund të mos jetë e lidhur me interesin e këtij organi kushtetues, që është ngarkuar nga Kushtetuta për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit. Nga ky këndvështrim, legjitimimi i tij “duhet të shqyrtohet rast pas rasti, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës, i cili e ka renditur këtë organ, në grupin e subjekteve që i drejtohen GJ K, vetëm nëse justifikojnë interesin e tyre në çështjen konkrete”. Shqyrtimi rast pas rasti i interesit të Avokatit të Popullit, për të vënë në lëvizje GJ K, përbën shtratin kryesor mbi të

²⁸ Për më tepër shih, K. Traja, vep.e cit., 263 e në vijim

cilin është orientuar jurisprudenca kushtetuese për legjitimimn e këtij subjekti (Sadushi, 2012: 290-291). Kështu në vendimet nr. 40/2007, 10/2013, 14/2013 GJK ka theksuar një qendrim të tillë:

Po në funksion të legjitimit rationae materie, Gjykata ka theksuar se interesi i Avokatit të Popullit për ta vënë atë në lëvizje, shqyrtohet rast pas rasti. Ky interes do të quhet i justifikuar nëse arrin të provohet se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rasti, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit.

Referuar këtij trajtimi GJK së fundmi në vendimin nr. 30/2015 nuk ka legjitimuar Avokatin e Popullit për arsye se ky i fundit nuk ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis interesit institucional apo funksionit kushtetues që kryen dhe dispozitës ligjore, që atakohej për antikushtetutshmëri, duke mos arritur të provojë një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak në çështjen konkrete. Interesant ky vendim paraqitet edhe në kuadër të interpretimit që i bëhet nenit 134 në lidhje me legjitimimin e Avokatit të Popullit kur thuhet se: “Neni 134/1, shkronja “dh”, i Kushtetutës, e ka vendosur Avokatin e Popullit në rrethin e subjekteve që mund të iniciojnë një gjykim kushtetues abstrakt të normës, por sipas pikës 2 të po këtij neni, kjo e drejtë kufizohet vetëm për çështjet që lidhen me interesat e këtij subjekti”.

Nga analiza jurisprudenciale referuar çështjes së “interesit” të Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kjo e fundit në vendimet e saj nr. 27/2010, 29/2010, 20/2014, 30/2015 konkludon se interesi i Avokatit të Popullit duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur, si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve, apo kur shkelja e të drejtave, lirive dhe interesave të

individit vjen si rezultat i vetë përmbajtjes së ligjeve, pra kur ato janë në kundërshtim me Kushtetutën; këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij; në këtë rast ai ka të drejtë t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të propozojnë ndryshime për përmirësimin e ligjeve ose të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e akteve të tilla. Kompetenca e Avokatit të Popullit për t’iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë, që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike. dhe është në diskrecionin e tij të zgjedhë mjetet e nevojshme për mbrojtjen e individëve, nëse një normë është *prima facie* antikushtetuese.

Përsa u përket katër subjekteve të para të parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës, kjo e fundit u ka njohur këtyre organeve të larta shtetërore, një pozicion të privilegjuar, pa qenë i nevojshëm vërtetimi i interesit për çështjen në shqyrtim. Kushtetuta ka pranuar se interesi i bartësve të funksionit publik, që u është njohur këtyre subjekteve, me qëllim mbrojtjen e sistemit normativ dhe parimet shtetformuese si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale, etj. nuk mund të kushtëzohet, gjë që është shprehur në disa vendime të GJ K si vendimi nr. 8/2000, 26/2001, 27/2001, 33/2001, 28/2002, 2/2005, 20/2007, 36/2007, 18/2008, si dhe 9/2010, 16/2015 apo 20/2015. Proceset kushtetuese që kanë për inicues këto subjekte synojnë të mbrojnë objektivisht “jetën e shtetit dhe të së drejtës” dhe jo aspekte subjektive private. Këto subjekte përjashtohen nga detyrimi për të provuar ekzistencën e interesit para GJ K, për shkak se Kushtetuta e prezumon interesin e tyre, duke i konsideruar ata përfaqësues të interesave të larta të

funksionimit të shtetit dhe të mbrojtjes së interesit publik. Prandaj ndërhyrja e këtyre subjekteve në këtë proces është në të mirë të kushtetutshmërisë dhe nuk i nënshtrohet ndonjë kriteri kufizues. Ato mund të venë në lëvizje GJ K për të gjitha çështjet që përfshihen në juridiksionin e saj, si për kontrollin *ex post facto* ashtu edhe *ex ante*, pa kufizime (Sadushi, 2012: 276-277). Edhe vendimet e GJK nr. 9/2010 dhe 12/2009 kanë qenë të rëndësishme në drejtim të legjitimitetit të pakushtëzuar të subjekteve në fjalë.

Mirëpo ndryshe është paraqitur situata në vendimin nr. 25/2012 ku GJ K, nuk ka legjitimuar jo më pak se 1/5 e deputetëve për shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 3, 5, 6, dhe 8 të ligjit nr. 10.449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”, vendim ky i cili ka patur një mendim paralel dhe tre mendime pakice, ku në të fundit gjyqtarja në fjalë ka konkluduar se:

Arsyetimi i shumicës për të pasur “qëllim dhe nxitje konkrete” përbën një kriter të ri, tej atyre të përcaktuara shprehimisht nga Kushtetuta që duhet të plotësohen nga jo më pak se një e pesta e deputetëve për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues në çështje me objekt shfuqizimin e ligjit. Përpunimi i këtyre kriterëve të reja, ka çuar, si rrjedhojë, në moslegjitimimin për herë të parë të jo më pak se një të pestës së deputetëve të cilët kërkojnë shfuqizimin e ligjit në referim të nenit 131, pika 1, germa “a”, duke ndryshuar, kështu, në mënyrë të paargumentuar qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës kushtetuese lidhur me legjitimimin e pakushtëzuar të kësaj kategorie subjektesh si dhe garancitë kushtetuese që gëzojnë pakicat parlamentare.

Kundër vendimit të GJ K, është shprehur edhe doktrina shqiptare. Kështu studiuesi dhe konstitucionalisti i njohur, Sokol Sadushi, është i mendimit se një qëndrim i tillë i mbajtur nga jurisprudenca kushtetuese në Shqipëri, nuk është i pranueshëm për konceptin modern të drejtësisë kushtetuese europiane. Ai është dakort me mendimin e Xhezair Zaganjorit i cili në librin “Demokracia dhe shteti i së drejtës” duke evidentuar kontributin e

rëndësishëm të GJ K F GJ për mbrojtjen e “rendit juridik nga ligjet që bien në kundërshtim me ligjin themelor” ka vënë në pah se “kjo kompetencë, ndër të tjera i krijon mundësi reale veçanërisht opozitës që të jetë sa më aktive”. Duke mbrojtur tezën e moskushtëzimit të të drejtës së pakicës parlamentare për të vënë në lëvizje GJ K, autori i referohet një studiuesi gjerman i cili nënvizon: “Po të hiqej kjo e drejtë (pra mundësia e paraqitjes nga opozita në GJ K të çështjeve lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve – XH. Z.), klima ndërmjet pozitës dhe opozitës do të hysterizohej. Përmes saj opozita, i kujton pozitës se në demokraci pushteti kufizohet me ligj” (Sadushi, 2012: 279-280).

Po ashtu së fundmi në vendimin nr. 43/2015 e në mënyrë të ngjashme edhe në vendimin nr. 20/2015, GJK shprehet:

Çështja e legjitimitetit (locus standi) të një të pestës së deputetëve ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë edhe në raste të tjera, në të cilat ajo në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se një e pesta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1, shkronja “c”, të Kushtetutës, të cilat kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (shih vendimin nr.9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si: konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (shih vendimin nr.18, datë 29.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

Përsa i përket të ashtuquajturave “subjekte të interesura” në kuptim të nenit 39/b, c të ligjit organik, GJ K duket se ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar, ku në vendimet nr. 29/2009 dhe 9/2010 është shprehur se është në diskrecion të saj të vendosë mbi kategorinë e subjekteve të tilla që thirren në çështje me interes publik dhe se këto subjekte marrin një cilësim të tillë pasi për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes, pavarësisht nëse thirren me kërkesë të kërkuarit apo kryesisht nga Gjykata.

Problemet e legjitimitetit, të trajtuara më sipër, vijnë edhe nga fakti se si në doktrinën ashtu dhe jurisprudencën kushtetuese, kontrolli konkret është identifikuar me kontrollin që GJ K ushtron mbi çështjet që inicohen nga gjykatat e zakonshme. Prandaj gjejmë me vend të nënvizojmë faktin që nëse subjektet e veçanta private ose shtetërore, do të kërkojnë të realizojnë kontrollin abstrakt, do të duhet të provojnë legjitimitetin e tyre përpara GJ K, duke argumentuar interesin që kanë, të lidhur me çështjen në shqyrtim. Në raste të kësaj natyre, këto subjekte nuk do t'i drejtohen GJ K në kuptim të kontrollit abstrakt, por të atij konkret (Sadushi, 2012: 145). Për këtë arsye, duke qenë se siç e theksuam dhe në fillim të trajtimit tonë, kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit nga GJ K përbën edhe funksionin kryesor të saj, zbatimi i tij kërkon pasjen e një kuptimi të drejtë dhe të qartë në rradhë të parë nga subjektet që inicojnë procesin kushtetues, për të cilët nuk paraqitet vetëm si një e drejtë e tyre për ta ushtruar, por njëkohësisht edhe si një detyrim, me qëllim që ligjet të cilët mbajnë antikushtetutshmëri të mos i shmangen këtij kontrolli kushtetues, qoftë për arsye të afatit të parashkrimit (neni 50 i ligjit organik), ashtu edhe të pasivitetit të këtyre subjekteve (Sadushi, 2004: 80-81).

Përsa i përket vënies në lëvizje të GJ K *ex officio*²⁹, Kushtetuta ka mbajtur qëndrim të njëjtë me ato të shumicës së vendeve të sistemit europian, ku nuk parashikohet diçka e tillë, duke qenë se siç pranohet dhe gjerësisht në doktrinë, kjo mund të cenojë pushtetin legjislativ. Një qëndrim i tillë është i ndryshëm nga ai që parashikohej në neni 25 të ligjit nr. 7561, dt.29.04.1992 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

²⁹ Shih vendimet nr.8/1992; 1/1996; 4/1997; 34/1996; 13/1997; 55/1997; si dhe 4/1995 të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare

3.1.1.1 Kontrolli i kushtetutshmërisë për kategori të veçanta ligjesh

Sipas nenit 51 të ligjit organik për GJ K, kjo e fundit gjatë shqyrtimit të kërkesave të inicuar nga subjektet e trajtuar më sipër, vlerëson përmbajtjen, formën, procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të ligjit. Ashtu siç trajton doktrina kushtetuese dhe konkretizohet nga jurisprudenca, përjashtim nga kontrolli kushtetues nuk bëjnë as kategori të caktuara të ligjeve, siç janë ligjet që nxirren në periudha emergjente, fatkeqësie natyrore ose gjendjeje të jashtëzakonshme, sepse një qëndrim i kundërt është i prirur të krijojë rrezik me shpërdorimin e këtyre instrumenteve. Këto ligje, pavarësisht nga momenti ose rrethanat që ndikojnë në nxjerrjen e tyre, do të konsiderohen njëloj si ligjet e tjera dhe me fuqi të njëjtë juridike në hierarkinë e normave (Sadushi, 2012: 148).

Në disa vende objekt kontrolli mund të jenë edhe vetë ligjet kushtetuese, përmes një kontrolli të jashtëm kushtetutshmërie (mbi procedurën e ndjekur) ose të brendshme (mbi ligjin në substancë) (Favoreu, 1992: 8-9).

Nëse Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë ose jo amendamente kushtetuese, është një çështje që ka mbetur ende e diskutueshme në nivelin teorik. Ndërkohë që në GJ K të demokracive të mëdha, ose nuk është pranuar, siç është rasti i Këshillit Kushtetues Francez me vendimin mbi amendamentin kushtetues të adoptuar nëpërmjet referendumit, 1962, ose është pranuar vetëm për çështje të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, siç është rasti i GJ K F GJ në çështjen “Fshehtësia e rasteve të Komunikimit” 1970 (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 160).

Kushtetuta shqiptare nuk parashikon shprehimisht kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve kushtetuese. Në të kundërt, ligji “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, e lejonte

kontrollin e kushtetutshmërisë së amendamentit kushtetues. Në vendimin nr. 57/1997, për hërë të parë në jurisprudencën kushtetuese është konstatuar pavlefshmëria e kushtetutshmërisë të dispozitave kushtetuese, duke prekur në këtë mënyrë vetë Kushtetutën. Në vitin 1997, Parlamenti i zgjedhur rishtazi, miratoi një amendament të ligjit Kushtetues “Për dispozitat themelore Kushtetuese”, ligj i cili në atë periudhë përfaqësonte ligjin më të lartë në vend. Meqënëse Gjykata Kushtetuese në atë periudhë, kontrollonte kushtetutshmërinë e normës edhe me nismën e vet, pra kryesisht, ajo mori në shqyrtim këtë ligj, duke u shndërruar në një nga gjykatat kushtetuese mjaft të rralla në botë, që kanë gjykuar amendamentet kushtetuese, pra vetë Kushtetutën. Në këtë çështje, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, mori në shqyrtim nenin 2 të ligjit nr. 8257, datë 19.11.1997, i cili vendoste: “ Gjykata Kushtetuese të zhvillojë “rotacionin” e parë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ”. Me vendimin përkatës, Gjykata Kushtetuese e konsideroi këtë nen antikushtetues duke sqaruar se kur nuk mbeten veçse pak muaj për të bërë ripërtëritjen e dytë - urdhërohet Gjykata të bëjë përtëritjen brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011 : 159-162), gjë që vjen në kundërshtim të hapur me vendimin nr. 4, datë 02.06.1995 të Gjykatës, e cila me këtë vendim të saj përtëritjen e ka quajtur të kryer gjer në përtëritjen e dytë. Me vendimin nr. 57/1997, GJ K ka kapërcyer kufijtë që Kushtetuta i vendos çdo autoriteti shtetëror, pa përjashtuar as vetë atë, duke realizuar një lloj të veçantë kontrolli që njihet si mbikonstitucionalitet ose supernormativitet (Sadushi, 2012: 221). Gjithsesi një çështje e tillë mbetet e diskutueshme edhe për doktrinën. Sipas kushtetutave të Rusisë (neni 125), Ukrainës (neni 67) , Turqisë (neni 148) apo Qipros (neni 89), kontrollit *a posteriori* i nënshtrohen edhe dispozitat kushtetuese dhe ligjet që amendojnë Kushtetutën. Kjo formë kontrolli e cila parashikohet

në shumë pak vende, duhet kryesisht të garantojë një ankim për anën formale të amendamenteve kushtetuese, duke e përjashtuar gjykatën nga shqyrtimi i kushtetutshmërisë në substancë. Nuk do ishte normale që Kushtetuta ose amendamentet që i bëhen asaj në dispozita konkrete, t'i nënshtrohen rishikimit abstrakt në përmbajtjen e tyre, pasi kjo formë kontrolli jo vetëm që nuk ka një përkrahje të gjerë në doktrinë, por, edhe në ato kushtetuta që parashikohet, gjykata vlerëson vetëm anën procedurale të miratimit të një ligji amendues. Kushtetuta aktuale nuk ka bërë një rregullim të plotë të këtij momenti të rëndësishëm por edhe paksa të diskutueshëm. Sipas nenit 152 dhe 177, GJ K mund të ushtrojë kontrollin kushtetues lidhur me procedurën e miratimit në Kuvend të amendamenteve kushtetuese, vetëm nëse ky do t'i nënshtrohet për miratim referendumit popullor. Megjithatë ky kontroll kushtetues nuk rezulton si një formë e rishikimit *a posteriori*, por e një kontrolli *a priori* që i bëhet kushtetutshmërisë së çështjes së zhvillimit të referendumit dhe jo përmbajtjes së amendamentit kushtetues (Sadushi, 2004: 81-82). Në vendimin nr. 31/2003, GJ K duke vlerësuar thelbin e çështjes ndaloi zhvillimin e referendumit popullor për shfuqizimin e ligjit në fjalë. Ky qëndrim e zhvilloi më tej jurisprudencën kushtetuese, duke hequr një pengesë për përfshirjen në të ardhmen të gjykimit të kushtetutshmërisë së përmbajtjes së projektamendamenteve kushtetuese që kanë lidhje me çështje të kësaj natyre. I të njëjtit mendim është edhe Kristaq Traja, një nga hartuesit e Kushtetutës i cili shprehet se nuk mund të thuhet gjithashtu se derisa dispozitat për rishikimin e Kushtetutës nuk e përmendin ndërhyrjen e GJ, kjo nuk legjitimohet të veprojë, sepse këto dispozita nuk përmendin as edhe kontrollin mbi procedurën e amendimit. GJ ka për detyrë që si garant i Kushtetutës, të sigurojë respektimin e nenit 151/2, dhe jo vetëm këtë por edhe frymën, parimet dhe vlerat e saj themelore. Aq më tepër

kur amendamentet nuk shtrohen për ratifikim popullor, por mbeten vetëm për miratim parlamentar. Nuk duhet pritur referendumi që GJ të ndërhyjë, por ajo duhet të bëjë edhe në emër të vlerave të frymës së Kushtetutës, sa herë që amendamenti, miratohet përfundimisht në Kuvend (Sadushi, 2012: 223-224).

Gjithsesi, pavarësisht qëndrimeve dyshuese dhe të ndryshme në jurisprudencë e doktrinë, në këtë drejtim duket sikur do të bëhet qartësi, pasi referuar ndryshimeve kushtetuese që parashikohen së fundmi, referuar edhe në Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, është propozuar që në nenin 131 të Kushtetutës, pas paragrafit **g**, të shtohet paragrafi 2 me këtë përmbajtje: Gjykata Kushtetuese nuk mund të shpallë antikushtetues një ligj të miratuar nga Kuvendi, për rishikimin e Kushtetutës.

Ndërsa përsa i përket ligjeve organike, çështja shtrohet e thjeshtë. Ato i nënshtrohen kontrollit të kushtetutshmërisë, pasi siç argumenton dhe konstitucionalisti Kristaq Traja: “Pikë së pari ato janë ligje dhe së dyti vetë neni 116/c i Kushtetutës, që parashikon sistemin normativ të vendit, sipas shkallës së fuqisë juridike zbritëse, i përfshin ato pikërisht në kategorinë e ligjeve, pra nën nivelin e normave kushtetuese dhe ndërkombëtare” (Traja, 2000: 257).

3.1.2 Kontrolli incidental i kushtetutshmërisë së ligjit

Në nenin 68 të ligjit organik të GJ K (ashtu si në mënyrë të ngjashme edhe në nenin 145/2 të Kushtetutës) thuhet se:

Kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cenuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij.

Në interpretim të këtij neni, vjen në ndihmë jurisprudenca e GJK, e cila ka mbajtur një qëndrim koherent dhe së fundmi në vendimin e saj nr. 55/2015 shprehet se:

Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit kur gjyqtari çmon se ligji (ose dispozita të tij) bie në kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e normës. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton edhe disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: së pari, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

Do të ishim dakort me mendimin e Kristaq Trajës, i cili duke iu referuar kontrollit incidental, thotë se ai është rrjedhojë e përpjekjeve për të kombinuar parimin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë që ushtron çdo gjyqtar i zakonshëm në sistemin amerikan, me supermacinë ose monopolin e gjykatës kushtetuese europiane (Traja, 2000: 58). Natyrisht gjyqtarit të zakonshëm nuk i mohohet funksioni i tij për të interpretuar kushtetutën, por vetëm kompetenca për të deklaruar, mbi bazën e saj, si antikushtetues një ligj që ai e çmon të tillë. Në rast të kundërt do të humbte vetë arsyeja e ekzistencës së

gjykatës kushtetuese dhe kontrolli kushtetues do të ishte i decentralizuar ose i shpërndarë, si në modelin amerikan dhe të disa vendeve të tjera (Sadushi, 2012: 37). Thelbi i tij qëndron në faktin se gjyqtari i zakonshëm është i detyruar *ex officio* ose me kërkesë të palëve, ta pezullojë gjykimin dhe t’ia referojë gjykatës kushtetuese ligjin në fjalë (Traja, 2000: 58). Përsa i përket interpretimit, qëndrim të konsoliduar ka mbajtur jurisprudenca e GJK, e cila në vendimet e saj nr. 5/2009, 13/2009, 12/2010, 30/2010, 7/2013, 39/2014, 5/2015, 30/2015 dhe 55/2015 ka parashikuar veç të tjerash se:

[...] përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën.

Po ashtu, në mënyrë të ngjashme në vendimin nr. 7/2015 thuhet se është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret³⁰.

³⁰ Shih vendimin nr. 7/2015 të GJK

Ashtu siç pranohet gjerësisht nga doktrina, në dallim nga subjektet e tjera të parashikuar në nenin 134 të Kushtetutës, gjyqtari *a quo* nuk merr pozicionin e kërkuesit por të relatorit të çështjes.

3.1.2.1 Bindje apo dyshim për gjyqtarin a quo?

Në lidhje me faktin nëse gjyqtari *a quo* duhet të ketë bindjen apo qoftë edhe vetëm dyshimin për kushtetutshmërinë e ligjit, në mënyrë që t'i drejtohet GJ K, ashtu siç pranohet dhe në literaturë, jemi të mendimit se termi “çmon” i përdorur nga ligjvënësi, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, ka të bëjë me bindjen e gjyqtarit *a quo* dhe jo me dyshimin e tij. Në Kapitullin II, trajtuam se një model i tillë është i parashikuar nga L TH F GJ, ndryshe nga Kushtetuta Italiane, e cila përqafon qëndrimin e “dyshimit”. Po t'i referohemi nenit 113/8 të Kushtetutës së Kosovës do të shohim se aty flitet për “*pasiguri të përpuethshmërisë së ligjit të kontestuar me Kushtetutën*”, duke u përqafuar në këtë mënyrë modeli italian. Duke qenë se një kontroll i tillë nga GJ K është themelor dhe se gjyqtari i zakonshëm nuk e ka një kompetencë të tillë në sistemin europian, do të ishim të mendimit që edhe në rastin shqiptar të përqafohet po ashtu modeli italian, në mënyrë që gjykatësi *a quo*, përpara një dyshimi të tillë, t'i drejtohet GJ K, në mënyrë që ky dyshim të zgjidhet nga organi kompetent dhe jo nga ai vetë.

3.1.2.2 Kompetencat, “interesi” dhe pozicioni procedural i gjyqtarit a quo

Me të drejtë, Temistocle Martines, bën një përmbledhje të kompetencave të gjyqtarit *a quo*, dhe thotë se ai paraprakisht marrjes së vendimit mbi çështjen, duhet të verifikojë *rëndësinë e saj*, pra gjyqtari duhet të shqyrtojë nëse çështja është ngritur kundër një ligji që ai mendon se duhet zbatuar për të përcaktuar gjykimin. Sipas jurisprudencës të konsoliduar të GJ K Italiane, vendimi nr. 49 /1983, që çështja të jetë e rëndësishme duhet të ekzistojë një marrëdhënie instrumentale e nevojshme mes zgjidhjes së vetë çështjes dhe vendimit të gjykimit kryesor (Martines, 2011: 344-345). Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GJ K shqiptare, ku në vendimin nr. 15/2000 shprehet se: “ [...] ky lloj gjykimi kushtetues kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetutshmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykata dhe zgjidhjes së çështjes konkrete”. Është kjo çështja e së drejtës që i intereson gjyqtarit, dhe jo mundësia abstrakte që një ligj të jetë kushtetues. Dhe në fakt, nëse çështja i përket një ligji që gjyqtari nuk mendon se duhet ta zbatojë për të zgjidhur mosmarrëveshjen që i nënshtrohet kontrollit të tij, vetë çështja për këtë gjykim, do të ishte krejt e parëndësishme dhe ai do ta hidhte poshtë (Sadushi, 2004: 110). Në jurisprudencën e saj të konsoliduar tashmë në këtë drejtim, GJK këtë lidhje e konsideron si *raport i domosdoshëm* midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese³¹. Ekzistenca e lidhjes së drejtpërdrejtë dhe objektive ndërmjet ligjit të zbatueshëm dhe përfundimit të çështjes konkrete, nënkupton “interesin” që vë në lëvizje mekanizmin e kontrollit kushtetues. Interesi i gjykatës konsiston në faktin se menjëherë pas deklarimit të

³¹ Shih vendimet nr. 12/2010, 30/2010, 7/2013, 39/2014, 7/2015, 30/2015, 55/2015 të GJK së RSH

antikushtetutshmërisë, vijnë efekte të drejtpërdrejta në çështjen që ai shqyrton (Sadushi, 2012: 157). Pasi e konsideron çështjen të rëndësishme, gjyqtari do të duhet të verifikojë që ajo nuk është *shprehimisht e pathemeltë*. Gjyqtari nuk duhet të verifikojë as që çështja është *e pathemeltë* as që është *e themeltë* sepse si në njërin rast edhe në tjetrin do të zëvendësonte GJ K (e cila është e vetmja që gjykon mbi pathemelësinë ose mbi themelësinë e çështjeve) por vetëm që ajo të mos jetë *shprehimisht e pathemeltë*. Gjyqtari do të duhet ta rrëzojë çështjen kur haptazi, *prima facie*, i duket pa asnjë themel juridik dhe do t'i duhet ta pranojë kur ai ka hijen e dyshimit mbi kushtetutshmërinë e ligjit, ka rezerva, mendon se mundet edhe të ekzistojë *një fumus boni juris* mbi themelësinë e çështjes. Ndër të tjera është e qartë se nëse gjyqtari duhet të mos e zbatojë normën dhe të ngrejë çështjen e kushtetutshmërisë përpara Gjykatës nëse ka dyshime mbi mospërputhjen me Kushtetutën, atëherë shumë do t'i duhet t'i drejtohet Gjykatës në rast se mendon se çështja që ka në shqyrtim është e themeltë. Në të dyja rastet, meqënëse nuk i takon gjyqtarit gjykimi mbi kushtetutshmërinë e ligjeve por GJ K, ai duhet të pezullojë gjykimin në proces dhe të kërkojë vendimin e GJ K. Siç mund të kuptohet lehtë, kompetencat që i janë dhënë gjyqtarit *a quo* janë të konsiderueshme, duke qenë se propozimi i gjykimit përpara GJ K varet ekskluzivisht nga ai. Gjyqtari funksionon, si *iniciator i nevojshëm* i gjykimit të pajtueshmërisë me kushtetutën përpara GJ K. Pra, mjafton që ai ta konsiderojë çështjen të parëndësishme ose shprehimisht të pathemeltë që ajo të mos mund të shkojë përpara GJ K. Prandaj i takon gjyqtarëve, ndjeshmërisë së tyre dhe përgatitjes profesionale, që të shmangin nga njëra anë që çështja të propozohet si një mjet i qartë zvarritjeje ose stërlodhjeje, por nga ana tjetër, që nëpërmjet betejave të praparojës, të forcohen në mbrojtjen e ligjeve haptazi në kundërshtim

me kushtetutën, ose kushtetutshmëria e të cilëve është të paktën e dyshimtë (Martines, 2011: 344-349).

Të gjitha këto që trajtuam më sipër, jurisprudenca kushtetuese shqiptare i ka konkretizuar në vendimet e saj, ku në mënyrë të përmbledhur dhe konçize, mund të përmendim së fundmi vendimin nr. 55/2015 ku GJK ka legjitimuar në kuadër të kontrollit incidental, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës, duke konkluduar se: gjykata referuese ka identifikuar *raportin e domosdoshëm* midis vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete; ka identifikuar parimet kushtetuese me të cilat, sipas saj, bie në kundërshtim dispozita e kundërshtuar; ka argumentuar se nuk ka pasur mundësi të interpretimit të ligjit në pajtim me Kushtetutën dhe për këtë arsye nuk mund të përdorte mekanizëm tjetër veç atij të vënies në lëvizje të gjykimit incidental për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës³².

Duke iu rikthyer edhe njëherë pozicionit të veçantë që ka gjyqtari *a quo* në gjykimin kushtetues, siç parashtruam dhe në fillim, ai nuk paraqitet në të njëjtin pozicion procedural me atë të kërkuesit të zakonshëm, edhe pse parashikohet në nenin 134/d të Kushtetutës. Interesi i tij nuk është vetjak. Ai nuk është një kërkues i zakonshëm pasi nuk shprehet me kërkesë por me vendim për të dërguar çështjen në GJ K. As ai dhe as palët që kanë mosmarrëveshje mes tyre, nuk janë të detyruara të paraqiten në proces. Një ndërhyrje e gjykatës në proces nuk përjashtohet të marrë edhe një ngarkesë të caktuar politike, pasi deklarimi i antikushtetutshmërisë së ligjit shtrihet në mënyrë të tërthortë edhe në një drejtim

³² Për më tepër shih vendimin nr. 55/2015 të GJK

politik (Sadushi, 2012: 160-161), prandaj ndërhyrja mund të justifikohet me mundësinë për të paraqitur argumentime juridike mbi antikushtetutshmërinë e ligjit (Sadushi, 2004: 113).

Jurisprudenca kushtetuese shqiptare (si për shembull në vendimet e saj nr. 3/2004, 3/2006 apo 55/2015), i ka dhënë një rëndësi të veçantë pikës 2 të nenit 68 të ligjit organik, ku thuhet se në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cenuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij.

Një çështje tjetër e shtruar për këtë lloj gjykimi, është ajo që lidhet me kuptimin e ligjit si objekt i kontrollit kushtetues për shkak të kërkesës së gjyqtarit të zakonshëm. Përgjigjia është e qartë, se Kushtetuta e vitit 1998 ka pasur parasysh vetëm ligjin në kuptimin formal të fjalës. Në këtë pikëpamje, nuk mund të jenë objekt i kontrollit incidental as aktet ndërkombëtare që bëhen pjesë e sistemit të brendshëm të R SH - së, as aktet e tjera nënligjore, pavarësisht se përbëjnë ligjin në kuptimin material të fjalës. Në këtë mënyrë kemi një ndryshim nga sa ishte sanksionuar në ligjin “Për dispozitat Kryesore Kushtetuese” dhe, në të njëjtën kohë, një përafrim me shumicën e gjykatave kushtetuese të Evropës, në të cilat kontrolli kushtetues konkret ushtrohet vetëm ndaj ligjeve në kuptimin formal (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 165-167).

Në dallim nga neni 50 i ligjit organik për GJ K, që parashikon se në procedurat abstrakte të kontrollit kushtetues, ligji nuk mund të bëhet objekt kontrolli tej afatit 3-vjeçar, nga koha e hyrjes së tij në fuqi, procedura e kontrollit incidental nuk njeh këtë kufizim kohor (Sadushi, 2012: 154).

Vendimi i GJ K po ashtu edhe në rastin e kontrollit incidental ka fuqi *erga omnes* pasi në një pjesë të saj procedura e gjykimit kushtetues, ka karakter objektiv përderisa është e inicuar nga gjyqtari i zakonshëm si autoritet shtetëror. Sipas Kristaq Trajës: “ [...] ky efekt nuk është gjë tjetër përveçse një lloj kompensimi, i mungesës së rregullit të precedentit” (Traja, 2000: 59).

3.1.3 Ankimi individual si mundësi për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit

Konceptimi i GJ K nga Kelzeni si një instrument për mbrojtjen e kushtetutës përmes shqyrtimit abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit, përjashtoi në fakt nga juridiksioni i saj shqyrtimin e ankesave individuale (Sadushi, 2012: 309). Madje ashtu siç trajtuam në Kapitullin II, ky duket si një problem i përbashkët i gjykatave kushtetuese kelzeniane (Czamota, 1999: 66). Megjithatë, disa nga vendet evropiane, ashtu siç parashtruar po në këtë Kapitull, kanë parashikuar tashmë një mjet të tillë garantues në legjislacionet respektive. Madje në disa prej tyre, mund të flitet edhe për rekurs individual specifikisht kundër ligjit. Në Europë e zbaton vetëm Gjermania (*verfassungsbeschwerde*); në Austri rekursi i nënshtrohet një procedure abstrakte, pa marrë parasysh gjendjen konkrete të kërkuarit; në Belgjikë çdo shtetas mund të bëjë rekurs për shfuqizimin e një ligji, duke invokuar cenimin e një interesi të thjeshtë, dhe akoma më shumë kjo ndodh në Hungari³³ (Traja, 2000: 56). Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se vendet që kanë ankimin individual kushtetues të zgjeruar (*Verfassungsbeschwerde*) janë: Austria, Kroacia,

³³ Në formën e një *actio popularis*

Armenia, Republika Çeke, Mali i Zi (me ndryshimet e fundit kushtetuese), Sllovenia, Gjermania, Letonia, Malta dhe Polonia³⁴.

Jemi plotësisht dakort me mendimin e profesor Sadushit i cili thotë se: “ Duke bërë një analizë historike të mekanizmit të ankimit kushtetues shqiptar, vihet re një lloj luhatjeje, që nuk evidenton, qartësisht modelin e pranuar ” (Sadushi, 2012: 323). Ankimi kushtetues i ofruar në vitin 1992 nga ligji “ Për dispozitat kryesore kushtetuese ” (i cili njihte rekursin për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit), ngjason me modelin gjerman, ndërkohë që rregullimi aktual kushtetues duket si një zgjidhje tipike shqiptare (Sadushi, 2012: 323). Kjo pasi vënia në lëvizje e GJ K me kërkesë të individit, lidhet vetëm me të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor (neni 131/f i Kushtetutës), pasi i ka shterur të gjitha mjetet e tjera që i lejon Kushtetuta dhe ligji shqiptar. Konkretisht, në rastin shqiptar, individi mund të bëjë kërkesë vetëm pasi çështja e tij të jetë shqyrtuar nga të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 167-168). Kristaq Traja, një nga themeluesit e Kushtetutës, thotë se ndryshimi i bërë në projekt, në momentet e fundit të miratimit nga Kuvendi, krijon perpleksitet. Ideja (e gabuar), shton Traja, ka qenë se meqë çdo e drejtë e individit, shqyrtohet në gjykatat e zakonshme, mjafton vetëm rekursi kushtetues për kontrollin e së drejtës për procesin e rregullt ligjor, që nënkupton procesin gjyqësor, që të drejtat e tjera themelore të mund të sigurohen (Traja, 2000: 263). Traja, kësaj ideje të “gabuar” siç e quan vetë ai, i kundërpërgjigjet në këtë mënyrë:

Në të vërtetë, procesi i rregullt ligjor është vetëm një nga të drejtat e individit që lidhet me rregullsinë e gjyqit të zakonshëm dhe nuk mund të shërbejë për të siguruar të drejtat e tjera të tij. Një gjyq mund të jetë fare i drejtë, nga pikëpamja e procesit të rregullt, në një

³⁴ Shih “Material shpjegues për ndryshimet kushtetuese në RSh.”, shtator 2015, fq. 23

kohë që e drejta e pronës-objekt gjykimi, mund të jetë cenuar për shkak të një ligji antikushtetues. Procesi i rregullt ligjor nuk është një e drejtë universale që i mbulon të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese të individit; ai është vetëm një procedurë e rregullt gjyqësore, në të cilën testohen të gjitha të drejtat e tjera. GJK këtu kontrollon gjykatën e zakonshme por jo të drejtën e individit (Traja, 2000: 263).

Pra sipas rregullimit aktual presupozohet se për të gjitha të drejtat e tij kushtetuese individit mund të kërkojë mbrojtje nga gjykatat e zakonshme, të cilat duhet t'i sigurojnë një proces të rregullt gjyqësor. Në këtë kuadër mund të themi se e drejta për një proces të rregullt ligjor nuk paraqet ndonjë ndryshim të dallueshëm nga e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, pasi në përgjithësi, të gjithë shtetasit kanë mundësi t'i drejtohen gjykatës kur u është shkelur një e drejtë e parashikuar në Kushtetutë. Sidoqoftë, ky dallim do të ishte i dukshëm nëse mbajmë parasysh faktin se GJ K nuk do të mjaftohej me kontrollin kushtetues të një procesi të rregullt gjyqësor nga pikëpamja procedurale, por do ta shtrinte atë edhe mbi ligjin material të zbatuar nga gjykatat (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 167-168). Kjo kompetencë e GJ K e kufizon respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor vetëm në aspektin procedural. Kufizimi i ankesës kushtetuese për individin është shfaqur edhe në një tjetër drejtim. Individit duke sjellë një ankim kushtetues para GJ K, nuk ka pasur hapësirë për të kundërshtuar drejtpërdrejt qoftë zbatimin në mënyrë anikushtetuese të ligjeve nga ana e autoriteteve publike, ashtu edhe cenimin e të drejtave themelore, për shkak të zbatimit të një ligji me përmbajtje antikushtetuese (Sadushi, 2012: 321). Deri tani, GJ K e ka reduktuar kontrollin kushtetues mbi bazën e kërkesave individuale, vetëm në kontrollin për një proces të rregullt ligjor. Kjo përbën një dallim nga përvoja e krijuar gjatë zbatimit të ligjit “ Për dispozitat kryesore Kushtetuese ”, mbi bazën e të cilit GJ K zgjidhte përfundimisht ankesat e personave në lidhje me thelbin e

të drejtave dhe lirive themelore. Në doktrinën juridike janë trajtuar shpesh opinione lidhur me kuptimin e kësaj kompetence. Ka autorë që mendojnë se “Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe më efikas të mundshëm. Ky do të ishte kuptimi substantiv i procesit”. Porse ky mendim nuk ka gjetur ende mbështetje nga jurisprudenca kushtetuese e GJ K (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 167-168), edhe pse në vendimin nr. 26/2007 të GJK thuhet shprehimisht se: “Gjykata Kushtetuese i përmbahet konceptit se kushtetuta duhet interpretuar si një “instrument i gjallë” dhe, në mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe më efikas të mundshëm”, si dhe në vendimin nr. 20/2011:

Nisur nga tagrat që i jep neni 124 i Kushtetutës, roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat kushtetuese nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese situatave juridike në të cilat ndodhen individët. Për shkak të vetë formës ekstremisht konçize që kanë dispozitat kushtetuese, nëpërmjet vendimeve, pra interpretimit që bën Gjykata, bëhet e mundur që Kushtetuta të jetë “e gjallë”, që do të thotë se Gjykata i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin dinjitet, njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese. Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, për më tepër e bën atë një burim parësor të saj, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ndërkohë që jurisprudenca e GJKFGJ, edhe në kë rast duket sikur ndodhet një hap përpara. Ajo paraqitet mjaft e konsoliduar duke bërë një interpretim të tillë të dispozitave kushtetuese³⁵ e për më tepër në mjaft vendime të saj si për shembull BVerfGE 19/377, 39/1 dhe 54/536 GJKFGJ jo vetëm që ka shfuqizuar vendimin gjyqësor të atakuar por edhe ligjin e konstatuar për antikushtetutshmëri.

³⁵ Shih për më tepër BVerfGE 39/1

Me synimin për të konsideruar ankesën kushtetuese të individit si një mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave themelore, jurisprudenca e GJ K e RSH-së është orjentuar deri diku nga jurisprudenca kushtetuese gjermane e spanjolle që shqyrtojnë drejtpërdrejt mbi ankesën e individit, kushtetutshmërinë e vendimeve jo vetëm të gjykatave të zakonshme por edhe të ligjvënësit, por jo duke analizuar konceptin e procesit të rregullt substancial (Sadushi, 2012: 321-322).

Të rëndësishme në këtë drejtim, janë vendimet që GJ K ka marrë në periudhën e ligjit “ Për dispozitat kryesore Kushtetuese ”, siç është vendimi nr. 10/1994 ku me kërkesën e një individi, GJ K shqyrtoi antikushtetutshmërinë e ligjit nr. 7698, dt.15.04.1993 “ Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve ” apo vendimi nr. 53/1997 përmes të cilit GJ K shfuqizoi për antikushtetutshmëri, nenin 7 të ligjit nr. 8227, dt.30.07.1997 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, dt.09.05.1997 “ Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë ”.

Pavarësisht kufizimit të së drejtës së individit për t’iu drejtuar GJ K vetëm në kuadër të shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, ashtu siç thamë dhe pak më sipër kur folëm për legjitimitetin e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të tjera, ky legjitimitet i kufizuar për individin, i ka krijuar hapësirë këtyre subjekteve, veçanërisht Avokatit të Popullit ose organizatave, për të qenë më aktiv përpara GJ K. Ky kufizim gjithashtu, ndikon edhe në pozicionin që duhet të ketë vetë GJ K për t’u bërë një mjet efektiv dhe për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Sadushi, 2012: 326). Nga ana tjetër, ashtu siç pohohet nga doktrina por edhe nga jurisprudenca, edhe kontrolli incidental me nismën e gjyqtarit *a quo*, mund të shndërrohet

në një mjet të rëndësishëm në këtë drejtim. Mjafton të citojmë vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Ruiz - Mateos kundër Spanjës*, në të cilin thuhet se: “ [...] përmes ngritjes së çështjes për antikushtetutshmërinë e ligjit, individët palë në gjykim, po përdorin mjetin e vetëm dhe të tërthortë në dispozicion të tyre për të mbrojtur të drejtën e pronës”. Madje edhe në rastin kur palës i mohohet padrejtësisht kërkesa për pezullimin e gjykimit, kjo është një çështje që nuk mund të shmanget nga kontrolli kushtetues, në kuadrin e ankimit individual për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor (Sadushi, 2012: 156-157).

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në mjaft çështje drejtuar kundër Shqipërisë, si për shembull në çështjen *Gjonbocari kundër Shqipërisë*, *Qufaj kundër Shqipërisë*, *Shkalla kundër Shqipërisë*, ka nënvizuar faktin se GJK në jo pak raste, nuk përbën një mjet ligjor efektiv për shtetasit shqiptarë, referuar mangësive të sipërpërmendura. Rëndësia e të qenurit konform standarteve të jurisprudencës së GJEDNJ dihet tashmë. GJEDNJ me të drejtë konsiderohet si “gjykata kushtetuese europiane”. Në vendimin e saj nr. 20/2011, GJK shprehet se: “ Në këtë kuptim mund të themi se Gjykata ka dy funksione themeltare: atë shtytës-evolutiv [...], i cili shpesh është rrjedhojë e vlerës që kanë vendimet e GJEDNJ-së, dhe faktit se Gjykata mund të përdorë në mbështetje të arsyetimeve të veta qëndrimet që kanë mbajtur Gjykatat homologe europiane dhe më gjerë dhe, nga ana tjetër, funksionin mbrojtës-konservativ, duke garantuar pandryshueshmërinë e mbrojtjes kushtetuese për ato vlera që konsiderohen si kryesore nga populli i Republikës së

Shqipërisë, vullnetin e të cilit interpreton Gjykata Kushtetuese. Të dyja këto funksione³⁶ janë njëherazi të rëndësishme dhe të barasvlefshme”.

GJK shqiptare, ka patur një qasje të rëndësishme me jurisprudencën e GJEDNJ, edhe në pjesët e cituara pak më sipër, në vendimet e saj nr. 26/2007 dhe 20/2011. Kjo qasje mund të shihet në çështjen *Stafford kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar* ku GJEDNJ shprehet se KEDNJ duhet parë si një *instrument i gjallë, dinamik* e që duhet interpretuar në varësi të rrethanave aktuale, në përmbushje të garantimit të të drejtave të individit; si dhe shtetet kontraktuese dhe jo vetëm, duhet të vlerësojnë sipas standarteve aktuale interpretimin si dhe zbatimin sa më adekuat të KEDNJ-së.

Duke u nisur nga të gjitha ato që thamë më lart, nga rëndësia që paraqet akses i drejtpërdrejtë i individit para GJ K si dhe për të qenë konform standarteve të GJEDNJ, do të ishim të mendimit se një parashikim i tillë në Kushtetutë, dhe si pasojë edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, do të përbënte përsëri një hap përpara në Drejtësinë Kushtetuese Shqiptare, një hap të cilin ligji “ Për dispozitat kryesore kushtetuese ” e kishte bërë që në vitin 1992. Një parashikim i tillë do të sillte benefite të dyanshme, duke shkuar jo vetëm në favor të individit, të drejtave dhe lirive themelore të tij, por edhe në atakim të ligjit antikushtetues e si rezultat në drejtim të mos “vesimit” të gjithë rendit juridik e të garantimit të parimit të sigurisë juridike.

³⁶ Funkzioni shtytës-evolutiv dhe ai mbrojtës-konservativ janë kryesisht të pranishëm në jurisprudencën kushtetuese gjermane. Shih edhe BVerfGE 14/61

3.1.4 Disa rregulla të përgjithshme procedurale

Në ligjin organik të GJ K përcaktohen me hollësi rregullat procedurale që duhet të ndiqen për zhvillimin e gjykimit kushtetues. Seancat e tij janë publike, megjithatë për qëllime të arsyeshme, e sidomos sigurie, mund të vendoset që të zhvillohen edhe me dyer të mbyllura. Shqyrtimi paraprak i kërkesës bëhet nga një kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë, në një procedurë seleksionimi. Kolegji vendos kalimin e çështjes në seancë plenare kur vëren se subjekti që ka paraqitur kërkesën legjitimohet dhe kur çështja është në kompetencën e GJK. Në qoftë se ndodh që edhe njëri prej gjyqtarëve të kolegjit nuk është i të njëjtit mendim me të tjerët, kërkesa kalon për shqyrtim paraprak tek Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila vendos me shumicë votash për kalimin ose jo të çështjes në seancë plenare. Në këtë seancë, si rregull, marrin pjesë të gjithë gjyqtarët, por asnjëherë më pak se 2/3 e tyre. Thirrjen dhe drejtimin e seancës e bën Kryetari i GJ K, por me autorizimin e miratimin e tij mund ta kryejë edhe një gjyqtar i saj. Për të lehtësuar punën në seancën plenare caktohet një relator për çështjen, i cili bën raportimin. Në gjykim ftohen të marrin pjesë të gjitha subjektet e lidhura me çështjen, të cilët mund të paraqiten vetë ose, përmes përfaqësuesve të tyre.

Vendimet e GJK janë vendime përfundimtare dhe kanë fuqi detyruese të përgjithshme (*erga omnes*). Si të tilla ato përbëjnë *res judicata* dhe pajtohen apo respektojnë parimin e sigurisë juridike, konform standarteve të GJEDNJ, ku në vendimin *Macovei dhe të tjerë kundër Moldavisë*, thuhet se: “[...] parimi i sigurisë juridike presupozon respekt për parimin e *res judicata* që është parimi i gjykimeve përfundimtare³⁷”. Përmes tyre, Gjykata ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Ato hyjnë në fuqi

³⁷ Për më tepër shih vendimin e GJEDNJ “*Macovei dhe të tjerë kundër Moldavisë*”

ditën e botimit në fletoren zyrtare, me përjashtim të rasteve kur GJ K vendos që ligji të shfuqizohet në një datë tjetër. Vendimet e GJ K botohen të arsyetuara, së bashku me mendimin e pakicës. Si rregull, vendimi që ka shfuqizuar një ligj për shkak të papajtueshmërisë me Kushtetutën, sjell efektet juridike nga dita e hyrjes së tij në fuqi. Pra është fjala për një pavlefshmëri relative *ex nunc* dhe jo absolute *ex tunc* (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 168-169). Ligji organik i GJ K, ka parashikuar shprehimisht disa raste, edhe pse jo në të njëjtin nen, në të cilat vendimi i saj, ka fuqi prapavepruese, si në rastin kur bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (neni 79); ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të shfuqizuar; ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë si dhe ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit të shfuqizuar (neni 76/2).

Nëse Gjykata Kushtetuese e anulon ligjin si antikushtetues, të gjitha autoritet duhet të shfuqizojnë normat e tjera të ngjashme ose të nxjerra mbi atë bazë (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 169)

Në disa vende janë aplikuar përvoja të ndryshme për rastet kur trupi gjyqësor nuk ka arritur të formojë një shumicë për marrjen e vendimit, pasi diku vlen vota mbizotëruese e Kryetarit, diku tjetër, kjo do të thotë vlefshmëri e aktit që gjykohet, diku tjetër vendimi quhet i marrë derisa të arrihet shumica (Traja, 2000: 99). Përvoja shqiptare hyn në grupin e tretë, sipas të cilës, vendimi konsiderohet i marrë vetëm atëherë kur arrihet shumica. Por, ligjvënësi e ka konceptuar gabimisht këtë fakt, kur ka parashikuar në ligjin organik për GJK se, kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë, Gjykata vendos refuzimin e

kërkesës. Refuzimi i kërkesës është i ndryshëm nga rrëzimi i saj, pasi nuk përbën *res judicata*. Kjo do të thotë se ai nuk është pengesë që kërkuesi ta riparqesë kërkesën e tij, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar. Ndërsa kur kërkesa e subjektit rrëzohet, atëherë ajo konsiderohet si gjë e gjykuar dhe subjekti nuk mund ta paraqesë sërish. Një qëndrim i tillë është kritikuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendimin e saj për çështjen *Marini kundër Shqipërisë*. Kjo Gjykatë ka konstatuar se Ligji organik i GJ K, me parashikimin e vendimeve për refuzimin e kërkesës në rast ndarjeje të barabartë të votave, çon në marrjen e një vendimi, i cili praktikisht nuk i jep asnjë zgjidhje çështjes në shqyrtim, duke e kthyer GJ K në një mjet joefektiv. Prandaj, e ngutshme, veç të tjerave, është nevoja për rishikimin e nenit 74 të Ligjit, i cili ka parashikuar refuzimin e kërkesës (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 169-170). Në gjykimin tonë, një parashikim i tillë nga neni 74 i ligjit organik, duket sikur ka dashur të bëjë dallimin mes vendimeve të rrëzimit dhe atyre të refuzimit, të marra në këto raste, mirëpo pa dyshim që kjo nuk është në përmbushje të standarteve të jurisprudencës së GJEDNJ dhe mundësia e rishikimit të nenit në fjalë do të shkonte drejt rritjes e forcimit të GJK si një mjet efektiv për t'i dhënë zgjidhje çështjes në thelb, arsye dhe pse GJK vihet në lëvizje.

Në çështjen *Marini kundër Shqipërisë*, GJEDNJ veç të tjerash shprehet: “ [...] parashikimi në nenin 74 të ligjit organik për ndarjen e votave në mënyrë të barabartë, nuk i shërben sigurisë juridike dhe mund të privojë ankuesin nga e drejta efektive për një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën që ai i drejton GJK³⁸”.

³⁸ Për më tepër shih vendimin e GJEDNJ, *Marini kundër Shqipërisë*, dt. 18.12.2007

Dallohen të meta *formale* dhe *materiale* të ligjit. Të metat janë *formale* kur ligji miratohet nga parlamenti duke shkelur një nga normat mbi procedurën e formimit të ligjeve të parashikuar në kushtetutë ose sipas një procedure të ndryshme nga ajo që është parashikuar (Martines, 2011: 337). Ka të meta *materiale* kur norma që përmbahet në një ligj të zakonshëm ose në një akt të barazuar me të është në kundërshtim me një normë kushtetuese ose me një parim kushtetues (edhe pse në mënyrë të nënkuptuar), ose kur organi që ka nxjerrë ligjin nuk ishte kompetent sipas ndarjes së kompetencave legislative të parashikuara nga kushtetuta. Si shembull të tipit të parë të të metës *materiale* mund të hipotezohet rasti kur Gjykata Kushtetuese shfuqizon ligjin për antikushtetutshmëri për shkak të mospërputhjes në thelb me parimet dhe normat kushtetuese (shumica e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë të kësaj natyre). Pra, mund të themi se të metat formale i përkasin aktit dhe më saktësisht procedurës me të cilën është krijuar akti. Ndërsa të metat materiale i përkasin:

së pari: përmbajtjes së aktit, që do të thotë se deri në çfarë shkalle ai është në kundërshtim me një normë kushtetuese (dhe në këtë rast do të kemi shkeljen e dispozitës kushtetuese);

së dyti: subjektit që ka shpallur aktin legjislativ jashtë sferës së kompetencës që i është rezervuar nga Kushtetuta (dhe në këtë rast do të kemi inkompetencën);

së treti: ushtrimit të pushtetit legjislativ për një qëllim të ndryshëm nga ai i dhënë nga Kushtetuta, ose në një mënyrë që nuk të çon në arritjen e qëllimit ose që edhe nuk i

përgjigjet kriterit të arsyetueshmërisë, pra parimit të proporcionalitetit. Dhe atëherë do të kemi tejkalim të pushtetit (Sadushi, 2004: 77-78).

Çështja e kushtetutshmërisë ngrihet nëpërmjet një kërkesë të posaçme, duke treguar:

a) dispozitat e ligjit të prekur nga antikushtetutshmëria (*rectius*, që konsiderohen me të meta);

b) dispozitat e kushtetutës ose të ligjeve kushtetuese që konsiderohen të shkelura.

Çështja e pajtueshmërisë me Kushtetutën është *thema decidendum* që i nënshtrohet gjykimin të Gjykatës Kushtetuese. Ajo ka si objekt një ligj. Që njëra nga palët ose gjyqtari *a quo* (në gjykimin incidental) ose shteti (në gjykimin e drejtpërdrejtë) konsiderojnë të prekur nga antikushtetutshmëria. Në këtë mënyrë Gjykatës i kërkohet të shprehet mbi pikën në vijim: nëse në procedurën e formimit të aktit legjislativ është shkelur një dispozitë kushtetuese (e metë formale), ose nëse norma që gjendet në aktin legjislativ vjen në kundërshtim me një normë që gjendet në kushtetutë ose me një parim që mund të nxirret prej saj nëpërmjet interpretimit (e metë materiale). Duket qartë që në rastin e dytë, norma mbi kushtetutshmërinë e të cilës kërkohet gjykimin përpara Gjykatës (dhe që përbën objekt të çështjes), është ajo që nxirret nëpërmjet interpretimit nga teksti legjislativ nga palët ose nga gjyqtari *a quo* në gjykimin prej nga ka lindur çështja, ose nga shteti në rast mosmarrëveshjeje mes këtyre dy enteve. Gjykata Kushtetuese duhet të gjykojë pikërisht mbi kushtetutshmërinë e kësaj norme, përveç rastit kur duke interpretuar rishtaz tekstin

legjislativ, ajo nxjerr një normë të ndryshme dhe e bën objekt të gjykimit të saj (Martines, 2011: 337).

3.2 Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit, përmes dy formave të kontrollit *a posteriori* dhe *a priori*

3.2.1 Kontrolli *a posteriori* përballë atij *a priori*. Analizë krahasimore e tyre

Siç dihet dhe është trajtuar tashmë, kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit mund të jetë *a posteriori* dhe *a priori*³⁹. Ky kontroll në Shqipëri është *a posteriori*, vetëm pasi ligjet marrin fuqinë juridike, çka konfirmohet me botimin e tyre në Fletoren Zyrtare, por jo më parë se 15 ditë nga ky botim dhe madje GJ K në jurisprudencën e saj nuk ka pranuar të shqyrtojë kërkesat për ligjet të cilat nuk janë botuar në Fletoren Zyrtare (Sadushi, 2012: 287).

Kontrolli *a posteriori* i ligjit, njihet si forma më e përhapur në të dy sistemet e kontrollit. E megjithatë, siç kemi parshtruar që në pjesën hyrëse të këtij punimi, kontrolli *a posteriori*, lejon mundësinë e krijimit të një legjislacioni të përbërë edhe nga ligje antikushtetuese, pra që nuk janë në pajtim me Kushtetutën. Për këtë arsye, në bazë të parimit “*të parandalosh është më mirë sesa të kurosh*” do të ishte shumë e vlefshme në

³⁹ Term i përdorur nga doktrina franceze

rastin tonë, të hidhnim një vështrim më “dashamirës” drejt kontrollit *a priori* të kushtetutshmërisë së ligjit, për të parë pikë së pari mundësinë e një aplikimi të tillë në Shqipëri⁴⁰. Aq më tepër që ashtu siç thotë dhe Favoreu: “ [...] nuk mund të dënohet kontrolli *a priori* dhe të preferohet ai *a posteriori* për faktin se ky i fundit është më i përhapur se i pari” (Favoreu, 1992: 6).

3.2.1.1 Karakteristikat dhe përparësitë e kontrollit *a priori*

Kontrolli paraprak i ligjeve ushtrohet pas votimit të tij në parlament, por para se ai të shpallet. Në këtë mënyrë, procedura e verifikimit të kushtetutshmërisë lidhet me një akt që nuk ka marrë fuqi juridike, dhe, pra, me një akt jo të plotë (*lex imperfecta*). Kontrolli është parandalues, deri sa ka si qëllim moslejimin e hyrjes në fuqi të një ligji, përmbajtja e të cilit bie ndesh me kushtetutën. Është e kuptueshme se një kontroll i tillë ushtrohet në lidhje me aktet kryesore të shtetit, siç është në rradhë të parë ligji. Shembulli klasik i këtij kontrolli është Franca, por ka edhe vende të tjera që e zbatojnë të cilat do t’i shohim pak më poshtë. Vënia në lëvizje e një procedure të tillë është në dorën e pushtetit publik sepse, ende nuk ka ndonjë interes privat që të jetë në lojë (Traja, 2000: 67-68). Kontrolli *a priori* mund të zhvillohet në dy forma kryesore: në formën e dhënies së një pëlqimi (si në Zvicër për kushtetutat e njësive federale) ose në formën e një shqyrtimi të detyrueshëm (si në Francë për ligjet organike) (Sadushi, 2012: 168).

⁴⁰ Kontrolli *a priori* në Shqipëri realizohet vetëm për marrëveshjet ndërkombëtare dhe çështjet e shtruara për referendum

Kontrolli *a priori* ka detyrimisht karakter abstrakt (Pizzorusso, 2011: 5). Madje ky i fundit konsiderohet edhe si një kontroll parandalues, për shkak të qëllimit të tij për të pastruar sistemin juridik nga ligjet me përmbajtje antikushtetuese, përpara se ato të cënojnë të drejtat dhe liritë themelore të individëve dhe parimet e shtetit të së drejtës (Sadushi, 2012: 145-146). Kështu, GJ K Shqiptare në vendimin e saj nr. 1/2005 veç të tjerash shprehet se:

Për Gjykatën Kushtetuese është i njohur rregulli i pranuar në doktrinë dhe në jurisprudencën kushtetuese, se gjatë kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme juridike nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar kërkesin. Tipari dallues i një kërkesë të tillë është se ajo vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të ligjit, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por është një interes që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre. Ky është dhe një qëndrim i mbajtur edhe në jurisprudencën tonë kushtetuese.

Në këtë kuptim kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit mund ta konsiderojmë si “*një instrument të kontrollit a priori*”.

Nga pikëpamja e afateve, brenda të cilave duhet të nisë një procedurë e tillë, ka vende që pranojnë një iniciativë pa afate kohore, mjafton që ligji të ketë hyrë në fuqi, ka edhe vende, të cilat e lejojnë kontrollin e mëpas’shëm abstrakt vetëm brenda një afati të caktuar pas hyrjes në fuqi të ligjit. Për shembull ky afat është 3 muaj në Spanjë, 30 ditë në Itali për rekursin e paraqitura nga regjionet etj. Në këto raste, kontrolli i mëpas’shëm i afrohet shumë kontrollit paraprak dhe dallimi nëse ligji ka hyrë ose jo në fuqi nuk paraqet ndonjë rëndësi praktike. Përgjithësisht, sa më pak pasoja të ketë prodhuar një ligj, aq më shumë anulimi i tij nga gjykata kushtetuese i afrohet kontrollit *a priori* (Traja, 2000: 66).

Ashtu siç trajtuam pak më sipër si dhe shprehet dhe vetë GJ K në vendimin nr. 206/2001, sipas nenit 50 të ligjit organik, kërkesat në GJ K për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre. Në këtë mënyrë, duke iu referuar asaj çfarë u nënvizua në paragrafin më sipër, do të mund të ishim të mendimit që të shkurtohej ky afat 3-vjeçar. Por kjo si çdo medalje tjetër ka të dy anët e saj, pasi nga njëra anë do të vinte në levizje akoma më aktivisht subjektet për të kërkuar antikushtetutshmërinë e ligjit, por nga ana tjetër çfarë do të ndodhte nëse ky afat do të kishte mbaruar? Subjekti nuk do të legjitimohej dhe ligji do të vazhdonte të mbetej në fuqi?! Prandaj përbën një rëndësi të veçantë paraqitja e avantazheve të kontrollit *a priori*, në një “përballje” me atë *a posteriori*.

3.2.1.2 Avantazhet dhe disavantazhet mes kontrollit *a priori* dhe *a posteriori*

Literatura gjerësisht ka trajtuar avantazhet dhe disavantazhet mes këtyre dy formave të kontrollit, të cilat sipas Favoreu janë simetrike (Favoreu, 1992: 6), apo dallimet mes tyre. Kështu pikë së pari literatura, duke marrë si rast përfaqësues Francën, e lidh kontrollin *a priori* kryesisht me kontrollin që realizohet nga një organ politik. Por kjo nuk është e thënë pasi ka mjaft vende, si ato të Amerikës Latine, të cilat i besojnë një kontroll të tillë sistemit gjyqësor apo GJ L. Pastaj, nuk do mund të thonim të njëjtën gjë për kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare. Madje, nga ana tjetër, ekziston edhe ideja se kontrolli *a priori* është tipik për këto të fundit ndërkohë që ai *a posteriori*, funksionon më mirë për ligjet. Ndërsa do të ishim dakort me idenë e parë, për vetë

rëndësinë dhe implikimet në nivelin politik e shtetëror që sjellin marrëveshjet ndërkombëtare në vetvete, nuk do t'i qëndronim shumë dhe pa rezerva idesë së dytë. Për më tepër, duhet të nënvizojmë dhe faktin se në disa vende ekziston edhe një kontroll *a posteriori* i marrëveshjeve ndërkombëtare⁴¹ i cili në rast konstatimi të pakushtetshmërisë së kësaj të fundit, sjell turbullime të ndjeshme (Traja, 2000: 70), e megjithatë ai ekziston.

Një ndër avantazhet kryesore të kontrollit *a priori*, është fakti se përmes tij jo vetëm që parandalohen efektet e antikushtetutshmërisë së ligjit, por njëkohësisht përforcohet besueshmëria dhe siguria e rregullave juridike. Kjo veçori që ai paraqet parandalon ardhjen e pasojave të dëmshme për një shtet të së drejtës dhe për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ndryshe ndodh me kontrollin represiv, i cili për shkak të natyrës që ka, si dhe përfshirjes së gjykatës në kontrollin kushtetues, vetëm kur çmohet e arsyeshme nga inicuesit e procesit, nuk arrin të zgjidhë të gjitha çështjet kushtetuese të cilat mbeten të parregulluara për shumë kohë. Pra kontrolli paraprak nuk lejon krijimin e pasojave juridike që mund të vijnë nga natyra antikushtetuese e ligjit, në dallim nga kontrolli represiv, i cili kur shpall antikushtetutshmërinë (ndërkohë që si rregull efektet e vendimit të GJ K nuk janë të karakterit *ex tunc*), nuk mund të zgjidhë dhe as të rregullojë pasojat, të cilat janë krijuar dhe ezauruar me kohë. Në kontrollin *ex ante* nuk kemi shfuqizim të normës, në dallim nga kontrolli *ex post*. Ligji në këtë rast veçse shpallet si i papajtueshëm me Kushtetutën. Dihet që kontrolli *ex ante* shqyrton ato çështje kushtetuese që janë gati për t'u zgjidhur nga organi ligjvënës. Parë nga ky këndvështrim, ai i krijon mundësinë këtij organi

⁴¹ Në vendet me sistem që e dallojnë marrëveshjen ndërkombëtare nga ligji që e ratifikon, rekursi në të vërtetë drejtohet kundër këtij ligji inkorporues (Gjermani, Austri). Kur, marrëveshja ndërkombëtare është pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe është drejtpërdrejt e zbatueshme në të, rekursi drejtohet kundër vetë marrëveshjes (Spanje, Portugali). Shih, K. Traja, vep. e cit. fq.67 e në vijim

që të ruajë dhe rris prestigjin, në një farë mënyre më shumë se në një sistem *ex post* të kontrollit të normës. (Sadushi, 2012: 196-197).

Në literaturë gjejmë shpesh argumentin se një ndër përparësitë kryesore të kontrollit *a posteriori* është fakti se karakteri antikushtetues i një ligji del në pah vetëm pas zbatimit të tij, si dhe, ndërkohë që kontrolli *a priori* ndërhyt dhe kundërshton direkt dhe menjëherë vullnetin e ligjvënësit, ai *a posteriori* merr në konsideratë një vullnet të tillë duke e shfuqizuar pas disa muajsh madje edhe vitesh. Kësaj kritike mund t'i përgjigjesh me tezën se kontrolli *a priori* e lejon ligjvënësin që të rishikojë dhe kontrollojë ligjin vetë ai, ndërsa kontrolli *a posteriori* e nënshton atë ndaj kontrollit të GJ K, që në fakt, gradualisht e rishkruan ligjin: në mënyrë të atillë që mund të pyesim se cila nga dy format respekton më shumë vullnetin e ligjvënësit (Favoreu, 1992: 7).

Kontrolli *a priori* gjithashtu mund të “mburret” me shpejtësinë në përgjigjet e dhëna, në efikasitetin dhe garancinë që jep në drejtim të qartësisë të së drejtës, në masën dhe kuptimin që ligji antikushtetues nuk do të hyjë në fuqi dhe si i i tillë nuk do ketë mundësi që të “vesojë” gjithë rendin juridik (Favoreu, 1992: 6). Në këtë kuadër, sistemi *a posteriori* mund të çojë edhe në cenimin e një elementi shumë të rëndësishëm të shtetit të së drejtës që është parimi i sigurisë juridike, parim ky mjaft i rëndësishëm dhe i evokuar nga jurisprudenca kushtetuese si dhe ajo e GJEDNJ. Si standarde formale kryesore të tij konsiderohen saktësia, qartësia dhe qëndrueshmëria në tërësi e të gjithë rendit juridik të një shteti të caktuar. Si standarde kryesore në kuptimin material konsiderohen mos cenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Kjo do të thotë që jo vetëm normat e veçanta, por i gjithë rendi juridik kërkohet të jetë i kuptueshëm, i

parashikueshëm dhe jo kontradiktor. Në këtë mënyrë, vlerësohet se krijohet edhe besimi i qytetarëve në qëndrueshmërinë e këtij rendi si dhe bindja e tyre në nevojën e respektimit dhe zbatimit të tij në jetën e përditshme. Në të njëjtën kohë, mbi këtë bazë, qytetarët përcaktojnë edhe hapësirën e lirisë apo mënyrën e sjelljes së tyre në shtet dhe shoqëri⁴².

Vetë GJ K Shqiptare në vendimine saj nr. 26/2005, kur është shprehur për parimin e sigurisë juridike ka thënë se:

[...]doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementët thelbësorë të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike, nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht.

Në mënyrë të ngjashme GJK në vendimet e saj nr. 34/2005, 9/2007, 24/2008, 4/2010 si dhe 5/2015 ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë për sipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve

⁴² Shih Degenhart C., (1998), Staatsrecht I, CF Muller Verlag, Germany

juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme⁴³.

Kontrolli *a posteriori* duket se përmban më tepër pasiguri dhe paqëndrueshmëri të sistemit juridik e të marrëdhënieve juridike të krijuara, për shkak të kontrollit të kushtetutshmërisë në vazhdimësi që i bëhet ligjit. Kontrolli *a priori* nga njëra anë sjell më tepër qëndrueshmëri të sistemit juridik, përderisa nëpërmjet kontrollit paraprak dhe brenda një afati të caktuar kohor arrin të shmangë defektet e antikushtetutshmërisë, por nga ana tjetër nuk lejon të kundërshtohet në të ardhmen një normë juridike e shpallur. Pasi norma juridike e ka kaluar fazën e kontrollit paraprak, ajo nuk mund të bëhet objekt i shqyrtimit kushtetues, pavarësisht defekteve që mund të evidentohen gjatë zbatimit të saj në praktikë. Nga kjo pikëpamje ky model kontrolli mbart si stabilitetin e sistemit ashtu dhe pamundësinë e tij për të kundërshtuar në të ardhmen antikushtetutshmërinë (Sadushi, 2012: 198). Kjo, në gjykimin tonë, përbën dhe dobësinë më të madhe të kësaj forme kontrolli, një dobësi jo e vogël në fakt, e cila do të na bënte që përballë shtrimit hipotetik të sipërcituar, për mundësinë e një kontrolli *a priori* terësisht të pastër, të përgjigjeshim me jo!

Mirëpo, përballë pyetjes: a do të mund të kishim një stabilitet dhe siguri juridike, në rastin kur në legjislacionin apo rendin juridik ekzistojnë edhe ligje që janë në kundërshtim me Kushtetutën, ligje të cilat një ditë do të shfuqizohen, do të krijojnë një vakum ligjor, do t'i lenë kështu vendin një ligji tjetër i cili në një farë mënyre apo mase do të krijojë një kaos, pra në vija të trasha, një pasiguri juridike?! – përsëri nuk jemi të “qetë” (aq më tepër pastaj, kur brenda të njëjtit sitem, kontrolli *a posteriori*, ushtrohet me të dy efektet e tij, *ex*

⁴³ Për më tepër shih vendimet nr. 34/2005, 9/2007, 24/2008, 4/2010 si dhe 5/2015 të GJK

nunc dhe *ex tunc*, ndonëse ky i fundit, i limituar vetëm për raste përjashtimore) dhe do të përpiqeshim të bënim një verifikim të fundit, përmes hipotezës: mundësia e adoptimit të një sistemi dualist të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, që gërsheton modelin *a posteriori* me atë *a priori* - duke qenë edhe dakort me mendimin e disa autorëve, këto janë dy forma kontrolli të cilat më shumë se kundërshtojnë njëra-tjetër, forcohen dhe kompletohen në mënyrë reciproke (Longobardi, 2004: 2). Që të arrijmë në verifikimin e kësaj hipoteze, duhet fillimisht të shohim disa aplikime interesante të një gërshetimi të tillë në vende të caktuara.

3.2.2 Sistemi dualist i kontrollit. Mundësitë e aplikimit në Shqipëri

3.2.2.1 Rasti i Francës

Siç parashtruam dhe pak më sipër, Franca është vendi më tipik ku aplikohet gjerësisht një kontroll *a priori* ndaj ligjit. Kushtetuta Franceze e vitit 1958 -të (neni 56-63) parashikoi Këshillin Kushtetues, trup politik i përbërë nga nëntë anëtarë të emëruar nga Presidenti i Republikës dhe nga presidentët e dy dhomave të asamblesë parlamentare, i ngarkuar me kontrollin *a priori* të kushtetutshmërisë së ligjeve (De Vergottini, 2004: 188). Gjithashtu në përbërje të KK parshikohen si anëtarë me të drejtë dhe të përjetshëm, ish-presidentët e Republikës (Traja, 2000: 223). Ashtu siç nënvizon dhe konstitucionalisti Cappelletti, në Kushtetutën e vitit 1958 nuk parashikohej një kontroll gjyqësor i kushtetutshmërisë së ligjit (Cappelletti, 1972: 50). Madje siç trajtuam dhe në Kapitullin II, inkorporimi i kontrollit të kushtetutshmërisë në Francë, u përball për një kohë të gjatë me parimin e fortë rusovian “

la loi est l'expression de la volonté générale ”⁴⁴ ashtu siç parashikohet në nenin 6 të Deklaratës për të Drejtat e Njëriut dhe Qytetarëve, 1789 (Barbera, 1997: 13). Nga ana tjetër K K deri në gjysmën e viteve 70’ ka ushtruar një funksion të tillë në mënyrë të kufizuar dhe ashtu siç është shprehur dhe vetë në Vendimin 62-20 DC, funksionet e tij nuk ishin ato të një organi të drejtësisë kushtetuese por ato të një organi rregullues të veprimtarisë të pushteteve publike (Favoreu, 1967: 7). Këto e kanë bërë K K të mos konsiderohet si një organ i mirëfilltë gjyqësor i drejtësisë kushtetuese, në kuptimin “kelzenian” të termit (Fromont, 2002: 182). Por me kalimin e viteve, vetë K K u distanca nga një qëndrim i tillë dhe e vetmja gjë që nuk ndryshoi, ishte ajo e mënyrës së kontrollit të kushtetutshmërisë: *a priori* (Fabbrini, 2009: 11).

Fakti është që KK ushtron kontrollin e kushtetutshmërisë. Në literaturë, KK njihet gjerësisht për kontrollin *a priori*, pra pas miratimit të ligjit nga Parlamenti por para shpalljes së tij. KK është i njohur gjithashtu për kontrollin *a priori* të detyrueshëm ndaj ligjeve organike, të realizuar *ex officio*, dhe për kontrollin e ligjeve të tjera të zakonshme, me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, të Kryetarit të Asamblesë Kombëtare, të Kryetarit të Senatit, të 60 deputetëve ose të 60 senatorëve. Në literaturë po ashtu atij i janë bërë mjaft kritika. Ka mendime që e shohin si një organ më shumë ligjbërës se gjyqësor, madje e quajnë dhe si një “dhomë e tretë” e legjislaturës (Sadushi, 2012: 169). Një kritikë e fortë, ka qenë dhe ajo që nënvizuam pak më sipër, për pamundësinë e atakimit të ligjit për antikushtetutshmëri, pas shpalljes së tij. Pikërisht këtyre kritikave, sistemi francez iu është përgjigjur përmes Ligjit për Rishikimin Kushtetues n°2008-7243, i

⁴⁴ Ligji është shprehje e vullnetit të popullit

aprovuar me 21 korrik 2008 nga Parlamenti Francez, ku parashikohet për herë të parë një lloj kontrolli *a posteriori* dhe konkret në rrugë incidentale, i inspiruar nga modeli italian⁴⁵ (Maus, 2006: 665). Përmes këtij ligji, tashmë neni 61/1 i Kushtetutës Franceze parashikon që në rast se gjatë një procesi gjyqësor, del në pah çështja e antikushtetutshmërisë së një ligji i cili është në fuqi dhe është i aplikueshëm në çështjen e konfliktit mes palëve, KK mund të vihet në lëvizje me kërkesën e Gjykatës së Kasacionit ose Këshillit të Shtetit, për të gjykuar mbi kushtetutshmërinë e ligjit në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njohura në Kushtetutë. Kjo reformë përbën dhe risinë më sinjifikative të rishikimit kushtetues të 2008-ës në Francë (Fabbrini, 2009: 5), dhe në vetvete instituti i *exception d'inconstitutionality*, siç e quajnë vetë francezët, përfaqëson për sistemin konstitucional francez një revolucion në kuptimin e vërtetë të fjalës (Meny, 2008: 3).

Nëse kjo zgjidhje, në gjykimin tonë, mjaft origjinale dhe efikase, nuk do t'i mjaftonte kritikëve të këtij sistemi, dhe sidomos atyre që shohin tek kontrolli *a priori*, një formë jo shumë gjyqësore kontrolli, do të na duhej t'i rikujtonim se një formë e tillë aplikohet pothuajse në të gjitha juridiksionet kushtetuese (Davis, 1986: 80).

3.2.2.2 Shembuj të tjerë të juridiksioneve kushtetuese dhe gjyqësore

Nisur nga ajo çka parashtruam pak më sipër, vlejné për t'u kujtuar disa shembuj të tjerë të juridiksioneve kushtetuese por edhe gjyqësore. Ligji për rishikimin kushtetues nr. 1/82, dt.30.09.1982 i Kushtetutës Portugeze të 1976-ës (neni 278) ka parashikuar ndërtimin

⁴⁵ Kontrolli incidental për herë të parë është aplikuar në Itali, në vitin 1947

e një GJ K me kompetencën për të ushtruar një kontroll *a priori* (me kërkesë të Presidentit) si dhe *a posteriori* të kushtetutshmërisë, që shërben dhe si instancë apelimi kundër vendimeve të gjykatave që aplikojnë ligje të deklaruar tashmë si antikushtetuese (De Vergotini, 2004: 193). Ndërkohë që ashtu si dhe në Francë, neni 278 i Kushtetutës Portugeze, parashikon kontroll *a priori* specifikisht për ligjet organike. Të njëjtën gjë parashikon dhe Kushtetuta Rumune (neni 144 e në vijim), megjithëse duhet nënvizuar se këtu fjalën e fundit e ka Parlamenti, për faktin se me një shumicë të cilësuar prej 2/3 nga të dy dhomat, mund të rrëzohet vendimi jo përfundimtar i GJ K (neni 145). Në Estoni në rast se Parlamenti refuzon veton pezulluese që ka ushtruar Presidenti i Republikës, duke e miratuar ligjin, atëherë Presidentit i lind e drejta t'ia referojë çështjen e kushtetutshmërisë së ligjit Dhomës së Kontrollit Kushtetues pranë GJ L. Në Poloni si në një rast përjashtimor, rishikimi kushtetues përpara shpalljes së ligjit mund të drejtohet në Tribunalin Kushtetues me kërkesë të Presidentit, vetëm në rast se ai nuk e ka shpallur ligjin më parë. Tribunalit Kushtetues i është njohur e drejta për të dhënë opinione këshillimore për ligjet e propozuara dhe kjo kompetencë nuk është kuptuar si një ndarje kompromentuese e pushteteve⁴⁶. Në Hungari kontrolli paraprak ka ekzistuar që në vitin 1998 dhe përfshinte jo vetëm mundësisinë e rishikimit të ligjeve pas votimit dhe përpara shpalljes së tyre, por edhe kontrollin e ligjeve të cilat nuk ishin votuar. Përsa i përket Spanjës, edhe ajo gjatë viteve 1980-1985, ka realizuar kontroll *a priori* për ligjet organike (Sadushi, 2012: 169-174). Në fakt një kontroll i tillë mbi ligjet organike është i përhapur gjerësisht në shumë vende të

⁴⁶ Ka mendime se pushteti i dhënies paraprake të opinioneve këshilluese, para miratimit në Parlament, duket se e kompromenton pavarësinë e GJK duke e kthyer atë në një organ besnik të Pralamentit. Nga ana tjetër ekziston pikëpamja se pushteti i dhënies së këshillave nuk është i pafavorshëm, por për më tepër prezumon një shkallë të lartë pavarësie. Shih S. Sadushi, (2012), vep. e cit., fq.172-174

botës, ku përveç shembujve të trajtuar, duke iu referuar kushtetutave respektive, mund të veçonim edhe Turqinë, Irlandën, Hungarinë, Qipron, Finlandën si dhe Austrinë.

Në kontrast me përfytyrimet e zakonshme që ekzistojnë për drejtësinë kushtetuese gjermane, si kontroll *ex post facto*, edhe këtu realizohet një kontroll paraprak i ligjeve federale, në tre raste: ndaj një ligji me të cilin miratohet ose ratifikohet një traktat ndërkombëtar, duke iu drejtuar Gj K F Gj para promulgimit të tij; në çështjet që lindin nga konfliktet ndërmjet organeve kushtetuese, ku mund të kontrollohet një ligj të cilin Presidenti i Republikës refuzon ta promulgojë dhe një organ tjetër kushtetues duke mos u pajtuar me këtë refuzim i drejtohet Gj. Në këtë rast Gj shqyrton kushtetutshmërinë e ligjit të votuar para se të shqyrtojë kushtetutshmërinë e refuzimit të promulgimit. Së fundi hyrja në fuqi e një ligji mund të vonohet deri sa Gj të vendosë; kjo ndodh kur Gj ka vendosur pezullimin e zbatimit të ligjit si rasti i ligjit për abortin i votuar me 18 qershor 1974 dhe i promulguar me 21 qershor, nuk hyri asnjëherë në fuqi pasi Gj me kërkesën e një landi e pezulloi dhe më vonë me vendimin e 25 shkurtit 1975 e anulloi. E njëjta gjë ka ndodhur me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1990 (Traja, 2000: 202-203).

Përsa i përket Italisë, me ligjin kushtetues 1/1999, u duk sikur u ndërhy në nenin 123 të Kushtetutës për parashikimin e një kontrolli paraprak për statutet e rajoneve dhe ligjet që i modifikojnë ato. Interpretimin përfundimtar e bëri Gj K me vendimin nr. 304/2002 ku ajo thotë se kjo është një formë e kontrollit paraprak.

3.2.2.3 Vetoja e Presidentit si instrument për kontrollin *a priori*

Në shembujt e parashtruar, konstatohet se Presidenti i Republikës ka një rol të rëndësishëm në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit. Një zgjidhje tjetër interesante, në këtë drejtim, jep edhe Irlanda, ku Presidenti i Republikës, kur është i bindur se ligji i votuar është në kundërshtim me Kushtetutën, ka të drejtë t'ia referojë çështjen Gjykatës së Lartë. Ky mekanizëm shoqëron veton, duke e zbutur atë dhe duke mënjeluar përplasjet e thata ndërmjet pushteteve publike (Traja, 2000: 67). Ndërkohë që sipas Kushtetutës së RSH-së, neni 85 pika 1, parashikon se: “Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë”.

Pyetja që lind në këtë rast është: A mund të konsiderohet vetoja pezulluese e Presidentit si një formë e kontrollit *a priori* të kushtetutshmërisë së ligjit dhe nëse jo, a mund t'i shërbejë ky instrument këtij qëllimi?

Pikë së pari, e drejta e kryetarit të shtetit për t'ia kthyer një ligj për rishqyrtim parlamentit, pra përmes vetos pezulluese, konsiderohet si një veprim kontrollues i përligjur që e detyron parlamentin të jetë më i matur në vendimet që merr (Omari, 2002: 301).

Po t'i referohemi literaturës në lidhje me veton e Presidentit, ajo shpesh herë shihet si një mjet për kontrollin e kushtetutshmërisë, duke përfshirë këtu edhe vetë sistemin amerikan të kontrollit, ku vetoja pezulluese konsiderohet si një mjet apo instrument i ngjashëm me *judicial review*. Në sistemin amerikan thuhet se Presidenti mund të shprehë një opinion në lidhje me mospreferencën e një akti të kaluar në Parlament (duke përfshirë

edhe motivin për antikushtetutshmërinë e tij) - por gjithsesi kjo nuk duhet të jetë fjala e fundit (Anstaplo, 2006: 36).

Në Gjermani, Presidenti Federal nuk e ka pasur asnjëherë të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për arsye se ai ka kompetencën për shpalljen e ligjeve dhe të ushtrimit të së drejtës së vetos, vetëm një herë. Deri më 1956 atij i njihej e drejta për të kërkuar nga Gjykata një mendim konsultativ për probleme me karakter kushtetues. Por edhe kjo e drejtë iu hoq po më 1956. Disa autorë janë të mendimit që e drejta e investimit të Gjykatës Kushtetuese duhet t'i njihet edhe Presidentit si një mjet për të shqyrtuar kushtetueshmërinë e ligjit përpara shpalljes së tij (Omari, 2004: 248-249).

Në sistemin italian të kontrollit, mundësia e kthimit të ligjeve për rishqyrtim Dhomave të Parlamentit, për motive antikushtetutshmërie, ka çuar një pjesë të doktrinës që të shohin Kryetarin e Shtetit dhe GJ K në funksionin e mbrojtësve të Kushtetutës, i pari përmes kontrollit *a priori* dhe i dyti përmes kontrollit *a posteriori* (Longobardi, 2004: 7).

Kjo në fakt do të ishte një zgjidhje interesante në drejtim të gërshtimit të dy formave të kontrollit *a priori* dhe *a posteriori*.

Ndoshta, në gjykimin tonë, një zgjidhje më e mirë e aplikueshme, do ishte ajo e adoptimit të modelit francez, por në linjë të kundërt. Që do të thotë se ndërkohë që Franca ka patur kontrollin *a priori* dhe më pas njohu atë *a posteriori*, në formën e kontrollit incidental, në rastin tonë kontrolli *a posteriori* duhet të lihet në të tre modalitetet e tij, abstrakt, konkret, incidental por me veçorinë që të mund të parashikohet në legjislacionin shqiptar edhe mundësia e kontrollit *a priori*, madje në formën e detyrueshme të tij. Kjo do

të mund të realizohet, pikë së pari në drejtim të ligjeve të zakonshme; ndaj ligjeve organike për vetë rëndësinë që ato paraqesin, si dhe për faktin se tashmë një praktikë e tillë është e konsoliduar në shumë sisteme kontrolli; ndaj ligjeve të tjera të përforcuara në kuptim të nenit 81 paragrafi 2, pikat *b, c, ç, d, e, ë, f*; rezerva do tregohet në drejtim të ligjit për gjendjen e jashtëzakonshme, parashikuar në pikën “*dh*” të këtij neni, kur ndiqet procedura e përshpejtuar, në rast të masave të jashtëzakonshme si dhe në rast nevojë urgjence, në kuptim të nenit 84, pika 4 të Kushtetutës; si dhe për ligje të tjera të përforcuara.

KAPITULLI IV: GJYKATA KUSHTETUESE SHQIPTARE NË FUNKSION TË KONTROLLIT TË KUSHTETUTSHËMRISË SË LIGJIT. REFORMA NË DREJTËSI DHE IMPAKTI I SAJ NË KONTROLLIN KUSHTETUES TË LIGJIT

4.1 Mundësia e adoptimit të kontrollit të decentralizuar në Shqipëri

4.1.1 Argumentet pro dhe kundër kontrollit të centralizuar dhe atij të decentralizuar

Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri realizohet nga Gjykata Kushtetuese, në kuadrin e kontrollit të centralizuar. Duke u kthyer mbrapa në kohë disa vite më parë (1991-1998), në periudhën e procesit të përpjekjeve për miratimin e Kushtetutës, konstitucionalisti Kristaq Traja, një nga hartuesit e saj, kujton:

[...] u hartuan disa projekte në të cilat pasqyrohen qartë modelet që propozoheshin për t'u adoptuar. Në të vërtetë ka patur një pozicion mjaft të qartë e të vendosur nga një pjesë e anëtarëve të komisioneve kushtetuese dhe të ekspertëve në favor të modelit amerikan të rishikimit gjyqësor të ligjeve dhe një pozicion po aq të qartë e të vendosur të pjesës tjetër për të adoptuar modelin evropian. Unë vetë kam qenë për variantin e parë, i cili përfundimisht nuk fitoi. Arsyet pse nuk u pranua ishin të shumta dhe mund të gjurmohen, në një pjesë të madhe, në debatet kushtetuese të vendeve të tjera: pamundësia e sistemit të zakonshëm gjyqësor, për të mbajtur peshën e një kontrolli tepër delikat dhe me pasoja të mëdha, frika e politizimit të gjyqësorit, konteksti gjeo-politik evropian, etj. etj. Disa nga këto arsye, sidomos e para, vërtet qëndrojnë, dhe atë mund ta shohim fare qartë në zbehtësishtë e frikshme, të kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së ligjeve nga gjykatat e zakonshme, ku vendimet për dërgimin e çështjes kushtetuese paragjykimore, në GJ K numërohen me gishta (Traja, 2000: 35-36).

Sipas Favoreu shumica e vendeve europiane që kanë sot një GJ K, në momente të caktuara janë joshur të pranojnë modelin amerikan, por më së fundi kanë hequr dorë prej tij. Megjithatë, disa vende kanë pranuar sisteme drejtësie kushtetuese, që në shkallë të

ndryshme, frymëzohen nga modeli amerikan. Vende të tilla janë Zvicra, Greqia, Danimarka, Suedia, Norvegjia (Omari, 2004: 236).

Në këtë mënyrë, për të parë mundësinë e adoptimit të një kontrolli të decentralizuar, le të shohim më nga afër argumentet pro dhe kundër.

Studiuesi shqiptar, Luan Omari kur parashton arsyet pse numri më i madh i shteteve në Europën kontinentale, kanë përqafuar sistemin e centralizuar të kontrollit të kushtetutshmërisë, nga ana e një gjykate të posaçme, thotë se kjo varet nga koncepti që ekziston në këto vende për ndarjen e pushteteve, nga moszbatimi i precedentëve gjyqësorë si dhe nga fakti se në këto vende gjyqtarët e zakonshëm, nuk janë të përshtatshëm për një kontroll të tillë (Omari, 2004: 228-229).

Garantimi i epërsisë së kushtetutës me anë të një kontrolli gjyqësor të ligjeve, ka shtruar problemin e pushtetit të gjyqtarëve, të legjitimitetit të tyre, sepse kontrolli do të thotë pushtet. Po t'u ngarkohet gjyqtarëve ky kontroll, kjo do të thotë që pushteti gjyqësor të ngrihet në një instancë që do të mbikqyrë tërë veprimtarinë politike. Studiues të ndryshëm vazhdojnë arsyetimin duke thënë se ndonëse tani janë të shumta shtetet ku është vendosur një kontroll i tillë, janë ende të pakta ato ku ky funksion kryhet me korrektësi. Prandaj këto raste shërbejnë për të përforcuar argumentimin se organi që duhet ta ushtrojë këtë kontroll nuk është gjyqtari i zakonshëm, por një gjykatë e posaçme, përbërja e së cilës jep maksimumin e garancive të objektivitetit (Omari, 2004: 211-212).

Edhe kritikave që bëhen ndaj vetë GJ K, si për shembull fakti se ajo është në kundërshtim me teorinë e ndarjes së pushteteve, mund t'i përgjigjemi me argumentet e

sakta që paraqet vetë ideatori i krijimit të një organi të tillë, Hans Kelzen, i cili jo vetëm që e konsideron gjykatën kushtetuese si një legjislator negativ por shkon edhe më tej duke thënë se një funksion i tillë është në përputhje të plotë me teorinë e ndarjes së pushteteve (Kelzen, 1981: 145).

Për të mos përmendur më pas, faktin e rëndësishëm, të cilin e hasim gjerësisht në literaturë dhe jo vetëm, që GJ K në shumicën e rasteve nuk janë pjesë e sistemit gjyqësor. Kështu, siç e dimë dhe u trajtua dhe pak më lart, këtu bën pjesë edhe Gjykata Kushtetuese Shqiptare. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor të zakonshëm, por ajo përbën një juridiksion të veçantë, e ngarkuar të kontrollojë kushtetutshmërinë e ligjeve⁴⁷. Nga ana tjetër, shumica e studiuesve e argumentojnë domosdoshmërinë e ekzistencës së një gjykatë kushtetuese, si kusht të rëndësishëm për ekzistencën e vetë shtetit të së drejtës.

Një vështirësi tjetër që paraqitet në mundësinë e adoptimit të një kontrolli të decentralizuar në Shqipëri, është fakti i mungesës së traditës juridike, pasi siç u theksua që në Kapitullin II, sistemi i decentralizuar, çon në forcimin e pushtetit gjyqësor, çka është e natyrshme në një vend ku zbatohet *common law*, ku gjyqtari mban një pjesë të sovranitetit të shtetit, që është e vështirë të pranohet në vendet ku ka një traditë tjetër juridike, siç është ajo e të drejtës romake.

Sipas Kelzen, gjyqtarët në Europë, të formuar në frymën e respektit besnik të ligjeve, nuk kanë autoritetin e nevojshëm për të kryer detyrën e kontrollit të ligjeve (Omari,

⁴⁷ Shih faqen zyrtare të “Gjykatat e RSH-së”, e aksesueshme në www.gjykata.gov.al

2004: 234). Modeli amerikan i një drejtësie kushtetuese të shkrirë dhe të decentralizuar, atij i dukej i kritikueshëm për disa arsye. Kelzeni nuk e pranonte modelin amerikan ku drejtësia kushtetuese i është besuar aparatit gjyqësor dhe nuk dallohet nga drejtësia e zakonshme, sepse të gjitha konfliktet gjykohen nga të njëjtat gjykata dhe aspekti kushtetues mund të jetë i pranishëm në të gjitha konfliktet dhe nuk ka nevojë për një trajtim të veçantë. Modeli evropian i projektuar nga Kelzeni është i ndryshëm sepse konflikti kushtetues, që dallohet nga konflikti i zakonshëm, është në kompetencë ekskluzive të një gjykate të vetme, të krijuar posaçërisht dhe që mund të vendosë me vendime që kanë efektin absolut të gjësë së gjykuar. Sipas Kelzenit, krijimi i një instance të vetme e të specializuar në konfliktet me karakter kushtetues, shmang interpretimet divergjente të gjykatave dhe lejohet të formulohet menjëherë “*një e vërtetë kushtetuese unike*”. Ky sistem lejon që të sqarohet përfundimisht situata dhe të zgjidhet konflikti kushtetues, sepse vendimi për mospajtimin e një ligji me Kushtetutën ka një vlerë absolute dhe ligji nuk mund të ketë më asnjë efekt (Omari & Anastasi, 2010: 425).

Në këtë aspekt ka qenë tipike mendësia e gjyqtarëve në Francë, para dhe pas revolucionit, të cilët kanë qenë të kufizuar në rolin e “shërbëtorëve të ligjit” dhe nuk mund të ishin kurrësi censorë të tij. Humanisti francez i kohës së absolutizmit, Bossuet lavdëronte “ frymën dhe parimet e një gjyqtari, i cili duke qenë i lidhur pas normës, nuk çon në gjykatë mendimet e veta [...] dhe do që të qeverisin ligjet dhe jo njerëzit ”. Por kjo nuk ishte vetëm një dukuri franceze. Edhe në vende të tjera evropiane një nga arsyet që shpjegojnë mospranimin e modelit amerikan ka qenë, sipas shprehjes së Louis Favoreu “shenjtërimi” i ligjeve. Në këto vende që nga Revolucionin francez dhe deri në

dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX u imponua dogma e Rusoit mbi pagabueshmërinë e ligjit. Mbretëria e së drejtës konsiderohej mbretëria e ligjit. Edhe Kapeleti sikurse më parë Kelzeni, ka vënë në dukje se në Europë gjyqtarët e zakonshëm, nuk kanë aftësinë të ushtrojnë drejtësinë kushtetuese sipas modelit amerikan, sepse, sipas tij, gjyqtarët e Europës kontinentale janë zakonisht gjyqtarë “karriere”, jo të përshtatshëm për të kryer një funksion kontrolli ndaj ligjeve, funksion që është patjetër krijues dhe shkon më tej sesa funksioni i tyre tradicional i interpretuesve të thjeshtë dhe të shërbyeve besnikë të ligjeve (Omari, 2004: 234).

Roli i Gjykatës së Lartë të SHBA-së është i qenësishëm në funksionimin e sistemit politik të atij vendi. Prandaj është thënë shpesh se sistemi amerikan, pa Gjykatën e Lartë, nuk do të njihte atë ekuilibër që e karakterizon (Omari, 2004: 225).

Studiuesi Cappelletti, ka vënë në dukje se në vendet që nuk njohin precedentin gjyqësor, sistemi i kontrollit të centralizuar, lejon që të krijohet një jurisprudencë koherente në fushën e së drejtës kushtetuese. Në sistemin amerikan, ku çdo gjyqtar ka mundësinë të vendosë për kushtetutshmërinë e ligjit, koherenca në jurisprudencë sigurohet nga detyrimi që kanë gjyqtarët për t’iu përmbajtur precedentëve dhe sidomos vendimeve të gjykatave eprorë. Ekzistenca e Gjykatës së Lartë Federale dhe detyrueshmëria e zbatimit të precedentëve të vendosura nga gjykatat eprorë, siguron atje unifikimin e jurisprudencës. Cappelletti i përgjigjet edhe pyetjes se përse në vendet europiane, që kanë pranuar kontrollin e përqëndruar ky nuk u është ngarkuar Gjykatave të Larta (apo të Kasacionit) ekzistuese, pa i lejuar gjykatat më të ulta që të ushtronin një kontroll të tillë, aq më tepër që, në rast se do të ishte pranuar një gjë e tillë, vendimet e Gjykatës së Lartë në çështjet e kushtetutshmërisë, mund të kishin një efekt të

përgjithshëm, *erga omnes*, ose të paktën, një efekt për rastin konkret të gjykuar. Pikë së pari kjo vjen nga vetë organizimi i gjykatave të larta, numri i madh i çështjeve të të gjitha llojeve që ato shqyrtojnë, mendësia që ato kanë formuar për një kohë të gjatë dhe formimi i tyre profesional i bazuar më shumë në teknikat e zbatimit të ligjeve, i pengojnë që të japin gjykime që duhet të kenë parasysh edhe faktorët politikë⁴⁸. Gjithashtu, shkrirja e Gjykatës së Lartë me Gjykatën Kushtetuese do të prishte së tepërmi ekuilibrat.

Një avantazh tjetër i gjykatave kushtetuese kundrejt atyre të zakonshme, që përbën njëkohësisht edhe disavantazhin e këtyre të fundit, është fakti se autoriteti dhe fuqia e tyre është aq e madhe saqë edhe pse në princip ato njohin supermacinë e ligjeve të Komunitetit European, megjithatë parashikojnë rezerva apo bëjnë kufizime, në respekt të parimeve themelore kushtetuese, duke i dhënë kështu vetes të drejtën për të rishikuar rastet e kapërcimit të kompetencave nga organet e Komunitetit European apo rastet e shkeljes së parimeve themelore kushtetuese të vendeve respektive. Kjo praktikë është krijuar kryesisht nga Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane në çështjet e *Solange I* dhe *II* si dhe *Mastritit* apo Gjykata Kushtetuese Italiane në çështjet e *Granital* dhe *Frontini* (Albi, 2005: 170). Madje mund të themi që edhe pse që më 1964, Gjykata Europiane e Drejtësisë e bëri të qartë se legjislacioni komunitar ka fuqi mbi atë kombëtar⁴⁹, të çdo niveli, duke përfshirë edhe kushtetutat e shteteve anëtare, sot pikëpamjet në lidhje me raportin mes kushtetutave kombëtare dhe legjislacionit komunitar, janë kontroverse dhe jo persistente (Bogdandy & Bast, 2006: 96-97). Ndryshe nga gjykatat e larta, Gjykatat Kushtetuese insistojnë se janë

⁴⁸ Shih Mario Capelletti, vep. e cit. dhe Luan Omari, vep. e cit., fq. 230 e në vijim

⁴⁹ Në literaturë, hasim edhe mendime që i ndajnë vendet anëtare të BE-së, në tre kategori: shtete në të cilat legjislacioni komunitar ka fuqi të plotë më të lartë; ato në të cilat legjislacioni komunitar ka fuqi të limituar si dhe shtete në të cilat mbizotëron kushtetuta e tyre.

kushtetutat kombëtare dhe jo Gjykata Europiane e Drejtësisë apo traktatet e Komunitetit Europian, që ndërmjetësojnë marrëdhëniet ndërmjet ligjeve të Komunitetit Europian dhe ligjeve kombëtare. Kjo gjetje është e një rëndësie të madhe në kontekstin e zgjerimit të Bashkimit Europian, duke qenë se GJK në vendet anëtare kanë një status të fuqishëm dhe një traditë ndikimi të gjerë të aktivizmit gjyqësor në rindërtimin e sistemeve të pavarura ligjore (Albi, 2005: 171).

Zgjedhja mes kontrollit të centralizuar dhe atij të decentralizuar, varet edhe nga faktorë të tjerë të karakterit teknik, pasi për shembull ky i fundit mund të funksionojë vetëm në rrugë incidentale ndërkohë që kontrolli i centralizuar funksionon në të dy mënyrat, në rrugë incidentale por dhe të drejtpërdrejtë. Një zgjedhje e tillë në aspektin politik ka ndikimin e vet. Kontrolli incidental, siç u pa dhe në Kapitullin II, është më pak “fyes” ndaj legjislatorit se kontrolli direkt (Favoreu, 1992: 5-6).

Në praktikën e gjykatave kushtetuese që ushtrojnë kontrollin abstrakt, mund dhe duhet të shfaqet një vetëpërmbajtje, por nga ana tjetër, edhe një gjykatë e lartë, e cila hedh poshtë ligjet në procesin e gjykimit konkret, mund të jetë shumë më aktiviste dhe jo aq e respektueshme ndaj funksionit të legjislativit (Sadushi, 2012: 164-165).

Dhe për ta mbyllur: thuhet se Kushtetuta është kujtesa e një shteti! Nëse kjo është e vërtetë, atëherë Gjykata Kushtetuese është mekanizmi i duhur për ta mbajtur atë gjallë. Përse kjo lidhje e ngushtë organike midis të dyjave? A mos vallë nuk mund të ekzistojë njëra pa tjetrën? Natyrisht që munden, por ekzistenca e secilës prej tyre do të ishte e mefshtë, e brishtë, aspak tërheqëse, madje në disa raste deri edhe kërcënuese për ekzistencën e shtetit dhe shoqërisë demokratike. Sot është tejkaluar faza e debatit nëse

duhet apo jo të ketë një Kushtetutë të shkruar. Në vendet me demokraci të konsoliduar madje është tejkaluar edhe debati mbi nevojën e Gjykatës Kushtetuese. Vendet që ende nuk janë në këtë fazë zhvillimi vazhdojnë herë pas herë të kapen pas ideve origjinale të demokracisë përfaqësuese, si parimi më i lartë në shtet, duke theksuar nevojën e kufizimit të pushtetit të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (Zaganjori, Vorpsi & Biba, 2012: 59).

4.1.2 Përafrimi i dy modeleve të kontrollit: Modeli miks

Një këndvështrim interesant është ai i disa autorëve të cilët mendojnë se Gjykata e Lartë e ShBA-së është njëkohësisht edhe një gjykatë kushtetuese, e ngarkuar për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit. Ata mbështesin pikëpamjen sipas së cilës Gjykata e Lartë Amerikane po afrohet praktikisht, përherë e më shumë me gjykatat europiane të cilat janë kompetente vetëm për çështje që lidhen me Kushtetutën. Këtë tendencë autorët e shohin jo vetëm te fakti se Gjykata e Lartë po e kufizon veprimtarinë e vet kryesisht në çështje të tilla por edhe te fakti se ajo ka marrë gjithnjë e më tepër qëndrim në çështje që kanë haptas një natyrë politike, si problemi i diskriminimit racial dhe caktimi i zonave zgjedhore. Studiuesi shqiptar Omari, mbështet qëndrimin e Yves Meny, ku në veprën e tij me titull *“Politique comparée. Les democraties: Allemagne, Etats Unis, France, Grande-Bretagne, Italie”*, të vitit 1993, autori kritikon pikëpamjet e Louis Favoreu, i cili nuk e konsideron Gjykatën e Lartë si një Gjykatë Kushtetuese, pasi mes tyre Favoreu sheh dallime kryesisht të natyrës procedurale dhe institucionale. Sipas autorëve po të ndiqej

logjika e Favoreu, nuk do të mund të krahasoheshin Kongresi Amerikan dhe parlamentet europiane apo Presidenti Amerikan dhe qeveritë parlamentare evropiane. Madje Meny, shkon edhe më tej, duke përfshirë këtu edhe Këshillin Kushtetues Francez (Omari, 2004: 231). Në fakt, do të ishim dakort me një arsyetim të tillë, por nga ana tjetër, nuk mund të anashkalojmë idenë e Favoreu, në lidhje me ndryshimet procedurale dhe institucionale që hasen mes dy rasteve, aq më tepër që Gjykata e Lartë amerikane është pjesë e sistemit gjyqësor, ndërkohë që Gjykata Kushtetuese, përfshi dhe atë shqiptare jo. Sipas Favoreu, një gjykatë kushtetuese është një gjykatë e krijuar për t'u marrë posaçërisht dhe ekskluzivisht me konfliktet kushtetuese, e vendosur jashtë sistemit të zakonshëm gjyqësor dhe e pavarur prej tij (Favoreu, 1986: 13).

Një tjetër studiues i fushës, Michel Fromont, kur flet për rolin e Gjykatës së Lartë amerikane thotë se nganjëherë ajo kryen edhe rolin e Gjykatës Kushtetuese duke kontrolluar respektimin e Kushtetutës Federale nga ligjet. Nga ana tjetër, sipas tij, gjykata kushtetuese po refuzon gjithnjë e më shumë që të ndërhyjë në këtë fushë, duke e ulur numrin e vendimeve të dhëna për çështje të kushtetutshmërisë nga 50% në 33% (Fromont, 2005: 126).

Konstatohet gjithashtu, që disa juridiksione kushtetuese, si për shembull GJ K FG, kalojnë progresivisht nga kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në kontrollin e aplikimit të ligjit, dhe kjo ndodh në masën që këto juridiksione mund të shndërrohen në një super - Gjykatë të Lartë (rrezik i denoncuar kohët e fundit në Spanjë në lidhje me rekursin *amparo*, por ekzistues prej disa kohësh edhe në Gjermani e Itali). Favoreu, shtron pyetjen: “ Ky është roli i mirëfilltë, ku konsiston funksioni i një juridiksioni kushtetues dhe përdorimi i

instrumentit të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit për këtë qëllim, është normal?” (Favoreu, 1992: 8).

Sistemi gjerman ka më shumë ngjashmëri me sistemin amerikan sesa me atë francez të kontrollit (Fromont, 2005: 29), shtoj dhe faktin se Gjykata Kushtetuese Federale konsiderohet pjesë e sistemit gjyqësor (Sadushi, 2012: 86). E në fakt me të drejtë, siç parashtruar edhe në Kapitullin II, këtë përafrim mund ta shohim, për ligje të shpallura para vitit 1949, ku gjyqtarët të zakonshëm në sistemin gjerman, i jepet më shumë liri në krahasim me gjyqtarët e tjerë të kontinentit, duke qenë se për këtë kategori ligjesh ai ka të drejtë të mënjanojë vetë zbatimin e ligjit. Më pas i takon individit që përmes rekursit individual, në kuadër të një interpretimi të gabuar të ligjit nga gjykata, t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ndërkohe që për ligje që i përkasin periudhës pas vitit 1949, çështja shtrohet në të njëjtën mënyrë si dhe në pjesën tjetër të kontinentit, pra çështja e kushtetutshmërisë së ligjit, dërgohet menjëherë në Gjykatën Kushtetuese (Fromont, 2005: 47-50).

Një ngjashmëri të tillë konstitucionalisti Traja, e sheh edhe të sistemi shqiptar i kontrollit, kur thotë se gjykatësi i zakonshëm mund të shndërrohet nga një gjykatës *ad quo*, në një gjykatës i cili ndjek *parimin e mënjanimi të zbatimit të ligjit*, sipas sistemit amerikan. E kjo është e mundur me ligjet e parashikuar në nenin 181/2 të Kushtetutës. Sipas tij, mund të thuhet se, përgjithësisht, atje ku kushtetuta lejon pushtetin gjyqësor të zbatojë ligjet vetëm kur nuk vijnë në kundërshtim me të, po atje ky pushtet jep drejtësi kushtetuese, sepse ai mënjanon ligjin duke zbatuar një normë kushtetuese. Kushtetuta shqiptare, sado e çuditshme mund t’u duket disave, ia njeh këtë prerogativë pushtetit të zakonshëm gjyqësor në çështjet që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para hyrjes së saj në fuqi.

Kjo është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e nenit 181 të Kushtetutës, sepse është vetë gjykata e zakonshme ajo që është e autorizuar të shprehet nëse ligji i kësaj fushe vjen ose jo në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo rezulton më e qartë po të shohim se neni 178/1 i saj bën një zgjidhje krejt të kundërt për të gjitha ligjet e aktet e tjera normative, që dalin jashtë suazës së shpronësimeve dhe konfiskimeve; ato “*do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar*” (Traja, 2000: 15).

Edhe orientimi tashmë mbizotërues i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Italiane, si për shembull vendimet nr. 350/1997, 269/1999, 316/2000, 198/2003, 104/2011, 6/2014 apo 81/2014 është në kuptimin që të kërkojë që gjyqtari *a quo* ta ngrejë çështjen vetëm nëse ka rezultuar e pamundur t’i bëhet një interpretim në përputhje me Kushtetutën, dispozitës që duhet zbatuar në gjykim. Ankimi në Gjykatë pranohet pra vetëm nëse nuk ekziston një interpretim i arsyeshëm që të mund të lerë në jetë normën e dyshuar për antikushtetutshmëri. Në këtë mënyrë, kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve ka tendenca të jetë më pak i përqëndruar dhe më shumë i shpërndarë, duke paraqitur ndonjë rrezik lidhur me harmoninë dhe koherencën e sistemit juridik dhe lindjen e një përqëndrimi tjetër të ndryshëm në Gjykatën e Kasacionit, e cila në ushtrimin e funksionit të saj unifikues mund të shndërrohet, në këtë mënyrë, në një organ të dytë të përqëndruar të drejtësisë kushtetuese (Martines, 2011: 346-347).

Një përafrim i tillë mes dy juridiksioneve, përbën drejtësinë kushtetuese në kuptimin material të fjalës, sipas së cilës: “ [...] kontrolli i kushtetutshmërisë shfaqet si operacioni intelektual, që konsiston në ballafaqimin e një norme me kushtetutën, cildo qoftë gjyqtari

që e zhvillon këtë veprimtari dhe cilido qoftë lloji i gjykimit ku përfshihet ky verifikim [...]” (Grewe & Fabri, 1995: 68).

Aashtu siç u parashtrua dhe në Kapitullin II, gjykatat kushtetuese europiane, në kundërshtim me funksionin e tyre origjinal, po shndërrohen gradualisht në gjykata të zakonshme, duke iu përshtatur Gjykatës së Lartë Amerikane. Shtimi i rasteve që shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese Italiane, pas inicimit të kërkesave nga gjykatat e zakonshme në rrugën e gjykimit incidental, trajtimi i ankesave të shumta individuale nga Gjykata Kushtetuese Gjermane, si dhe suksesi i padiskutueshëm i kërkesave ”*amparo*” në Gjykatën Kushtetuese Spanjolle, dëshmojnë për hapësirat që ka marrë kontrolli gjyqësor i ligjeve (Sadushi, 2012: 85-86).

Megjithëse ky konceptim material i drejtësisë kushtetuese lejon një studim të sistemuar të saj në planin ndërkombëtar, prapësëprap duhet thënë se ky koncept ende nuk paraqitet homogjen kudo. Drejtësia kushtetuese është e ndryshme në vende të ndryshme, kështu që klasifikimi i llojeve ose i modeleve të kontrollit kushtetues paraqet medoemos një karakter relativ dhe është reduktues (Traja, 2000: 17).

Ndër të tjera, duke nënvizuar veçantitë e rregullimit në rrugë incidentale – që siç u tha dhe në Kapitullin III, është rrjedhojë e përpjekjeve për të kombinuar parimin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë që ushtron çdo gjyqtar i zakonshëm në sistemin amerikan, me supermacinë ose monopolin e gjykatës kushtetuese europiane - të parashikuara nga një numër i madh sistemesh – doktrina më e fundit ka konfiguruar një model të tretë krahas atij të tipit të centralizuar dhe të decentralizuar, model i përkufizuar si *miks*, duke qenë se

përmban elemente të gjendura në dy modelet e tjera. Në mënyrë më preçize, do të konsiderohej si i tillë ai model që, krahas instrumenteve tipike të parashikuara nga kushtetuta austriake, do të përfshinte edhe rekursin incidental (është e vërtetë gjithashtu se vetë Kelsen nuk e injoronte mundësinë e përfshirjes së një mjeti të tillë, edhe pse, nuk gjen hapësirë në kushtetutën austriake). Sipas doktrinës, veçantitë e modelit të përzier do të lejonin zbutjen e ndarjes tradicionale ndërmjet sistemit të kontrollit të centralizuar dhe sistemit të kontrollit të decentralizuar (De Vergottini, 2004: 195-196).

Në pjesën e parë të këtij trajtimi pamë se qoftë kontrolli i decentralizuar përmes juridiksionit gjyqësor, qoftë ai i centralizuar përmes juridiksionit kushtetues, qenkan efikas secili në sistemin e vet. Në këtë pjesë të dytë arritëm në përfundimin se për më tepër këto dy modele kontrolli kanë edhe ngjashmëri dhe madje për afrohen deri aty sa flitet në doktrinë për një model *miks*. Kjo do të thotë që në rastin tonë, adoptimi i kontrollit të decentralizuar jo vetëm që është i panevojshëm por për më tepër Gjykata Kushtetuese përbën organin më ideal në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë.

4.2 Problematika e kontrollit të centralizuar në Shqipëri

Përveç përfundimeve të cituara pak më sipër, një konstatim i rëndësishëm që duhet nënvizuar është ai sipas të cilit organi që duhet të ushtrojë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit nuk është gjyqtari i zakonshëm, por një gjykatë e posaçme, përbërja e së cilës jep maksimumin e garancive të objektivitetit. Dhe pikërisht problemi që shtrohet në këtë rast është ai që ka të bëjë me këtë fakt.

Gjatë veprimtarisë së saj që nga krijimi në vitin 1992 e gjer më sot GJ K ka patur rastin të shqyrtojë çështje të natyrave dhe përmasave të ndryshme duke krijuar hap pas hapi një praktikë të pasur, ku të bie në sy përpjekja e vazhdueshme për t'i dhënë mbrojtjen e duhur parimeve kushtetuese. Natyrisht vend për kritika mund të ketë, por nisur nga fakti që në një kohë të shkurtër duhej të merreshin vendime për çështje të rëndësishme, ky organ është përpjekur gjithsesi të shfaqë tendencën e tij për paanshmëri në gjykimet e dhëna. Gjykata Kushtetuese është bërë shpesh objekt kritikash nga ana e politikës për shkak të natyrës së çështjeve të gjykuara prej saj. Përplasje të tilla janë të pashmangshme po të kihet parasysh se GJ K duhet të ushtrojë kontroll mbi aktet e legjislativit që në fund të fundit është formuar nga shumica e votuar në zgjedhjet politike⁵⁰.

4.2.1 Ndikimi i politikës në kushtetutshmëri

Bashkëesenciale me bërjen e kushtetutës është edhe predispozita për të garantuar respektimin dhe mbijetesën e saj. Në fakt, për sado të shumëllojshme të jenë justifikimet

⁵⁰ Shih faqen zyrtare të “Gjykatës Kushtetuese të RSH-së”

ideologjike të një kushtetute (si rezultat dhe format e ndryshme të qeverisjes), është e sigurt se forcat politike që miratojnë një kushtetutë, kanë për synim që të sigurojnë përmes saj *stabilizimin* e qëndrimit të tyre në pushtet. Një formë e veçantë për të garantuar sigurinë e kushtetutës ofrohet nga ekzistenca e një organi ose një sistemi organesh kompetente për të verifikuar nëse aktet e e organeve të tjera janë ose jo konform kushtetutës, me mundësinë për të ndërmarrë masa me qëllim rivendosjen e respektimit kushtetues. Problemet më delikate dalin kryesisht gjatë verifikimit të përputhshmërisë së kushtetutës me aktet që formulojnë urdhërime të zbatimit rregullator primar ose sekondar të kushtetutës. Si rregull këto adoptohen nga parlamentet, pra nga organet që janë titullare të funksionit politik. Është mjaft e qartë vështirësia për të lejuar ekzistencën e organeve që mund të kontrollojnë punën e organeve politike me qëllimin për të verifikuar nëse është shkelur ose jo kushtetuta, duke adoptuar masa që me qëllimin për të garantuar rivendosjen e shkeljes së bërë, shfuqizojnë atë që është vendosur më përpara, për shembull duke anuluar dispozitat e një ligji (De Vergottini, 2004: 180-187). Kur maxhoranca në Parlament, kalon ligje antikushtetuese, e bën këtë ose sepse nuk mendon se ai bie në kundërshtim me Kushtetutën ose sepse është opozitare e principit kushtetues respektiv (Alexander, 2001: 282-283). Të kontrollosh shtetin si mekanizëm nuk do të thotë se është e gabuar ose është atavizëm i autokracive. Nëse ne drejtojmë një makinë, kemi në dorë të vendosim se ku duhet dhe nuk duhet të ecë ajo. Kështu që, kur kontrollohet qeverisja, pyetja e parë që të vjen ndërmend është: Kush e drejton makinën dhe sa i aftë ose i besueshëm është ai (Zaganjori, Vorpsi & Biba, 2012: 15)?

Kushtetuta është e gjitha rreth pushtetit! Ajo i jep pushtet njerëzve dhe institucioneve që bëjnë ligjet tona, na qeverisin dhe na gjykojnë ne! Por ajo gjithashtu vendos dhe kufizime kundrejt këtij pushteti (Howard, 2003: 22).

Çdo kushtetutë që hartohet mishëron në dispozitat e saj një filozofi politike. Mirëpo, sapo ajo miratohet, partitë politike, si bartëse të kësaj filozofie arrijnë të ndërgjegjësohen se sa e kanë kufizuar vetveten, nëpërmjet ngritjes së barrierës të kushtetueshmërisë, parim i cili formulon për çdo subjekt, për çdo institucion politik, madje edhe për vetë krijuesin e kushtetutës, kërkesën për nënshtrimin ndaj saj. Pengesa që vendos kushtetutshmëria përballë interesave momentale të politikës krijon një konflikt ndërmjet tyre, për shmangien e të cilit ka zgjidhje të ndryshme. Veçori e vendeve me demokraci të konsoliduar është nënshtrimi i politikës ndaj rregullave afatgjata të kushtetutës. Një zgjidhje e tillë imponon një kushtetutshmëri të stabilizuar dhe autoritare. Megjithatë, konflikti arrihet të shmanget, edhe kur, për shkak të ndërhyrjeve të shpeshta, të pastudiuara e të panevojshme në ligjin themeltar të shtetit, kushtetutshmëria i nënshtrohet politikës. Kjo është karakteristikë e vendeve në tranzicion, ku përfshihemi edhe ne (Sadushi – Përmbledhje Kumtesash, 2012: 129-130).

Gjatë debatit Schmitt - Kelsen, ky i fundit e kishte parashikuar rrezikun e ri të shek. XX që vinte pikërisht nga parlamentet ne drejtim të “dhunimit”, pra ndërhyrjes së pushtetit legjislativ në veprimtarinë e organeve të tjera (Kelsen, 1981: 238). Rëndësia e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese në vendimmarrjen e saj, jo vetëm nga Kuvendi por edhe nga çdo ndikim tjetër, përbën një rëndësi shumë të madhe dhe një çështje delikate për trajtim, pasi

ashtu siç thotë dhe Charles Evans Hughes: “ Ne jemi nën Kushtetutën, por Kushtetuta është ajo çfarë gjyqtarët thonë se është ” (Zaganjori, Vorpsi & Biba, 2012 : 13).

4.2.2 Një “Drejtësi e Re Kushtetuese”

Evoluimi i drejtësisë kushtetuese dhe instrumentit të saj kryesor, kontrollit të kushtetutshmërisë, ka modifikuar ose është duke modifikuar në thelb, drejtësinë kushtetuese të shumë vendeve që janë përfshirë në këtë proces. “*Drejtësia e re kushtetuese*” është rrjedhojë e transformimit të raporteve mes politikës dhe të drejtës, që vjen si rezultat i pranisë gjithnjë e më të madhe të drejtësisë kushtetuese dhe kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit. Në sajë të këtij kontrolli, shteti i së drejtës mund të realizohet dhe të jetë kompatibël me shtetin demokratik (Favoreu, 1992: 25).

Dy transformimet kryesore institucionale në gjysmën e fundit të shekullit XX në Europë ecën me të njëjtin hap: ardhja e demokracisë qeverisëse në pjesën më të madhe të vendeve dhe zhvillimi i shtetit të së drejtës nga kontrolli i gjykatësit kushtetues. Në fillim Gjermania, pastaj Franca, Portugalia dhe Spanja më vonë, Greqia sipas mënyrës së saj, Italia sot dhe Europa Lindore po ndjekin këto dy rrugë që plotësojnë njëra-tjetrën. Demokracia mazhoritare është e domosdoshme për të fituar pak aftësi për të qeverisur dhe për t’i dhënë aksionit politik kohëzgjatjen e nevojshme. Golistët kanë drejtuar Francën për pesëmbëdhjetë vjet, socialistët për dhjetë vjet të ndërprerë një herë nga një parentezë e shkurtër, konservatorët britanikë ose gjermanë, socialistët spanjollë kanë përfitur nga një kohë e gjatë për të tentuar përshtatjen e vendit të tyre me globalizimin e ekonomisë dhe me

ndryshimet sociale që shkaktuan fitimet nga produktiviteti dhe hapja e tregjeve. Fuqia e këtij pushteti mazhoritar është mbajtur brenda kufijve të së drejtës. Kështu, zënka mbi pseudo-qeverisjen e gjykatësve duket se ka kaluar. Gjykatësi kushtetues nuk vendos me detyrim një politikë, por kontrollon procedurën. Ai mendon që në një regjim të rregullt, ndërrimi i ligjit është i thjeshtë, kurse ndryshimi i Kushtetutës më i komplikuar; më saktë do të thoshim se ndryshimi i ligjit është në dorën e mazhorancës së momentit, kurse ndryshimi i Kushtetutës kërkon një marrëveshje më të gjerë. Gjithashtu, kur pushteti mazhoritar vë në dyshim një të drejtë të garantuar nga Kushtetuta, një gjykatë kushtetuese e ndalon atë. Nëse qeveritarët duan ta kalojnë këtë gjë, ata duhet të ndjekin rrugën e reformës kushtetuese. Një kontroll i gjerë i kushtetuesisë kontribuon gjithashtu me një mënyrë tjetër në demokracinë shqyrtuese. Sigurisht që demokracia ushqehet me konflikte politike që jo të gjitha meritojnë të shqyrtohen juridikisht, por në të njëjtën kohë duhet të dihet sesi të mbarohet një betejë politike dhe që juridiksionalizimi i pjesshëm i rrugëzgjdhjes të paraqesë avantazhe reale për të dy palët (Duhamel, 2004: 38).

4.2.3 Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit

Respektin ndaj Kushtetutës, politika duhet ta shprehë jo vetëm në procesin e hartimit të saj, por edhe në bindjen dhe nënshtrimin në vazhdimësi ndaj rregullave demokratike që ajo sanksionon. Një kushtetutë demokratike synon jo vetëm vendosjen e themeleve të institucionit të shtetit por edhe kufizimin e ushtrimit të pushtetit prej këtyre

institucioneve. Përparësia e kushtetutës mbi të gjitha normat juridike dhe konsolidimi i shtetit të së drejtës, që si produkt të tyre të domosdoshëm kanë demokracinë kushtetuese, nuk mund të konfirmohen pa institucionin që realizon drejtësinë kushtetuese. Ky mision i është besuar, në radhë të parë Gjykatës Kushtetuese. Në vitet e para ka pasur vështirësi në krijimin e një institucioni të fuqishëm, qoftë për shkak të mungesës së përvojës në fushën e drejtësisë kushtetuese, ashtu dhe të trysnisë prej atyre që nuk e pranonin një institucion të tillë. Nuk ka qenë e lehtë për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë të luajë këtë rol, po të kihet parasysh ndjeshmëria politike e epokës së tranzicionit, shqetësimi i vazhdueshëm politik i Kuvendit, dhe natyra tejet e politizuar e shumicës së çështjeve, që i është dashur të vendosë. Ajo ka qenë nën vëzhgimin e vëmendshëm të opinionit publik dhe është bërë sa target i kritikave të shumta për qëndrimet e saj të njëanshme, ashtu siç është vlerësuar si një rregullator i ekuilibrit të pushteteve, por dhe si një garant i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Sadushi - Përmbledhje Kumtesash, 2012: 133-134).

Në sistemin politik aktual, Gjykata Kushtetuese Shqiptare ka zënë një hapësirë që e karakterizon tashmë si subjekt me një pushtet të padiskutueshëm. Rëndësia që marrin arsyetimet e vendimeve të Gjykatës, si dhe pesha e tyre për shkak edhe të paapelueshmërisë, i kanë dhënë këtij autoriteti kushtetues një rol zotërues, që nuk parapëlqehet lehtë (Sadushi, 2012: 139). Deklarimi i antikushtetutshmërisë së ligjit shtrihet në mënyrë të tërthortë edhe në një drejtim politik. Duke iu referuar kuptimit kelzenian të një *“ligjëvënësi negativ”* pushteti i gjykatës kushtetuese për të shfuqizuar ligjet, u jep vendimeve të saj rrjedhoja politike. Pavarësisht nga shfaqja gjyqësore, në formë dhe në procedurë, Gjykata Kushtetuese mbetet politike në natyrë. Në këtë linjë arsyetimi qëndron

dhe Alek Ston Suit (*Alec Stone Sweet*) kur shprehet se “ kur gjykata anulon një ligj, ajo zëvendëson tekstin e të drejtave të shumicës parlamentare me synimin e saj politik ”. Nga ana tjetër gjyqtarët kushtetues janë faktorë politikë edhe për arsye të mekanizmit të emërimit të tyre, që zakonisht është politik. Për shkak të kësaj veçorie shpesh dyshohet se pikëpamjet e gjyqtarëve kushtetues, për interpretimin ligjor dhe kushtetues, kanë prirje për të qenë të njëjta me zgjedhësit e tyre. (Sadushi, 2012: 105-160). Në këtë prizëm, pavarësia e GJ K merr një rëndësi të veçantë.

Në vendimin e saj nr. 25/2008, GJ K shprehet:

“Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik, [...]. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

Lidhur me rëndësinë e pavarësisë së gjyqtarëve kushtetues shprehet edhe GJEDNJ ku në vendimin e saj *Pular kundër Britanisë së Madhe*, lidh parimin e pavarësisë me atë të paanshmërisë dhe thotë se një parim i tillë garanton rendin e të drejtës, krijon besimin që gjykata duhet të gëzojë në një shoqëri demokratike si dhe mundëson një proces të rregullt ligjor⁵¹.

Gjyqtarët kushtetues kanë një varg garancish për të siguruar pavarësinë e tyre. Ata i nënshtrohen parimit të parevokueshmërisë. Nuk mund të shkarkohen nga detyra gjatë kohës që ushtrojnë mandatin. Madje, Kushtetuta përcakton qartë rastet e mbarimit të mandatit të gjyqtarit, mbarim i cili deklarohet me vendimin e vetë Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, ajo parashikon detyrimin e Gjyqtarit Kushtetues për të qëndruar në detyrë deri në emërimin

⁵¹ Për më tepër shih vendimin *Pular kundër Britanisë së Madhe*

e anëtarit të ri. Duke folur për statusin e gjyqtarit do të qëndronim edhe në papajtueshmërinë e detyrës së tij, me ndonjë veprimtari tjetër private apo shtetërore. Kushtetuta nuk lë shkas për interpretim kur thekson në nenin 130 se, “*Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private*”. Gjithashtu, gjyqtarët kushtetues kanë imunitet të garantuar nga Kushtetuta. Në radhë të parë, ata nuk mbajnë përgjegjësi për atë çka thonë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre dhe as për vendimet që marrin, ose votat që shprehin. Madje, mendimi i pakicës në marrjen e një vendimi, botohet së bashku me vendimin e Gjykatës në Fletoren Zyrtare. Së dyti, Gjyqtari kushtetues ka imunitet nga procesi penal, i cili po diskutohet mjaft kohët e fundit, në kuadrin e reformimit të përgjithshëm të imuniteteve të funksionarëve të lartë të shtetit. Ai nuk mund të ndiqet penalisht pa pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese. Edhe në rastin kur Gjyqtari mund të ndalohet e të arrestohet për faktin se kapet në kryerje e sipër të një krimi, ose menjëherë pas kryerjes së tij, Gjykata Kushtetuese duhet të japë pëlqimin e saj brenda 24 orëve për dërgimin në Gjykatë të gjyqtarit të arrestuar. Në rast të kundërt, organi kompetent detyrohet ta lirojë atë (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 158-159). Në literaturë kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarit kushtetues si dhe mospërsëritja e këtij mandati, shihen si faktorë për pavarësishtë e gjykatës (Omari & Anastasi, 2010: 436). Në vendimin e saj nr. 24/2011 Gjykata Kushtetuese, kur bën interpretimin e nenit 125 të Kushtetutës, shprehet:

Neni 125 i Kushtetutës sanksionon dy parime të rëndësishme për garantimin e pavarësishtë së Gjykatës Kushtetuese: parimi i qëndrueshmërisë në përbërjen e Gjykatës dhe parimi i garantimit të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues.

Ndërkohë që në vendimin e saj nr. 20/2009 thotë se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, Gjykata çmon se, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre (e ashtuquajtura garancia e kohëzgjatjes). Këto janë një sërë garancish që Kushtetuta i siguron anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim pavarësinë e tij. Mirëpo a janë të mjaftueshme ato, aq më tepër përballë presionit politik të Kuvendit?

Raporti i Gjykatës Kushtetuese me Kuvendin, sipas legjislacionit shqiptar, është mjaft i ndërlidhur. Anëtarët e GJ K, jo vetëm që emërohen me pëlqimin e Kuvendit, por, sipas nenit 128 të Kushtetutës, parashikohet edhe që anëtari i saj mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Ndërkohë që po në këtë nen, parashikohet gjithashtu se është pikërisht GJ K ajo e cila do të shqyrtojë vendimin e Kuvendit, dhe kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklarohet shkarkimin nga detyra të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese (të njëjtin parashikim ajo bën edhe për anëtarët e GJ L). Në këtë kuptim, Kushtetuta Shqiptare duket se ka ruajtur ekuilibrat. Në vendimin e saj nr. 75/2002, Gjykata Kushtetuese shpreh:

“Gjykata Kushtetuese duke shqyrtuar vendimin e Kuvendit që ka shkarkuar gjyqtarin, vërteton nëse ekziston shkaku i shkarkimit. Pra, ajo vërteton nëse Kuvendi ka vepruar në përputhje me Kushtetutën, rregulloren dhe me ligjet përkatëse dhe nëse ai i ka respektuar të gjitha procedurat për ta motivuar, argumentuar dhe arsyetuar plotësisht vendimin e shkarkimit. Nëpërmjet këtij kontrolli konstitucional që kryhet mbi vendimin e Kuvendit, Gjykata Kushtetuese shqyrton jo vetëm procedurën e shkarkimit, por edhe thelbin e çështjes. Prandaj, me qëllim që vendimi i Kuvendit të jetë sa më i bazuar dhe të mos rrëzohet si antikushtetues, ai duhet të ketë plotësuar të gjitha elementet e domosdoshëm të një procedure korrekte, sepse mjafton mosrespektimi i procedurës dhe i formës së nxjerrjes së një akti, që ai të konsiderohet i pavlefshëm.”.

Më pas ajo shton:

“Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të verë në dukje se elementet bazë të një procedure ligjore, që lidhen me mënyrën e inicimit të procedurës për shkarkim, quorum-in e nevojshëm për vendimmarrjen, shkaqet ligjore për shkarkim, si dhe organin që vendos përfundimisht për to, janë të parashikuara përgjithësisht në Kushtetutë. Megjithatë një rregullim të mëtejshëm ato e gjejnë në ligjet bazë, siç është rasti i quorumit të domosdoshëm që nevojitet për inicimin e procedurave për shkarkim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.[...]”

Në kushtet kur në Kushtetutë, apo edhe në ligjet e tjera elementet thelbësorë të një procedure nuk gjejnë rregullim të hollësishëm, atëherë Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se këto rregulla procedurale nuk mund të plotësohen nëpërmjet vendimit të saj interpretues. Interpretimi, si funksion dhe metodë, ka vend për një normë ekzistuese kur ka paqartësi në kuptimin e saj dhe jo për të plotësuar boshllëkun, sepse përndryshe Gjykata Kushtetuese do të vihej në pozicionin e gabuar të krijuesit të normës juridike, funksion, që siç dihet, i përket ligjvënës.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nënvizon se pavarësisht nga kjo mënyrë rregullimi në Kushtetutë apo në ligj të procedurave të shkarkimit të gjyqtarit apo prokurorit, kjo nuk e pengon Kuvendin të adoptojë rregulla të veçanta për çdo rast konkret, apo për të gjitha rastet në tërësi, por gjithmonë duke respektuar parimin kushtetues, atë të një procesi të rregullt ligjor”.

Në fakt duhet të themi që ky është një arsyetim shumë i mirë, pasi ligjvënës nuk është dhe nuk duhet të jetë askush tjetër përveç se organit legjislativ, pra Kuvendit, dhe GJK nuk mundohet të marrë përsipër një rol të tillë. Por nga ana tjetër kjo tregon, për efekt të studimit tonë, se raporti Kuvend - Gjykatë Kushtetuese është shumë i ndërlidhur. Gjithsesi një vendim i tillë së bashku me atë nr. 76/2002, ka hasur në kundërshti të mëdha nga vetë politika (Sadushi, 2012: 112).

Komisioni European në Raportin Analitik për Shqipërinë, të datës 09.11.2010, ka thënë se Parlamenti (duke theksuar Asambleja ose Kuvendi) është organi më i lartë i pushtetit shtetëror. Referuar këtij fakti do të ishim dakort me analizën që bëhet në librin “Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, me autorë Xhezair

Zaganjorin, Aurela Anastasin dhe E. Çani (Methasani) ku duke u nisur nga interpretimi i neneve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e përkatësisht nenit 1/1 dhe nenit 2 të saj, konstatohet me të drejtë se Kuvendi nuk e merr një atribut të tillë nga Kushtetuta, e cila është mjaftuar me shpalljen e formës së qeverisjes, si Republikë Parlamentare, si dhe, edhe kur afirmon parimin e Sovranitetit, Kushtetuta i dedikon popullit ushtrimin e sovranitetit përmes përfaqësuesve të tij, ose drejtpërsëdrejti. Ky fakt na bën të mendojmë se, Kuvendi i Shqipërisë, nuk mund të karakterizohet si organi më i lartë i pushtetit shtetëror. Kushtetuta është dedikuar për të siguruar një balancë të kujdesshme midis pushteteve. Në analizë të parimit kushtetues për ndarjen dhe balancimin e pushteteve, Kuvendi është cilësuar nga doktrina, si organi më i lartë që ushtron pushtetin ligjvënës (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 123).

Por, ndërsa doktrina dhe jurisprudenca e kanë të qartë rolin dhe vendin që duhet të ketë Parlamenti në përgjithësi apo Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në veçanti, duket sikur situata nuk paraqitet e njëjtë në krahun tjetër, pra për vetë anëtarët e pushtetit legjislativ. Gjykatat kushtetuese vlerësohen në literaturë, si gardiane të shtetit kundrejt interesave jokonstitucionale, edhe në rastet kur këto interesa përbëjnë shumicën parlamentare (Arjomand, 2008: 121). Mirëpo duket sikur një aspiratë të tillë GJ K nuk e përmbush gjithmonë. I tillë është rasti i vendimit nr. 25/2012 ku GJ, përtej çdo kriteri të konsoliduar nga vetë jurisprudenca e saj, nuk ka legjitimuar jo më pak se 1/5 e deputetëve për shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 3, 5, 6, dhe 8 të ligjit nr. 10.449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”, vendim ky i cili ka patur një mendim paralel, plot tre mendime

gjqtarësh në pakicë, si dhe një serë kritikash nga doktrina shqiptare. Gjyqtarët që përbëjnë mendimin e parë të pakicës në këtë vendim, sjellin në vëmendje Raportin e Komisionit të Venecias (2008) dhe Rezolutën nr. 1601/2008 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës mbi rolin e opozitës në një parlament demokratik, ku rekomandohet se: “ një pakicë parlamentare duhet të ketë të drejtë të kërkojë shqyrtimin kushtetues të ligjeve, qoftë para ose pas miratimit, nga gjykata kushtetuese. Kjo është një kompetencë që i jep opozitës (një fraksioni të caktuar të saj) mundësinë për të sjellë ligjet dhe aktet tjera të shumicës parlamentare përpara një autoriteti të pavarur gjyqësor ”. Nga ana tjetër: “ Argumentet e shumicës për ta rrëzuar kërkesën me arsyet e mësipërme më duken të sforcuara ” – thuhet në mendimin paralel të këtij vendimi.

Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, në vendimin BverfGE 49/89, thotë:

Parimi i demokracisë parlamentare nuk lejon që t'i jepet prioritet parlamentit dhe vendimeve të tij, kundrejt pushteteve të tjera si një princip interpretimi që i mbulon të gjitha klasifikimet konkrete të kompetencave.

Një tjetër vendim interesant është edhe ai nr. 57/1997, ku Gjykata Kushtetuese me nismën e vet ushtroi pushtetin e saj shfuqizues mbi një normë kushtetuese. Me këtë vendim ajo konstatoi pavlefshmërinë konstitucionale të nenit 2 të ligjit nr. 8257, dt. 19.11.1997 “Për një plotësim në ligjin nr. 7561, dt. 29.04.1992 “ Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, dt. 29.04.1991 “ Për dispozitat kryesore kushtetuese””. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka realizuar një lloj të veçantë kontrolli që siç trajtuam dhe në Kapitullin III, njihet si mbikonstitucionalitet ose supernormativitet, ndaj një norme kushtetuese që kishte marrë miratimin e shumicës së cilësuar të Kuvendit dhe të Presidentit të Republikës. Kjo

jurisprudencë kushtetuese, që rezultoi më tepër si një reaksion politik sesa si një vendim i drejtësisë kushtetuese, ishte rezultat i një konflikti mjaft të mprehtë të shkaktuar ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit (Sadushi, 2012: 221).

Vetë Gjykata Kushtetuese duhet të tregohet e “ kujdesshme ”. Problematikë të veçantë paraqet kontrolli abstrakt, pasi kur drejtohet te ligjet që miratohen nga Parlamenti, nuk e ka të mundur shmangien e gjykatës kushtetuese nga përfshirja në qendër të kundërshtimeve politike. Natyra e kontrollit abstrakt e imponon thirrjen e Gjykatës Kushtetuese, për të vendosur për pajtueshmërinë me kushtetutën të zgjidhjeve ose alternativave politike, të bëra nga Parlamenti në ligjin konkret (Sadushi, 2012: 164).

Pavarësisht konsideratve të ndryshme, Gjykata Kushtetuese hap pas hapi, është evidentuar si një mbrojtëse e Kushtetutës ndaj shpërdorimeve të ligjvënësit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Gjyqtarët kushtetues kanë evoluuar, në mënyrë graduale, nga lexues mekanik të normave ligjore në interpretues vizionar të parimeve dhe standarteve kushtetuese, duke lartësuar pozicionin e institucionit të tyre. Nëpërmjet disa vendimeve tepër të guximshme, Gjykata Kushtetuese ka përmbushur misionin, për të cilin është ngarkuar, duke kontribuar fuqishëm në konsolidimin e shtetit të së drejtës. Ndhimesa e saj në drejtim të integritit të Republikës së Shqipërisë, në bashkësinë ndërkombëtare, ka qenë vendimtar. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 65/199 për heqjen e dënimit me vdekje dhe nr. 186/2002 për pajtueshmërinë kushtetuese të Statutit të Romës “Për Gjykatën Ndërkombëtare Penale” janë me vlera të jashtëzakonshme historike, por edhe doktrinare (Sadushi - Përmbledhje Kumtesash, 2012: 134-135). E megjithatë politika ka patur kundërshtitë e veta edhe në këtë rast. Një reagim të përafërt, dhe me qëndrime mjaft kritike, ka shfaqur politika kur Gjykata

Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë me Kushtetutën e ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” (*i quajtur ndryshe ligji i lustracionit*), evidentonte shqetësimin serioz që krijonte për parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, ndryshimi ose kufizimi me ligj i kompetencave të disa organeve kushtetuese. Përfundimi në të cilin arriti Gjykata Kushtetuese, mbi ligjin për lustracionin, ishte në të njëjtën gjatësi vale me faktorin ndërkombëtar, i cili e vlerësoi këtë vendimmarrje kushtetuese si një ndihmesë e ndjeshme për arritjen e “*një demokracie funksionale, në përputhje me shtetin e së drejtës*” (Sadushi, 2012: 111). Vetë Gjykata Kushtetuese Shqiptare, ka treguar pavarësi nga Kuvendi apo mazhoranca dhe këtë e ka treguar ndër vite, me anë të vendimeve të saj ku do të mund të përmendnim vendimin nr. 2, dt. 08.02.1993, ku u hodh poshtë kërkesa e grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe tre kandidatëve për deputetë nga Partia Demokratike, për të shfuqizuar vendimin e Kuvendit Popullor që shpallte si deputet tre persona që në listën shumëemërore ishin renditur më poshtë se tre të parët, apo vendimin nr. 3, dt.23.02.1995, për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 2 të ligjit nr. 7866, dt.10.10.1994 “Për referendumet” si dhe vendimin e Kuvendit Popullor dt.10.10.1994 “Për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me Referendum”. Pavarësisht kritikave në fakt, që iu bënë Gjykatës Kushtetuese shqiptare, në drejtim të këtyre vendimeve, prapësëprapë mbeten të rëndësishme në funksion të pavarësisë që ky organ kushtetues mund dhe duhet të paraqesë përballë mazhorancës apo gjithë Kuvendit.

E për ta mbyllur do të konkludonim me konstitucionalistin Kristaq Traja i cili thotë:

Drejtësia kushtetuese është pushtet i gjyqtarëve. Shumë kanë frikë prej tij. Kjo ndjenjë ushqehet shumë sidomos në rrethet e politikës [...] meqë është fjala për rregulla, politikanët duhet të dinë se rregullat janë pronë më parë e juristëve se sa e tyre (Traja, 2000: 9-10).

4.3 Ndikimi i Reformës në Drejtësi mbi kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit

4.3.1 Rëndësia e Reformës

Kur trajtuam qëllimin e këtij kërkimi shkencor thamë se do të shihet mundësia e përmirësimit të sistemit tonë të kontrollit, edhe përballë “sfidës” së ndryshimit të tij. Përmes këtij trajtimi do të shihet se sa dhe si Reforma arrin të ndikojë në këtë qëllim.

Reforma në drejtësi dhe ndryshimet kushtetuese të parashikuara së fundmi, ndikojnë në disa drejtime kompetencën e GJK në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit. Në “Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, të qershorit 2015, thuhet se sistemi i drejtësisë në Dokumentin Analitik, është vlerësuar përkundrejt parametrave të: a) pavarësisë e paanshmërisë; b) përgjegjshmërisë dhe transparencës; c) efektivitetit dhe efikasitetit; d) nivelit të bashkëpunimit institucional në të gjitha hallkat e tij. I njëjti vlerësim qëndron në Strategjinë e Reformës ku thuhet se “ në vijim të synimit të përgjithshëm të reformës, kjo strategji ndjek disa synime specifike për reformimin e sistemit të drejtësisë për ta bërë atë: të pavarur ndaj çdo lloji ndikimi; të paanshëm në funksionimin e tij; të përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore të tij; eficient dhe profesional; të besueshëm, transparent dhe i aksesueshëm prej publikut; bashkëpunues në nivel institucional.

Pavarësisht vetëdijes për rëndësinë thelbësore të sistemit të drejtësisë, në asnjë rast gjatë 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjetve nuk ka pasur një përpjekje të gjerë e të thellë për të analizuar rezultatet e sistemit të drejtësisë në tërësi dhe për t’u ballafaquar me problemet e tij të shumta në mënyrë rrënjësore. Vëmendja publike dhe e klasës politike te problemet e sistemit të drejtësisë ka qenë sporadike dhe afatshkurtër. Praktikisht këto probleme (si p.sh.

mungesa e pavarësisë, e profesionalizmit dhe integritetit) kanë ardhur në qendër të vëmendjes vetëm kur organet e sistemit të drejtësisë janë përfshirë në zgjidhjen e konflikteve politike, si p.sh. konfliktet zgjedhore, në procese penale kundër funksionarëve të lartë të shtetit, në rrëzimin e akteve normative të qeverisë etj. ose kur funksionarë të caktuar të sistemit të drejtësisë janë përfshirë në çështje korrupsioni. Rëndom me përfundimin e këtyre proceseve është zbehur edhe interesi i klasës politike dhe publikut për t'i zgjidhur problemet e evidentuara. Ky deficiet i vëmendjes mund të shpjegohet nga disa faktorë. Njëri syresh është kultura politike e juridike e trashëguar nga e shkuara komuniste, sipas së cilës sistemi i drejtësisë shihej më shumë si një instrument për zbatimin e vendimeve të ekzekutivit sesa një pushtet i pavarur. Ky kuptim i shtrembëruar duket se ka relativizuar rëndësinë e reformave në sistemin e drejtësisë bazuar në konceptin se, po të kemi një qeveri të mirë, edhe sistemi i drejtësisë nuk mund të jetë ndryshe. Një tjetër faktor ka qenë perceptimi simplist i organeve të sistemit të drejtësisë si instanca/forume për zgjidhjen e problemeve “ të vogla ” midis personave privatë pa ndonjë potencial për të ndikuar në politika zhvillimore. Ndonëse ky perceptim ka ndryshuar, teksa është qartësuar roli i kufizuar i institucioneve përfaqësuese (qeveria dhe parlamenti) në luftën kundër krimit, është konstatuar rritja e rolit të gjyqësorit në kontrollin e ligjshmërisë në veprimtarinë e administratës publike (i cili ekzistonte vetëm në formë embrionale gjatë sistemit totalitar) dhe është rritur kontrolli i kushtetutshmërisë së legjislacionit nga Gjykata Kushtetuese, gjurmët e tij në mentalitetin e klasës politike dhe të publikut vazhdojnë të mbeten. Sa i takon politikës, qëndrimi i saj ndaj një reforme të thellë, që do të sillte një konsolidim të sistemit të drejtësisë në vend, ka qenë ngurues dhe kompleksiv. Ndonëse në nivel ideologjik, thuhet në Dokumentin Analitik, si të djathtët, ashtu dhe të majtët duhet të

jenë të interesuar për forcimin e sistemit të drejtësisë dhe atij gjyqësor në veçanti, në praktikë ka munguar gatishmëria për të parë përtej interesave politike të çastit. Në kushtet e mungesës së një presioni të artikuluar nga publiku, të një marrëveshjeje të gjerë politike, si dhe nga mungesa e një tradite të pamjaftueshme demokratike të vendit, shumicat parlamentare dhe qeveritë e kohës janë mjaftuar me ndërhyrje të pjesshme e kozmetike në sistemin e drejtësisë, kryesisht të mbështetura vetëm me votat e shumicës. Ç'është më e keqja, vetë natyra e këtyre ndërhyrjeve ka krijuar hapësira për politikën, që në ndonjë rast synojë kontrollin mbi qeverisjen e institucioneve të drejtësisë për parandalimin e rreziqeve që mund t'i vijnë politikës nga një drejtësi e pavarur. Politika nuk i ka shpëtuar tundimit për të ruajtur sa më shumë rol kontrollues në çështjet që kanë të bëjnë me emërimet, statusin, karrierën dhe disiplinimin e funksionarëve të drejtësisë, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe mbi sjelljen e tyre. Ndoshta shembulli më i spikatur i kësaj prirjeje konstante është këmbëngulja për të ruajtur një rol ekskluziv të ekzekutivit në inspektimin e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe në disiplinimin e tyre. Së fundi, por pa dyshim jo për nga rëndësia, reformat e deritanishme (sado të pjesshme) janë prekur edhe nga interesat korporatiste të funksionarëve të drejtësisë (gjyqtarë e prokurorë), të cilët përmes aleancave me krahë të ndryshëm të politikës, por edhe përmes instrumentalizimit të aktorëve të tjerë të fushës (organizata të shoqërisë civile ose institucione ndërkombëtare), ia kanë dalë të gjejnë shtigje për të ndikuar mbi objektivat dhe instrumentet e reformës. Me fjalë të tjera, një nga shkaqet kryesore që ka ndikuar në sterilitetin e reformave të deritanishme në drejtësi ka qenë fakti se interesat e aktorëve kryesorë të reformës (klasa politike dhe funksionarët e sistemit të drejtësisë) nuk kanë përkuar gjithmonë me interesin publik për një sistem të pavarur, profesional dhe me integritet. Në këto kushte, i vetmi presion konstant dhe i

çinteresar për reformën në drejtësi ka ardhur nga partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë dhe organizatat e specializuara të shoqërisë civile. Bashkimi European në takimin e Këshillit European të vitit 1993 në Kopenhagë ka artikuluar kushtin për forcimin e shtetit të së drejtës në vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE. Falë kushtëzimit të BE-së reformat në organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, me qëllim forcimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së tij, kanë qenë të vazhdueshme⁵².

Pra Reforma në Drejtësi së bashku me ndryshimet kushtetuese përkatëse, duke e vënë theksin e duke synuar kryesisht në rritjen e pavarësisë, efektivitetit dhe efikasitetit të GjK, si rrjedhojë dhe të çdo kompetence a funksioni të saj, duke zbritur për më tepër, ashtu siç do të analizohet pak më poshtë, në ndryshimet kushtetuese përkatëse që prekin kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, vlerësohet me një interes e rëndësi të veçantë.

Ashtu siç vlerësohet në strategjinë e reformës në sistemin e drejtësisë, Gjykata Kushtetuese është një organ kushtetues që ka për mision final ruajtjen e kushtetutshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ajo funksionon si organ i pavarur dhe ka në kompetencë të shfuqizojë aktet e pushtetit publik si dhe vendimet e gjykatave të zakonshme kur ato bien ndesh me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Nisur nga këto veçanti që ajo paraqet si dhe duke iu referuar praktikës së saj 23-vjeçare, Gjykata Kushtetuese ka pasur një rol të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm në vendosjen dhe respektimin e parimeve kushtetuese, si: ndarja dhe balancimi i pushteteve, shteti i së drejtës, demokracia, hierarkia e akteve normative dhe supremacia e

⁵² Për më tepër shih “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisionit të Posaçëm Parlamentar, Qershor 2015

kushtetutës, respektimi i të drejtave të njeriut, siguria juridike etj. Megjithatë, edhe ky organ gjatë praktikës ka hasur në disa pengesa kushtetuese dhe ligjore, të cilat në disa raste kanë sjellë si pasojë mosfunksionimin efikas të saj nga pikëpamja organizative ose mosqenien efektive në ushtrimin e kompetencave që asaj i janë njohur nga Kushtetuta. Objektivat kryesorë⁵³ lidhur me efektivitetin e Gjykatës Kushtetuese do të arrihen me anë të ndërhyrjeve në ligjin organik, duke synuar: përqasjen me Kushtetutën të subjekteve që legjitimohen t'i drejtohen GJK-së sipas ligjit organik të GJK-së përmes përfshirjes edhe në ligj të subjekteve që parashikon neni 134/1 i Kushtetutës; qartësimin e legjitimitetit të subjekteve të kushtëzuara e të pakushtëzuara që iniciojnë çështje për një gjykim kushtetues, për trajtimin tonë, në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit; parashikimin e afateve më të arsyeshme për disa nga procedurat që parashikohen në ligjin organik të GJ K-së për të garantuar sigurinë juridike të shtetasve dhe pajtueshmërinë e këtyre afateve me praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit; mbrojtjen dhe garantimin efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të individit duke parashikuar procedurat që mungojnë në ligjin për Gjykatën Kushtetuese, për aksesin e individit në GJ K, me anë të ankimit individual kushtetues.

⁵³ Për më tepër shih Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, korrik 2015

4.3.2 Analiza kushtetuese dhe ligjore mbi reformën e Gjykatës Kushtetuese. Ndikimi i saj në kontrollin kushtetues

Në analizën kushtetuese mbi reformën në drejtësi dhe analizën ligjore mbi reformën e Gjykatës Kushtetuese, thuhet se përsa i përket Gjykatës Kushtetuese, është i domosdoshëm reformimi i saj. Një nga problemet me të cilat përballlet aktualisht GJK-ja, ashtu si dhe mjaft hallka të sistemit gjyqësor në vend, është efienca. Efienca e Gjykatës Kushtetuese analizohet në këndvështrim të ligjit organik të saj. Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” (ligji organik) ka parashikuar në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit dhe të funksionimit të GJK-së, statusin e gjyqtarit kushtetues, paraqitjen e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre, parimet dhe rregullat e gjykimit kushtetues, procedurat e veçanta, marrjen e vendimeve si dhe ekzekutimin e tyre. Zbatimi i ligjit organik në praktikën kushtetuese ka evidentuar jo pak çështje problematike në drejtim të efijencës dhe qenies së saj mjet efektiv. Problemet e vërejtura për sa i përket efijencës së GJ K-së, përveç të tjerash, lidhen kryesisht edhe me mungesën e një procesi transparent për mbledhjen dhe seleksionimin e kandidaturave për gjyqtarë në GJK si dhe mungesën e rregullave të qarta, mbi bazën e të cilave të funksionojë procesi i emërimit të gjyqtarëve të GJK-së, dhe të kritereve ligjore që duhet të përmbushin kandidatët që të dëshmojnë për objektivitet dhe paanshmëri të vendimmarrësve.

Kushtetuta shqiptare në nenin 125 ashtu si edhe ligji organik parashikon se Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Gjyqtarët emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, nga rradhët e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo tre vjet në një të tretën e saj sipas procedurës së caktuar me ligj. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e anëtarëve të saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një periudhë prej 3 vjetësh. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij.

Studiues të fushës, por edhe përfaqësues të qarqeve politike, të medias e të shoqërisë civile e kanë theksuar se në rritjen e autoritetit të këtij institucioni kushtetues ndikon, veçanërisht mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues. Mekanizmi kushtetues i përfshirjes së dy institucioneve të larta të shtetit, Presidentit të Republikës dhe Kuvendit është menduar fillimisht nga hartuesit e Kushtetutës, si zgjidhja më e mirë, në raport me formulën e mëparshme që parashikonte ligji “ Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Përvoja trembëdhjetë vjeçare e zbatimit të kësaj formule kushtetuese dëshmon për një qasje të natyrës politike që merr dhënia e pëlqimit nga Kuvendi për gjyqtarin kushtetues. Defektin e kësaj formule përzgjedhjeje një pjesë e studiuesve e kanë gjetur te natyra politike që merr emërimi i gjyqtarëve, dikush te *cuorumi* i një shumice të thjeshtë me të cilën jepet pëlqimi, e ndokush tjetër te ndryshimet e panevojshme kushtetuese, që prekën formulën konsensuale të zgjedhjes së Presidentit të Republikës (Sadushi - Përmbledhje Kumtesash, 2012: 136). Po t’i referohemi ligjit për “ Dispozitat Kryesore Kushtetuese ”, neni 18 i tij parashikonte se 5 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese zgjidheshin nga Parlamenti dhe 4 të tjerët nga Presidenti.

Në lidhje me autoritetin e GJ K, një linjë e tillë mendimi mbahet edhe në analizën e sipërpërmendur, analizën kushtetuese mbi reformën në drejtësi dhe analizën ligjore mbi reformën e Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet se një ndër faktorët që ndikon ndjeshëm në

rritjen e autoritetit të Gjykatës Kushtetuese është mënyra e emërimit të gjyqtarëve të saj. Sistemi aktual kushtetues i emërimit të gjyqtarëve kushtetues përfshin në proces Presidentin dhe Kuvendin, me qëllim pasjen e një garancie më të madhe për pavarësinë e këtyre gjyqtarëve. Përzgjedhja e kandidaturave bëhet nga Presidenti i Republikës, i cili si institucion jopolitik e si garantues *par excellence* i vlerave dhe ekuilibrit kushtetues duhet ta kryejë këtë funksion në mënyrë të pavarur e të paanshme. Ndryshimi kushtetues i vitit 2008, që lejon zgjedhjen e Presidentit pas raundit të tretë me shumicë të thjeshtë, shman arritjen e konsensusit dhe krijon mundësinë që Presidenti të zgjidhet vetëm me votat e mazhorancës qeverisëse. Teorikisht probabiliteti që një president i zgjedhur nga një forcë politike të jetë më i prirur të ndikohet nga presioni politik në përzgjedhjen e kandidaturave është më i lartë sesa në rastin kur kreu i shtetit është produkt i konsensusit politik. Situata aktuale, ku Presidenti është një politikan aktiv i zgjedhur me votat e mazhorancës së kohës, nuk i shman këto dyshime, të cilat shkojnë në disfavor të cilësisë në përzgjedhjen e kandidatëve dhe në dëm të garantimit të pavarësisë dhe paanshmërinë që duhet të karakterizojnë procesin e emërimit të gjyqtarëve kushtetues. Për shkak të rrethanave të krijuara nga ndryshimi i formulës konsensuale së zgjedhjes së Presidentit të Republikës, garancia që duhet të japë përfshirja e Presidentit në emërimin e këtyre gjyqtarëve nuk ka arritur të krijojë besueshmëri të shumica parlamentare. Gjithashtu është për t'u theksuar nevoja e shoqërisë për një Gjykatë Kushtetuese jopolitike dhe mbi të gjitha kompetente. Pas përzgjedhjes nga Presidenti kandidaturat kalojnë për votim në Kuvend. Kompetenca e Kuvendit për të miratuar kandidatët e propozuar nga Presidenti është thelbësore, sepse ai vlerëson në meritë/thelb kandidaturat e paraqitura. Kjo do të thotë se Kuvendi mund të mos pranojë kandidaturat e Presidentit, por këto raste duhet të jenë gjithmonë të arsyetuara

bindshëm, me qëllim respektimin institucional të organit të emërimit, por dhe të kandidatëve, që duhet të jenë të informuar për mosesuksesin e tyre në këtë proces. Megjithëse procesi i emërimit bazohet në sistemin e përzier, shumica e thjeshtë (një minimum prej 36 votash), që kërkohet për të miratuar kandidaturat nga Kuvendi, duket se e përjashton një lloj konsensusi ndërmjet palëve. Kjo lloj shumice minimale është një e metë e rregullimit kushtetues aktual në drejtim të garancive që duhet të ofrojnë në funksion të pavarësisë dhe paanshmërisë së kandidaturave të miratuara. Mungesa e një kontrolli të ndërsjellë të forcave politike mbi kandidatët e propozuar për shkak të shumicës minimale të kërkuar, rrjedhimisht nuk shkon në favor të miratimit të kandidatëve që ofrojnë më shumë garanci për pavarësi e paanshmëri. Ndër të tjera, pragu i ulët i votave që kërkohen për emërimin e gjyqtarit kushtetues ndikon negativisht në besimin e publikut ndaj procesit të votimit dhe kandidaturës së miratuar. Në analizën kushtetuese mbi reformën në drejtësi dhe analizën ligjore mbi reformën e Gjykatës Kushtetuese arrihet në përfundimin se faktorët që kanë ndikuar në mosfunksionimin si duhet të procesit të emërimit të gjyqtarëve të GJK-së janë: a) roli kryesor që luan Presidenti i Republikës në përzgjedhjen e kandidaturave, porë edhe në fokusin e formulës aktuale të zgjedhjes së Presidentit; b) natyra politike që i jepet procedurës së emërimit të gjyqtarëve të lartë në Kuvend; c) shumica minimale prej jo më pak se 36 vota për dhënien e pëlqimit nga Kuvendi.

Nga njëra anë ka mendime në literaturë, që shohin disa vërtetësi, pra të mira në procedurat apolitike të emërimit të gjyqtarëve kushtetues. Sipas tyre këto procedura apolitike emërimi, rrisin legjitimitetin dhe autoritetin e Gjykatës në sytë e publikut (Kogaciolgu, 2004: 22), godasin interesat e politikanëve dhe institucioneve politike

(Brown, 2002: 150-159)⁵⁴. Nga ana tjetër, ka mendime se në vendet demokratike, një procedurë emërimi pjesërisht politike, nuk është vetëm e nevojshme për të vendosur legjitimitetin demokratik të rishikimit gjyqësor por gjithashtu edhe për të prodhuar rezultate më demokratike (Arjomand, 2008 : 105).

Në analizën që i bëhet sistemit të drejtësisë, kur prezantohet gjendja aktuale në lidhje me emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese thuhet se emërimi i gjyqtarit kushtetues është kompetencë e përbashkët e Presidentit dhe e Kuvendit dhe kalon në dy faza: faza e përzgjedhjes së kandidatëve nga Presidenti dhe faza e miratimit të kandidaturave nga Kuvendi. Ky proces ka shumë rëndësi për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen nga radhët e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion (neni 7 i ligjit organik). Ky parashikim ligjor është i njëjtë me formulimin e nenit 125 të Kushtetutës dhe, si i tillë, nuk ka specifikuar konceptin “kualifikim i lartë”. Në tërësinë e tij ligji organik nuk përcakton kritere të detajuara për përzgjedhjen e kandidatëve të pavarur dhe të kualifikuar profesionalisht. Mosparashkimi i kriterëve ligjorë referuese shkon në dëm të objektivitetit, paanshmërisë e cilësisë që duhet të orientojnë përzgjedhjen e kandidatëve. Sistemi i emërimit i pranuar nga Kushtetuta ka në esencë kooperimin institucional të Presidentit të Republikës dhe të Kuvendit të Shqipërisë, gjë që në thelb shpreh respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre, me qëllim që të sigurohet një përbërje cilësore dhe e përshtatshme e Gjykatës. Pavarësisht se Gjykata Kushtetuese e ka

⁵⁴ Shih rastin e Turqisë

vënë theksin në respektimin e këtij parimi, zbatimi në praktikë i bashkëpunimit institucional President – Kuvend ka rezultuar i mangët. Pikërisht, për shkak të një praktike të pakonsoliduar parlamentare, për të parën herë, Kuvendi me vendimin nr. 138, datë 15.07.2004, ka vendosur mosdhënien e pëlqimit për emërimin e një anëtari të Gjykatës Kushtetuese nga ana e Presidentit të Republikës. Shkak për këtë është bërë edhe mungesa në ligj e rregullave të qarta për procesin e emërimit në të dyja fazat e tij. Procesi i emërimit nuk është karakterizuar nga transparencja për arsye të mosparashikimit në ligj të kriterëve specifike të kualifikimit dhe të rregullave që duhet të zbatohen nga organet kompetente (Presidenti dhe Kuvendi) për kryerjen e procesit. Vitet e fundit është vënë re një numër i madh refuzimesh në Kuvend të kandidaturave të paraqitura nga Presidenti, gjë që e ka bërë inefiçent procesin e emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese. Parashikimi nga ligji organik, por jo nga Kushtetuta, i afatit një mujor përpara mbarimit të mandatit të gjyqtarit të GJK-së për fillimin e procedurave të zëvendësimit të tij nuk ka rezultuar efektiv⁵⁵.

Në raportin e OSBE-së (raporti 2010 – 2011), kur bëhet analiza e procesit të caktimit të anëtarëve të rinj të GJ K, nënvizohet tensioni i shkaktuar, pasi disa nga kandidatët e propozuar në periudhën në shqyrtim, u hodhën poshtë, ngaqë, sipas qeverisë, nuk përmbushnin kriteret e caktuara, me pretendimin që ata kishin qenë politikisht aktivë gjatë regjimit komunist⁵⁶.

⁵⁵ Shih Dokumentin Analitik, Qershor 2015

⁵⁶ Shih Raportin “Drejt drejtësisë së OSBE-së” 2010-2011, fq. 75 e në vijim

Nga ana tjetër, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë ka dalë me konkluzionet se duhen specifikuar kriteret ligjore që duhet të përmbushin kandidatët për GJK, me qëllim që krahas integritetit moral të jetë i matshëm edhe niveli profesional. Rëndësi themelore sipas tyre, ka edhe transparenca dhe monitorimi i publikut për mënyrën e përzgjedhjes dhe të emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që do të ishte e vetmja rrugë e besueshme për përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e tyre.

Në analizën që i bëhet kriterëve kushtetuese për përzgjedhjen, propozimin dhe cilësitë e kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, thuhet se çështja e procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve të GJK-së në mënyrë të vazhdueshme është ngritur nga Bashkimi European, që ka insistuar në analizimin e problemeve në lidhje me pavarësinë e GJK-së, duke filluar nga procesi i emërimit të gjyqtarëve e duke vijuar me parashikimin e procedurës që siguron një proces dëgjimor si dhe një votim të rregullt e të depolitizuar. Për emërimet e gjyqtarëve kushtetues kërkohet “bashkëpunim me institucionin e Presidentit për vendosjen e kriterëve ligjore që garantojnë një përbërje cilësore të GJK-së”. Kushtetuta në nenin 125 parashikon si kriterë kualifikuese: a) qenien jurist me kualifikim të lartë; dhe b) përvojën e punës jo më pak se 15 vjet në profesion. As Kushtetuta dhe as ligji organik i GJK-së nuk elaborojnë se çfarë nënkupton termi “kualifikim i lartë”. Pozicioni i rëndësishëm që zë GJK në sistemin e drejtësisë imponon nevojën për vendosjen e kriterëve të larta për përzgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues. Krahas integritetit moral mjaft i rëndësishëm është vlerësimi profesional, i fokusuar në disa parametra, si: pasuria e përvojës profesionale në fushën ligjore, vijueshmëria e një vendimi të dhënë në shkallët e tjera të gjyqimit, sasia dhe cilësia e punës së kryer, respektimi i afateve për shpalljen e vendimit,

pjesëmarrja aktive dhe asistencë e ofruar nga gjyqtari për mbarëvajtjen e zyrës/gjykatës në të cilën vepron, disponibiliteti, frekuenca e kurseve trajnuese, kontributi në zgjidhjen e problemeve organizative, meritat e veçanta në fushën e mësimdhënies, etj. Të gjitha këto janë kritere bazë që shërbejnë për përzgjedhjen e gjyqtarëve cilësorë. Në mungesë të kritereve të qarta procedura për përzgjedhjen e gjyqtarëve nuk garanton transparencë, ku si rrjedhojë e një seleksionimi korrekt e të paanshëm të evidentohen nga Presidenti i Republikës kandidatët e spikatur profesionalisht dhe me integritet të lartë. Jo në të gjitha rastet janë respektuar procedurat dëgjimore publike nga Kuvendi dhe urdhërimet e Rregullores së Kuvendit për të aplikuar procedurën e votimit të fshehtë për rastet e votimit për persona konkretë.

Problematikat e parastruara më lart theksohen edhe në Materialin shpjegues për ndryshimet kushtetuese (Draft 24/09/2015), përmes të cilit thuhet se sa i takon Gjykatës Kushtetuese, Dokumenti Analitik i Sistemit të Drejtësisë ka identifikuar disa probleme të rëndësishme në lidhje me organizimin dhe funksionimin e saj. Problemi i parë ka të bëjë me dështimin e formulës së emërimit të anëtarëve të GJ K. Një pasojë e këtij dështimi është zgjatja e mandatit të gjyqtarëve kushtetues përtej afatit të parashikuar nga Kushtetuta. Problemi i dytë (ose grupi i problemeve) ka të bëjë me politizimin e përbërjes së GJK dhe cilësinë e dobët të vendimeve të saj. Dokumenti Analitik arrin në përfundimin se këto probleme shkaktohen nga mungesa e kritereve të sakta profesionale në përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të GJ K. Së fundi, Dokumenti Analitik arrin në përfundimin se sipas rregullimit aktual të Kushtetutës, ashtu siç do të trajtohet dhe më poshtë, hapësira për

ankimet e individëve para GJ K është tepër e kufizuar duke bërë që gjykimi në GJ K të mos jetë një mjet efektiv për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Përkundrejt këtyre problemeve të evidentuara nga Dokumenti Analitik i Sistemit të Drejtësisë, si dhe në linjë me objektivat e reformës në Gjykatën Kushtetuese të artikuluar në Strategjinë e reformës në sistemin e drejtësisë, është propozuar që anëtarët e GJ K të emërohen sipas kësaj formule: 3 anëtarë nga Presidenti, 3 nga Kuvendi dhe 3 nga gjyqësori, përkatësisht nga mbledhja e përbashkët e GJ L dhe GJ L A, duke ndjekur kështu opinionin e Komisionit të Vencias (2009) lidhur me emërimin e gjyqtarëve kushtetues në Ukrainë. Ky Komision ka mirëpritur spostimin e kompetencës ekskluzive të emërimit nga Presidenti tek një sistem miks i cili siguron zgjedhjen e gjyqtarëve nga 3 degët kryesore të pushtetit, pasi ky sistem ka më shumë legjitimitet demokratik. E kundërta, mospranimi i këtij sistemi dhe shkuarja drejt një kombinimi emërimi nga Presidenti me miratimin e parlamentit nuk është e mirëpritur. Kështu p.sh duke qenë se nga gjyqësori kandidaturat do të jenë vetëm gjyqtarë, atëherë Presidenti dhe Kuvendi duhet të zgjedhin të paktën 2 anëtarë nga profesione të tjera (avokat, prokuror, profesorë të së drejtës ose bota akademike etj). Si për gjyqësorin, ashtu edhe për Kuvendin rekomandohet të gjejë zbatim miratimi me shumicë të cilësuar i të gjithë anëtarëve, pas një përzgjedhje të kualifikuar dhe pas një procesi transparent nëpërmjet një Këshilli për Emërimet (komision *ad hoc*), që do të gjejë zbatim edhe për kandidaturat e emëruara nga Presidenti. Ky Këshill do të bëjë rradhitjen e kandidaturave, sipas kriterëve shkencorë të parashikuara në ligjin organik. Kandidatët e refuzuar mund t'i drejtohen GJ K, nëse pretendojnë se nuk është respektuar procesi i përzgjedhjes nga organet e emërtesës. Kjo formulë zgjedhjeje siguron pjesëmarrjen e disa

organeve dhe grupeve të interesit në proces, pasi secili organ ka kompetencë thelbësore dhe të pandarë me të tjerët, gjë që garanton mosbllokimin e procesit duke krijuar edhe mundësinë e miksimit të përvojave të anëtarëve të GJ K. Gjithashtu, ky proces nuk dominohet dukshëm nga politika, si dhe mundëson balancimin.

Lidhur me kriteret sa më objektive për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të GJ K, ato do të përcaktohen kryesisht në Kushtetutë, por edhe në ligj dhe do të jenë të fokusuara më së shumti në merita, duke u bazuar kështu mbi Opinionin e Komisionit të Venecias CDL(2011)065 mbi ligjin e GJ K të Turqisë, sipas të cilit është e rëndësishme të theksohet se përzgjedhja e gjyqtarëve duhet të bazohet mbi kriteret objektive të paracaktuara në ligj ose nga autoritetet kompetente dhe ato (kriteret) duhet të fokusohen kryesisht tek meritat. Parashikimi i kriterëve të domosdoshme për t'u patur nga kandidatët duhet të jenë kryesisht: Përvoja si jurist (të paktën 15 vjet); formimi profesional: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë të universiteteve, juristë që kanë punuar në pozicione të larta në administratën publike ose këshilltarë në Gjykatën Kushtetuese. Kandidatët e evidentuar krahas aktivitetit të tyre duhet të kenë edhe një afërsi me jetën akademike (jo detyrimisht të kenë tituj shkencorë, por kjo mund të jetë kriter preferencial), të kenë qasje të njohur në fushën e të drejtave të njeriut ose fushave të përafërta me të drejtën kushtetuese (p.sh në të drejtën administrative, kushtetuese, të drejtën europiane etj). Edhe këto kriteret janë në linjë me Opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2006)006, sipas së cilit është shumë e mirëpritur që GJ K të përbëhet jo vetëm nga gjyqtarë karriere dhe prokurorë por edhe nga avokatë dhe profesorë të së drejtës, duke qenë se një përbërje e tillë ka efekt pozitiv në vendimmarrjen e GJ K. Kandidatët duhet të jenë me integritet të lartë moral dhe profesional

dhe të mos kenë qenë anëtarë të forumeve drejtuese të partive politike. I gjithë procesi i emërimit duhet të karakterizohet nga transparenca dhe publiciteti (që kanë munguara deri sot), pasi këto elemente kontribuojnë në cilësinë e drejtësisë kushtetuese dhe po ashtu në perceptimin dhe forcimin e besimit të publikut mbi pavarësinë e gjyqtarëve kushtetues dhe për rrjedhojë në legjitimitetin e garantit të Kushtetutës. Në funksion të gjithë kësaj propozohet që mandati i anëtarëve të GJ K të zgjatet në 12 vjet (nga 9 vjet që është aktualisht) me qëllim që të krijojë më tepër siguri për pavarësinë e anëtarëve të GJ K dhe një stabilitet në vendimmarrje, për shkak të veçorisë që ka gjykimi kushtetues⁵⁷.

Në gjykimin tonë, gjithë këto kriterë që u analizuan më sipër, janë mjaft të domosdoshme në drejtim të pavarësisë së GJK në terësi, në mënyrë që edhe vendimmarrja e saj në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit të rezultojë sa më e pavarur dhe efikase.

4.3.3 Rritja e efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në funksion të ankimit individual

Në kapitullin III, kur trajtuam ankimin individual si mundësi për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, arritëm në përfundimin se nisur nga rëndësia që paraqet aksesin i drejtpërdrejtë i individit para GJ K, do të ishim të mendimit se një parashikim i tillë në Kushtetutë, dhe si pasojë edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, do të përbënte përsëri një hap përpara në Drejtësinë Kushtetuese Shqiptare, një hap të cilin ligji “ Për dispozitat kryesore kushtetuese ” e kishte bërë që në vitin 1992. Gjithashtu u nënvizua fakti

⁵⁷ Shih “Material shpjegues për ndryshimet kushtetuese”, shtator 2015

që një parashikim i tillë do ta bënte GJ K një mjet më efektiv aq më tepër në drejtim të garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Konfirmimi vjen edhe në Dokumentin Analitik për Reformën në Drejtësi, ku pikë së pari shtrohet pyetja: A është Gjykata Kushtetuese një mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave themelore të parashikuara në Kushtetutë? Më tej në analizën që i bëhet çështjes në fjalë thuhet se efektiviteti i Gjykatës Kushtetuese në nivel kushtetues lidhet me juridiksionin e saj. Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Nga përmbajtja e kësaj dispozite është e qartë se juridiksioni kushtetues është i kufizuar për individët vetëm për sa i përket mbrojtjes së të drejtave të tyre kushtetuese në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Individët nuk mund të vënë në lëvizje GJK-në për çështje që nuk lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe kjo pengesë kushtetuese nuk garanton efektivitetin e GJK-së. Nuk ka asnjë parashikim ligjor për kompetencën më të rëndësishme të GJK-së dhe që zë vëllimin më të madh të punës së saj: shqyrtimin e kërkesave individuale për një proces të rregullt ligjor (ankimi individual kushtetues). Ashtu siç parashtruam pak më sipër, përfundohet duke thënë se në jo pak raste qenien e Gjykatës Kushtetuese si një mjet joefektiv e ka konstatuar edhe praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Këto probleme të evidentuara e kanë ballafaquar veprimtarinë e kësaj Gjykate me standardin e një mjeti efektiv që kërkon neni 13 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Edhe në Materialin shpjegues për ndryshimet kushtetuese (Draft 24/09/2015) propozohet të zgjerohet juridiksioni i GJ K në funksion të mbrojtjes më efikase së të drejtave të individit si dhe theksohet fakti se aktualisht ankimi individual në GJ K nuk është mjet efektiv në kuptim të Kushtetutës, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës përkatëse të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Një nga ndryshimet që solli Kushtetuta e vitit 1998, thuhet në material, ishte dhe kufizimi i së drejtës së individit për t'iu drejtuar GJ K. Nga mundësia e individit për të kundërshtuar aktet gjyqesore dhe pushtetit publik që kufizojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij, u kalua tek e drejta për një proces të rregullt ligjor, e cila edhe për shkak të përkufizimit, por edhe për shkak të praktikës së GJ K, tashmë është kufizuar vetëm në shkeljet procedurale, pa përfshirë shkeljen e të drejtave materiale. Është mbështetur idea për të riformuluar nenin 131/f të Kushtetutës me qëllim bërjen e GJ K një mjet efektiv dhe mbrojtëse të të gjithë të drejtave kushtetuese të individit për të qenë tërësisht në përputhje me rolin e saj.

Në kuadër të gjithë asaj që u tha më lart, në amendimet kushtetuese të paraqitura nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, parashikohet ndryshimi i pikës **g** të nenit 131 të Kushtetutës, si më poshtë vijon:

Gjykata Kushtetuese vendos për:

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

në:

Gjykata Kushtetuese vendos për:

f) Shqyrtimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër vendimeve gjyqësore dhe akteve të pushtetit publik që çënojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave përveç kur është parashikuar ndryshe në Kushtetutë.

Një ndryshim i tillë do të ishte edhe në përputhje të plotë me atë çka thuhet në Përmbledhjen e Mendimeve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias mbi Drejtësinë Kushtetuese. Komisioni i Venecias⁵⁸ ka nënvizuar rëndësinë e zgjerimit të ankimit kushtetues individual, i cili duhet të riformulohet me qëllim një mbrojtje më të madhe të individit ndaj akteve të pushtetit publik, duke iu referuar modelit gjerman - *Verfassungsbeschwerde*.

4.3.4 Ndryshime në rrethin e subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese

Në Kapitullin III, parashtruam si dhe analizuam disa problematika që hasen në lidhje me legjitimitimin e subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për një kontroll abstrakt apo konkret të kushtetutshmërisë së ligjit, mes të cilave llojin e “interesit” që duhet të provojnë të ashtuquajturat subjekte me legjitimitet të “kushtëzuar”. Theksuam gjithashtu se duke qenë që kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit nga GJ K përbën edhe funksionin kryesor të saj, zbatimi i tij kërkon pasjen e një kuptimi të drejtë dhe të qartë në

⁵⁸ Shih Përmbledhjen e Mendimeve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias mbi Drejtësinë Kushtetuese, fq.18 e në vijim

rradhë të parë nga vetë subjektet që inicojnë procesin kushtetues, për të cilët nuk paraqitet vetëm si një e drejtë e tyre për ta ushtruar, por njëkohësisht edhe si një detyrim, me qëllim që ligjet të cilët mbajnë antikushtetutshmëri të mos i shmangen këtij kontrolli kushtetues, qoftë për arsye të afatit të parashkrimit (neni 50 i ligjit organik), ashtu edhe të pasivitetit të këtyre subjekteve. Çështjen e legjitimitetit (*locus standi*) Gjykata me të drejtë e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues, qëndrim ky i ritheksuar së fundmi edhe në vendimet e saj nr. 46/2015 dhe 64/2015. Jurisprudenca kushtetuese shqiptare ka mbajtur një qëndrim uniform lidhur me rëndësinë e legjitimitetit të subjekteve, e megjithatë në praktikë janë evidentuar problematika në lidhje me legjitimitimin e tyre, referuar kryesisht subjekteve me legjitimitet të kushtëzuar.

Në analizën që i bëhet subjekteve që venë në lëvizje GJ K, në Dokumentin Analitik thuhet se rrethi i subjekteve që mund të fillojë një gjykim kushtetues, nuk kufizohet vetëm në nenin 134 të Kushtetutës, duke qenë kjo një dispozitë jo shteruese. Ndërkohë që në vendimin nr. 19/2015 si dhe 43/2015 Gjykata Kushtetuese thotë se në nenin 134/1 të Kushtetutës është përcaktuar në mënyrë shteruese rrethi i subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Subjektet që e vënë në lëvizje GJK-në, sipas nenit 131/a të Kushtetutës, ndahen në dy kategori: subjekte me legjitimitet të pakufizuar (p.sh. Presidenti, Kryeministri, 1/5 e deputetëve) dhe subjekte me legjitimitet të kufizuar (p.sh. organet e qeverisjes vendore, individët etj.). Të gjitha subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 1, shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” të Kushtetutës kanë legjitimitet të kufizuar dhe e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm nëse ato argumentojnë “interesin e tyre” në një çështje të veçantë. Nga ligji organik rezulton se neni

49 i ligjit parashikon për të gjitha subjektet e nenit 134 të Kushtetutës, me përjashtim të individit, të drejtën për të nisur një gjykim kushtetues për shfuqizimin e një norme ligjore⁵⁹.

Në lidhje me subjektet që kanë legjitimitet të “kushtëzuar”, me të drejtë në Dokumentin Analitik, nënvizohet fakti se duke pasur parasysh rolin dhe funksionin e rëndësishëm që ka Avokati i Popullit në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve, është parë problematik parashikimi i tij si subjekt i kushtëzuar për t’iu drejtuar GJK-së.

Një tjetër nënvizim i rëndësishëm që bëhet në Dokumentin Analitik, është ai referuar faktit se në kushtet kur kontrolli incidental i ligjeve bëhet vetëm me iniciativë të gjykatës, kjo i kufizon palët t’i drejtohen GJK-së kur gjatë gjykimit identifikojnë një cenim të të drejtave të tyre nga një ligj që mund të jetë antikushtetues. Një mundësi e palëve për të kërkuar kontroll incidental, thuhet në dokument, do të ishte një garanci më tepër për aksesin e tyre në Gjykatën Kushtetuese, sidomos në rastet kur gjykatat janë pasive në këtë drejtim. Nisur dhe nga ajo që kemi parashtruar dhe analizuar tashmë, një parashikim i tillë do të ishte mëse i rëndësishëm dhe do të shkonte jo vetëm në favor të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit, por do të ishte një garanci më shumë edhe në drejtim të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në fjalë.

Në amendimet kushtetuese të propozuara nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, është parashikuar ndryshimi i nenit 134 të Kushtetutës, duke zgjeruar rrethin e subjekteve që legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në këtë kuadër neni 134 ndryshohet si më poshtë vijon:

⁵⁹ Për më tepër shih “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në RSH.”, Qershor 2015, fq.36 e në vijim

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:

a) Presidentit të Republikës; b) Kryeministrit; c) Jo më pak se një së pestës së deputetëve; ç) Avokatit të Popullit; d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit; dh) Çdo gjykatë sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute; e) Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale; ë) Komisionerit kundër Diskriminimit; f) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë; g) Organeve të qeverisjes vendore; gj) Organeve të bashkësive fetare; h) Partive politike dhe organizatave të tyre; i) Individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët ç, d, e, ë, f, g, gj, h dhe i të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre.

Edhe në Materialin shpjegues për ndryshimet kushtetuese (Draft 24/09/2015) thuhet se do të ketë veç të tjerash edhe një ridimensionim të subjekteve që mund të inicojnë një gjykim kushtetues.

4.3.5 Afate më të arsyeshme në kërkesën për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit

Në analizën që i bëhet sistemit të drejtësisë, përveç pikave të trajtuara pak më lart, Dokumenti Analitik, ndalet edhe në afatin e paraqitjes së kërkesës për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit ku thuhet se nga përmbajtja e ligjit organik për Gjykatën Kushtetuese vihen re disa mangësi sa i takon afatit të paraqitjes së kërkesave para GJK-së, mes të cilave afati kufizues kohor për paraqitjen e kërkesës për shfuqizimin e ligjeve. Neni 50 i ligjit organik parashikon afatin 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit, brenda të cilit mund

të nisë një gjykim kushtetues për shfuqizimin e normës ligjore. Nga ana tjetër në Kushtetutë gjenden dy dispozita të tjera që mundësojnë shfuqizimin e ligjeve edhe tej afatit 3-vjeçar. Kështu neni 178 i Kushtetutës parashikon se ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar. Me të drejtë në Dokumentin Analitik thuhet se kjo frazë nuk e përjashton të drejtën e Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë ligjet e miratuara para vitit 1998, çka do të thotë pra edhe përtej afatit 3 vjeçar të parashikuar në ligjin organik. Gjithashtu neni 180 i Kushtetutës i njeh të drejtën Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dispozitat e të cilave vijnë në kundërshtim me të, ndërsa neni 53/2 i ligjit organik parashikon të drejtën e Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë aktin e ratifikimit të marrëveshjes ndërkombëtare, pra të ligjit miratues.

Siç u trajtua dhe më parë, nga pikëpamja e afateve brenda të cilave duhet të nisë një procedurë e tillë, ka vende që pranojnë një iniciativë pa afate kohore, mjafton që ligji të ketë hyrë në fuqi, ka edhe vende, të cilat e lejojnë kontrollin e mëpas'shëm abstrakt vetëm brenda një afati të caktuar pas hyrjes në fuqi të ligjit. Për shembull ky afat është 3 muaj në Spanjë, 30 ditë në Itali për rekursat e paraqitura nga regjionet etj. Në këto raste, kontrolli i mëpas'shëm i afrohet shumë kontrollit paraprak dhe dallimi nëse ligji ka hyrë ose jo në fuqi nuk paraqet ndonjë rëndësi praktike. Përgjithësisht, sa më pak pasoja të ketë prodhuar një ligj, aq më shumë anulimi i tij nga gjykata kushtetuese i afrohet kontrollit *a priori*. Gjithashtu folëm për mundësinë e shkurtimit të këtij afati 3-vjeçar. Për një mundësi të tillë flitet edhe në Dokumentin Analitik kur nënvizohet fakti se lidhur me afatin kohor kërkojnë një vëmendje edhe disa dispozita të tjera të ligjit organik, siç është edhe afati i gjatë 2-

vjeçar për paraqitjen e kërkesave nga individët, pasi një afat i tillë jo vetëm që nuk është efektiv por edhe dëmton parimin e sigurisë juridike, ashtu siç u trajtua edhe në Kapitullin III të këtij punimi. Më pas analiza fokusohet përsëri në afatin 3-vjeçar të sipërpërmendur, për paraqitjen e kërkesave për shfuqizimin e ligjeve nga momenti i hyrjes së tyre në fuqi. Me të drejtë edhe një afat i tillë konsiderohet i gjatë dhe jo efektiv, pasi ligji brenda 3 vjetve mund të sjellë pasoja juridike të pakthyeshme.

4.3.6 Efektet juridike, shpallja dhe ekzekutimi i vendimeve

Sipas nenit 132 pika 2 e Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Po ashtu parashikohet në po pikën 2 të këtij neni kushtetues se Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ligji të shfuqizohet edhe në një datë tjetër.

Po ashtu në ligjin organik për GJ K, neni 26, pika 1, parashikohet se vendimet e GJ K botohen në Fletoren Zyrtare dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit të saj. Ndërkohë që kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, thuhet në po këtë nen, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij. Më poshtë në nenin 76 ku flitet për efektet juridike të vendimeve të GJ K, parashikohet shprehimisht se vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj si të papajtueshëm me Kushtetutën si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi dhe se vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm në disa raste përjashtimore si : a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë

kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të shfuqizuar;
b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë; c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit të shfuqizuar.

Në analizën që i bëhet fuqisë juridike të vendimeve të GJ K, me të drejtë thuhet se ka një mospërputhje ndërmjet Kushtetutës dhe ligjit organik, pasi siç u parashtrua konkretisht përmes dispozitave kushtetuese dhe ligjore respektive, Kushtetuta njeh botimin në Fletoren Zyrtare dhe afatin që vendos vetë Gjykata si dy mënyra të hyrjes në fuqi të vendimit ndërkohë që nga ana tjetër ligji organik në nenin 26 të tij parashikon si rregull të përgjithshëm hyrjen në fuqi të vendimit me botimin e tij në Fletoren zyrtare, fuqinë e menjëhershme të vendimit pas shpalljes vetëm në rastet kur vendos GJ K-ja dhe bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të individit, si dhe fuqinë prapavepruese në rastet e parashikuara në nenet 76 e 79. Neni 76/2 i ligjit organik përcakton efektin prapaveprues të një vendimi të GJ K-së që ka shfuqizuar një ligj si antikushtetues në tri situatat e sipërpërmendura, pra a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit; b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë si dhe c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit të shfuqizuar. Dokumenti Analitik konstaton se ky nen ka shumë paqartësi në zbatimin e tij në praktikë, sidomos lidhur me shkronjat “a” dhe “c” të tij. Gjithashtu edhe për rastet e parashikuara në pikën “b” është problematik mosqartësimi i konceptit “vendim i formës së prerë” sipas standardeve të GJEDNJ-së. Kjo e fundit në jurisprudencën e saj ka konsoliduar faktin se një vendim i formës së prerë është *res judicata*, pra gjë e gjykuar dhe rrjedhimisht moscenimi i vendimit të formës së prerë është pjesë e *res judicata* dhe se e gjithë kjo shkon

në favor të parimit të sigurisë juridike. Në çështjen *Rosca kundër Moldavisë, Bumarescu kundër Rumanisë, Ryabykh kundër Rusisë*, thuhet se veç të tjerash, parimi i sigurisë juridike “kërkon” që atje ku gjykatat kanë marrë një vendim të formës së prerë, ky vendim nuk duhet të vihet në dyshim. GJK në disa vendime të saj si 23/2007, 20/2008, 24/2008, 21/2014, ka shkuar konform GJEDNJ në lidhje me rëndësinë e çështjes në fjalë: “[...] ku vendimi i formës së prerë përbën gjë të gjykuar [...] Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore [...] pra në cenim të vetë sigurisë juridike”.

Ligji nuk parashikon në lidhje me qartësimin e efekteve konkrete të vendimit të GJK-së në dispozitiv me qëllim rritjen e efektivitetit të GJK-së si dhe qartësisë së vendimit për palët dhe organet që do ta zbatojnë atë. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese jo vetëm sa i takon dispozitivit, por edhe pjesës arsyetuese nuk janë zbatuar në çdo rast nga organet shtetërore; ligji organik nuk parashikon masa efektive për raste të tilla; në disa raste vendimet e GJK-së shpallen pa pjesën arsyetuese, duke shkaktuar në këtë mënyrë konfuzion për fillimin e efekteve të tyre.

Përsa i përket ekzekutimit të vendimeve të GJK, ose siç quhet me të drejtë gjatë analizës, (mos)ekzekutimit të tyre, duke pasur parasysh se zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ndikon në rritjen e autoritetit të saj, ajo i ka dhënë rëndësi dhe efekteve të vendimmarrjes së saj, duke theksuar se vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. I detyrueshëm nuk është vetëm dispozitivi i vendimeve të GJK-së, por dhe pjesa arsyetuese e vendimit. Megjithatë, jo në të

gjitha rastet vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë respektuar nga organet shtetërore. Gjatë analizës përmenden vendimet nr. 27/2010 dhe 43/2011 të GJK, ku Gjykata, edhe pse shfuqizoi disa nene të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës për papajtueshmëri me Kushtetutën, Kuvendi në plotësim të boshllëkut ligjor të krijuar miratoi në substancë po të njëjtat dispozita, duke mos mbajtur parasysh vendimin e mëparshëm të kësaj gjykate, dispozita që përsëri u shfuqizuan nga Gjykata Kushtetuese një vit më vonë në vendimin e saj nr. 43/2011. Në këtë kontekst, ligji organik ka mungesa për sa i përket vendosjes së rregullave dhe sanksioneve për mosekzekutimin e vendimeve të GJK-së⁶⁰.

⁶⁰ Shih Dokumentin Analitik, fq.40 e në vijim

KAPITULLI V: KONKLUZIONE

Duke u nisur nga pyetja kryesore kërkimore e këtij punimi: *Sa efikas është sistemi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri; a është më i përshtatshmi për vendin tonë - në drejtim të cilave karakteristika mund të bëhen ndryshimet përkatëse duke i adoptuar ato nga sistemi tjetër, ai amerikan apo qoftë edhe duke adoptuar karakteristika të tjera nga vetë sistemi evropian, por të marra këto nga modelet e ndryshme që përfshihen po brenda këtij sistemi?* – mbi bazën edhe të hipotezave e pyetjeve ndihmëse hipotetike, arritëm në përfundimin se sistemi shqiptar i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit, paraqet efikasitet kryesisht në drejtim të kontrollit abstrakt, konkret, incidental, *erga omnes* si dhe kontrollit të centralizaur. Ndërkohë që për sa i përket kontrollit *a posteriori*, paraqitëm rezervat tona në drejtim të arsyeve të cilat do t'i përmbledhim në mënyrë preçize, në këtë kapitull.

Nëse do të zbrisnim fillimisht në disa konsiderata të përgjithshme, do të thonim se eksperiencat europiane kanë qenë sigurisht në origjinë të një rinovimi për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, ashtu siç nga ana tjetër ky kontroll lindi dhe u zhvillua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Europa krijoi një model të vetin duke qenë sistemi amerikan i paaplikueshëm për arsye teknike e historike – por me të njëjtat objektiva.

Teoria e kontrollit kushtetues ka evoluar dhe është transformuar e ndërkohë edhe pse në të dy anët e Atlantikut është arritur në të njëjtin qëllim duke ndjekur rrugë të ndryshme, ka sigurisht ngjashmëri dhe dallime mes dy sistemeve kryesore të kontrollit. Kështu siç dhe pamë, në rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të mund të flitet për

kontroll të decentralizuar, konkret, *a posteriori* dhe *inter partes*, çka duket sikur mund t'ia kundërvëmë totalisht kontrollit francez i cili paraqitet abstrakt, direkt, *a priori* dhe *erga omnes*; kontrolli italian do të prezantohet si kontroll abstrakt, incidental, *a posteriori* dhe *erga omnes*; përse i përket kontrollit gjerman, spanjoll dhe atij portugez, paraqesin njëkohësisht më shumë se një nga këto karakteristika.

E megjithatë, rëndësi përbën fakti që nga njëra anë disa modele kontrolli akumulojnë karakteristika të ndryshme marrë nga të dy sistemet, e nga ana tjetër vetë praktika synon të amortizojë diferencat teorike.

Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri paraqet modalitetet e sistemit europian të kontrollit. Edhe pse në fakt gjatë qasjes krahasimore që bëme në këtë trajtim, arritëm në konkluzionin se klasifikimi në vetvete paraqitet disi i vështirë, e kjo në fakt jo aq në drejtim të dallimeve, që dy sistemet e kontrollit paraqesin në modalitetet e tyre të kontrollit të kushtetutshmërisë, se sa referuar ngjashmërive të tyre dhe pikërisht një tendence për përafrim. Kjo do të thotë në fakt se asnjë nga sistemet e kontrollit nuk është i pastër dhe se tendencat për gërshetimin e karakteristikave të njërit me tjetrin, janë tipike për konstitucionalizmin e sotëm modern. Kjo na jep mundësinë dhe përbën bazën juridike për vërtetimin e hipotezave.

Në lidhje me kontrollin abstrakt dhe konkret, të kushtetutshmërisë së ligjit në Shqipëri, problematikat paraqiten në drejtim të legjitimitetit të subjekteve inicuese për këto kontrole respektivisht. Gjykata Kushtetuese çështjen e legjitimitetit (*locus standi*) me të drejtë e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi

kushtetues, qëndrim ky i ritheksuar vazhdimisht në vendimet e saj. Jurisprudenca kushtetuese shqiptare ka mbajtur një qëndrim uniform lidhur me rëndësinë e legjitimitetit të subjekteve, e megjithatë në praktikë janë evidentuar problematika në lidhje me legjitimitimin e tyre, kryesisht në drejtim të subjekteve me legjitimitet të kushtëzuar. Nga analiza që i bëhet jurisprudencës së GJK arrihet në përfundimin se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 134/1 ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kriteri kushtetues i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit të mësipërm, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” të paragrafit 1 të nenit 134, të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, janë subjekte të kushtëzuara. Parashikimi i këtij kriteri kushtetues vetëm për një numër të kufizuar subjektësh kushtetuese, në një interpretim *a contrario*, do të thotë se ai nuk është i zbatueshëm për subjektet e tjera të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, të cilat nuk kanë detyrimin për të justifikuar interesin në rast se i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese. Rrethi i subjekteve që duhet të argumentojnë interesin e tyre me çështjen në shqyrtim ka paraqitur një rëndësi të veçantë për jurisprudencën kushtetuese, sidomos në drejtim të përcaktimit të disa kriterëve standarte që duhen përmbushur. Në jurisprudencën kushtetuese janë vërejtur luhatje përsa u përket standarteve të vendosura për legjitimitimin e grupit të dytë të këtyre subjekteve të parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese Shqiptare nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim për interpretimin e “interesit” të subjekteve në fjalë, çka është shumë i rëndësishëm jo vetëm për legjitimitimin e tyre por edhe për klasifikimin e një kontrolli si konkret apo abstrakt. Në këtë mënyrë jemi të mendimit se përsa kohë nuk kemi një qëndrim të konsoliduar, çështja duhet të shihet rast pas rasti, aq më tepër që në disa raste shpallja e një ligji si antikushtetues, prevalon mbi moslegjitimitimin e një subjekti.

Problemet e legjitimitit, vijnë edhe nga fakti se si në doktrinën ashtu dhe jurisprudencën kushtetuese, kontrolli konkret është identifikuar me kontrollin që Gjykata Kushtetuese ushtron mbi çështjet që inicohen nga gjykatat e zakonshme. Prandaj gjejmë me vend të nënvizojmë faktin që nëse subjektet e veçanta private ose shtetërore, do të kërkojnë të realizojnë kontrollin e kushtetutshmërisë, do të duhet të provojnë legjitimitetin e tyre përpara Gjykatës Kushtetuese, duke argumentuar interesin që kanë, të lidhur me çështjen në shqyrtim. Në raste të kësaj natyre, këto subjekte nuk do t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në kuptim të kontrollit abstrakt, por të atij konkret. Për këtë arsye, duke qenë se kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit nga Gjykata Kushtetuese përbën edhe funksionin kryesor të saj, zbatimi i tij kërkon pasjen e një kuptimi të drejtë dhe të qartë në rradhë të parë nga subjektet që inicojnë procesin kushtetues, për të cilët nuk paraqitet vetëm si një e drejtë e tyre për ta ushtruar, por njëkohësisht edhe si një detyrim, me qëllim që ligjet të cilët mbajnë antikushtetutshmëri të mos i shmangen këtij kontrolli kushtetues, qoftë për arsye të afatit të parashkrimit (neni 50 i ligjit organik), ashtu edhe të pasivitetit të këtyre subjekteve .

Kontrolli incidental, është rrjedhojë e përpjekjeve për të kombinuar parimin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë që ushtron çdo gjyqtar i zakonshëm në sistemin

amerikan, me supermacinë ose monopolin e gjykatës kushtetuese europiane. Natyrisht gjyqtarit të zkonshëm nuk i mohohet funksioni i tij për të interpretuar kushtetutën, por vetëm kompetenca për të deklaruar, mbi bazën e saj, si antikushtetues një ligj që ai e çmon të tillë. Në rast të kundërt do të humbte vetë arsyeja e ekzistencës së gjykatës kushtetuese dhe kontrolli kushtetues do të ishte i decentralizuar ose i shpërndarë, si në modelin amerikan dhe të disa vendeve të tjera. Thelbi i tij qëndron në faktin se gjyqtari i zakonshëm është i detyruar *ex officio* ose me kërkesë të palëve, ta pezullojë gjykimin dhe t’ia referojë gjykatës kushtetuese ligjin në fjalë.

Nga analiza e jurisprudencës kushtetuese shqiptare arrijmë në përfundimin se GJ K ka legjitimuar në kuadër të kontrollit incidental në rastin kur, në mënyrë të përmbledhur dhe konçize gjykata referuese ka identifikuar *raportin e domosdoshëm* midis vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete; ka identifikuar parimet kushtetuese me të cilat, sipas saj, bie në kundërshtim dispozita e kundërshtuar; ka argumentuar se nuk ka pasur mundësi të interpretimit të ligjit në pajtim me Kushtetutën dhe për këtë arsye nuk mund të përdorte mekanizëm tjetër veç atij të vënies në lëvizje të gjyimit incidental për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës.

Objekt i kontrollit incidental është vetëm ligji në kuptimin formal të fjalës, duke patur në këtë mënyrë një ndryshim nga sa ishte sanksionuar në ligjin “Për dispozitat Kryesore Kushtetuese” (Kushtetuta e vitit 1998 ka parasysh vetëm ligjin në kuptimin formal) dhe një përafrim me shumicën e gjykatave kushtetuese europiane.

Në lidhje me faktin nëse gjyqtari *a quo* duhet të ketë bindjen apo qoftë edhe vetëm dyshimin për kushtetutshmërinë e ligjit, në mënyrë që t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese,

ashtu siç pranohet dhe në literaturë, jemi të mendimit se termi “çmon” i përdorur nga ligjvënësi, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, ka të bëjë me bindjen e gjyqtarit *a quo* dhe jo me dyshimin e tij. Një model i tillë është i parashikuar nga Ligji Themelor Federal Gjerman, ndryshe nga Kushtetuta Italiane, e cila përqafon qëndrimin e “dyshimit”. Po t’i referohemi nenit 113/8 të Kushtetutës së Kosovës do të shohim se aty flitet për “*pasiguri të përpuethshmërisë së ligjit të kontestuar me Kushtetutë*”, duke u përqafuar në këtë mënyrë modeli italian. Duke qenë se një kontroll i tillë nga Gjykata Kushtetuese është themelor dhe se gjyqtari i zakonshëm nuk e ka një kompetencë të tillë në sistemin europian, do të ishim të mendimit që edhe në rastin shqiptar të përqafohet po ashtu modeli italian, në mënyrë që gjykatësi *a quo*, përpara një dyshimi të tillë, t’i drejtohet GJ K, në mënyrë që ky dyshim të zgjidhet nga organi kompetent dhe jo nga ai vetë.

Konceptimi i GJ K nga Kelzeni si një instrument për mbrojtjen e kushtetutës përmes shqyrtimit abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit, përjashtoi në fakt nga juridiksioni i saj shqyrtimin e ankesave individuale dhe ky duket si një problem i përbashkët i gjykatave kushtetuese kelzeniane.

Duke bërë një analizë historike të mekanizmit të ankimit kushtetues shqiptar, vihet re një lloj luhatjeje, që nuk evidenton, qartësisht modelin e pranuar. Ankimi kushtetues i ofruar në vitin 1992 nga ligji “ Për dispozitat kryesore kushtetuese ” (i cili njihte rekursin për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit), ngjason me modelin gjerman, ndërkohë që rregullimi aktual kushtetues duket si një zgjidhje tipike shqiptare.

Ngushtimi i hapësirës për individin i cili nuk vendoset në të njëjtin pozicion si dhe subjektet e tjera, ka qenë një ndër arsytet që ka nxitur artificialisht disa nga subjektet, që

ndodhen më pranë mbrojtjes së ineresave të shtetasve, të paraqiten më shpesh para Gjykatës Kushtetuese. Kjo prirje e këtyre subjekteve, për të marrë për çdo rast pozicionin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, ka detyruar Gjykatën Kushtetuese për të qenë sa e hapur në zgjerimin e pakufizuar të rrethit të subjekteve që legjitimohen për t'u paraqitur para saj, aq edhe e vetëpërmbajtur deri në një kufizim të skajshëm të aksesit për një gjykim kushtetues. Në mënyrë graduale, jurisprudenca kushtetuese, duke e interpretuar termin “interes” në funksion të çdo rasti konkret, ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme në pasurimin e doktrinės kushtetuese. Përsa i përket individit, aksesit i tij në Gjykatën Kushtetuese kushtëzohet me justifikimin e interesit, si një argument për të ngritur vetëm pretendimin për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Procesi i rregullt ligjor është vetëm një nga të drejtat e individit që lidhet me rregullsinë e gjyqit të zakonshëm dhe nuk mund të shërbejë për të siguruar të drejtat e tjera të tij. Një gjyq mund të jetë fare i drejtë, nga pikëpamja e procesit të rregullt, në një kohë që e drejta e pronës - objekt gjykimi, mund të jetë cenuar për shkak të një ligji antikushtetues. Procesi i rregullt ligjor nuk është një e drejtë universale që i mbulon të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese të individit; ai është vetëm një procedurë e rregullt gjyqësore, në të cilën testohen të gjitha të drejtat e tjera. Gj K këtu kontrollon gjykatën e zakonshme por jo të drejtën e individit. Procesi i rregullt ligjor duhet kuptuar në aspektin procedural dhe substantiv të tij. Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe më efikas të mundshëm. Ky do të ishte kuptimi substantiv i procesit.

Nga ana tjetër, ashtu siç pohohet nga doktrina por edhe nga jurisprudenca, edhe kontrolli incidental me nismën e gjyqtarit *a quo*, mund të shndërrohet në një mjet të

rëndësishëm në këtë drejtim. Mjafton të citojmë vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Ruiz - Mateos kundër Spanjës*, në të cilin thuhet se: “ [...] përmes ngritjes së çështjes për antikushtetutshmërinë e ligjit, individët palë në gjykim, po përdorin mjetin e vetëm dhe të tërthortë në dispozicion të tyre për të mbrojtur të drejtën e pronës”.

Duke u nisur nga rëndësia që paraqet aksesin i drejtpërdrejtë i individit para Gjykatës Kushtetuese si dhe për të qenë konform standarteve të GJEDNJ do të ishim të mendimit se një parashikim i tillë në Kushtetutë, dhe si pasojë edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, do të përbënte përsëri një hap përpara në Drejtësinë Kushtetuese Shqiptare, një hap të cilin ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” e kishte bërë që në vitin 1992. Një parashikim i tillë do të sillte benefite të dyanshme, duke shkuar jo vetëm në favor të individit, të drejtave dhe lirive themelore të tij, por edhe në atakim të ligjit antikushtetues e si rezultat në drejtim të mos “vesimit” të gjithë rendit juridik e të garantimit të parimit të sigurisë juridike.

Vendimet e GJK janë vendime përfundimtare dhe kanë fuqi detyruese të përgjithshme (*erga omnes*). Si të tilla ato përbëjnë *res judicata* dhe pajtohen apo respektojnë parimin e sigurisë juridike, konform standarteve të GJEDNJ, ku në vendimin *Macovei dhe të tjerë kundër Moldavisë*, thuhet se parimi i sigurisë juridike presupozon respekt për parimin e *res judicata* që është parimi i gjykimeve përfundimtare. Ndryshe ndodh në rastin e vendimeve të refuzimit, parashikuar nga neni 74 i ligjit organik për GJK.

Në disa vende janë aplikuar përvoja të ndryshme për rastet kur trupi gjyqësor nuk ka arritur të formojë një shumicë për marrjen e vendimit, pasi diku vlen vota mbizotëruese e Kryetarit, diku tjetër, kjo do të thotë vlefshmëri e aktit që gjykohet, diku tjetër vendimi quhet i marrë derisa të arrihet shumica (Traja, 2000: 99). Përvoja shqiptare hyn në grupin e tretë, sipas të cilës, vendimi konsiderohet i marrë vetëm atëherë kur arrihet shumica. Por, ligjvënësi e ka konceptuar gabimisht këtë fakt, kur ka parashikuar në ligjin organik për GJK se, kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë, Gjykata vendos refuzimin e kërkesës. Refuzimi i kërkesës është i ndryshëm nga rrëzimi i saj, pasi nuk përbën *res judicata*. Kjo do të thotë se ai nuk është pengesë që kërkuuesi ta riparqesë kërkesën e tij, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar. Ndërsa kur kërkesa e subjektit rrëzohet, atëherë ajo konsiderohet si gjë e gjykuar dhe subjekti nuk mund ta paraqesë sërish. Një qëndrim i tillë është kritikuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendimin e saj për çështjen *Marini kundër Shqipërisë*. Kjo Gjykatë ka konstatuar se Ligji organik i GJ K, me parashikimin e vendimeve për refuzimin e kërkesës në rast ndarjeje të barabartë të votave, çon në marrjen e një vendimi, i cili praktikisht nuk i jep asnjë zgjidhje çështjes në shqyrtim, duke e kthyer GJ K në një mjet joefektiv. Prandaj, e ngutshme, veç të tjerave, është nevoja për rishikimin e nenit 74 të Ligjit, i cili ka parashikuar refuzimin e kërkesës (Zaganjori, Anastasi & (Methasani) Çani, 2011: 169-170). Në gjykimin tonë, një parashikim i tillë nga neni 74 i ligjit organik, ka dashur të bëjë dallimin mes vendimeve të rrëzimit dhe atyre të refuzimit, të marra në këto raste, mirëpo pa dyshim që kjo nuk është në përmbushje të standarteve të jurisprudencës së GJEDNJ dhe mundësia e rishikimit të nenit në fjalë do të shkonte drejt rritjes e forcimit të GJK si një mjet efektiv për t'i dhënë zgjidhje çështjes në thelb, arsye dhe pse GJK vihet në lëvizje. Do të konkludonim me atë çka

GJEDNJ thotë në çështjen *Marini kundër Shqipërisë* se parashikimi në nenin 74 të ligjit organik për ndarjen e votave në mënyrë të barabartë, nuk i shërben sigurisë juridike dhe mund të privojë ankuesin nga e drejta efektive për një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën që ai i drejton GJK.

Nuk mund të dënohet kontrolli *a priori* dhe të preferohet ai *a posteriori* për faktin se ky i fundit është më i përhapur se i pari.

Kontrolli *a priori* ka detyrimisht karakter abstrakt. Madje ky i fundit konsiderohet edhe si një kontroll parandalues, për shkak të qëllimit të tij për të pastruar sistemin juridik nga ligjet me përmbajtje antikushtetuese, përpara se ato të cënojnë të drejtat dhe liritë themelore të individëve dhe parimet e shtetit të së drejtës .

Në këtë kuptim kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit mund ta konsiderojmë si “*një instrument të kontrollit a priori*”.

Sipas nenit 50 të Ligjit Organik për Gjykatën Kushtetuese, kërkesat në GJ K për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre. Do të mund të ishim të mendimit që të shkurtohej ky afat 3 -vjeçar. Por kjo si çdo medalje tjetër ka të dy anët e saj, pasi nga njëra anë do të vinte në lëvizje akoma më aktivisht subjektet për të kërkuar antikushtetutshmërinë e ligjit, por nga ana tjetër çfarë do të ndodhte nëse ky afat do të kishte mbaruar? Subjekti nuk do të legjitimohej dhe ligji do të vazhdonte të mbetej në fuqi?! Megjithatë, ajo që prevalon është padyshim parashikimi i një afati më të arsyeshëm që nuk cenon parimin e sigurisë juridike.

Kontrolli *a priori* mund të “ mburret ” me shpejtësinë në përgjigjet e dhëna, në efikasitetin dhe garancinë që jep në drejtim të qartësisë të së drejtës, në masën dhe kuptimin që ligji antikushtetues nuk do të hyjë në fuqi dhe si i i tillë nuk do ketë mundësi që të “vesojë” gjithë rendin juridik. Në këtë kuadër, sistemi *a posteriori* mund të çojë edhe në cenimin e një elementi shumë të rëndësishëm të shtetit të së drejtës që është parimi i sigurisë juridike, parim ky mjaft i rëndësishëm dhe i evokuar nga jurisprudenca e GJEDNJ. Si standarde formale kryesore të tij konsiderohen saktësia, qartësia, dhe qëndrueshmëria në tërësi e të gjithë rendit juridik të një shteti të caktuar. Si standarde kryesore në kuptimin material konsiderohen mos cenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Kjo do të thotë që jo vetëm normat e veçanta, por i gjithë rendi juridik kërkohet të jetë i kuptueshëm, i parashikueshëm dhe jo kontradiktor. Në këtë mënyrë, vlerësohet se krijohet edhe besimi i qytetarëve në qëndrueshmërinë e këtij rendi si dhe bindja e tyre në nevojën e respektimit dhe zbatimit të tij në jetën e përditshme. Në të njëjtën kohë, mbi këtë bazë, qytetarët përcaktojnë edhe hapësirën e lirisë apo mënyrën e sjelljes së tyre në shtet dhe shoqëri.

Kontrolli *a posteriori* duket se përmban më tepër pasiguri dhe paqëndrueshmëri të sistemit juridik e të marrëdhënieve juridike të krijuara, për shkak të kontrollit të kushtetutshmërisë në vazhdimësi që i bëhet ligjit. Kontrolli *a priori* nga njëra anë sjell më tepër qëndrueshmëri të sistemit juridik, përderisa nëpërmjet kontrollit paraprak dhe brenda një afati të caktuar kohor arrin të shmangë defektet e antikushtetutshmërisë, por nga ana tjetër nuk lejon të kundërshtohet në të ardhmen një normë juridike e shpallur. Pasi norma juridike e ka kaluar fazën e kontrollit paraprak, ajo nuk mund të bëhet objekt i shqyrtimit

kushtetues, pavarësisht defekteve që mund të evidentohen gjatë zbatimit të saj në praktikë. Nga kjo pikëpamje ky model kontrolli mbart si stabilitetin e sistemit ashtu dhe pamundësinë e tij për të kundërshtuar në të ardhmen antikushtetutshmërinë. Kjo, në gjykimin tonë, përbën dhe dobësinë më të madhe të kësaj forme kontrolli, një dobësi jo e vogël në fakt, e cila do të na bënte që përballë shtrimit hipotetik të sipërcituar, për mundësinë e një kontrolli *a priori* (terësisht të pastër), të përgjigjeshim me jo!

Mirëpo, përballë pyetjes: a do të mund të kishim një stabilitet dhe siguri juridike, në rastin kur në legjislacionin apo rendin juridik ekzistojnë edhe ligje që janë në kundërshtim me Kushtetutën, ligje të cilat një ditë do të shfuqizohen, do të krijojnë një vakum ligjor, do t'i lenë kështu vendin një ligji tjetër i cili në një farë mënyre apo mase do të krijojë një kaos, pra në vija të trasha, një pasiguri juridike?! – përsëri nuk jemi të “qetë” (aq më tepër pastaj, kur brenda të njëjtit sitem, kontrolli *a posteriori*, ushtrohet me të dy efektet e tij, *ex nunc* dhe *ex tunc*, ndonëse ky i fundit, i limituar vetëm për raste përjashtimore).

Kontrolli *a posteriori* dhe ai *a priori* janë dy forma kontrolli të cilat më shumë se kundërshtojnë njëra-tjetrën, forcohen dhe kompletohen në mënyrë reciproke.

Presidenti i Republikës ka një rol të rëndësishëm në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit.

E drejta e kryetarit të shtetit për t'ia kthyer një ligj për rishqyrtim parlamentit, pra përmes vetos pezulluese, konsiderohet si një veprim kontrollues i përligjur që e detyron parlamentin të jetë më i matur në vendimet që merr .

Po t'i referohemi literaturës në lidhje me veton e Presidentit, ajo shpesh herë shihet si një mjet për kontrollin e kushtetutshmërisë, duke përfshirë këtu edhe vetë sistemin amerikan të kontrollit, ku vetoja pezulluese konsiderohet si një mjet apo instrument i ngjashëm me *judicial review*. Në sistemin amerikan thuhet se Presidenti mund të shprehë një opinion në lidhje me mospreferencën e një akti të kaluar në Parlament (duke përfshirë edhe motivin për antikushtetutshmërinë e tij) - por gjithsesi kjo nuk duhet të jetë fjala e fundit.

Në sistemin italian të kontrollit, mundësia e kthimit të ligjeve për rishqyrtim Dhomave të Parlamentit, për motive antikushtetutshmërie, ka çuar një pjesë të doktrinës që të shohin Kryetarin e Shtetit dhe GjK në funksionin e mbrojtësve të Kushtetutës, i pari përmes kontrollit *a priori* dhe i dyti përmes kontrollit *a posteriori*. Kjo në fakt do të ishte një zgjidhje interesante në drejtim të gërshetimit të dy formave të kontrollit *a priori* dhe *a posteriori*.

Ndoshta, në gjykimin tonë, një zgjidhje më e mirë e aplikueshme, do ishte ajo e adoptimit të modelit francez, por në linjë të kundërt. Që do të thotë se ndërkohë që Franca ka patur kontrollin *a priori* dhe më pas njohu atë *a posteriori*, në formën e kontrollit incidental, në rastin tonë kontrolli *a posteriori* duhet të lihet në të tre modalitetet e tij, abstrakt, konkret, incidental por me veçorinë që të mund të parashikohet në legjislacionin shqiptar edhe mundësia e kontrollit *a priori*, madje në formën e detyrueshme të tij.

Kjo do të mund të realizohej, pikë së pari në drejtim të ligjeve të zakonshme; ndaj ligjeve organike për vetë rëndësinë që ato paraqesin, si dhe për faktin se tashmë një

praktikë e tillë është e konsoliduar në shumë sisteme kontrolli; ndaj ligjeve të tjera të përforcuara në kuptim të nenit 81 pragrafi 2, pikat *b, c, ç, d, e, ë, f*; rezerva do tregonim në drejtim të ligjit për gjendjen e jashtëzakonshme, parashikuar në pikën “*dh*” të këtij neni, kur ndiqet procedura e përshpejtuar, në rast të masave të jashtëzakonshme si dhe në rast nevojë urgjence, në kuptim të nenit 84, pika 4 të Kushtetutës; si dhe për ligje të tjera të përforcuara.

Qoftë kontrolli i decentralizuar përmes juridiksionit gjyqësor, qoftë ai i centralizuar përmes juridiksionit kushtetues, janë efikas secili në sistemin e vet.

Këto dy modele kontrolli kanë edhe ngjashmëri dhe madje përafrohen deri aty sa flitet në doktrinë për një model *miks*. Kjo do të thotë që në rastin tonë, adoptimi i kontrollit të decentralizuar jo vetëm që është i panevojshëm por për më tepër Gjykata Kushtetuese përbën organin më ideal në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë.

Vetë Gjykata Kushtetuese duhet të tregohet e “kujdesshme”. Problematikë të veçantë paraqet kontrolli abstrakt, pasi kur drejtohet te ligjet që miratohen nga Parlamenti, nuk e ka të mundur shmangien e gjykatës kushtetuese nga përfshirja në qendër të kundërshtimeve politike. Natyra e kontrollit abstrakt e imponon thirrjen e Gjykatës Kushtetuese, për të vendosur për pajtueshmërinë me kushtetutën të zgjidhjeve ose alternativave politike, të bëra nga Parlamenti në ligjin konkret .

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nga abuzimet e ligjvënësit, paraqet rëndësi specifike, jo vetëm në drejtim të përfituesve të këtyre të drejtave dhe lirive,

por edhe në planin politik, në masën që sigurimi dhe garantimi i këtyre të drejtave e lirive, nënkupton në të njëjtën kohë, edhe kufizimin e shumicës në pushtet.

“ Performanca e një gjykate kushtetuese, - shprehet Herman Schwartz, një studiues i njohur amerikan, - varet nga ata që veshin mantelin e gjyqtarit, të cilët mund të bëhen mbrojtësit kurajoz dhe energjik të parimeve kushtetuese dhe të drejtave të njeriut. Pikërisht për të tillë njerëz parimorë, të emancipuar, të spikatur profesionalisht dhe me integritet të lartë ka nevojë një gjykatë kushtetuese. Në suksesin e vërtetë, të një gjykate kushtetuese, ndikojnë pjesërisht dijet ligjore të gjyqtarëve, aftësitë e gjykatës për të ushtruar që në fillim disiplinë doktrinare, si dhe arsyetimi institucional dogmatik që ajo përdor. Janë këto cilësi që kontribuojnë në pavarësinë e gjykatës, për ta bërë atë të pathyeshme ndaj sulmeve të politikës. “Vetë pavarësia ka parakushte objektive, të cilat parashikohen në vendimmarrjen e gjykatës kushtetuese dhe në komponentët subjektivë të gjyqtarëve të saj. Është shumë e rëndësishme që Gjykata Kushtetuese të bëhet e besueshme për publikun e gjerë, por më e rëndësishme është, që ajo të praktikojë dhe të demonstrojë neutralitet (Sadushi, 2012: 103-104)”.

Pavarësisht konsideratave të ndryshme të artikuluar, Gjykata Kushtetuese, hap pas hapi, është evidentuar si një garant i respektimit të Kushtetutës kundër shpërdorimeve të ligjvënësit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Ajo është vlerësuar si një rregullator i ekuilibrit të pushteteve, por dhe i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individëve. Të gjithë skeptikët e ngritjes së këtij institucioni kushtetues dhe partizanët e bashkimit të saj në një organ të vetëm me Gjykatën e Lartë, duhet të kenë reflektuar për domosdoshmërinë e

gjykatës kushtetuese shqiptare, e cila në njëzet vite të ekzistencës së saj është imponuar nëpërmjet jurisprudencës si një mbrojtëse e Kushtetutës.

Fuqizimi i kontrollit kushtetues ka nxitur në mënyrë të favorshme zhvillimin dhe pasurimin e doktrinës, dhe të jurisprudencës kushtetuese. Gjyqtarët kushtetues shqiptarë kanë evoluuar, në mënyrë graduale, nga lexues mekanikë të normave ligjore, në interpretues vizionarë të parimeve dhe standarteve kushtetuese, duke lartësuar pozicionin e institucionit të tyre përballë degëve të tjera të së drejtës (Sadushi, 2012: 109). E kjo vërtetohet kryesisht edhe përmes jurisprudencës kushtetuese, përmes evoluimit të qëndrimeve që GJ K shqiptare ka mbajtur me anë të vendimeve të saj, të analizuara për qëllimin e studimit tonë përgjatë kapitujve.

Në mbështetje të këtij suksesi, vjen edhe Reforma e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, e cila së bashku me ndryshimet përkatëse kushtetuese, e vë theksin në rritjen e pavarësisë dhe efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese. Reforma në drejtësi dhe ndryshimet kushtetuese të parashikuara së fundmi, ndikojnë në disa drejtime të rëndësishme kompetencën e GJ K në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit. Propozimet e bëra lidhen me mangësitë e evidentuara gjatë analizës, në Kushtetutë dhe ligjin organik.

Reforma në Drejtësi së bashku me ndryshimet kushtetuese përkatëse, duke e vënë theksin e duke synuar kryesisht në rritjen e pavarësisë, efektivitetit dhe efikasitetit të GJ K, si rrjedhojë dhe të çdo kompetence a funksioni të saj, duke zbritur për më tepër, ashtu siç u analizua, në ndryshimet kushtetuese përkatëse që prekin kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, vlerësohet me një interes e rëndësi të veçantë edhe për qëllim të studimit tonë.

Zbatimi i ligjit organik në praktikën kushtetuese ka evidentuar jo pak çështje problematike në drejtim të efikasitetit dhe qenies së saj mjet efektiv, evidentuar shpesh herë nga jurisprudenca e GJEDNJ. Në mënyrë të përmbledhur, objektivat kryesorë lidhur me efektivitetin e Gjykatës Kushtetuese do të arrihen me anë të ndërhyrjeve në ligjin organik, duke synuar: përfaqësimin me Kushtetutën të subjekteve që legjitimohen t'i drejtohen GJK-së sipas ligjit organik të GJK-së përmes përfshirjes edhe në ligj të subjekteve që parashikon neni 134/1 i Kushtetutës; qartësimin e legjitimitetit të subjekteve të kushtëzuara e të pakushtëzuara që iniciojnë çështje për një gjykim kushtetues, për trajtimin tonë, në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit; parashikimin e afateve më të arsyeshme për disa nga procedurat që parashikohen në ligjin organik të GJ K-së për të garantuar sigurinë juridike të shtetasve dhe pajtueshmërinë e këtyre afateve me praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit; mbrojtjen dhe garantimin efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të individit duke parashikuar procedurat që mungojnë në ligjin për Gjykatën Kushtetuese, për aksesin e individit në GJ K, me anë të ankimit individual kushtetues, po konform standarteve të GJEDNJ.

Pikë së pari synohet rritja e efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në funksion të ankimit individual duke qenë se e drejta e individit për të nisur një gjykim kushtetues për shfuqizimin e një norme ligjore nuk është e sanksionuar. Individët nuk mund të vënë në lëvizje GJ K për çështje që nuk lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe kjo pengesë kushtetuese nuk garanton efektivitetin e GJK. Nuk ka asnjë parashikim ligjor për kompetencën më të rëndësishme të GJ K dhe që zë vëllimin më të madh të punës së saj:

shqyrtimin e kërkesave individuale për një proces të rregullt ligjor (ankimi individual kushtetues). Qenien e Gjykatës Kushtetuese si një mjet joefektiv e ka konstatuar edhe praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Këto probleme të evidentuara e kanë ballafaquar veprimtarinë e kësaj Gjykate me standardin e një mjeti efektiv që kërkon neni 13 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Propozohet të zgjerohet juridiksioni i GJ K në funksion të mbrojtjes më efikase së të drejtave të individit si dhe theksohet fakti se aktualisht ankimi individual në GJ K nuk është mjet efektiv në kuptim të Kushtetutës, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës përkatëse të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Është mbështetur idea për të riformuluar nenin 131/f të Kushtetutës me qëllim bërjen e GJ K një mjet efektiv dhe mbrojtëse të të gjithë të drejtave kushtetuese të individit për të qenë tërësisht në përputhje me rolin e saj.

Një ndryshim i tillë do të ishte edhe në përputhje të plotë me atë çka thuhet në Përmbledhjen e Mendimeve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias mbi Drejtësinë Kushtetuese. Komisioni i Venecias ka nënvizuar rëndësinë e zgjerimit të ankimit kushtetues individual, i cili duhet të riformulohet me qëllim një mbrojtje më të madhe të individit ndaj akteve të pushtetit publik, duke iu referuar modelit gjerman - *Verfassungsbeschwerde*.

Ndryshime kushtetuese parashikohen edhe në rrethin e subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Rrethi i subjekteve që mund të fillojë një gjykim kushtetues, nuk kufizohet vetëm në nenin 134 të Kushtetutës, duke qenë kjo një dispozitë jo shteruese.

Në lidhje me subjektet që kanë legjitimitet të “ kushtëzuar ”, nënvizohet fakti se duke pasur parasysh rolin dhe funksionin e rëndësishëm që ka Avokati i Popullit në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve, është parë problematik parashikimi i tij si subjekt i kushtëzuar për t’iu drejtuar GJ K.

Një tjetër nënvizim i rëndësishëm, është ai referuar faktit se në kushtet kur kontrolli incidental i ligjeve bëhet vetëm me iniciativë të gjykatës, kjo i kufizon palët t’i drejtohen GJ K kur gjatë gjykimit identifikojnë një cenim të të drejtave të tyre nga një ligj që mund të jetë antikushtetues. Një mundësi e palëve për të kërkuar kontroll incidental, do të ishte një garanci më tepër për aksesin e tyre në Gjykatën Kushtetuese, sidomos në rastet kur gjykatat janë pasive në këtë drejtim. Nisur dhe nga ajo që kemi parashtruar dhe analizuar tashmë, një parashikim i tillë do të ishte mëse i rëndësishëm dhe do të shkonte jo vetëm në favor të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit, por do të ishte një garanci më shumë edhe në drejtim të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit në fjalë.

Gjithashtu, sugjerohen afate më të arsyeshme në paraqitjen e kërkesës për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit. Afati 3-vjeçar për kontrollin e ligjeve është i gjatë dhe cenon parimin e sigurisë juridike, parim ky mjaft i rëndësishëm dhe i evokuar shpesh herë në jurisprudencën e GJEDNJ. Ligji brenda 3 vjetve mund të sjellë pasoja juridike të pakthyeshme.

Në lidhje me fuqinë juridike të vendimeve të GJ K, ka një mospërputhje ndërmjet Kushtetutës dhe ligjit organik, pasi Kushtetuta njih botimin në Fletoren Zyrtare dhe afatin që vendos vetë Gjykata si dy mënyra të hyrjes në fuqi të vendimit ndërkohë që nga ana

tjetër ligji organik në nenin 26 të tij parashikon si rregull të përgjithshëm hyrjen në fuqi të vendimit me botimin e tij në Fletoren zyrtare, fuqinë e menjëhershme të vendimit pas shpalljes vetëm në rastet kur vendos GJ K dhe bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të individit, si dhe fuqinë prapavepruese në rastet e parashikuara në nenet 76 e 79. Neni 76/2 i ligjit organik përcakton efektin prapaveprues të një vendimi të GJ K që ka shfuqizuar një ligj si antikushtetues në tri situatat e sipërpërmendura, pra a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit; b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë si dhe c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit të shfuqizuar. Ky nen ka shumë paqartësi në zbatimin e tij në praktikë, sidomos lidhur me shkronjat “a” dhe “c” të tij. Gjithashtu edhe për rastet e parashikuara në pikën “b” është problematik mosqartësimi i konceptit “vendim i formës së prerë” sipas standardeve të GJEDNJ-së. Ligji nuk parashikon në lidhje me qartësimin e efekteve konkrete të vendimit të GJ K në dispozitiv me qëllim rritjen e efektivitetit të GJ K si dhe qartësisë së vendimit për palët dhe organet që do ta zbatojnë atë.

Rekomandime:

* Duke u nisur nga rëndësia që paraqet aksesin i drejtpërdrejtë i individit para Gjykatës Kushtetuese si dhe për të qenë konform standarteve të GJEDNJ, do të rekomandonim se një parashikim i tillë në Kushtetutë, dhe si rrjedhojë edhe në ligjin organik për Gjykatën Kushtetuese, ku ankimi individual kushtetues të ishte një mundësi për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, do të përbënte përsëri një hap përpara në Drejtësinë Kushtetuese Shqiptare, një hap të cilin ligji “ Për dispozitat kryesore kushtetuese ” e kishte bërë që në vitin 1992.

* Rekomandojmë, që të shihet si mundësi juridike aplikimi i një kontrolli dualist *a priori* si dhe *a posteriori*, për ligjet.

* Rekomandojmë gjithashtu parashikimin e afateve më të arsyeshme për paraqitjen e kërkesës për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit me qëllim garantimin e parimit të sigurisë juridike.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

- Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Qershor 2015
- Albi, A., (2005). EU Enlargement and the Constitutions of Central and Eastern Europe
- Alexander, L., (2001). Constitutionalism. Philosophical foundations. Cambridge University Press.
- Anastaplo, G., (2006). Reflections on constitutional law. The University Press of Kentucky
- Aquarone, A., D'addio, M. & Negri, G., (1959). Le costituzioni italiane
- Arjomand, A.S., (2008). Constitutional Politics in the Middle East. Oxford and Portland Oregon. Hart Publishing.
- Arjomand, SA., (2003). 'Law, Political Reconstruction and Constitutional Politics' 18 International Sociology (March)
- Barbera, A., (1997). Le basi filosofiche del costituzionalismo. Roma-Bari, Laterza
- Beale, A., (1997). "Essential Constitutional Law", Second Edition, Cavendish Publishing Limited, London - Sydney, f.55
- Beguin, J.C., (1982). Le controle de la constitutionnalite des lois en RFA, Paris, Economica
- Berberi, B., (2014). Kufijtë kushtetues strukturorë të pushtetit ligjvënës dhe kontrolli kushtetues, fq.50
- Bogdandvy, A., & Bast, J., (2006). Principles of European Constitutional law. Oxford and Portland Oregon. Hart Publishing
- Bon, F., Moderne, F. & Rodrigues, Y. (1984), La justice constitutionnelle en Espagne, Economica et Presses Universitaires d'Aix, Marseille
- Brown, NJ., (2002). Constitutions in a Non-Constitutional World. Albany, State University of New York
- Cappelletti, M., & Cohen, W. (1979). Comparative constitutional law. Indianapolis.
- Cappelletti, M., (1972). Il controllo giudiziario di costituzionalità delle leggi nel diritto comparato, Milano: Giuffrè
- Cappelletti, M., (1990). Le pouvoir des judges. Paris: Economica.
- Cheli, E., (1996). *Il giudice delle leggi*, il Mulino, Bologna
- Czarnota A., (1999). *The Rule of Law after Communism: Problems and Prospects in East-Central Europe* (Brookfield, VT, Ashgate, 1999)
- Davis, M., The law politics distinction, the French Conseil constitutionnel and the U.S. Supreme Court, in "The American journal of comparative law", 1986, XXXIV, pp. 45-92.
- De Tocqueville, A., (1995). "De la démocratie en Amerique", Flammarion: Paris
- De Vergottini, G., (2004). Diritto costituzionale comparato, Sesta Edizione, Volume I, Cedam, Padova
- Degenhart C., (1998). Staatsrecht I, Botuar nga CF Muller Verlag, Gjermani
- Duhamel, O., (2004). E Drejta kushtetuese: demokracitë. Botimet Logos-A.
- Emmert, C., (1988), Judicial review in state supreme courts: Opportunity and activism, Material i paraqitur në Mbledhjen Vjetore të Midwest Political Science Association, Chicago

Fabbrini, F., (2009). La riforma del controllo di costituzionalità in Francia: tra innovazione e conservazione. Astrid Rasegna

Favoreu L., (1986). Les cours constitutionnelles, PUF, Paris

Favoreu, L., (1992). Controllo di costituzionalità delle leggi. Enciclopedia delle Scienze Sociali.

Fromont, M., (2002). La justice constitutionnelle en Europe ou l'exception française. Mélanges Conac, Paris: Economica

Fromont, M., (2005). "Grands systèmes de droit étrangers, Dalloz

Fondacioni Moisiu, Realiteti i sotëm shqiptar dhe sfidat e ardhshme kushtetuese ligjore, Përmbledhje kumtesash, Botimet Toena, Tiranë 2012

Gate, J.B. & Johnson, C.A., (1997), Gjykatat Amerikane. Analizë Kritike, Tiranë: ARBRI

Gestel, van R., Micklitz, Hans-W., & Maduro, M. P., (2013). Methodology in the new legal world, European University Institute, Florence Department of Law

Ginsburg, J., (2003). Judicial Review in New Democracies: Constitutional Courts in Asian Cases (Cambridge, Cambridge University Press, 2003).

Glendon, M.A., (1991) Rights talk: The impoverishment of political discourse. New York: Free Press

Grewe, C., & Fabri, H.R. (1995). Droits Constitutionnels européens.

Grimm, D., (2002). Die Zukunft der Verfassung (Suhrkamp, Frankfurt, 2002, third edition). 33.

Grimm, D., Deutsche Verfassungsgeschichte (Suhrkamp, Frankfurt, 1995, third edition) pp. 10 et seq.

Groppi, T., (1997), Il ricorso di amparo costituzionale in Spagna: caratteri, problemi e prospettive, GC

Hamilton, W. H., (1930). Constitutionalism: Encyclopedia of Social Sciences, 4, 255

Heringa, A. W., & Kiiver, P., (2012). Constitutions Compared. Introduction to the Comparative Constitutional Law, Volume 104

Hoart, N., (2013). Beginning constitutional Law

Kay, R.S., (1998). American Constitutionalism in: constitutionalism: philosophical foundations

Kelzen, H., La giustizia costituzionale, a cura di C. Geraci, Giuffrè, Milano

Kogacioglu, D., (2004). 'Progress, Unity, and Democracy: Dissolving Political Parties in Turkey'

Longobardi, N., (2004). Il principio del «giusto procedimento» come limite al legislatore. Intervento al convegno annuale del gruppo di San Giustino, Napoli.

Martines, T., (2005). Diritto Costituzionale, Giuffrè Ed

Martines, T., (2011). E drejta kushtetuese, Kapitulli VI — Gjykata Kushtetuese, UET Press

Material shpjegues për ndryshimet kushtetuese, shtator 2015

Maus, D., (2006). Nouveaux regards sur le contrôle de constitutionnalité per voie d'exception, Mélanges Troper, Paris: Economica

Meny, Y., (2008). Révolution constitutionnelle et démocratie. Chance et risques d'une nouvelle définition de la démocratie, Colloque du Cinquantenaire du Conseil Constitutionnel, Paris

Nergelius, L., (2008). Constitutionalism. New challenges. Martinus Publisher. Leiden/Boston

Nino, C.S., (1996). Introduzione all'analisi del diritto. Torino: G. Giappichelli Editore. fq. 24

Omari, L., & Anastasi, A., (2010) Edrejta kushtetuese. Tiranë, ABC

Omari, L., (2002). Parime dhe institucione të së drejtës publike. Tiranë: Elena Gjika

Omari, L., (2004). Shteti i së drejtës. Tiranë

Opinion i Komisionit të Venecias CDL-AD(2006)006

Opinion i Komisionit të Venecias CDL-AD(2009)024

Opinion i Komisionit të Venecias CDL(2011)065

Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë”, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010.

Përmbledhje e Mendimeve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias mbi Drejtësinë Kushtetuese, 2015

Pizzorusso, A., (2011), La giustizia costituzionale italiana fra modello “diffuso” e modello “concreto”, Cedam

Raporti “ Drejt Drejtësisë së OSBE-së ”, (2010-2011)

Raporti analitik i Komisionit Evropian për Shqipërinë, dt. 09.11.2010, f. 10

Rossenfeld, M., & Sajo, A., (2012). The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law, Oxford University Press

Russell, PH., (2001). ‘Toward a General Theory of Judicial Independence’ in PH Russell and DMO’Brien (eds), Judicial Independence in the Age of Democracy (Charlottesville, University Press of Virginia, 2001)

Sadushi, S., (2004). Kontrolli kushtetues. Tiranë: BOTIMPEX

Sadushi, S., (2012). Drejtësia Kushtetuese në Zhvillim: Trajtime Teorike dhe të Praktikës së Gjykimit Kushtetues. Tiranë: Botimet Toena

Schmitt, C., (1981). *Il custode della Costituzione*, Giuffrè, Milano

Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, korrik 2015

Sweet, A. S., (2012). Constitutional Courts. The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law, OPU

Sweet, A. S., (1992). *The Birth of Judicial Politics in France* (Oxford, Oxford University Press, 1992)

Sweet, A. S., (2000). *Governing with Judges* (New York, Oxford University Press, 2000)

Toska E., Ndarja dhe balancimi i pushteteve, Revista juridike 'E drejta parlamentare dhe politikat ligjore', nr.1/2009

Traja, K., (2000). Drejtësia Kushtetuese

Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane”, Botimi Jubilar, Konrad Adenauer Stiftung, 2010

Vështrim mbi sistemin amerikan të qeverisjes (2001), Zyra e Programeve Ndërkombëtare të Informacionit, Embassy of the United States of America

Zaganjori, Xh., & Vorpsi, A., Biba, D., (2012), Parime kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Tiranë: Adelprint

Zaganjori, Xh., Anastasi, A. & Methasni (Çani) E., (2011). Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH, Tiranë

Zagrebelsky, G., (1988). La giustizia costituzionale, il Mulino, Bologna

Burime Parësore

Legjislacion

Kushtetuta e Austrisë
Kushtetuta e Finlandës
Kushtetuta e Francës
Kushtetuta e Hungarisë
Kushtetuta e Irlandës
Kushtetuta e Italisë
Kushtetuta e Kosovës
Kushtetuta e Portugalisë
Kushtetuta e Qipros
Kushtetuta e Rumanisë
Kushtetuta e Rusisë
Kushtetuta e SHBA-së
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
Kushtetuta e Turqisë
Ligji Themelor i Republikës Federale Gjermane
Ligji kushtetues italian nr. 1/1999
Ligji kushtetues italian nr. 3/2001
Ligji organik francez, n° 58-1067, dt.7.11.1958 për Këshillin Kushtetues francez
Ligji portugez për Rishikimin Kushtetues nr.1/82, dt.30.09.1982
Ligji francez për Rishikimin Kushtetues n° 2008-7243, dt. 21.07. 2008
Ligji nr.7561, datë 29.4.1992, “ Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, dt. 29.4.1991, “ Për dispozitat kryesore kushtetuese ”
Ligji nr. 8577, dt. 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 8, dt. 18.09.1992, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 2, dt. 08.02.1993, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 10, dt. 30.11.1994, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 3, dt. 23.02.1995, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 4, dt. 02.06.1995, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 1, dt. 31.01.1996, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 34, dt. 24.09.1996, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 4, dt. 27.02.1997, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 13, dt. 29.05.1997, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 53, dt. 13.11.1997, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 55, dt. 21.11.1997, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 57, dt. 05.12.1997, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 65, dt. 10.12.1999, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 8, dt. 03.03.2000, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 15, dt. 07.04.2000, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 49, dt. 31.07.2000, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 26, dt. 24.04.2001, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 27, dt. 27.04.2001, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 33, dt. 09.05.2001, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 43, dt. 18.05.2001, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 178, dt. 22.07.2001, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 206, dt. 24.12.2001, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 28, dt. 21.02.2002, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 75, dt. 19.04.2002, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 76, dt. 25.04.2002, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 186, dt. 23.09.2002, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 31, dt. 23.10.2003, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 2, dt. 03.02.2004, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Mendim pakice në Vendimin nr. 2, dt. 03.02.2004, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 3, dt. 11.02.2004, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 1, dt. 07.01.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 2, dt. 19.01.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Mendim pakice në Vendimin nr. 2, dt. 19.01.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 3, dt. 19.01.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 26, dt. 02.11.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 34, dt. 20.10.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 3, dt. 20.02.2006, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 20, dt. 11.07.2006, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 9, dt. 26.02.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 11, dt. 04.04.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 19, dt. 03.05.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 20, dt. 04.05.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 23, dt. 08.06.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 26, dt. 13.06.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 35, dt. 10.10.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 36, dt. 15.10.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 40, dt. 16.11.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 41, dt. 16.11.2007, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 9, dt. 19.03.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 16, dt. 25.07.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 17, dt. 25.07.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Mendim pakice në Vendimin nr. 17, dt. 25.07.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 18, dt. 29.07.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 20, dt. 29.09.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 24, dt. 12.11.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 25, dt. 05.12.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 5, dt. 06.03.2009, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 12, dt. 24.08.2009, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 13, dt. 04.05.2009, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 20, dt. 09.07.2009, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 29, dt. 21.10.2009, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 31, dt. 02.12.2009, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 4, dt. 12.02.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 7, dt. 12.03.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 9, dt. 23.03.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 11, dt. 06.04.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 12, dt. 14.04.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 15, dt. 15.04.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 23, dt. 17.05.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 27, dt. 26.05.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 29, dt. 31.05.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 30, dt. 17.06.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 32, dt. 21.06.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 33, dt. 24.06.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 4, dt. 23.02.2011, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Mendim pakice në Vendimin nr. 4, dt. 23.02.2011, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 20, dt. 01.06.2011, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 43, dt. 06.10.2011, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 25, dt. 08.05.2012, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Mendim pakice (1) në Vendimin nr.25,dt.08.05.2012, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Mendim pakice (3) në Vendimin nr.25,dt.08.05.2012, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Mendim paralel në Vendimin nr.25, dt. 08.05.2012, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 7, dt. 27.02.2013, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 10, dt. 18.03.2013, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 14, dt. 17.04.2013, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 10, dt. 06.03.2014, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 11, dt. 06.03.2014, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 20, dt. 04.04.2014, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 21, dt. 07.04.2014, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 39, dt. 30.06.2014, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 5, dt. 05.02.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 7, dt. 16.02.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 10, dt. 26.02.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 11, dt. 13.03.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 16, dt. 10.04.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 19, dt. 15.04.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 20, dt. 15.04.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 22, dt. 24.04.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 23, dt. 24.04.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 30, dt. 25.05.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 43, dt. 26.06.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 46, dt. 29.06.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 55, dt. 21.07.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
Vendimi nr. 64, dt. 23.09.2015, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendime të Gjykatave të tjera

88/1966 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

88/1977 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

40/1979 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

84/1979 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

49 /1983Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

73/1983 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

223/1983Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

266/1988 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

501/1988 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

1/1991 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

124/1991 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

390/1991 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

477/ 1991 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

254/1992 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

343/1992 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

368/1992 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

350/1997 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

269/1999 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

316/2000 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

304/2002 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

198/2003 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

104/2011 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

6/2014 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

81/2014 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane

BverfGE 1/184 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

BverfGE 49/89 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

BVerfGe 39/1 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

BVerfGe 14/61 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

BVerfGe 88/203 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane
BVerfGe 19/377 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane
BVerfGe 54/536 Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane
Martin v. Hunter's Lessee, 14 U.S. 304 (1816) Vendim i Gjykatës së Lartë të SHBA
Santa Clara County v. Southern Pacific Railroad Company, 118 U.S. 394 (1886)
Bush v. Gore, 531 U.S. 98 (2000) Vendim i Gjykatës së Lartë të SHBA

Vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Bumarescu kundër Rumanisë, dt. 28.10.1999

Dhoma Kombëtare e Noterisë kundër Shqipërisë, dt. 06.05.2008

Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë, dt. 31.03.2005

Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, dt. 23.06.1981

Macovei dhe të tjerë kundër Moldavisë, dt. 15.11.2011

Marini kundër Shqipërisë, dt. 18.12.2007

O.V.R. kundër Rusisë, dt. 03.04.2001

Popov e të tjerët, Vakarelova, Markov e Bankov kundër Bullgarisë, dt. 06.11.2003

Pular kundër Britanisë së Madhe, dt. 10.06.1996

Qufaj kundër Shqipërisë, dt. 22.08.2006

Rosca kundër Moldavisë, dt. 22.03.2005

Ruiz-Mateos kundër Spanjës, dt. 23.06.1993

Marini kundër Shqipërisë, dt. 18.12.2007

Ryabykfi kundër Rusisë, dt. 24.07.2003

Shkalla kundër Shqipërisë, dt. 10.08.2011

Stafford kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt. 28.05.2002

Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt. 25.04.1978

Faqe zyrtare web

<http://www.gjk.gov.al>

<http://www.governo.it/Governo/Costituzione/>

[http://www.parlament.al/web/Kushtetuta e Republikes se Shqiperise e perditesuar 1150_1.php](http://www.parlament.al/web/Kushtetuta_e_Republikes_se_Shqiperise_e_perditesuar_1150_1.php)

www.qbz.gov.al

www.gjykata.gov.al

www.reformanëdrejtësi.al

<http://echr.ketse.com>

